~~~~~~

REVISTA 'LIRIA' ZËDHËNËSE E REZISTENCËS KOMBËTARE

~~~~~~

Prof.dr.Sabile Keçmezi-Basha

~~~~~~

1. ROLI I REVISTËS "LIRIA" SI ZËDHËNËSE E KOHËS SË VET (NR.1)

Grupi Revolucionar, i formuar në fillim të viteve '70, pavarësisht arrestimeve të veprimtarëve të tij (1974-1975), ka vazhduar veprimtarinë dhe zgjerimin e radhëve. Kjo organizatë, për t'iu shmangur ndjekjeve policore, disa herë ka ndërruar emrin e vet dhe të organit të shtypit. Më 1975-76 Grupi Revolucionar do të quhet Grupi Marksist-Leninist i Kosovës, kurse nga fundi i dekadës, Organizata Marksiste-Leninste e Kosovës. Organi i shtypit të kësaj organizate që pa ndërprerë veproi për plotë 12 vjet, nga "Zëri i Kosovës" siç u quajt më 1974, mori emrin "Pararoja" më 1975-76 dhe "Liria" më 1980.

Pas shndërrimit të "Grupit Marksist-Leninist të Kosovës" në "Organizatën Marksiste-Leniniste të Kosovës", veprimtaria botuese e kësaj organizate intensifikohet dukshëm. Pos një përmbledhjes me poezi, detyrë e përhershme me përparësi më të madhe ishte shtypja dhe shpërndarja e afisheve. Pos afishes me emrin "Trakt", që u shpërnda me rastin e 100- vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, kjo organizatë përgatiti dhe afishen tjetër, po ashtu me emrin "Trakt", që u shpërnda me rastin e ardhjes për vizitë në Kosovë të kryetarit të Jugosllavisë, më 1979.
~~~~~~



Bollina e numrit te pare te Zerit te Kosoves

Edhe me rastin e regjistrimit të popullsisë, anëtarët e "OMLK"-së reaguan nëpërmjet një afisheje tjetër, që kryesisht u shpërnda në Shkup, Tetovë e Gostivar. Në kuadër të organizatës vendoset që të nxirret revista "Liria", si organ informativ i organizatës. Në tetor të vitit 1980, përgatitet numri i parë, i cili dërgohet në Zvicër dhe me angazhimin e patriotit Kadri Zeka, arrin që të dalë "Liria". Numri 2 (dy) i saj del në dhjetor të po atij viti. Pas demonstratave të vitit 1981, anëtarët e kësaj organizate shtuan aktivitetin për hartimin e sa më shumë teksteve, poezive dhe afisheve që të shpërndajnë në popull. Të gjitha ato i botonin në revistën "Liria" dhe në forma tjera të publikimit.

Gjatë hulumtimeve që bëra për monografinë shkencore "Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989", në arkivat e gjykatave të qarqeve në Kosovë, në dosjet e shumta që hetuesit iu kishin marrë të arrestuarve politikë. Në mesin e shumë materialeve që gjeta, kureshtjen time prej hulumtuesi ma shtoi shtypi ilegal që botoi kjo organizatë. Dhe tani do i prezantoi lexuesit shtatë numrat e revistës "Liria", që i gjeta në dosjen e Hydajet Hysenit, në Gjykatën e Qarkut-në Prishtinë.

Si zakonisht shtypi i ilegales në fillimet e saja botohej në fleta A- 4, pasi se për një teknikë më të përsosur nuk kishte kushte e as mundësit elementare për të. Pra, në këtë format u botua edhe organi informativ i organizatës së OMLK-së. Por përsëri do iu referohesha atdhetarit të shquar të Kosovës, Mehmet Hajrizit i cili njëkohësisht ishte edhe kryeredaktor i gazetës "Liria" si dhe i organit kryesor të "Grupit Revolucionar" "Zëri i

Kosovës", ai shkruan se: "Liri" ishte organ i OMLK dhe filloi të botohej më 1980. "Liria" përgatitej dhe redaktohej në Kosovë, por nën përkujdesjen e Kadri Zekës botohej jashtë, me teknikë moderne dhe shpërndahej në Kosovë e në mërgatë. Pa Kadri Zekën "Liria" nuk do të mund të botohej në atë formë dhe në atë tirazh, por roli i tij në këtë ndërmarrje serioze dhe të vështirë, ka qenë i një rëndësie të veçantë edhe në përmbajtjen e saj.[1] Gazeta "Liria" të cilës në ballinë i paraprinte flamuri kombëtar me yllin pesëcepësh, dhe sentenca "Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni". Po ashtu në ballinë vazhdohet me tekstin në formë parathënieje që e kanë pagëzuar "LIRIA", dhe më tutje jepet arsyetimi se pse filloi të dal revista, arsyet e saja dhe si do të botohej në të ardhmen, çfarë misioni do të ketë dhe çfarë mesazhi do ti përcjellë popullit të saj nëpër vite. Këtë tekst, e ka shkruar Mehmet Hajrizi. Në tekstin e parathënies autori prezanton një punim më të thukët për konceptin dhe rendësin e lirisë në kushte okupimi.

Thuhej në tekst se "Liri! Liri thirri në shekuj populli shqiptar për Atdheun e tij të dashur. Gjaku lum u derdh për lirinë e shtrenjtë në tokën e shqipes. Liri thërret sot Kosova e robëruar, Kosova e shumëvuajtur e martire, Kosova trime. Bijtë e Kosovës luftuan në shekuj për liri, kundër armiqve të shumtë e të egër që lakmonin fushat tona të gjëra, malet tona të bukura, pasurit e shumta që ka në vete toka jonë e dashur. Me këto lakmi të çmendura kralët e Serbisë e të Malit të Zi, me ndihmën e imperializmit evropian, me gjithë luftën heroike të popullit shqiptar, arritën të shkëpusin nga trungu i Shqipërisë gati gjysmën e saj dhe ta fusin nën robërinë e tyre të egër."[2] Pasi autori jep të dhëna të bollshme për popullin shqiptar të Kosovës, e cila me tradhti të krerëve të Beogradit ngeli nën Serbi, megjithatë ai (populli) asnjëherë nuk u pajtua me te, edhe pse okupuesi përdorte pa ndërprerë mënyra dhe metoda të ndryshme për ta mbajtur sa më gjatë nën tutelën e saj. Ai (okupuesi), siç është e ditur gjatë historisë për të arritur qëllimet e veta, herë përdori politikë e herë më tepër dhunë e terror, por asnjëherë nuk pati sukses që të bindë një popull të tërë që të pajtohet me fatin e robërisë.

[1] Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate...vep. e cit., f. 123.
[2] " Liria", revista " Liria", nr. 1. 1980.

Zürich, 1980: Kadri Zeka dhe Hydajet Hyseni.

Më vonë shton autori "Prandaj, populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi ka luftuar vazhdimisht dhe lufton pa pushuar, në forma të ndryshme, kundër pushtuesve të sotëm revizionistë, për çlirim kombëtar e shoqëror. Kjo luftë do të rritet gjithnjë e më shumë, do të zgjerohet e thellohet çdo ditë, do të marrë zjarr, do ti djegë në flakën e saj armiqtë dhe tradhtarët dhe do t'i sjell fitoren e sigurt popullit tonë, lirinë e ëndërruar në shekuj. Kosovën pa pushtues, pa shtypës e shfrytëzues, të lirë e të bashkuar me atdheun socialist do ta bëjë vetëm gjaku i pastër i bijve më të mirë të saj."[3] Qëllimi i gazetës do të ishte që kjo me shkrimet e veta që do të botojë "do ta ndihmojë këtë luftë të popullit tonë për të drejta e liri". Autori i shkrimit "Liria", për konceptin e gazetës shtonte:

"Liria", në gjithë punën e saj do të frymëzohet nga aspiratat e larta të popullit dhe do të orientohet nga një vijë e drejt politike e ideologjike…

"Liria" do të jetë një tribunë e vërtet e popullit që ka për qëllim të ndihmojë bashkimin e gjithë popullit në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve.

"Liria", do të luftojë pa mëshirë kundër armiqve të popullit tonë dhe do të demaskojë propagandën e poshtër demagogjike e mashtruese të tij.

"Liria" do t'i tregojë popullit çartë cilët janë armiqtë e vërtetë të tij, kush i rrëmbeu lirinë, kush e vrau dhe e mashtro, kush e dëboi nga vatrat e veta, kush e varfëroi dhe e qoi në këtë gjendje të mjeruar, kush i përplas nëpër burgjet e errëta jugosllave bijtë e tij, kush e shtyp dhe e shfrytëzon kaq egërsisht dhe do t'i tregojë cila është rruga e shpëtimit nga robëria e tmerrshme.

"Liria" do t'i mbrojë me guxim interesat e popullit tonë të robëruar para çdo armiku.

"Liria" jonë do të jetë gjithë jetën tribunë e së vërtetës, e drejtësisë dhe zëri i lirisë së vërtet të popullit tonë.

"Liria" do të punojë e luftojë me vullnet të hekurt për edukimin dhe kalitjen e popullit me një patriotizëm të flakët e revolucionar.

"Liria" do të ngre lart me krenari traditat e shkëlqyera luftarake të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë, përpjekjet e luftërat e tij për liri e bashkim kombëtar.

"Liria" do të pasqyrojë urrejtjen e madhe që ka mbushur gjokset shqiptare kundër regjimit shtypës e shfrytëzues, luftën e popullit që bëhet në forma të ndryshme kundër këtij regjimi, do t'i sqarojë masat mbi gjendjen brenda dhe jashtë vendit si dhe do t'i orientojë ato në situata të ndryshme.

"Liria" do të përkrahë luftën çlirimtare në Jugosllavi e kudo në botë dhe është kundër politikës antipopullore e gjakatare[4]…"

Dhe nëpër mes këtyre rreshtave autori paraqet misionin e kësaj gazete.

Është për t'u habitur se në revistën "Liria", shkrimet që botohen nuk kanë më as pseudonime të autorëve, as nismëtare, as emra të vërtet, vetëm se aty-këtu me laps të thjesht janë të shkruar me dorë, (kuptohet nga punëtoret e hetuesisë, që gjatë procedurës hetimore kanë arritur të deshifrojnë emrat e autorëve). Herë-herë në tekstet e gazetës

[3] Po aty.
[4] Po aty.

ndodh të jetë nënvizuar e shkruar "ovo je jako vazhno" (kjo është shumë me rëndësi), dhe ndodhte shpesh që gjatë hetuesisë zbuloheshin edhe autorët e vërtet të shkrimeve, dhe përsëri ndodhte që emri i autorit të shkruhet me laps.

Në shkrimin "Asnjë masë e revizionistëve nuk mund ta mposht popullin tonë heroik", autori Hydajet Hyseni në pika të shkurtra na jep të dhëna se si pushteti jugosllav në mënyra të ndryshme mundohet të bëjë propagandë për jetën e "rehatshme" dhe "pa brenga" bëjnë shqiptaret në Jugosllavi, dhe se çfarë të drejtash gëzojnë ata. Autori në mënyrë historike bënë elaborimin e problemeve që e mundonin shqiptarin dhe se mbi të gjitha i mungonte liria dhe vazhdimisht për atë angazhohet dhe lufton me të gjitha mjetet duke sakrifikuar çdo gjë që ishte e mundshme vetëm e vetëm për të arritur atë -LIRINE e merituar.

Menjëherë pas luftës së Dytë Botërore, klika gjakatare e Tito-Rankoviçit ndërmorën masa të papara për ta shfarosur, dëbuar e shkombëtarizuar popullin shqiptarë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe për të realizuar në këtë mënyrë ëndrrat e çmendura të shovinistëve siç ishin Vasa Qubrilloviqi, Ivo Andriqi e shumë të tjerë. Zhdukja mizore e dhjetëra e mija shqiptarëve gjatë dhe pas luftës, dëbimi me dhunë për në Turqi e vende të tjera nëpër botë, rrahja e poshtërimi i pothuajse të gjithë burrave kosovarë gjatë aksionit famëkeq të armëve, plaçkitja e pamëshirshme e pasurive tona natyrore, grabitja e dhunshme e tokës dhe e bereqetit janë vetëm disa nga masat që xhelatët titistë ushtruan mbi kurrizin e popullit. Por megjithëkëtë masa të përbindshme ata nuk ia kishin arritur dot qëllimit të tyre.

Megjithatë, populli ynë trim e patriot nuk u shfarosë, nuk e lëshoi tokën e tij të dashur, nuk e harroi gjuhën e tij të ëmbël, zakonet e traditat e lashta shqiptare. Ai nuk u frikësua e nënshtrua para dhunës e terrorit fashist e gjenocidalë të okupatorit, por, përkundrazi, urrejtja dhe pezmi i tij u shtuan dhe u grumbulluan edhe më shumë.

Pas vitit 1966, Tito me bashkëpunëtorët e vet filluan një fushat të madhe propaganduese se të gjitha padrejtësisë që kanë ndodhur para këtij viti, ndaj shqiptarëve thuhej se ishin bërë pa dijeninë e Titos, dhe se tani e tutje u premtohej se shqiptarëve do ti sigurohej liria e barazia e vërtet dhe të drejtat e plota etj…etj…Të gjitha fajet për ato që ishin bërë ndaj shqiptarëve iu ngarkuan njërit nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Titos, xhelatit Rankoviq, të cilin klika e Titos e rrëzoi për hesape të veta dhe aspak për krimet ndaj popullit shqiptar që kishin kryer së bashku me të sa e sa vite më parë.

Autori thotë se "kishte nga ata që u gënjyen nga kjo demagogji dhe menduan se duke ndërruar qimen, ujku po e harronte edhe zakonin. Por, populli ynë, që në shekuj është mësuar me manovra të ndryshme të armiqve të tij, nuk u mashtrua nga reformat dhe propaganda e revizionistëve. Ai e kuptoi se ishin të njëjtat qëllime të të njëjtit armik, se ato që po ndryshonin ishin vetëm format e mjetet e shtypjes e shfrytëzimit. Masat e reja të revizionistëve jo vetëm që nuk e gënjyen popullin tonë, por përkundrazi, bënë edhe më shumë që të shtohet urrejtja ndaj shtypësve e shfrytëzuesve dhe lufta e tij për të drejta e liri."[5] .

[5] "Asnjë masë e revizionistëve nuk mund ta mposhtë popullin tone heroik", revista "Liria", nr, 1. f. 2.

"Viteve të fundit", thuhej në tekst "kur kjo luftë, si rezultat i shtimit të pakënaqësisë e urrejtjes së masave dhe ngritjes së ndërgjegjes së tyre kombëtare e klasore, po bëhej gjithnjë e më e vendosur, më e organizuar dhe po merrte përmasa gjithnjë e më shqetësuese për regjimin, pushtetarët kishin hequr maskat dhe ishin hedhur mbi popullin tonë me të gjitha mjetet dhe forcat e tyre. Periudhën pas Rankoviçit[6], gjatë së cilës populli ynë fitoi i thënçin disa të drejta , ndërsa pushtetarët e quanin si periudha e liberalizmit, duke arsyetuar kështu hapur vënien përsëri në plan të parë të politikës së tyre të dhunës. Si rezultat i kësaj vije se numri i policëve, agjentëve e spiunëve po shtohej pa ndërprerë dita më ditë. Bastisjet dhe arrestimet ishin bërë të zakonshme dhe shtohej nga viti në vit. Populli ynë po shihte se po ringjallen përsëri veprimet gjakatare të kohës së Rankoviçit" .[7] Vë në pah autori i revistës ilegale.

Edhe pse në shikim të parë duke u bazuar në fjalët e pushtetarëve, fitohej përshtypja se tani në Kosovë frymohej më lehtë, megjithatë, u gabuan , ngase jugosllavet asnjëherë nuk hoqën dorë nga politika e shkombëtarizimit të viseve të pushtuara shqiptare dhe sllavizmit të tyre. Këtë politikë destruktive ata me konsekuencë e njekën edhe më vonë me mjete e forma të ndryshme. Më tepër se 130 mijë shqiptar kishin lënë shtëpitë e tyre dhe për të siguruar kafshatën e tyre, ikën nëpër vendet e ndryshme të Jugosllavisë dhe jashtë saj. Sa familje shqiptare nga Kosova, Maqedonia e Mali i Zi, braktisin përgjithmonë vatrat e tyre dhe vendosen nëpër republikat jugosllave apo vende të ndryshme të botës.

Nga ana tjetër, tokat shqiptare popullohen vazhdimisht me popullsinë sllave. Në mënyrë të veçantë shovinistët maqedonas po përpiqeshin me çdo kusht të grumbullonin gjithë diasporën maqedonase dhe ta vendosnin nëpër viset shqiptare. Në këtë mënyrë jugosllavet po synonin të ndryshonin strukturën nacionale të popullsisë së tokave shqiptare dhe ti shpallnin pastaj tokat tona si toka serbe, malazeze apo maqedonase . Aq larg shkuan ata në këto përpjekje sa që në emër të planifikimit të familjes etj, u përpoqën që më masa masive mjekësore të pengojnë edhe shtimin natyror të shqiptarëve!.[8] Dhe nga e tërë kjo që u tha më lartë, të tëra këto dëshmojnë për vazhdimësinë e e planeve të egra të Çubrillovoqit, dhe të masave shfarosëse që ndërmori Rankoviqi e xhelatët e tjerë si këta.

Gjatë vizitës së tij të fundit (1979),të Titos në Kosovë, ashtu si edhe gjatë vizitave të mëhershme , Tito, përsëri këndoi po të njëjtën këngë, dhe ata bashkëpunëtorët e UDB-es, dhe tradhtarët e popullit, ende pa u larguar ai, ata ia filluan një fushate të paparë ndjekjesh, bastisjesh e arrestimesh. Mija bijë e bija të popullit nga më të mirët u rrahën e u torturuan në mënyrë shtazarake, të denjë vetëm për udëbashët që vazhdonin rrugën e Rankoviqit. Dhjetëra bijë të popullit u nxorën para gjyqeve dhe iu shqiptuan dënime të rënda, të shumtën në mungesë të plotë të fakteve. Të gjitha proceset gjyqësore u mbajtën me dyer të mbyllura, sigurisht jo nga frika se mos populli do ti sulmonte bijtë e tij, siç

---

[6] Po aty, Më gjerësisht shih, Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Zhvillimi historik i PKJ-LKJ-së në Kosovë (1945-1966), Prishtinë, 1987.

[7] Po aty, f. 3

[8] Dr. Tefik Basha, Eksodi bashkëkohor demografik shqiptar-shkaqet dhe pasojat (Shqiptarët në rrjedhat ballkanike), Prishtinë, 1996, f. 305.

përralloste gazeta beogradase "Politika", por nga frika e madhe që kishte regjimi titist nga populli shqiptar që me vite ishte mbushur plotë pezëm e urrejtje. Ata menduan se me përdorimin e këtyre masave do ta frikësonin popullin tonë, por siç detyrohen të pranojnë edhe vetë më vonë, u gabuan keq[9]. Populli ynë jo vetëm që nuk u frikësua, por e shtoi edhe më shumë urrejtjen dhe luftën e tij kundër okupuesit, kurse bijtë e tij me qëndresën dhe luftën heroike në gjyqet dhe burgjet anë e këndë Jugosllavisë, po u futnin tmerrin armiqve e tradhtarëve, edhe duke qenë të lidhur me pranga e zinxhirë.

Me anë të këtyre masave që ndërmori pushteti jugosllavë, qëllimi ishte që ti zbulojnë patriotët e vërtet dhe atdhetaret e devotshëm që luftonin për liri dhe pavarësi të Kosovës. Me qëllim që ti diskreditonin ata, dhe ti izolojnë nga shoqëria dhe nga vetë nënat që i kishin lindur, ata ndërmorën një fushat të gjerë të shpifjeve e trillimeve. Për këtë qëllim ,ata u mundonin ti futnin me një thes me gjithfarë elementësh, ti akuzojnë ata si "nacionalist", "irredentistë", "reaksionar", "armiq të popullit" etj[10]…Dhe shtrohet pyetja athua a u mashtrua dikush nga këto fjalë boshe të pushtetarëve, mund të thuhej lirshëm se- Jo. Populli kishte kaluar më iluzionet, se diçka e mirë do ti ndodhë në këtë kreaturë të quajtur shtet. Populli ishte pjekur politikisht dhe shumë mirë i dallonte djemtë e vetë liridashës dhe okupatorin e vërtet.

Pas viteve të tetëdhjeta, pushteti jugosllav vuri në shërbim të plotë një propagandë të tërë kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Mjetet e propagandës si çdo kund ishin: shtypi, radio, televizioni dhe aty-këtu ndonjë informator e shërbëtor i ligë i pushtetit. U mundonin me të gjitha mjetet t'ia mbushnin mendjen popullit se Jugosllavia na qenka atdheu i tyre, se sistemi i saj "vetëqeverisës" na qenka "sistem i vërtet socialist", sistemi më "human" e "demokratik", sistem që iu "siguron masave liri, mirëqenie e begati", se politika e "mos angazhimit" na qenka "e vetmja politik e drejtë" etj… Të kota ishin të gjitha këto se populli njëherë e përgjithmonë e kishte kuptuar se Jugosllavia ishte atdheu i tyre aq sa ishte Turqia e sulltanëve, Jugosllavia e kralëve, apo Italia fashiste, se Jugosllavia e Titos ishte "socialiste, humane e demokratike" aq sa ishte Spanja e Karlosit apo Kili i Pinoqetit.

Në shkrimet e ndryshme në shtypin jugosllavë rëndësi të veçantë, pushteti po i kushtonte edhe propagandës së fabrikuar kundër shtetit amë- Shqipërisë[11]. Ata herë pas here deklaronin se janë "shumë të interesuar" për marrëdhënie "të mira" e "miqësore" me Shqipërinë, kurse në mbledhjet e shumta që organizonin në popull, fabrikonin kundër saj trillime e shpifje nga më të ndryshmet. Në këtë mënyrë ata mundohen, përveç tjerash edhe të armiqësojnë popullin shqiptarë që ishte i lodhur nga robëria shekullore në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi me popullin në Shqipëri.

Megjithatë edhe pse bëhen të tëra këto propaganda dhe makineri që ishin në shërbim të sistemit, populli shqiptarë përsëri vazhdonte luftën dhe do të vazhdojë[12] është optimist autori, dhe se vetëm i bashkuar do të fitojë luftën e tij deri në fitore dhe do të

---

[9] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Format dhe mënyra e shtypjes me qëllim të shpërnguljes dhe asimilimit, (Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995), përmbledhje punimesh, Prishtinë, 1997, f. 60.

[10] Revista "Liria", nr. 1, f. 3.

[11] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Organizatat dhe grupet ilegale...vep. e cit.,f. 297.

[12] Po aty.

qojë në vend amanetin e shenjët të Isa Boletinit, Bajram Currit e Shotë Galicës, të Ali Kelmendit, Asim Vokshit, Emin Durakut e mija dëshmorëve të ndritur që jetën e tyre ia falën lirisë së shtrenjtë.

Në një pjesë të gazetës jepen të dhënat se në çfarë terminësh mundë të dëgjohet Radio Tirana: Dëgjoni Radio Tiranën, ora : 5-7, 7-8, 8-12, 12-18, 18-20,30, 20,30-23. Në këtë skemë programore u jepnin edhe në cilat valë mundë të përcilleshin si: në valë të mesme dhe në valë të shkurtra : 221 m - 6om, 275 m - 60 m, 463 m- 60 m etj… Në këtë faqe jepet edhe informata se në ora 1-2, 3-4, 7-8, 14-15 dhe në 19-20 mundë të ndiqeshin emisionet për shqiptarët jashtë Atdheut. Po ashtu jepeshin edhe në cilat valë mund ti përcillnin siç ishin valët e mesme dhe të shkurtra: 247 m – 49 m, 206 m- 42 m[13] etj.

Në faqen e katërt (4), prezantohet një pjesë nga libri "Tërmeti lëkund malet por jo shqiptarin", fjalë e mbajtur në rrethin e Shkodrës. Në rubrikën "Shoku Enver Hoxha për Kosovën", e titulluar "Zemra jonë lëngon për ta", ndër të tjera shkëputen disa fragmente nga fjala e tij ku thotë se "Vëllezërit tanë shqiptarë në Jugosllavi vuajnë. Një nga vendet më të prapambetura në Jugosllavi është Kosova. Edhe shqiptaret në Maqedoni vuajnë , por tashti pas tërmetit të 15 prillit të këtij viti, më keq akoma janë vëllezërit tanë shqiptarë në Mal të Zi. Zemra jonë lëngon për ta. Si të mos na dhembë zemra për mijëra vëllezër tanë në Hot e Grudë, në Ulqin e në Tivar, kur tash që po vjen dimri nuk do të kenë çati për të futur kokën[14]. Për të vazhduar se " Titoja ka katër ditë që u ngrit dhe vajti në Kosovë dhe, prej andej u kthye prapë në Beograd. Atje ai bëri disa mbledhje dhe përrallisi disa fjalë. U detyrua të pranonte realitetin që në Jugosllavi ka një minoritet të madh shqiptar, por këtë fakt ai nuk e fshehë dot, se në Kosovë ka 1 milion e 500 mijë shqiptar, në Maqedoni nja 400 mijë, në Mal të Zi 40 mijë. Kështu në Jugosllavi bëhen rreth dy milion shqiptarë… [15]Gjatë bisedave që bëri, ai tha se Kosova ka pasuri të mëdha, sikur këtë nuk e dinin kosovarët, por heshti për faktin që këto pasuri i përpunon Sllovenia e Kroacia. Nuk i bëri zemra të thoshte që të ngrihen fabrika dhe të përpunohen mineralet në Kosovë. Ai u detyrua të konstatojë faktin e pamohueshëm dhe të hidhur që frytet e pasurisë së Kosovës i rrëmbejnë të tjerët, por nuk zuri në gojë se në qoftë se Sllovenia e ka nivelin e jetës 100 për qind, Kosova e ka 30-35 për qind. Titoja bëri një vizitë në Pejë, në Prizren, dhe në Gjakovë. Po përse e bëri këtë vizitë në Kosovë Titoja? E bëri për të qetësuar disi ndjenjat e patriotizmit, të lirisë dhe të pavarësisë, që janë të mëdha në Kosovë. Këto ndjenja patriotike të shqiptarëve, që jetojnë në Jugosllavi, Titoja dhe shokët e tij i cilësojnë si "irredentizëm" e "nacionalizëm"[16]. Më vonë vazhdon autori për të cituar "Ndihma jonë për zhvillimin e kulturës luan një rol të madh në Kosovë. Ky zhvillim dhe gjuha amtare atje nuk mund të frenohen. Në radion, në televizionin dhe në shtypin kosovar është adaptuar drejtshkrimi i gjuhës shqipe, tash kosovari lexon, flet dhe shkruan ashtu si ne. Këtë gjë populli atje e realizoi në një kohë shumë të shkurtër, se e ka nxitur zjarri që e digjte nga brenda. Ne do të vazhdojmë politikën e marrëdhënieve të drejta me vëllezërit tanë të gjakut e të gjuhës. Shqipëria nuk do të angazhohet vetëm në

[13] "Dëgjoni Radio Tiranën", revista "Liria", nr. 1, f. 3.
[14] "Zemra jonë lëngon për ta **"** ,revista "Liria", nr. 1, f. 4.
[15] Vjetari, ESK, 1981.
[16] Pjesë nga libri " Tërmeti lëkund malet por jo shqiptaret", revista "Liria", nr. 1, f. 4.

fushën e kulturës e arsimit, por ajo premtonte se do të angazhohet edhe në fushën e tregtisë, se nëpër mes të këtyre marrëdhënieve ata do të jenë më afër atyre dhe do të njihen drejtpërsëdrejti në mes veti[17] përfundon komentin autori i shkrimit.

1.1. Kolapsi i ekonomisë kosovare

Në revistën ilegale "Liria" rëndësi e veçantë i kushtohej zhvillimit dhe gjendjes ekonomike në Kosovë dhe në trojet tjera shqiptare në ish- Jugosllavi. Në shkrimin "Gjendje e rëndë në ekonominë e Kosovës", me një laps të thjesht, shkruar anash fletës, me dorë, me gjasë nga hetuesit është deshifruar autori, ngase tek punimi i shkruar qëndron emri i ilegalistit të njohur nga Begraca e Kaçanikut: Berat Luzha[18]. Pas një analize të gjithanshme të situatës së rëndë ekonomike në Jugosllavi, autori ndalet dhe analizon pse në Kosovë është një gjendje aq e rëndë ekonomike, dhe rëndësi të veçantë i kushton situatës pas viteve 1980. Ai shkruan se "Viti 1980, si edhe vitet e mëparshme, për Jugosllavin është një vit i vështirë. Veçanërisht e rëndë paraqitet gjendja në Kosovë. Ekonomia e Kosovës jo vetëm që nuk po bënë hapa përpara, por gjendja e saj po keqësohet edhe më tepër. Një nga sëmundjet më të rënda e të pashërueshme në ekonomin e Kosovës, janë humbjet e mëdha dhe të vazhdueshme. Gjatë vitit të kaluar, jo më pakë se 112 ndërmarrje ekonomike kishin 1,4 miliard dinarë (të rinj) humbje, prej të cilëve 72 për qind i takonin industrisë dhe xehetarisë" [19] na ofron të dhëna autori i shkrimit.

"As këtë vit" komenton autori, "se nuk u bënë përparime, por gjendja u keqësua edhe më. Në nivelin e vitit të kaluar, gjatë gjashtëmujorit, prodhuan vetëm 17 degë të rëndësishme të industrisë. Vetëm ekonomia e Prishtinës, gjatë gjysmës së parë të këtij viti kishte rreth 242 milionë dinarë humbje, e Mitrovicës 117, e Ferizajt 119 milion etj[20].

Gjendja në bujqësi është edhe më e vështir na bënë me dije autori, por pos humbjeve të mëdha, që vitin e kaluar arritën në shkallën 8,4 për qind të të gjitha humbjeve të ekonomisë kosovare, për çdo vit, siç shkruan shtypi, mbesin të pa mbjella mijëra hektar tokë të punueshme , përveç mijave të tjerë që janë djerrin e përhershme. Kjo degë e ekonomisë jep vetëm 20,9 për qind të prodhimit shoqëror, kur dihet se me të merret më së gjysma e popullsisë. Gjatë viteve të fundit prodhimtaria bujqësore ka rënë 5,4 %, kurse planifikohej të rritej 4 % , por ndodhë e kundërta.

Edhe pse toka e Kosovës është e njohur për plleshmërin e saj, rendimentet e kulturave lavërtarie janë deri 50% nën mesataren jugosllave.

Blegtoria si sektor i veçan i ekonomisë kosovare, jepte vetëm 33% të prodhimit bujqësor, dhe epte rendimente shumë të ulëta. Fondi i përgjithshëm i bagëtive po

---

[17] Po aty.

[18] Berat Luzha u lind me 1953 në fshatin Begracë të Kaçanikut. Ishte anëtarë i organizatës ilegale OMLK. Në procesin gjyqësor të anëtarëve të grupit të OMLK-së, me 10 korrik 1982, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shqiptoi dënimin prej 12 vitesh burg të rëndë.

[19] "Gjendja e rendë në ekonominë e Kosovës", revista "Liria" , nr. 1, 1980, f. 5.

[20] Autori i shkrimit vlen të theksohet se për të dhënat që na i prezanton është shumë i saktë, ngase shërbehet me të dhëna statistikore, që i merr nga shërbimet që i botonte vetë Oda Ekonomike e Kosovës dhe Enti Statistikor i Kosovës.

varfërohet gjithnjë e më shumë, ndërsa 95 % të tij i takonin sektorit privat dhe nga 600 mijë dele, sa kishte Kosova në vitin 1970, më 1980 kishin mbetur vetëm 295.000 copë.

Në gjendje hiq më të mirë ndodhej edhe pylltaria e Kosovës. Pyjet e pasura të Kosovës, u plaçkitnin me të madhe nga regjimi antipopullor titist dhe shkatërroheshin vazhdimisht.

Kosova, me të drejtë konstaton artikullshkruesi, "Përdoret si një zonë tregu për shitjen e mallrave të gatshme industriale nga republikat e Jugosllavisë. Rreth 70% të tregtisë së Kosovës e mbajnë mbi 200 firma tregtare jugosllave me më shumë se 600 njësi tregtare, 200 prej të cilave ndodhën në Prishtinë[21]. Ndërmarrjet e republikave jugosllave nuk kanë kurrfarë pengese për shitjen e mallrave të tyre në Kosovë, ndërsa mallrat e pakta kosovare vështirë gjejnë vend në tregjet jugosllave, bile edhe në tregun kosovar, jo vetëm për shkak të konkurrencës së egër, por edhe nga pengesat administrative. Në këtë mënyrë shumë ndërmarrje kosovare punojnë me kapacitete të përgjysmuara ose i kanë mbushur depot me mallra stoqe, duke i shtuar edhe në humbjet. Mirëpo, kjo nuk ndodh me lëndët e para minerale që nxirren në "Trepçë", "Kosovë", "Novobërdë", Kizhnicë, Hajvali , Golesh, Devë, Volljakë, Karaqevë, Strezovcë, Babush e në vende të tjera[22] anë e këndë Kosovës.

Autori nuk e lënë pa e përmendur as tregtinë e jashtme në Kosovë që në Jugosllavi nuk ka raporte të drejta. Derisa në Jugosllavi vitin e kaluar iu dhanë ndërmarrjeve 1188 pëlqime për tregti të jashtme, në Kosovë u dhanë vetëm 5 sosh. Tregtia e jashtme e Kosovës, kishte një deficit prej 3 miliardë dinarësh, ose dyfish më shumë se një vit më parë. Importi, që u rrit 67 %, ishte dy fish më i madh se eksporti, ndërsa vetëm gjatë gjashtë mujorit të parë të këtij viti, edhe përkundër masave të kufizimit, u rrit për 34%. Vlera e eksportit mbulonte vetëm 50% të vlerës së importit.

Rrjedhim i krizës së rëndë ekonomike ishte edhe shkalla e lartë e papunësisë dhe kurbeti. Të aftë për punë në Kosovë kishte 52% të popullsisë (rreth 800 mijë veta), por të zënë në punë në të ashtuquajturën sektor shoqëror kishte vetëm rreth 168 mijë vetë. Më tepër se 700 mijë vetë kërkonin punë nëpër entet e punësimit, por numri i vërtet i tyre ishte shumë më i madh, sepse shumica e tyre as që paraqiteshin fare në këto farë entesh. Shkalla e zënies në punë e popullsisë së Kosovës ishte më shumë se katër herë më e ulët se ajo në Slloveni.

Struktura nacionale e të punësuarve nuk ishte fare në proporcion të drejtë me strukturën nacionale të popullsisë. Vetëm 62% të punonjësve ishin shqiptarë, kurse serbë e malazezë jo më pak se 32,4%. Kjo mospërputhje do të ishte shumë më e madhe po të analizohej struktura e atyre që punojnë nëpër zyra dhe vende udhëheqëse[23].

Akoma më të vështirë e bënte gjendjen faktike, se 52,3% të vendeve të lira nuk plotësoheshin fare. Në anën tjetër shteti kishte futur sistemin e punës jashtë orarit të punës. Vetëm gjatë vitit 1978 me orar të zgjatur kanë punuar 51.865 vetë, ndërsa në vitin 1979, 7.400 vende të punës janë mbajtur me honorar[24].

---

[21] Po aty, f. 5.
[22] Po aty, f. 6.
[23] Po aty, f. 7.
[24] Gazeta "Rilindja", 23 maj, 1980.

Papunësia e madhe, varfëria dhe jeta e vështirë i kishte detyruar një numër të madh të të papunëve që të marrin rrugën e trishtueshme të kurbetit. Siç detyrohen edhe vet pushtetarët të pranojnë se në rrugën e kurbetit janë rreth 120.000 vetë nga Kosova që punojnë në viset e ndryshme të Jugosllavisë apo në vende të tjera të botës. Nga ana tjetër numri i të mërguarve nga viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi ishte gjithashtu shumë i madh. Vetëm nga komunat e Tetovës, Gostivarit, Strugës, e Kumanovës kanë emigruar mbi 16.000 shqiptarë[25].

Kadri Zeka (25 prill 1953 - 17 janar 1982)

Nga këto të dhëna artikullshkruesi, na dëften se në Kosovë mbretëronte një gjendje kaotike e ekonomisë dhe popullata shqiptare jetonte në varfëri të skajshme. Populli jetonte siç do thoshte populli me një kore buke. Andaj, ndaj kësaj gjendjeje të mjeruar populli gjeti dhe reagoi në mënyrën e vet. Prandaj pushtetarët të cilët ishin përgjegjës për të tëra këto, thoshin se shkaktar për këtë gjendje ishte gjendja e rëndë ekonomike botërore, pastaj prapambetja e trashëguar e Kosovës, dobësitë subjektive e profka të tjera shpikëshin ata. Por siç e dinin të gjithë e vërteta qëndronte krejt ndryshe.

Kosova siç dihej thotë autori "Është një krahinë e begatë me pasuri të shumta natyrore . Rezervat e saja të thëngjill - linjitit kapin 64% të të gjithë rezervave jugosllave, ato të plumbit e të zinkut 67%, të hekur-nikelit 24%, të energjisë elektrike 30%, pastaj kadi të gjitha rezervat e argjendit, kromit etj. Por, këto pasuri nuk shfrytëzohen nga kosovaret. Ato grabiten dhe shfrytëzohen si lëndë të parë nga pushtuesit revizionist jugosllavë. Prandaj ekonomia e Kosovës është e gjymtuar, e një anshme dhe e varur nga ekonomia e republikave jugosllave.[26] Vendin kryesor në ekonomi e zë bujqësia, industria

[25] Të dhënat janë marr nga Enti Statistikor i Serbisë, na njofton autori i shkrimit.
[26] "Gjendja e rendë në ekonominë e Kosovës- pasojë e shfrytëzimit kolonial e kapitalist" , revista "Liria", nr. 1, f. 6, 1980.

e lëndëve të para dhe ajo e përpunimit fillestar të tyre. Vetëm Kombinati "Trepça" dhe "Kosova", të cilët prodhojnë energji elektrike dhe lëndë të parë minerale, japin 48,8% të prodhimit të përgjithshëm industrial të Kosovës. Industria e lëndëve të para minerare dhe bazike japin dy të tretat e prodhimit të përgjithshëm industrial. Në këto degë derdheshin edhe shumica e investimeve të kapitalit jugosllav dhe atij botëror[27].

Kosova e shfrytëzonte vetëm 37 % të energjisë elektrike që e prodhonte vetë, ndërsa pjesën tjetër e merrnin republikat jugosllave. Vetëm Bashkësia Elektroekonomike e e Serbisë në vitin 1979 kishte marr mbi 2 milion e 360.000 megavate orë energji elektrike. Një pjesë të energjisë elektrike i përcillej Elektroekonomisë së Serbisë, dhe në të, ata shkruanin "Ekonomia", dhe ajo realizohej me çmime shumë të ultë në krahasim me çmimet me të cilat ne e blinim të njëjtën energji elektrike nga Elektrodistribucioni i Serbisë, dhe nga ana tjetër "Zhelezara" e Shkupit[28], që merrte për çdo vit rreth një milion megavat orë energji elektrike, deri më 1977 e paguante një kilovat orë vetëm 0,25 dinarë, ose disa herë më pakë se sa paguanin kosovaret. Nga ky çmim Kombinati "Kosova" çdo vit kishte humbje rreth 150 milion dinar. Kontestin rreth çmimit të kësaj energjie padrejtësisht e kishte marr në dorë një komision jugosllav i arbitrazhit i cili sigurisht që nuk do ta zgjidhte atë drejtë dhe në mënyrë fatlume. Përveç kësaj, pothuajse gjithë sasinë e thëngjillit të këtij kombinati që nuk e harxhonin termocentralet e Kosovës, shkonte në republikat jugosllave siç i shkonte edhe gati gjithë gazi industrial i këtij gjiganti.

Ekonomia e Kosovës, siç na argumentojnë të dhënat statistikore, ishte në vartësi dhe kontroll të plotë nga Serbia dhe nga republikat tjera jugosllave. Ndryshe nuk mund kuptohet deklarata e kryetarit të "Veçës" së Serbisë, I.Stamboliqit, kur thotë: "Sipas mendimit tim nuk ka pjesë të vendit tonë që nuk ka interes dhe leverdi për zhvillimin e "Trepçës"[29] në Kosovë.

Propaganda e Beogradit çirrej sa mundke se gjoja federata jugosllave ndihmonte me të madhe zhvillimin më të shpejt të Kosovës e se bile kjo krahinë gëzuaka prioritet në Fondin Federativ për të pa zhvilluarit .Kjo zhurmë vijmë në përfundim se nuk u bënte për të tjetër, veçse u mundonin për ti hedhur hi syve kosovarëve dhe për të mashtruar opinionin jugosllav e atë të jashtëm rreth gjendjes së vërtet në Kosovë.

Në bazë të të dhënave që kemi, vijmë në përfundim se faktet tregojnë të kundërtën. Shkalla e zhvillimit të krahinës jo vetëm që nuk bëri asnjë hap përpara, por siç detyrohet ta pranojë edhe shtypi i kohës, viteve të fundit ajo ka rënë edhe për 5,1% (në vitin 1975 ishte 33,1%, ndërsa më 1980 ajo ra në 28%)[30].

Në periudhën prej vitit 1953-1978 prodhimi shoqëror për banor në Kosovë u rrit më ngadalë se në Jugosllavi. Derisa në vitin 1953 ai arrinte në shkallën 46,1% të mesatares jugosllave, 25 vjet më vonë (më 1978) zbriti në shkallën 28,8%. Siç dihej se popullsia e Kosovës përbënte 7 % të popullsisë së përgjithshme të Jugosllavisë, kurse pjesëmarrja e saj në të ardhurat kombëtare mezi arrinte shkallën 1,9%.[31]

---

[27] Po aty.
[28] Po aty. f. 7.
[29] Po aty.
[30] Broshura, Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion, 1986, f. 23.
[31] Po aty, f. 32.

Propaganda e Beogradit në Kosovë dhe Jugosllavi edhe pse mundohej ta arsyetonte prapambetjen e Kosovës dhe gjendjen e vështirë të ekonomisë së saj. Gënjeshtrave dhe demagogjisë së tyre djallëzore nuk u besonte më njeri. Populli i Kosovës po shihte gjithnjë e më qartë se shkaktari i vërtetë i kësaj gjendjeje ishte kriza e thellë politike, ekonomike e shoqërore që po e brente nga themeli regjimin titist dhe shtypja e shfrytëzimi i egër kolonial që ushtrohej mbi te. Ai po e kuptonte gjithashtu se e vetmja rrugë për të dalë nga kjo gjendje ishte lufta e pa kompromis kundër regjimit jugosllav dhe tradhtarëve të vendit.

1. 2. Prezantimi i luftërave për liri e pavarësi

Rëndësi të veçantë në gazetë autorët i kushtojnë luftëtarëve për liri e pavarësi të popullit shqiptar. Në këtë numër të revistës bëhej prezantimi i patriotit të shquar shqiptar- Isa Boletinit. Në shkrimin "Një faqe e lavdishme e luftës për liri e pavarësi" e autorit Kadri Zeka. Autori fletë për historinë e popullit shqiptarë, por në pah vë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, detyrat që dilnin nga ajo dhe të tjera. Detyrat historike të shtruara nga LSHP vazhdonin edhe më tutje të mbeteshin në rendë të ditës që pritnin një kohë më të mirë për tu realizuar[32].

Pranvera e vitit 1910 e gjeti mbarë Kosovën në këmbë e me armë në dorë. Kryengritja siç pohonin edhe dëshmitarë të kohës, kishte në bazë idenë kombëtare të pavarësisë. Dhe, në fakt, udhëheqës të lëvizjes, si dhe shtypi patriotik shqiptar që e mbështeti kryengritjen, deklaroheshin se lufta bëhej për realizimin e autonomisë administrative të Shqipërisë.

Shtypi i kohës, jo vetëm ai shqiptar, por edhe shtypi i huaj, i krahasonte betejat e Kaçanikut e të Carralevës, me betejën e Termopileve të epokës së lashtësisë. Porse gjatë kryengritjes së vitit 1910 pati edhe beteja të tjera të mëdha midis forcave të panumërta xhonturke, siç qenë ato të Qafës së Morinës dhe të Qafës së Agrit[33]. Aty gjenerali famëkeq Shefqet Turgut Pasha u ngujua me javë të tëra. Qeverisë dhe autoriteteve ushtarake xhonturke iu deshën më se tre muaj për ta shtypur këtë kryengritje[34], e rastet e tilla gjatë historisë së lavdishme të popullit shqiptarë nuk ishin të pakta.

Kryengritja kishte jehon të thellë e të gjerë jo vetëm brenda vendit në vilajetet e Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës, por edhe jashtë tyre. Përvoja e kryengritjes së Kosovës nuk kishte shkuar kot. Lëvizja kombëtare shqiptare nxori prej saj mësimet e duhura. Në këtë kuptim Kryengritja e Kosovës e vitit 1910 dhe Kryengritja e Malësisë së Mbishkodrës, Hotit e Grudës e vitit 1911 mund të merren si uverturë e Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912. Si rrjedhim logjik dhe i drejtpërdrejtë i kësaj lufte mbarëshqiptare, erdhi Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912[35] që ishte edhe një moment kaherë i pritur.

---

[32] Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori, Prishtinë, 2008.
[33] Po aty.
[34] "Një faqe e lavdishme e luftës për liri e pavarësi", revista "Liria" nr, 1, 1980, f. 7.
[35] Më gjerësisht, Historia e popullit shqiptar, Tiranë 2002.

Si pasojë e vendimeve të padrejta, të fuqive të mëdha, me të cilat u lanë jashtë kufijve të shtetit të ri shqiptar Kosova e Rrafshi i Dukagjinit, dhe toka të tjera shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi, kjo fitore mbeti e gjymtuar për shumë dekada. Megjithatë në themelet e çimentuara me gjak të pavarësisë shqiptare qëndron edhe kryengritja e vitit 1910, e popullit trim e liridashës të Kosovës, e udhëhequr nga trimat e patriotë të shquar si Isa Boletini e Idriz Seferi me shokë.

1. 3. Vështrime librash

Gati krejt në fund të revistës jepen edhe vështrime të ndryshme të librave të botuara si në Kosovë njashtu edhe në Shqipëri. Në vështrimin "Vepër me rëndësi të madhe teorike dhe praktike" i shkruar nga Jakup Krasniqi i kushtohej librit "Vetëadministrimi " jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste" me autor Enver Hoxha. Mbi

këtë tekst me një shkrim të çoroditur as në çirilicë e as në latinicë, me laps është i shkruar emri i autorit Jakup Krasniqit[36].

Në mesin e shumë analizave që bënë autori për librin në fjalë, vëmendje të posaçme i kushtohet pjesës ku flitej për të drejtat kombëtare në Jugosllavi. Autori në mes tjerash thotë se " Problem tjetër që trajton shoku Enver në këtë libër, është edhe çështja nacionale e pazgjidhur në Jugosllavi, problem i trashëguar nga koha e kralëve të vjetër. Pas Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste e Jugosllavisë lëshoi parullën e "vëllazërim- bashkimit", por vetë parulla nuk mund ti zgjidhte grindjet e vjetra nacionale, që u thelluan edhe më shumë. "Bashkimi" dhe "Vëllazërimi" i popujve , për të cilët flitet shumë në Jugosllavi, kurrë nuk është shtruar mbi themele të drejta të barazisë ekonomike, politike, sociale e kulturore të kombeve e të kombësive. Këtë e dëshmon më së miri politika fashiste e bandës së Beogradit e ushtruar, për decenie me radhë, mbi popullsinë shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi"[37].

Për të dobësuar sa më shumë rezistencën e shqiptarëve, jugosllavët bënë atë që kishin bërë pushtuesit osmanë shumë kohë më parë: copëtuan tokat shqiptare në tri republika dhe një krahinë autonome, që përveç emrit nuk ka asgjë autonome, pasi se, si ekonomikisht ashtu edhe politikisht, është e varur plotësisht nga republika e Serbisë. Popullsia shqiptare në Jugosllavi edhe pse, siç thotë shoku Enver në fjalën e 9 Nëntorit, si për nga madhësia e tokave, ashtu edhe për nga numri i popullsisë, bënë sa dy republika të marra së bashku të Jugosllavisë, bile edhe më shumë, ndodhet në një prapambetje të theksuar ekonomike, politike, sociale e kulturore[38] thuhej në tekst.

Titistët mundohen ta paraqesin Jugosllavinë si vendin ku është zgjidhur më së miri çështja nacionale. Por, siç thuhej në libër "me fjalë titistët mund t'i paraqesin si të duan marrëdhëniet midis kombeve e kombësive në Jugosllavi, por e vërteta e hidhur për këtë problem... ishte krejt tjetër" [39], përfundon autori.

1. 4. Politika e jashtme

Krejt në fund të revistës, epet një tablo e shkurtër e lajmeve e ngjarjeve shkurtë nga bota. Shkrimi "Populli afgan do të fitojë" i autorit Kadri Zeka, në pika të shkurtra i kushtohej luftës gati një vjeçare që bënte populli afgan për çlirim nga okupuesi sovjetik dhe regjimit kukull të Kabulit. Po ashtu edhe shkrimi tjetër "Diktatura fashiste nuk mund ta mposhtë popullin turk", shkruar nga Kadri Zeka, i kushtohej oficerëve të lartë dhe gjeneralëve të ushtrisë turke, në krye me Kenan Evrenin[40], që kishin organizuar një puç ushtarak me anë të të cilit përmbysën qeverinë e Demirelit më 12 shtator1980.

Numri i parë i gazetës "Liria" që ishte organ informativ i organizatës së "OMLK"-së, nga lexuesit u prit me një admirim dhe simpati. Kryesisht revista iu përmbajt një

[36] Jakup Krasniqi, u lind më 1951, në fshatin Negroc, të Drenasit. Ishte anëtar i OMLK-së. Në kohën kur u arrestua ishte profesor i historisë. Më 10 korrik 1982, Gjykata e Qarkut në Prishtinë i shqiptoi dënimin me 15 burg të rëndë
[37] "Vepër me rendësi të madhe teorike dhe praktike", revista "Liria" nr. 1, 1980, f. 8.
[38] Rubrika "Vështrim librash", revista "Liria" nr. 1, 1980.
[39] Po aty.
[40] Diktatura fashiste nuk mund ta mposht popullin turk, Liria, 1980, f.17.

programi të qartë atdhetar, qëllimi kryesor i saj ishte që populli të jetë i përgatitur, dhe fundja të jetë i gatshëm edhe për një luftë të armatosur, se vendi dhe tokat shqiptare duhet liruar nga robëria se ndryshe nuk bënte. Për plotësimin e këtij qëllimi , redaksia u përpoq të sqarojë popullin shqiptar lidhur me gjendjen e krijuar dhe ti tregojë udhën e drejtë që do të çonte në konsolidimin e popullit atdhetar e liridashës për tu shkëputur nga robëria. Si mjet kryesor për arritjen e këtyre synimeve atdhetare, gazeta konsideronte unitetin e popullit, luftën kundër përçarjes dhe organizimin e mirëfilltë ilegal për ti arritur synimet e kahershme jetike.

2. PIKËPAMJET E GAZETËS "LIRIA" , NR 2. DHE ORGANIZATA E OMLK-së

Pas një muajit të daljes së numrit të parë të revistës "Liria", ajo përsëri befasoi këndshëm anëtarët e vet me daljen e numrit të dytë të saj. Numri i dytë doli në dhjetor të vitit 1980. Më herët është sqaruar që të gjithë numrat janë përgatitur brenda, kurse jashtë është bërë shtypja(bashkë me përgatitjen teknike). Kadri Zeka dhe më vonë Jusuf Gërvalla kanë shkruar artikuj për "Lirin'".

Artikujt që u botuan në atë kohë patën jehonë të madhe tek anëtarësia por edhe te organet e sigurimit. Me fuqinë që kishin dhe demaskimin që i bënin armikut, ajo dhe autorët që i shkruanin ato gëzonin një përkrahje të madhe tek populli.

2. 1. Gjahu ndaj shqiptarëve dhe angazhimi i revistës për rezistencë

Revistës "Liria" nr. 2 i paraprin shkrimi shumë me interes dhe me një titull interesant "Kush janë luftëtarët e lirisë në Kosovë dhe ç'duan ata" shkruar nga Mehmet Hajrizi. Autori në fillim të tij na dëften se "Një luftë e ashpër po zhvillohet kudo në Kosovë kundër "irredentizmit" dhe "nacionalizmit", kundër "irredentistëve" dhe "nacionalistëve", kundër "reaksionarëve" e "armiqve të të gjithë (sic) popullit shqiptar" [41] etj… Këtë front aq të gjerë lufte e kanë hapur prej kohësh në Kosovë armiqtë e vërtetë të saj, okupuesit dhe shërbëtoret e tyre. Sa fjalime të zjarrta u mbajtën për të "demaskuar" "irredentistët", në pikëpamje "ideologjike" e "politike", sa artikuj u shkruan në gazetat zyrtare e të kohës kundër "nacionalizmit shqiptar", sa "vizita" të krerëve të Beogradit u bënë (bile edhe vetë Titua zbriti në Kosovë për këtë qëllim), dhe në fund, sa arrestime, sa bastisje e sa dënime u shqiptuan ndaj bijve e bijave të popullit shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi që të qërohen hesapet përfundimisht me "irredentizmin", që si një "epidemi" thoshin pushtetarët, u përhapte te shqiptaret.

[41] "Kush janë luftëtarët e lirisë dhe çka duan ata", revista "Liria", nr. 2, 1980. f, 1.

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE DHE POPUJ TË SHTYPUR, BASHKOHUNI !

LIRIA

ORGAN I MARKSISTË-LENINISTËVE TË KOSOVËS

DHJETOR 1980 Nr. 2

KUSH JANË LUFTËTARËT E LIRISË
Ë KOSOVË DHE Ç'DUAN ATA?

Një luftë e ashpër po zhvillohet kudo në Kosovë kundër "irredentizmit" e "nacionalizmit",kundër "irredentistëve" e "nacionalistëve",kundër "reaksionarëve" e armiqve të të gjithë (sic.) popullit shqiptar,"armiqve të socializmit" etj.etj.Këtë front kaq të gjerë lufte e kanë hapur prej kohësh në Kosovë armiqtë e vërtetë të saj,revizionistët gjakatarë të Beogradit dhe sahanlëpirësit e tyre në Kosovë.Sa fjalë "të zjarrta"kanë shkuljur politikanët zvarrë nëpër Kosovë për t'i "demaskuar" "irredentistët" etj.në pikëpamje"ideologjike" e "politike",sa artikuj janë shkruar nëpër fletushkat revizioniste kundër"nacionalizmit shqiptar",sa "vizita" të krerëve revizionistë janë organizuar këtu (bile edhe vetë Titua zbriti në Kosovë për këtë qëllim para më se një viti) dhe në në fund,sa arrestime,sa bastisje e sa dënime janë bërë në popullsinë shqiptare të Kosovës,Maqedonisë e Malit të Zi që të gërvishen hesapet për"fundlaisht se "irredentizmin" që si një "epidemi" po përhapet te shqiptarët.Padronët të Beogradit,krerët e ministra të mbrojtjes e sigurimit të shtetit në përgjithësi janë ndarë të kënaqur nga mjetet e format e luftës që përdorin trashtarët tanë kundër popullit,bile kohë pas kohe edhe i kanë lavdëruar ata,por me rezultatet e kësaj lufte nuk kanë qenë dhe nuk janë të kënaqur as pushtuesit e as trashtarët.

Po kush janë "irredentistët" e "nacionalistët" në Kosovë?Kundër rreqimit titist "luftojnë edhe njerëz e grupe të ndryshme vërtetë reaksionare e nacionaliste,por trashtarët dhe revizionistët nuk e kanë hallin tek ata. Në gjuhën e trashtarëve dhe revizionistëve pushtues,"irredentistë" e "nacionalistë" quhen të gjithë ata patriotë liridashës,revolucionarë,që nuk durojnë robërinë ,marksistë-leninistët , luftëtarët e lirisë në Kosovë,që përpiqen për të drejtat e popullit tonë të robëruar,për lirinë e tij,për bashkimin kombëtar dhe për socializmin e vërtetë.Në propagandën e tyre të pashtër ata thonë se këta njerëz janë "të pakët","njerëz të këqinj", "janë ndikim në popull",të cilët "nxisin nacionalizmin e irredentizmin në popullsinë shqiptare","janë reaksionarë të ndikuar nga jashtë" dhe se "duan të shkatërrojnë atë që e ka arritur populli shqiptar,vëllazërimbashkimin e popujve jugosllavë,socializmin vetëqeverisës",etj.etj.,pranday si "armiq jo vetëm të regjimit por edhe të vetë popullit shqiptar duhet të luftohen nga vetë populli" vetëqeverisës",jugosllavinë revizioniste,për "aspiratat tona të reja e ato shekullore që i realizuan në epokën e Titos" e plotë shovinistë të tjera.Na kujtohet Koçi Xoxeja i shkretë që nuk arriti të fusë nën sundimin e Titos edhe Shqipërinë socialiste e të "realizonte" edhe atje "aspiratat shekullore të popullit,por populli i këputi me kohë kokën këtij agjenti të nxjerë"

Është bërë tashmë zakon i trashtarëve që në fushatat "demaskuese" kundër "nacionalistëve" shqiptarë,fjalimet e tyre plot sharje e shpifje për "armiqtë" e zakonshëm edhe për Shqipërinë socialiste,t'i "bëhëlsojnë" pastaj me fjalët më të bukura për sunduesit tanë shovinistë e revizionistë,për "të mirat" që na vijnë nga Beogradi,për "atdheun tonë

Është krejt e kuptueshme pse armiqtë nuk na qajnë me emrin e vërtetë.Kështu kanë bërë edhe paraardhësit e tyre që t'u kishte efekt propaganda në popull.Është poashtu e natyrshme që ata të zgjedhin emrat më të këqinj dhe më të urryer për ne,me qëllim njollosjeje të ideallove tona,qëllimeve tona të vërteta. Irredentizëm? Sa e preferuar është bërë kjo fjalë në

(vijon në faqen 2)

Udhëheqësit nga Beogradi , krerë e ministra të mbrojtjes e sigurimit të shtetit në përgjithësi ishin ndarë të kënaqur nga mjetet e format e luftës që përdornin bashkëpunëtorët e tyre kundër popullit të vet , bile kohë pas kohe edhe i lavdëronin dhe i shpërblenin në mënyra të ndryshme, por më vonë, me rezultatet e kësaj lufte nuk qenë të kënaqur as pushteti e as bashkëpunëtorët, ngase ilegalja për çdo ditë ishte edhe më aktive.

Me kohë populli pyeste, po çka do të thotë "irredentizëm"[42] e "nacionalizëm[43]" dhe kush janë ata në Kosovë? në gjuhën e okupatorëve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre "irredentistë e nacionalist" quheshin të gjithë ata patriotë liridashës , revolucionarë, që nuk duronin robërinë shekullore, quheshin luftëtarët e lirisë së Kosovës, që u përpiqeshin për të drejtat e popullit të robëruar, për lirin e tij, për bashkimin kombëtar. Në fushatën që kishin ndërmarrë, ata propagandonin dhe me të madhe trumbetonin se këta njerëz në Kosovë ishin "të pakët", dhe "janë njerëz që nuk ia duan të mirën popullit të vet", janë

[42] Lëvizje politike që kërkon të bashkohen me atdheun tokat e pushtuara nga një shtet tjetër (Fjalor i shqipes së sotme, Toena, 2002, f. 513).

[43] Lëvizje kombëtare kundër pushtimit dhe shtypjes së huaj (Fjalori i shqipes së sotme, Toena, 2002, f. 824)

”njerëz pa ndikim në popull”, të cilët “nxisin nacionalizmin dhe irredentizmin në popullsinë shqiptare”, “janë reaksionarë të ndihmuar nga jashtë” dhe “ se duan me qëllim të shkatërrojnë e tërë atë që e ka arritur me shumë mund populli shqiptar, vëllazërim-bashkimin e popujve në Jugosllavi, socializmin vetëqeverisës” etj…Prandaj thonë pushtetarët si “armiq jo vetëm të regjimit por edhe të vetë popullit shqiptar duhet të luftohen nga vetë populli”.

Është krejt e kuptueshme pse ata patriot nuk u quanin me emrin e vërtet. Po populli ishte mësuar me politikën përçarëse që aplikonte pushteti, se kështu kishin vepruar edhe më herët paraardhësit e tyre që t’iu kishte efekt propaganda në popull. Ishte po ashtu e natyrshme që ata të zgjedhin emrat më të urryer dhe më të vrazhdë për ne, me qëllim njollosjeje të idealeve liridashëse, qëllimeve supreme të popullit. Irredentizëm! Ishte fjala më e preferuar në fjalorin e pushtuesve e shërbëtorëve të tyre. Autori në shkrimin e vet me një tonë urdhërues iu drejtohet pushtetarëve se është e mira së mirës që ju të “Shfletoni fjalorin dhe të kërkoni këtë fjalëz absurde për realitetin tonë. Të paktën dy fakte të domosdoshme duhet ti keni parasysh: nuk mund të quhet “irredentist” një popull i tërë që nuk donë të jetojë në robëri dhe trojet e këtij populli nuk janë pjesë të vogla toke të shpërndarë, por gjysma e Atdheut të tij që padrejtësisht u shkel nga këmba okupuese fashiste e mbretërisë revizioniste të Titos. Faktet historike nuk mbulohen dhe nuk zhduken dot me një fjalëz qesharake, me një propagandë të shfrenuar dhe as me dhunë fashiste sado e tërbuar të jetë ajo. Një popull, si ky i yni, që ne shekuj kurrë nuk e ka pushuar luftën për liri, të drejta e demokraci, që rrugën e historisë së tij e ka qarë me shpatë në dorë, nuk mashtrohet e nuk përulet dot sado dinak e i egër të jetë armiku i tij. Tokat e më shumë se dy milionëve shqiptarë të robëruar nga Jugosllavia titiste, përbëjnë një tërësi të vetme dhe janë ndarë artificialisht nëpër republika jugosllave për t’i sunduar më lehtë ato dhe për t’i kënaqur interesat historike të shovinistëve dhe grabitqarë të këtyre republikave. Kërkesa e popullit tonë të robëruar që të bashkohen trojet e tij në një njësi të vetme administrative është e drejt dhe e ligjshme.”[44]

Ndjenja e patriotizmit dhe e lirisë tek shqiptaret në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi nëpër vite ishte shtuar dhe ishte shumë e fuqishme. Kështu, po të shprehemi me fjalë të armikut, ata thoshin, “i gjithë populli është i “infektuar” nga “ irredentizmi dhe nacionalizmi”. Me këtë fakt, ata në një mënyrë legalizonin intensifikimin e dhunës dhe të luftës së ashpër që bënin pushtuesit dhe tradhtarët kundër popullit sidomos pas viteve të tetëdhjeta. Por udëbashët mundohen ta fshehin të vërtetën. Ata gënjejnë me të madhe dhe pa u skuqur fare. Gjëja se njerëzit që arrestojnë, bastisin e persekutojnë në Kosovë, nuk janë disa, thuajse populli nuk e dinte se ata ishin me mija që u dënonin me vite burgu marramendës. Me dhjeta mija dosje u hapen nga organet titiste, të dhunës për patriotë e revolucionarë shqiptarë në Kosovë dhe gjithandej ku jetonin shqiptarët. Gjatë fushatës së arrestimeve të shumta që u bënë në popullsinë shqiptare, pas vizitës së fundit të Titos në Kosovë, p.sh. burgjet nuk i zinin të burgosurit politikë shqiptarë. Këtë më së miri e di populli i ynë i shumë vuajtur. Por me gjithë masat fashiste represive, patriotët e revolucionaret nuk u zhduken, e më vonë edhe më me ngulm vazhduan punën ilegale në

[44] “Kush janë luftëtarët e lirisë në Kosovë dhe ç’duan ata “, revista “Liria” nr. 2, 1980.

të gjitha trojet ku jetonin shqiptarët, sepse vetë populli i ynë ishte patriot e atdhetar se lirin e kishin gjakuar me shekuj[45]. Bijtë e Kosovës së okupuar, që këto troje i kishin trashëguar të lara me gjakun e baballarëve të tyre, kurrë nuk do t'i shesin as nuk do ti falin këto troje.

Populli shqiptarë dihet historikisht, jo vetëm që nuk "nxiten" "nacionalizëm" e "irredentizëm" në popull, por rezistencën e luftën që e bënë kundër regjimit , në forma e me mjete të ndryshme, ata e bënë me vet organizim dhe pa nxitjen e askujt. Ilegalja nëpër mes shtypit kishte shpallur hapur se do të ndihmojë gjerë në fund këtë luftë. Nëpër mes propagandës shpifëse e mashtrues, pushtetarët e tradhtarët poshtë e lartë nëpër Kosovë mundoheshin ta bindnin popullin se gjoja ilegalja e ilegalistët na qenkan "reaksionarë" të lidhur me forcat reaksionare jashtë vendit, dhe janë të ndihmuar prej tyre dhe se ata dashkan që t'i shesin interesat e popullit tek të huajt.[46] Se sa shumë ka pasur efekt propaganda antishqiptare e dëshmon më së miri organi informativ i organizatës ilegale OMLK, "Liria". Armiku do të dëshironte sigurisht që populli shqiptarë këtë organ ta hidhëte tej, të mos e lexonte dhe t'ia dorëzonte organeve të sigurimit. Por, ç'ndodhi me këtë gazetë informative, populli e merrte këtë gazetë ilegale "Lirinë", e lexonte dhe e përcillte dorë më dorë, dhe e ruanin si gjënë më të shtrenjtë që të mos binte në duar të armikut, bile kishte raste të shpeshta kur njerëzit e merrnin dhe e shumëzonin në kopje të reja. Nëse armiku ka arritur të shtije në dorë ndonjë kopje, kjo ka ardhur nga pakujdesia e ndonjë lexuesi.

Gjatë hulumtimeve që kam bërë në teren, kemi të dhëna se populli e ruante dhe e lexonte me ëndje këtë revistë. Ngase, ai (shqiptari) e kishte të qartë se "Liria" nuk ishte gazetë e armiqve të popullit, por e bijve të vërtetë të tij[47]. Ajo dilte nga vetë populli dhe populli ishte i gatshëm ta mbronte atë në çdo kohë. I ndodhur në një robëri të egër, në një shfrytëzim kolonial, i shtypur deri në palcë nga një dhunë fashiste, populli i ynë si në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, po e kuptonte gjithnjë e më shumë se të drejtat e tij me dhunë i janë rrëmbyer dhe se vetëm me dhunë mund të fitohen , se nevoja e luftës kundër regjimit gjakatar është e domosdoshme për të shporrur pushtuesin, për të hequr qafe një herë e përgjithmonë robërinë, skamjen, varfërinë, kurbetin e zi e padituri, dhe për të jetuar të lirë dhe sovran në atdheun e shtrenjtë. Propaganda demagogjike e shfrenuar, arrestimet në masë, torturat e mjetet tjera të represionit fashist të armikut, ato nuk po e ulnin urrejtjen, por përkundrazi po e shtonin akoma më shumë atë. Në vitet e mëvonshme lufta e popullit tonë për të drejta e liri, po merrte hov gjithnjë e më të madh, dhe nuk kishte asnjë forcë e terror që mund ta ndalte[48].

2. 2. Apeli që bënte ilegalja

Një shkrim tjetër në revistë, që kishte një titull shumë domethënës "Të burgosurit kosovarë të kthehen në Kosovë"! shkruar nga Hydajet Hyseni. Autori me një gjuhë të

[45] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Spastrimet e intelektualëve në Kosovë më 1945-1990, Epoka e Re, dhjetor 2007.
[46] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Të burgosurit politik shqiptar 1945-1990, (monografi në dorëshkrim), Prishtinë, 2006.
[47] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Shtypi ilegal në Kosovë 1945-1989, Epoka e Re, (fejton), 2007.
[48] Po aty.

mprehtë, kërkon që në emër të popullit shqiptarë që të gjithë të burgosurit shqiptar që dergjen nëpër burgjet jashtë Kosove, në një afat të caktuar të kthehen në Kosovë, ngase "Me mija kosovarë po kalben sot nëpër qelitë e errëta të burgjeve të shumta anë e këndë Jugosllavisë. Organet e pushtetit tradhtar të Kosovës dhe gjykatat që i kanë dënuar ata me faj, me fakte e pa fakte, jo vetëm nuk çajnë fare kokën për ta, por "kujdesën" që të dënojnë sa më shumë kosovarë të tjerë dhe tua japin për ti "riedukuar" shtëpive ndëshkimore fashiste të republikave jugosllave. Lihen kështu me mija kosovarë në "mëshirën" e shovinistëve, rankoviqistëve, çetnikëve e ustashëve nga më të tërbuarit të Jugosllavisë.

Të burgosurit e republikave të Jugosllavisë dhe ata të Krahinës së Vojvodinës nuk dërgohen kështu nëpër burgjet e republikave tjera , por mbajnë burgun në republikën apo krahinën e vet. Vetëm krerët tradhtar të Kosovës janë kaq "bujar" e "zemërgjerë" sa tu dërgojë xhelatëve të burgjeve jugosllave me mijëra shqiptarë që tua thithin , siç dinë vetëm ata, edhe pikën e fundit të djersës e gjakut."[49] Bënë apel autori

Me mija të burgosur shqiptar me vite të tëra gjatë okupimit jugosllav derdhnin djersën dhe kohën më të mirë të jetës po e linin nëpër punishtet e shumta të burgjeve jugosllave. "Përse ky lum i madh djerse të derdhet në republikat jugosllave e jo në Kosovën tonë të varfër.?"[50], bënte pyetje autori i shkrimit.

Autori, theksonte se pikërisht jeta e të burgosurve shqiptarë nëpër burgjet jugosllave ishte tepër e mundimshme, por të burgosurit politik kishin një tretman të posaçëm dhe vazhdimisht ishin të rrezikuar. Mbi ta u ushtronte dhunë e përmasave ç'njerëzore, çfarë nuk kishin ushtruar as nazistët hitlerianë ndaj të burgosurve dhe robërve të luftës. Gjatë viteve sa ishte Kosova nën okupimin jugosllav nuk ishin të pakta rastet kur policia jugosllave kishte bërë masakra të vërteta mbi të burgosurit shqiptarë. Nuk ishin të pakta rastet kur të burgosurit shqiptarë kishin mbetur të plagosur, të gjymtuar e të vrarë mizorisht në këto kasaphana kriminale[51] dhe askush nuk dha llogari.

Shkrimi në fjalë fund e krye është i argumentuar me të dhëna të bollshme, dhe vërtet përse liheshin me mija shqiptarë në duart e përgjakura të kriminelëve e xhelatëve gjakpirës të Jugosllavisë që të shfryjnë sa të duan dhe si të duan mllefin çmendurak mbi trupat e lidhur të bijave e bijve tanë?

Ishin vetë ata- organet e burgjeve jugosllave që nxisin, përgatisnin e organizonin përleshje të përgjakshme në mes të burgosurve shqiptarë dhe atyre jugosllavë. Këto ata i bënin me paramendim që më vonë të "arsyetojnë masakrat që bënin pastaj mbi të burgosurit shqiptarë dhe, njëkohësisht ti armiqësojnë, në këtë mënyrë, të burgosurit dhe nëpërmjet tyre edhe popujt jugosllavë me të burgosurit dhe gjithë popullin shqiptar. Në këtë mënyrë duke i paraqitur të burgosurit shqiptarë si shkaktarë të turbullirave e përleshjeve nëpër burgje, ata mundoheshin ti bindin popujt jugosllavë se, jemi ne shqiptarët "fajtorë" edhe për mos stabilitetin, pasigurinë dhe të këqijat tjera që e mundonin Jugosllavinë. Bëhet pyetja, nëse vërtet të burgosurit shqiptarë qenkan shkaktarë të përleshjeve të përgjakshme të Nishit, Idrizovës, Titogradit, Pozharevcit etj.,

[49] Të burgosurit kosovarë të kthehen në Kosovë, revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 3.
[50] Po aty.
[51] Më gjerësisht : Dr. Sabile Keçmezi- Basha Organizatat dhe grupet...vep. e cit.

atëherë përse nuk sillen ata në Kosovë, por lihen atje, që të "shkaktojnë" gjakderdhje të tjera[52].

Të burgosurit shqiptarë duke qenë kështu të shkapërderdhur nëpër skajet më të largëta të Jugosllavisë, atyre dhe familjeve të tyre u bëhet edhe një dënim tjetër edhe më i rëndë. Për ti shkuar njeriut të tyre në vizitë, familjeve të shumta i u duhet të kalojnë qindra kilometra rrugë, dhe të harxhojnë shuma të mëdha parash. E ku t'i merrnin paratë familjet e të dënuarve, pasi se dihej çfarë sanksione të rëndë ndërmerrte pushteti okupues jugosllav? Nuk ishin të pakta familjet, të cilat, në mungesë të parave, me gjithë mallin e madh që kishin, detyroheshin ti vizitonin shumë rrallë ose fare, njerëzit e tyre të dashur[53]. Nënat e baballarët vdisnin pa i parë djemtë e tyre të burgosur…

Nën pretekstin se burgjet jugosllave nuk kishin përkthyes (që ti censuronte bisedat), të burgosurve shqiptarë dhe familjeve të tyre u kërkohej që edhe në ato takime të shkurtra e të rralla që u lejohej, të flasin jo në gjuhën shqipe, në gjuhën e nënës, por në gjuhën serbokroate, "në gjuhën që e kuptonte edhe zoti" siç thoshin ata. Ç'dënim i rëndë! Të detyrohet shqiptari të flasë në gjuhë të huaj me prindërit e tij, me vëllezërit e motrat e tij, me gruan e fëmijët e tij! Të flasin në gjuhë të huaj edhe ata që po kalben burgjeve pikërisht ata që nuk e pranuan kurrë këtë gjuhë nepërke që nxiste urrejtje, të flasin në këtë gjuhë të huaj edhe ata që nuk dininë asnjë gjuhë të huaj…! Gjatë vizitave që bënin familjarët të afërmve të tyre që ndodheshin nëpër burgje anë e kënd Jugosllavisë, shpesh ka ndodhur që sa e sa familje të kthehen prapa pa këmbyer asnjë fjalë me djemtë e tyre.

Përse të mbaheshin të burgosurit shqiptarë nëpër burgje jugosllave ku " nuk ka" (dhe nuk po mundkan të sigurohen) përkthyes! Përse njerëzit tanë të detyrohen të flasin në mes veti në gjuhë të huaj? Përse të burgosurit kosovarë nuk kthehen në Kosovë? Këtë pyetje e bënte me të drejt si të burgosurit, si familjaret, po ashtu e bënte edhe populli liridashës i Kosovës.

Të vetmen "arsyeja" që e sjellin pushtetarët, ishte se gjëja në Kosovë nuk na paska mjaft burgje, çfarë zbulimi epokal!!! Dhe kjo e dhënë nga ana e pushtetarëve sa është ironike aq është edhe e pa bazë. Ç'është e vërteta në Kosovë kishte pak shkolla, kishte pak spitale, kishte pak shtëpi kulture, kishte pak biblioteka, kishte pak muzeume e çerdhe fëmijësh, se sa për burgje e stacione policesh nuk na kalonte kush. Burg në atë kohë ishte e gjithë Kosova.

Të burgosurit kosovarë me vite kishin kërkuar që të ktheheshin në Kosovë. Për këto kërkesa ata kishin shkruar shumë shkresa e ankesa organeve kompetente të burgjeve dhe pushtetarëve të shumtë, por si gjithmonë ato hasën në veshë të shurdhër, dhe nuk dhanë rezultate të duhura. Kërkesa e tyre për të mbajtur burgun në vendin e tyre, për të derdhur djersën në tokën e tyre… ishte një e drejtë e pamohueshme dhe kjo kërkesë kishte përkrahjen e gjithë popullit[54]. Kërkesat e tyre ishin kërkesa edhe të familjarëve të tyre. Luftës heroike që bënin bijtë, vëllezërit e shokët tanë që po treteshin nëpër burgjet e

[52] Po aty.
[53] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Aktet gjenocidale të UDB-es ndaj anëtarëve të organizatave ilegale shqiptare në Kosovë pas vitit 1945, (Gjenocidi dhe aktet gjenocidale te pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej), Prishtinë, 1995, f, 191-192.
[54] Xhafer Shatri, Pse dergjet ne burg Adem Demaçi, Bern, 1990. f. 93.

errëta jugosllave, iu bashkua çdo kosovar që e donte lirinë, duke kërkuar me këmbëngulje që të burgosurit kosovarë të kthehen në Kosovë.

2. 3. Biseda e Enver Hoxhës me Stalinin për Kosovën

Në faqet e revistës "Liria" vend të veçantë zinin shkrimet, intervistat, dhe debatet e Enver Hoxhës për dhe rreth Kosovës. Në shkrimin "…Plagë e hapët që kërkon shërim" , jepet në pasuse të shkurtra, pjesë të librit "Me Stalinin" (kujtime), dhe në këtë rubrikë "Shoku Enver Hoxha për Kosovën", bëhet prezantimi i shumë të dhënave për takimin që kishte pasur E. Hoxha me udhëheqësin komunist Rusë –Stalinin[55]. Për kohën kur u botua kjo revistë për opinionin e gjerë ishin me shumë interes ngase bllokada informative ishte në një nivel të pa konceptueshme për momentin. Vlen të cekët se si mbas një të dhëne, se gjatë një bisede që kishte pasur E. Hoxha me Stalinin, ai e kishte pyetur se "Jetojnë shumë shqiptarë në Jugosllavi? Dhe ç'far besimi fetar kanë ata? Ai iu kishte përgjigjur se "Më tepër se një milion shqiptarë, ndërsa bashkëpunëtori i tij (Vishinski), thuhej në tekst se kishte pas ngelur i habitur, për këtë numër kaq të madh të shqiptarëve[56]. Thuajse që të gjithë janë të fesë myslimane dhe gjatë gjithë kohërave janë shquar për patriotizëm të zjarrtë dhe lidhjet e fuqishme me atdheun dhe me bashkatdhetarët e tyre. Ata kurdoherë i janë kundërvënë me forcë përpjekjeve të ethshme ekspansioniste e asimiluese të reaksionarëve serbomëdhenj dhe kanë ruajtur me fanatizëm identitetin e tyre shqiptar në çdo pikëpamje, u është përgjigjur E. Hoxha në pyetjen e Stalinit se si nuk janë asimiluar shqiptaret nga sllavet në Kosovë[57]. Ndërsa në bisedë për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë zhvillohet ky dialog: " Sidoqoftë në vitet e para pas luftës ne akoma e quanim Partinë Komuniste të Jugosllavisë një parti motër dhe shpresonim se çështja e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare do të gjente zgjidhjen e drejtë sapo të krijohej momenti i përshtatshëm. Ky moment menduam se u krijua në kohën e nënshkrimit të traktatit (Është fjala për Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, që u nënshkrua në korrik të vitit 1946[58]). Me Jugosllavinë dhe në atë kohë unë ia shtrova Titosë këtë problem. Titoja më pyeti se çmendoja unë për Kosovën. "Kosova e viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi i thashë unë, janë toka shqiptare që fuqitë e mëdha padrejtësisht ia shkëputën Shqipërisë, ato i përkasin Shqipërisë dhe duhet ti kthehen Shqipërisë. Tani që na jemi dy vende socialiste janë kushtet që ky problem të zgjidhet drejt". Titoja më tha: " Jam dakord, ne e dëshirojmë këtë, por tash për tash nuk mund të bëjmë gjë , sepse nuk e kuptojnë dot serbet një gjë të tillë", "Në rast se nuk e kuptojnë sot, i thashë unë, duhet ta kuptojnë nesër", për të vazhduar më vonë se "problemi i Kosovës dhe i popullsisë shqiptare me banim në viset të tjera të Jugosllavisë, e ardhmja e tij mbetet një çështje për të cilën i takon të vendosë vetë populli i Kosovës

---

[55] Shiko Letrën e Enver Hoxhës drejtuar Komitetit Central të P.K. (B) të U.R.S.S. "Mbi Kosovën dhe Metohin", Dr. Hamit Kaba, Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohtë (studime dhe dokumente), Tiranë, 2007, f, 260.

[56] Enver Hoxha, Kosova është Shqipëri, Neraida, 1999, 90-93.

[57] "…Plagë e hapët që kërkon shërim", revista ilegale "Liria", nr. 2, 1980, f. 4.

[58] Vladimir Dedijer " Marrëdhëniet jugosllave- shqiptare 1939-1948", Beograd, 1949, f. 153.

dhe i viseve të tjera[59]. Por ne, nga ana e jonë, pa ndërhyrë kurrsesi në punët e brendshme të Jugosllavisë, asnjëherë s'do të pushojmë së përkrahuri të drejtat e vëllezërve tanë të një gjaku me banim në Jugosllavi, ne do të ngremë zërin kundër terrorit dhe politikës së shfarosjes që ndjek ndaj tyre klika Tito- Rankoviq"[60]. Në bazë të këtij shkrimi, që na i prezanton ilegalja mund të përfundojmë se edhe Stalini pas vitit 1948[61], pas prishjeve të marrëdhënieve me Jugosllavin (Sulmit të Byrosë Informative ndaj PKJ-së), ai e përkrahte idenë e vetëvendosjes së shqiptarëve ,dhe krejt në fund i jep ketë përgjigje udhëheqësit të Shqipërisë,"Jam i një mendimi me ju, se çështjen e së ardhmes së tij e vendos e do të vendos vetë populli i Kosovës"[62] e mbyll shkrimin e vet autori

2. 4. Shënim përvjetorësh

Me rastin e 80 vjetorit të lindjes së patriotit të shquar Ali Kelmendi, në faqen e gjashtë të revistës jepet shkrimi i Kadri Zekës, me titull "Çështja për të cilën luftoi Ali Kelmendi do të triumfojë edhe në Kosovë".Veç shënimeve biografike që përfshihen në tekst, autori na prezanton edhe një çështje që ishte jetike për patriotin e madh. Çështja për të cilën Ali Kelmendi shkriu të gjitha energjitë e tij intelektuale e materiale, ajo triumfoi në RPS të Shqipërisë por jo edhe në Kosovën e tij të dashur. Tradhtia e titistëve dhe të disa sahanlëpirësve shqiptar bëri që populli martir i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, me gjithë gjakun që derdhi si lumë të mbetej përsëri në robëri, në shtypje e shfrytëzim të egër, në errësirë, skamje e mjerim, nën aneksimin e Serbisë.

Armiqtë dhe tradhtarët ishin munduar ta bënin popullin tonë të robëruar që ta harrojë birin e tij të shtrenjtë dhe çështjen e madhe për të cilën punoi dhe luftoi ai. Por, këtij qëllimi nuk ia arritën kurrë. Emri dhe vepra e Ali Kelmendit ishin të gjalla dhe të shtrenjta në zemrat e gjithë klasës punëtore, patriotëve e komunistëve të Kosovës, ishin burim i madh frymëzimi në luftën e madhe të popullit tonë për liri… Për çështjen për të cilën punoi dhe luftoi Ali Kelmendi...[63], përfundon triumfushëm autori.

2. 5. Tendencat për demaskimin e politikës asimiluese

Përpjekjet e pushtetarëve për të asimiluar popullin shqiptar kudo që ndodhej, paraqitën në shkrimin e Hydajet Hysenit "Jemi shqiptarë e asgjë tjetër"[64], që nëpër mes të këtij shkrimi, popullit shqiptar i bëhej me dije se ka përpjekje nga zyrtarët jugosllav, se me rastin e regjistrimit të popullsisë gjatë gjysmës së dytë të muajit prill (1981), në Jugosllavi do të mundohej që të luhej një lojë jo e ndershme me popullin shqiptar dhe ekziston mundësia që popullata të regjistrohet në bazë të fesë e jo në baza kombëtare. Këto regjistrime të tilla, për regjimin titist nuk është ndonjë risi, ngase në këtë mënyrë i

[59] Si në shënimin 182, f, 4.
[60] Shoku Enver Hoxha për Kosovën, revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 4.
[61] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Zhvillimi historik...vep. e cit., f. 170.
[62] Po aty.
[63] Çështja për të cilën luftoi Ali Kelmendi do të triumfojë edhe në Kosovë ", revista "Liria" nr. 2, 1980. f. 6.
[64] "Jemi shqiptarë e asgjë tjetër" , Liria, nr. 2, 1980, f. 7.

ka bërë gjithmonë për hesape dhe llogari të veta dhe më qëllim të caktuara politike. Pos tjerash, pushtetarët jugosllavë i kanë shfrytëzuar ato edhe për qëllime antishqiptare. Me anë të mashtrimeve, presioneve, spekulimeve e falsifikimeve të ndryshme ata kanë bërë që gjatë çdo regjistrimi shumë shqiptarë të mos "regjistrohen" fare ose të regjistrohen jo shqiptarë, si "turq. "myslimanë"," serbë", "maqedonë" e "malazez". Në këtë mënyrë numri i shqiptarëve në Jugosllavi, sipas statistikave, ishte gjithmonë shumë më i vogël se numri i vërtetë i tyre.

Në shkrim qartësohej se shqiptaret nuk janë jugosllavë, por qëllimet që fshiheshin edhe pas regjistrimit të prillit 1981. Jo rastësisht në shtypin jugosllav, kishte kohë që ishte shtruar çështja e deklarimit të pjesëtarëve të kombeve të ndryshme si "jugosllavë" . Propaganduesit dhe përkrahësit e një deklarimi të tillë mundohen ta arsyetojnë atë me "përzierjen e popullsisë në Jugosllavi", me "ndjenjën e patriotizmit jugosllavë", me "rëndësinë që do të kishte një deklarim i tillë për forcimin e vëllazërim - bashkimit" etj… por në të vërtet, pas idesë për tu deklaruar "jugosllavë" fshiheshin qëllime të rrezikshme shoviniste e reaksionare.[65]

Shovinistët serbomëdhenj gjithmonë gjatë historisë ishin përpjekur për një Jugosllavi unitariste, ku nuk do të kishte kombe e kombësi të ndryshme, por të gjithë do të ishin e do të quheshin "jugosllavë", e dihej pastaj se e kujt do të ishte një Jugosllavi e tillë. Qëllime të tilla shoviniste kishte edhe kërkesa që në regjistrimin e popullsisë njerëzit në vend të përkatësisë së tyre kombëtare të shënojnë "jugosllavë"

Në pamje të parë dukej (dhe lënë të kuptohet), sikur kjo çështje ishte shtruar pa ndonjë qëllim të keq dhe jo nga ndonjë organ a personalitet shtetëror por si mendime dhe dëshira spontane të lexuesve dhe individëve të ndryshëm. Po në fakt, po të shikohet thellë kjo çështje, del çartë se ajo jo vetëm që është e organizuar, por edhe burimi i këtij helmi gjendet në qarqet reaksionare të udhëheqjes më të lartë të Jugosllavisë. Vetë kryerevizionisti Tito, në një intervistë të dhënë me rastin e Ditës së Republikës, dhënë gazetës " Mlladost", theksonte se i kishte pëlqyer shumë, kur "qysh para dhjetë vitesh kishte lexuar se të rinjtë në numër të madh deklaroheshin për jugosllavizëm" (za jugosllovenstvo),… ne të gjithë në të njëjtën kohë,[66] shtonte ai, jemi jugosllav"[67]. Ndërsa shtypi jugosllav, duke u mbështetur në këto "deklarime avangarde të Titos" shkon edhe më larg, duke theksuar se "… çdo deklarim tjetër, do të ishte i zbehtë dhe pothuajse i parëndësishëm"[68]

Autori i shkrimit komenton se për shqiptaret nuk ishte aq e rëndësishme se si do të deklaroheshin popujt tjerë në Jugosllavi Ajo ishte çështje e vetë këtyre popujve dhe ata me siguri nuk do të lejonin të bien në kurthet e rrezikshme që u kishin ngrehur shovinistët.

Sipas shkrimit të botuar në këtë revistë, ishte absurde që këto "këshilla avangarde " të shiten tek populli shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare në Maqedoni , Serbi e Mal të Zi. "Jugosllav" do të thotë sllav i jugut, e dihej botërisht se ne jo vetëm që nuk

[65] "Jemi shqiptarë e asgjë tjetër", revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 7.
[66] Revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 7.
[67] Po aty.
[68] Po aty.

jemi sllavë të jugut, por nuk jemi fare sllav. Ne nuk jemi sllavë të jugut, por jemi shqiptarë të veriut. Fakti që ne jemi të pushtuar nga Jugosllavia, këtu nuk ndryshon asgjë. Në trojet tona kanë ardhur e kanë shkuar shumë pushtues, por ne kemi qenë dhe kemi mbetur shqiptarë. Prandaj, të deklarohesh në ç'far do mënyre një shqiptar " jugosllav", kjo do të thotë që ai të mohojë gjakun e tij shqiptarë, të mohojë prejardhjen e tij , të mohojë gjuhën shqipe… do të thotë të mos jetë më shqiptar. E të mohosh atë që të parët tanë e kanë ruajtur në shekuj me aq shumë gjak e sakrifica, është një ligësi dhe poshtërsi e madhe. "Shqiptarë" të tillë sot ka shumë pak, dhe, nëse ka ndonjë, ai meriton urrejtjen dhe përbuzjen më të madhe të të gjithëve. Mjerë nënat që kanë lindur "shqiptarë" të tillë[69] e mbyll artikullin autori, duke përcjell mesazhe të qarta.

Qëllimi i pushtetarëve ishte që gjatë regjistrimit të popullsisë të bëjë ngatërrimin e fesë me kombin dhe kështu në këtë mënyrë të krijojë huti dhe t'i mashtrojë shqiptaret që të regjistrohen si "turq", "mysliman" etj. Por, ilegalja shqiptare nuk do të ishte atdhetare sikur të mos apelonte tek popullata se duhet pasur kujdes që të mos i ngatërrojmë kombin e fenë se këto dy nocione nuk janë e njëjta gjë. Porosisin ata nëpër mes shtypit se kur nga ju në regjistrim kërkohet përkatësia kombëtare, kjo nuk ka të bëjë fare me besimin fetar që kanë banoret, por me kombin e tyre, me gjakun që kanë, me gjuhën, zakonet etj. Nëse një shqiptarë deklarohet se është "turk" apo "mysliman" kjo nuk do të thotë se ai u shkrua si besimtar i fesë islame, por llogaritet se nuk është shqiptar, por pjesëtar i një kombi tjetër, i kombit turk, boshnjak , mysliman etj. Të gjithë ata që do të regjistrohen kështu bëjnë vetëm një gabim shumë të madh, e që ishte edhe qëllimi i shtetit jugosllav, që në masë të madhe të zvogëlohet numri i vërtet i shqiptarëve në Jugosllavi[70].

Tek intelektualet dhe shqiptaret në përgjithësi dominonte frika e arsyeshme se regjistrimi që u përgatitët të bëhej nuk ishte një regjistrim i thjeshtë i popullsisë, nuk ishte vetëm një çështje statistike e demografike, por ishte edhe një çështje me rëndësi të madhe politike për të ardhmen e popullit të Kosovës. Prandaj, apelohej te të gjithë populli i Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi që të mos mashtrohen nga propaganda e rrezikshme e pushtetarëve tanë[71], që në shekuj janë munduar të na zhdukin e shkombëtarizojnë. Ishin të vetëdijshëm dhe e dinin shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi se nuk ishin as jugosllavë, as turq dhe as myslimanë" (boshnjak), prandaj shumica dërmuese nuk u deklaruan si të tillë. Ne ishim vetëm shqiptarë dhe në rubrikën ku shënohej përkatësia kombëtare, të gjithë u shënuan- Shqiptar dhe asgjë tjetër. Ja, pra këto ishin në pika të shkurtra rekomandimet e ilegales shqiptare e cila ishte vigjilente për çdo shantazh që ndërmerrte armiku, mirëpo ajo çdoherë qëndronte e zgjuar për të ruajtur popullin e saj nga "kurthet " që i përgatiste ma mjeshtëri armiku i përbetuar jugosllav.

Një tjetër punim që tërheqë vëmendjen e lexuesit, është punimi i Jakup Krasniqit "Hapat kilometër të Shqipërisë socialiste", dhe përsëri me laps grafiti është i shkruar emri i Jakup Krasniqit, por me një "ç" të fortë ngase nga kjo kuptojmë se hetuesi ishte një

---

[69] "Jemi shqiptar e asgjë tjetër", revista "Liria" nr. 2, 1980, f. 7.

[70] Po aty, f.7.

[71] Dr. Pajazit Nushi, Fenomenologjia e dhunës ushtarake-policore në Kosovë në vitet 1982-1992, (Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual), Tiranë 1996, f, 284.

njohës i dobët i gjuhës shqipe. Është për të ardhur mirë se me çfarë të dhënash e njohurish historike është i brumosur autori i tekstit. Fillimisht jepet një historik i shkurtër i Shqipërisë, lufta çlirimtare, ndërtimi dhe rindërtimi i vendit. Më vonë jepen të dhëna të bollshme për zhvillimin e industrisë, shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe bujqësisë. Autori e përshkruan Shqipërinë se "Ëndrrat e saja shekullore të popullit shqiptar për liri, pavarësi e përparim shoqëror u bënë realitet vetëm me fitoren e revolucionit popullor. Shqipëria e para çlirimit ishte vendi më i prapambetur në Evropë si në pikëpamje ekonomike, ashtu edhe në at arsimore, kulturore, sociale, e shëndetësore. Populli jetonte në skamje e mjerim, kurse pasuritë e tij i shfrytëzonin e i grabitnin të huajt dhe regjimi satrap i Zogut."[72], për të vazhduar se "Vetëm 36 vjet kanë kaluar prej atyre kohëve të vështira, por transformimet që kanë ndodhur në Shqipërinë socialiste mund të maten vetëm me shekuj. Shqipëria e kandilit, sëmundjeve dhe e legjendave të misrit, sot është shndërruar në vend socialist me ekonomi të zhvilluar e dinamike, me nivel arsimor e kulturor të lartë dhe me një mbrojtje të fuqishme e të sigurt.[73]

Më vonë autori jep në vazhdimësi se si janë plotësuar dhe realizuar të gjitha planet pesëvjeçare."Edhe gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, të shtatit me radhë, populli në Shqipërinë Socialiste do të mobilizohet dhe do të realizojë me sukses detyrat e caktuara për zhvillimin ekonomik - shoqëror të vendit dhe mbrojtjen e atdheut. Viti 1980 është viti i parë i Pesëvjeçarit të shtatë, i cili hartohet duke u mbështetur krejtësisht në forcat e veta dhe pa asnjë ndihmë e kredi të huaj. Ky plan do të jetë plani më madhështor që ka hartuar gjerë tani Shqipëria. Ai parasheh të ndërtohen vepra industriale, bujqësore, arsimore, kulturore, shëndetësore etj. aq sa janë ndërtuar gjatë katër pesëvjeçarëve të parë të marr së bashku (1950 - 1970)".[74]

Si në numrin e parë të revistës, edhe në këtë jepet programi i Radio Tiranës, dhe këshillohen qytetaret që ta dëgjojnë me rregull këtë stacion informativ. Propozohet që të përcillen me kujdes sidomos lajmet që i përgatiteshin gazetarët nga tereni.

2. 6. Situata ekonomike e Kosovës

Në vazhdim (sipas të dhënave të hetuesve që i kanë shënua në faqet e revistës, shenjë që me shumë kujdes e kishin hulumtuar shtypin ilegal), na del se shkrimi që fliste për situatën ekonomike ishte i Berat Luzhës[75], që hetuesit kishin arritur ta deshifrojnë, ishte punimi me titull "Krizë e degjenerim në Jugosllavinë titiste". Shkrimi në fjalë përfshinte situatën ekonomike të Kosovës në vitet e tetëdhjeta, dhe autori thotë se "Jugosllavia titiste është mbërthyer sot nga një krizë e thellë dhe e gjithanshme. Kjo krizë sa vjen edhe thellohet duke e bërë kështu jetën gjithnjë e më të vështirë e të pa durueshme. Në këtë krizë kaq të thellë të sistemit anarko – sindikalist "vetadministrues" jugosllav e solli zhvillimi në rrugë kapitaliste i ekonomisë dhe i sferave të tjera të jetesës.

---

[72] " Hapat kilometër të Shqipërisë Socialiste ", revista " Liria", nr. 2, 1980, f. 8.
[73] Po aty.
[74] Revista ilegale "Liria", nr. 2, 1980, f. 8.
[75] Arkivi i Gjykatës së Qarkut, Prishtinë, Aktgjykimi i Berat Luzhës: PP. nr. 17-82.

Si rrjedhim , sistemi jugosllav vuan nga plagë të njëjta e të pashërueshme të sistemit kapitalistë- revizionist."[76].

Karakteristik e ekonomisë jugosllave në ato vite jo vetëm që ishte zhvillimi i dobët e disproporcional, por edhe mosrealizimi i planeve të prodhimit e humbjet përditë e më të mëdha. Gjatë vitit 1979 ekonomia jugosllave kishte rreth 19 miliardë dinarë humbje, që ishin 23% më të mëdha se sa ato të një viti më parë. Ndërkaq, vetëm për nëntë muajt e parë të vitit 1980 humbjet kapnin shumën prej 2o,0 e miliardë dinarësh (30% më tepër se në periudhën e njëjtë të vitit 1979)[77]. Këto humbje u krijuan në degët dhe sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë, në industrinë ushqimore e atë të jometaleve, bujqësi etj.

Humbjet e vazhdueshme thotë autori i tekstit, gjithnjë në rritje bien mbi kurrizin e punëtorëve dhe të masave tjera punonjëse. Për ti mbuluar humbjet, ndërmarrjet u futeshin në borxhe të reja te bankat, apo i harxhonin rezervat e tyre të fundit, i ulnin pagat e punëtorëve etj. Megjithatë humbjet e vitit 1979 ishin mbuluar vetëm 84% (më se 90% e mjeteve për mbulimin e humbjeve ishin nga kredit "sanuese" të bankave me afate të shkurtra kthimi e kamata të larta)[78].

Edhe pse Jugosllavia kishte kushte të përshtatshme për kultivimin e drithërave, gjatë gjithë periudhës së pasluftës ajo ishte importuese e tyre. Bujqësia jugosllave ishte në shkatërrim e sipër, kështu që nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e tregut, jo vetëm për drithëra, por edhe për bimë industriale, si luledielli e panxharsheqeri dhe shumë prodhime tjera bujqësore e blegtorale. Aktualisht mbi 700 mijë hektarë tokë e punueshme nuk u punonte fare dhe në po aq sipërfaqe, sipas shtypit jugosllav, mezi punoheshin diçka. Bujqësia jugosllave zhvillohej mbi bazën e pronës private. Sektori privat përfshinte më se 90%[79] të tokave të punueshme, në Jugosllavi.

Autori cek se në një gjendje të mjerueshme që e ka sjellë Jugosllavin është edhe shkalla e madhe e papunësisë dhe e emigracionit ekonomik që është gjithnjë në rritje. Në Jugosllavinë titiste në atë periudhë (1980), kishte mbi një milionë të papunë (vetëm në Maqedoni janë 120.000 me rritje të shkallës së papunësisë 7%) dhe mbi 1 milion e 300 mijë kurbetçinj të cilët e kanë marrë botën në sy për bukën e gojës. Numri i vërtet i tyre, sigurisht , është shumë më i madh, pasi shumë prej tyre emigrojnë pa ndërmjetësimin e organeve shtetërore. Numri i të papunëve dhe i të mërguarve ekonomik rritej gjithnjë e më tepër. Po ashtu rritej edhe numri i punëtorëve me mëditje, i shërbëtorëve etj. Vetëm në Serbi te punëdhënësit punonin rreth 40 mijë vetë. Në sistemin e kalbur "vetadministrues" jugosllav sundojnë ligjet e xhunglës, konkurrenca e egër në treg bënë që ndërmarrje të tëra të falimentojnë ose të detyrohen të "integrohen" me ndërmarrje më të mëdha. Përveç konkurrencës në treg manipulohej lirshëm edhe me çmime, maliverzohej me artikuj konsumues etj. Në bazë të të dhënave që na i ofron artikullshkruesi, del se njeriu i rëndomtë, në horizont e me një farë mënyre e shef se Jugosllavia si një krijesë artificiale që ishte po i numëroheshin ditët dhe për çdo moment

[76] "Krizë e degjenerim në Jugosllavin titiste", revista "Liria", nr. 2.1980, f. 10.
[77] Gazeta "Rilindja", 17 maj 1979, f. 3.
[78] "Krizë e degjenerim në Jugosllavin titiste", revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 10.
[79] Po aty.

priteshin çrregullira sociale, e mos të flasim për pakënaqësitë që ishin grumbulluar tek populli shqiptar.

2. 7. Konferencat ndërkombëtare në pendën e një ilegalisti

Në faqen e fundit (12) të revistës, ishte punimi "Maskaradë e pasigurisë evropiane", dhe mbi titull të punimit qëndron e shkruar me laps të thjesht nismëtoret -H. Hyseni[80], dhe nga kjo kuptojmë se edhe ky punim ishte deshifruar nga hetuesit e shumtë që i kishte angazhuar okupuesi që të bëjë zbulimin e grupit "Marksistë-Leninist të Kosovës".

Autori bënë prezantimin e shkurtër për formimin dhe mbajtjen e konferencave ndërkombëtare. Shkrimi fillon që nga Konferenca e Helsinkit, e quajtur "Konferencë mbi sigurimin dhe bashkëpunimin në Evropë", e cila ishte mbajtur para pesë viteve dhe në të cilën morën pjesë 33 vende evropiane, SH. B. A dhe Kanadaja. Autori shton se" Nuk kaluan veçse dy vite nga Helsinki dhe pjesëmarrësit e konferencës u mblodhën prapë, kësaj here në Beograd, për të parë "zbatimin në praktik të klauzolave të Mbledhjes së Helsinkit. Dhe patën ç'të shihnin. Me javë të tëra u grindën në mes veti, përfaqësuesit e vendeve imperialiste dhe sidomos ata të superfuqive, duke u munduar që secili ta bënte fajtorë tjetrin për gjendjen e rëndë të krijuar në Evropë, për tensionin dhe pasigurinë, që pas Helsinkit ishin shtuar edhe më shumë. Vetë pjesëmarrësit e mbledhjes u detyruan ta pranojnë dështimin e saj, kurse shtypi borgjez e quante atë "një mbledhje për asgjë"[81].

I vetmi vendim konkret që u mor në Beograd ishte ai për tu mbledhur edhe një herë, pas dy viteve, në Madrid. Megjithatë, propaganda borgjeze e revizioniste vazhdonte të bëjë zhurmë rreth "rëndësisë" së kësaj mbledhjeje "historike"[82].

Por realiteti në Evropë dhe botë, pas mbledhjes së Beogradit demaskonte më së miri, këtë maskaradë dhe zhurmën që bëhej rreth saj. Pas mbledhjes së Beogradit , ashtu si edhe pas asaj të Helsinkit, gjendja në Evropë erdhi e u bë gjithnjë më e rëndë e më e turbullt, tensioni, jo vetëm nuk u ulë, por u shtua edhe më shumë, kurse gara e armatimeve mori përmasa të papara. Në aleancë dhe rivalitet, dy superfuqitë ndërmorën akte të reja ndërhyrjeje në vende të ndryshme të botës, kurse manovrat ushtarake e shpërthimet bërthamore u bënë edhe më të shpeshta…

Autori, konferencat ndërkombëtare i shihte dhe i shpjegonte se "Në këto rrethana u mblodh në Madrid mbledhja tjetër e "sigurimit dhe bashkëpunimit evropian" dhe ishte e qartë se në të s'mund të bëhej tjetër, pos muhabete pa bukë. Ka muaj të tërë që atje bëhen akuza e kundër akuza të shumta, propozime e kundërpropozime të njëpasnjëshme, dhe në fakt nuk vendoset gjë[83]. Pjesëmarrësve iu desh të ndalnin orën që të fillonte "me kohë" ky "kuvend i paqes", kurse me javë të tëra ata nuk mundën të vendosin as rendin e

---

[80] Hydajet Hyseni, u lind më 1954 në fshatin Përlepnicë të Gjilanit. Ishte anëtar i OMLK-së. Në kohën kur u arrestua ishte student i vitit të IV në Universitetin e Prishtinës. Në procesin gjyqësor të grupit të OMLK-së, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi me 15 vite burg të rëndë (Aktgjykimi , PP. Nr. 17-82.

[81] Maskaradë e pasigurisë evropiane, Liria, nr. 2, Prishtinë, 1980, f. 12.

[82] "Maskaradë e pasigurisë evropiane", revista "Liria", nr. 2, 1980, f. 12.

[83] Po aty.

ditës! I ashtuquajturi akt i tretë i kësaj mbledhjeje që po mbahet në Madrid dëshmon më së miri fundin e turpshëm të kësaj komedie të vërtetë të dy superfuqive[84].duke aluduar vazhdimisht se për Kosovën dhe çështjen shqiptare nuk vendosnin asgjë.

3. REVISTA "LIRIA", NR. 3. E BEFASON UDB-ën

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

Maj 1981

LUFTA E POPULLIT TONË ËSHTË E DREJTË DHE DO TË TRIUMFOJË

Revista "Liria", vazhdoi të dal edhe më vonë, edhe atëherë kur çdo gjë ishte e vështirë dhe tepër e rëndë. Vazhdoi të botohej edhe atëherë kur gjahu ndaj shqiptarëve ishte i pa dënueshëm (1981), vazhdoi të ecë edhe atëherë kur nuk ecej fare, çka do të thotë , se revista u botua edhe pas demonstratave studentore e gjithë popullore të pranverës shqiptare të vitit 1981. "Liria" ishte po ajo revistë ,vetëm se tani kishte një eksperiencë më të gjatë, dhe një numër autorësh ilegalistësh më të pjekur dhe më të

[84] Po aty.

kujdesshëm. Ajo tani dilte me një tirazh më të shtuar, dhe gati lirshëm mund të themi se s'kishte familje shqiptare që nuk e siguronte fshehurazi këtë revistë. Revistën ilegale jo vetëm që e lexonin dhe e siguronin, por ata të cilët kishin mundësi edhe e fotokopjonin dhe e shpërndanin gjithandej ku kishin mundësi. Ishte rrezik të të zbulonin këtë revistë UDB- ashët, mirëpo njerëzit nuk qanin kokën. Kishte ardhur një kohë , dhe një moment kur njerëzit ishin të lodhur dhe për asgjë nuk qanin kokën. Kështu me gjasë kishte ndodhur edhe me ne, thuajse njerëzit (shqiptaret) në heshtje, me një rregull të pa shkruar ishin marr vesh se tani kishte ardhur momenti "Ja të rrojmë të lirë - ja të vdesim të tanë".

Ky numër i revistës dashamirët e saj i gëzoi pa masë, që kaherë e kishin pritur. Kishin pritur një informim objektiv. Popullata shqiptare ishte e lodhur nga gënjeshtrat dhe ofendimet nga shtypi i vendit. Ishin të lodhur nga një informim i dirigjuar nga lart. Shpirti iu kishte ardhur në grykë, siç thoshte populli me njollosje e fyerje të bijve dhe bijave më të devotshme të popullit. Andaj një shkrim si ky që e kishte botuar revista në faqen e parë e që vazhdonte gjerë në faqen e nëntë, ishte i pritur. Edhe ky numër sikurse numrat e më parëm i kishin rënë në dorë të policisë. Dhe si mos të bije, kur në Kosovën e përgjakur ishin vërsulur me qindra e mija hetues nga gjithë Jugosllavia, dhe përgjonin, vetëm e vetëm që të zbulojnë aktorët kryesor të demonstratave studentore. U burgosën e u malltretuan, u përgjakën e u vranë shumë të tjerë, burgjet e ish- Jugosllavisë u mbushën me të rinj shqiptar nga të gjitha trojet shqiptare në ish- Jugosllavi.

3. 1. Lufta jonë e drejtë do të triumfojë

Shkrimi "Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe do të triumfojë", vërehet se edhe në këtë tekst është zbuluar autori. Vlen të njoftohen lexuesit se hetuesit e sigurimit jugosllav, gjatë tërë kohës bënin hulumtime, dhe bënin presion të vazhdueshëm te të burgosurit për të tregua se kush ishin autorët e shkrimeve në gazetë. Ndodhte shpesh, që gjatë bastisjeve që bënin në shtëpitë e të burgosurve u zbulonin skicat e shkrimeve që më parë i kishin bërë vet autorët, dhe në këtë mënyrë vinin gjerë te e vërteta, dhe u zbulonin autorët e vërtet. Hetuesit për të treguar dhe dëshmuar para të burgosurve në revistë çdo herë me laps grafiti shënonin nismëtaret ose emrin e mbiemrin e plotë të autorit. Autori i shkrimit sipas shkrimit që kanë bërë udbashët në revistë është kush tjetër pos Hydajet Hyseni. Teksti është i shkruar nga Hydajet Hyseni në një gjuhë të rrjedhshme, dhe fund e krye i kushtohet demonstratave, dhe shkaqeve që sollën deri te këto. Punimi është i ndarë në nëntituj që në mënyrë të shkurtuar do i prezantojmë në vazhdim. Autori nëpër mes të këtij shkrimi e njofton opinionin e gjerë, si atë të brendshëm njashtu edhe atë ndërkombëtare se "Këto kohët e fundit, e tërë Kosova jonë kreshnike ishte arenë e përleshjeve të përgjakshme midis popullit tonë trim dhe regjimit të urryer të revizionistëve jugosllavë. Të bashkuar si një grusht i vetëm e i pathyeshëm, dhjeta mija punëtor, fshatarë, studentë, nxënës e intelektualë, burra, gra, pleq e fëmijë, lanë kantieret e tyre të punës, lanë arat dhe bankat, lanë shtëpitë e tyre dhe, me grushte të ngritur, vërshuan si lumë i furishëm e i papërmbajtur nëpër rrugët e pothuajse të gjitha qyteteve të Kosovës. E gjithë Kosova jonë trime u ngrit në këmbë dhe i tregoi edhe njëherë botës se, si në të kaluarën e saj të lavdishme, edhe sot di tu përgjigjet armiqve të saj ashtu si i ka

hije: me grusht"[85].Në bazë të shkrimit dhe gjuhës që përdor autori vërehet mllefi dhe urrejtja e pa përmbajtur e autorit ndaj sistemit okupues dhe hyzmeqarëve të tyre

"Armiku", thotë autori ishte i tmerruar nga grushti i popullit, robëruesit revizionist të Beogradit dhe zagarët e tyre në Kosovë, grisën maskat, pas të cilave fshiheshin, dhe, duke përdorur mjetet dhe armët e tyre të fundit, tanket dhe çizmen ushtarake, treguan fytyrën e tyre të vërtetë fashiste. Pas maskave të çjerra, populli i ynë dhe popujt e botës panë lakuriq fantazmat e zeza të Drazha Mihajlloviqëve, Çubrilloviqëve e Rankoviqëve"[86].

Siç dihej, pas demonstratave studentore, ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi filloi një fushat e paparë sulmesh e shpifjesh. Pushtetarët dhe shërbëtoret e tyre filluan të punojnë sipas devizës "Rrej shumë, se diçka mbetet", okupuesit dhe tradhtarët, duke mohuar edhe ato gjëra që vetë i kishin thënë vetëm pakë kohë më parë, mundoheshin të bindshin shqiptarët dhe të tjerët se Kosova e okupuar dhe e varfër na qenka një parajsë e vërtet, një vend ku kombe e kombësi të ndryshme jetuakan të lira, të barabarta e të lumtur, në një mirëqenie e bollëk të paparë, se pikërisht kjo gjendje 'kaq e mrekullueshme" po i penguaka disa forca e grupe "nacionaliste" e "irredentiste", "dogmatike e staliniste", "reaksionare" e "kundërrevolucionare", të cilat, me "parulla demagogjike sociale e nacionale" si dhe me kërcënime, shantazhe e vandalizëm", paskan arritur t'i mashtronin e ti hedhin në greva e demonstrata disa qindra veta dhe kështu paskan prishur vëllazërimin e bashkimin, paskan cenuar integritetin e Jugosllavisë, paskan sulmuar frytet e revolucionit dhe, sidomos, të arriturat e popullit shqiptar, bile edhe paskan dashur të bëjnë "kontrarevolucion"!!![87]

Në nëntitullin e shkrimit " Cila është e vërteta", autori na prezanton të vërtetën e hidhur për gjendjen e mjerueshme të popullit shqiptar në Jugosllavi. Edhe pse okupatori mundohej me çdo kusht dhe me çdo mjet për ta fshehur të vërtetën, po megjithatë ajo shteg dhe del në sipërfaqe. Populli shqiptar thotë autori u ndodhë në një gjendje të rëndë dhe të padurueshme, mbi të cilët ushtrohej një shtypje e shfrytëzim i egër e i shumëfishtë kolonial. Kjo nuk mund të fshihej as para të huajve e as mos të flasim para shqiptarëve[88], të cilët mbanin mbi supet e veta tërë peshën e robërisë.

Qytetarët e Kosovës i dinin pasurit e shumta e të paskajshme të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, por edhe të tjerët e dinin dhe e njihnin prapambeturin e theksuar të tyre. Gjithkush e di (këtë të dhënë e dinin edhe vetë pushtetarët) se Kosova, ashtu si edhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi, jo vetëm që nuk u zhvillonte më shpejt se republikat e Jugosllavisë, po përkundrazi diferenca, si në shkallën e zhvillimit ashtu edhe në dinamikën e tij, po shtohej nga viti në vit. Prandaj, gjithkush, me të drejt, bënte pyetjen : Pse ndodhë kështu? E kjo e dhënë ishte fare e lehtë për ta ditur ngase Kosova dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi nuk ishin të lira, se ato ishin koloni të thjeshta të republikave jugosllave, se ato ishin plaçka tregu dhe burim i thjesht i lëndëve të para dhe i krahut të lirë të punës. Kosova kishte pasuri të shumta, të cilat nuk u shfrytëzonin për të

[85] " Lufta e popullit tone është e drejtë dhe do të triumfojë", gazeta "Liria", nr. 3, 1981, f. 1.
[86] Po aty, f. 2.
[87] Po aty.
[88] Cila është e vërteta, Liria, nr. 3, 1981, f , 2.

mirën e saj. Në Kosovë gjatë gjithë okupimit jugosllav u derdhte lumë djerse e bijve të saj, për të tjerët, dhe ishte shumë dëshpëruese kur të tjetër i shfrytëzonin ato, dhe tjetërkush u pasuronte me të mirat e saja. Në vazhdim, në shkrim bëhen analiza të thukëta për gjendjen në Kosovë dhe në terë Jugosllavinë. Prodhimet shoqërore dhe të ardhurat kombëtare 3-4 herë ishin më të ulëta se mesatarja e përgjithshme jugosllave, dhe rreth gjysma e popullsisë ishte analfabete, më shumë se çdo i dhjeti banor kishte marr rrugën në kurbet dhe akoma më shumë kishte të papunë[89], qindra fshatar të Kosovës ishin pa rrymë elektrike, pa rrugë, pa asnjë shitore dhe pa asnjë mbrojtje shëndetësore…Këto ishin vetëm nga disa tregues që flasin për gjendjen e vërtetë të popullit shqiptar të Kosovës, pa përfshirë këtu viset e tjera shqiptare, ku gjendja ishte edhe më e rëndë, dhe vazhdimisht ushtrohej një politikë e tillë shoviniste dhe asimiluese, që e kishin lakmi edhe vendet më raciste të botës.

Në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi shumica e popullsisë, sidomos ajo shqiptare , jetonte në skamje, varfëri e mjerim të vërtet. Një pjesë e mirë e popullsisë nuk kishte kurrfarë të ardhurash, e edhe ata që merrnin diçka, ose nuk mund të të gjejnë në treg as mallrat më të nevojshme të jetës, ose edhe po ti gjenin, ato kushtonin aq shtrenjtë (dhe shtrenjtoheshin çdo ditë) dhe nuk mundeshin ti blinin fare[90].

Në gjendje aspak më të mirë nuk ishte as fshatari ynë, i cili, në gjendjen tepër të rëndë në të cilën ndodhej bujqësia, nuk kishte leverdi të punojë as atë pak tokë, që akoma nuk ia kishin gllabëruar shteti dhe uzurpatorët, sepse siç thoshte fshatari, "dara u delte më shtrenjtë se barra. Ishte pikërisht kjo gjendje e padurueshme që po i detyronte fshataret që t'ia mësyjnë në mënyrë masive kurbetit e qytetit, ku i priste i njëjti fat.

Edhe më e mjerueshme ishte gjendja e rinisë shkollore dhe e asaj studentore. Aq të vështira ishin kushtet e tyre të jetës dhe të mësimit sa që nuk mundeshin të krahasoheshin jo vetëm me ato të shokëve të tyre në Jugosllavi, por edhe as me një vend tjetër më të varfër. Ishin të shumta shkollat dhe fakultetet që zhvillonin mësime në kushte që ishin jashtë çdo norme shëndetësore dhe pedagogjike. Shumë student dhe nxënës po kalbnin trupin e tyre të njom nëpër podrume të lagështa dhe stalla të tilla ku nuk jetonin dot as kafshët. Dhe për të qenë ironia edhe më e madhe, çmimi i këtyre kushteve ishte aq i lartë sa studenti nuk mundte ta paguante as me gjithë bursën apo kredinë që merrte. Nuk ishin të pakt studentët e nxënësit që e hanin bukën thatë ose me ndonjë "zdenkë" (copë e vogël djathi) apo ata që e hanin bukën e mykur, të sjellë nga shtëpia, prandaj edhe suksesi në studime ishte aq i pakënaqshëm[91]" konstaton autori.

Rinia kosovare mund të mbaronte fakultete, mundë të përfundonte shkolla të mesme, por askush atyre nuk iu siguronte punë. Pra, e ardhmja e rinisë sonë nuk ishte fare e sigurt .

Me një fjalë, poçes analizohet në tersi situata në Kosovë, del se të pakënaqur ishin edhe punëtorët e fshatarët. Të pakënaqur ishin nxënësit dhe studentët, me një fjalë tërë populli ishte i pakënaqur. Në një gjendje të tillë të padurueshme, e natyrshme ishte që tërë populli ishte mbështetur për muri, e thika po i prekte ashtin dhe mjaftonte një

[89] Po aty, f. 2.
[90] Po aty.
[91] "Cila është e vërteta", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 3.

shkëndijë e vogël që të merrte flakë e tërë Kosova. Këtë shkëndijë kaherë të pritur nga masat e gjëra, e ndezën me 11 mars studentet trima të Universitetit të Kosovës. Ata kishin kërkuar shumë herë më parë në rrugë e në forma të ndryshme, që të përmirësohet gjendja e tyre e mjeruar, por për ankesat e tyre nuk çau kokën askush. Të ngopur me gënjeshtra e premtime boshe, studentet tanë nuk duruan më, por u bashkuan si një grusht dhe dolën e demonstruan nëpër rrugët e Prishtinës.

Edhe pse kërkesat e parullat e demonstratës së parë ishin kryesisht me karakter social dhe ekonomik, ajo u cilësua si armiqësore dhe jo vetëm që nuk u përfillën fare kërkesat e studentëve, jo që nuk u morë asnjë masë për përmirësimin e gjendjes së tyre, por ndaj tyre u përdorë dhuna policore. Kjo dhe arrestimet që u bënë ndaj tyre, e shtuan edhe më shumë pakënaqësinë dhe revoltën e studentëve, e cila shpërtheu më me forcë dhe më me vendosmëri më të madhe në demonstratat e 26 marsit[92]. Studentëve në këtë demonstratë iu bashkua edhe një numër i madh i punëtorëve, nxënësve dhe qytetarëve të tjerë. Përveç parullave të mëparshme, në përgjithësi ekonomike e sociale, kësaj here u ngritën edhe kërkesa e parulla politike. Demonstrata e 26 marsit ishte më popullore dhe më shumë kishte karakter politik. Mirëpo, po me 26 mars ndodhi edhe masakra më e madhe ndaj demonstruesve. Me tradhti studentet u futen nëpër konvikte. Dhe në ndihmë kolegëve policë të Kosovës iu erdhën edhe njësitë speciale të Beogradit. Ata erdhën jo për tjetër vetëm e vetëm sa për të shfryrë mllefin e tyre shovinistët mbi rininë, mbi vëllezërit, dhe motrat tona. Dhe xhelatët "udbashë" të Rankoviqit e treguan veten dhe kënaqën jo vetëm vojvodët e tyre në Nish e Beograd, por edhe krerët kuislingë në Kosovë. Xhandarët e Beogradit thyen dyer e dritare të konvikteve, rrahën egërsisht secilin që gjenin për para, fyenin e shanin në mënyrën më të poshtër jo vetëm vëllezërit e motrat, por fyenin gjithë popullin shqiptar, sidomos shfrynin vrerin me të shara në nënat shqiptare… Rrugaçët e Beogradit shkuan deri atje sa thyen edhe dollapët e studentëve dhe plaçkitën edhe ato pak para e plaçka që kishin lënë studentet në dhomat e tyre. Qindra studentëve të gjymtuar e të lënduar rëndë, jo vetëm që nuk iu dha ndihma e nevojshme mjekësore, por ata u dërguan ashtu siç ishin drejt e në çeli, ku i rrahën e i torturuan përsëri në mënyrën më shtazarake[93].

Paria politike e Kosovës jo vetëm që nuk bëri asgjë për ta penguar këtë masakër, jo vetëm që nuk ngriti zërin kundër veprimeve kriminale të çetnike të Rankoviqit, por e kërcënoi rininë dhe popullin shqiptar me masa edhe më të ashpra, poçes edhe njëherë guxojnë e ngritën përsëri.

Se sa u gabuan në vlerësimet e tyre, shovinistët jugosllavë u bindën shumë shpejt. Dhuna dhe terrori fashist jo vetëm nuk frikësoi rininë trime, por përkundrazi, e shtuan edhe më shumë pezmin dhe urrejtjen e tyre ndaj armiqve dhe tradhtarëve. Kupa e pakënaqësisë dhe revoltës ishte mbushur shumë më herët, por tani, pas dhunës që u përdor ndajë sajë, ajo nuk zinte më. Në këmbë u ngritë i gjithë populli. Demonstrata e greva të shumta shpërthyen anë e këndë Kosovës. Në demonstrata hodhën parullat :

---

[92] Dr. Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Demonstratat studentore të vitit 1981, kthesë e rëndësishme në historinë e Kosovës, Epoka e Re, 26 prill 2006.

[93] Po aty.

"Punëtorë, studentë, fshatarë, jemi një e të pandarë"[94] dhe ashtu u bë. Dhjeta mijëra punëtorë, fshatarë, studentë, nxënës, zejtarë e intelektualë u bashkuan si një trup i vetëm në një bllok të fuqishëm e të paparë. Dhe përvoja vërtetonte se kur energjitë e pashterueshme të rinisë bashkohen me luftën revolucionare të klasës punëtore dhe masave të tera popullore, nuk ka forcë në botë që mund ta mposhtin luftën e tyre"[95] komenton pjesëmarrësi i demonstratave.

Megjithëse pushtetarët ndërmorën masa të jashtëzakonshme dhe me gjithë mungesën e organizimit e përgatitjeve të nevojshme të demonstruesve, forcat policore nuk mundën ta ndalin armatën e madhe të popullit që mbushi rrugët e të gjitha qyteteve të Kosovës.

Ditën e një prillit, nga të gjitha anët e Prishtinës, lumenj të mëdhenj demonstruesish qan përmes reve të gazit lotsjellës, plumbave dhe bajonetave dhe u derdhën në qendrën e qytetit, u bashkuan dhe formuan aty një det të madh e të paparë. Pamja që mori qendra e Prishtinës ishte vërtetë madhështore. Nuk mund të shihej aty asgjë tjetër përveç kazmave, lopatave e çekanëve që ngiteshin kërcënueshëm para selisë së komunistëve të Kosovës, përveç grushteve të fuqishëm të mase 20 mijë demonstruesve të të gjitha moshave e profesioneve, që ishin bashkuar në një grusht të vetëm e kolosal. Nuk mund të dëgjohej aty asgjë tjetër përveç korit madhështor të popullit që kumbonte në të gjithë qytetin, përveç brohoritjeve të fuqishme: "Kushtet për studentët!", "Kushte për puntorët!", "Çmimeve stop!", "Duam punë!", " Ktheni kurbetëçinjët!", "Mjaft me shtypje e shfrytëzim!", "Poshtë robëria- Rroftë liria!", "Lironani shokët!", "Kërkojmë llogari!", "Të burgosurit kosovar kthenani në kosovë!" , "Trepça është jona!", "Kosova është jona!", "Kosova- kosovarve!", "Kosova- republikë!", "Duam vetëvendosje!", "Të gjithë shqiptaret jemi një!", "Jemi shqiptar, s"jemi jugosllavë!"[96] etj…etj rrëfen vet pjesëmarrësi i demonstratave.

Qëndresa e fuqishme e popullit dhe kërkesat e tij të drejta u kallën tmerrin armiqve dhe bashkëpunëtorëve të cilët pa asnjë paralajmërim, pa asnjë përpjekje për tu marrë veshë me popullin që kërkonte të drejtat e veta, por në të njëjtën kohë kërkonte llogari e përgjegjësi për ato që kishin ndodhur më parë. Në këtë rast okupuesi tregoi fytyrën e tij të vërtet, popullit iu përgjigj me një sulm tjetër akoma më brutal dhe më çnjerëzor se ato të mëparshmet. Kundër popullit duarthatë e të pa mbrojtur, në mesin e të cilit kishte edhe gra, pleq e fëmijë, udhëheqja e Jugosllavisë "socialiste", "humane" e "demokratike" urdhëroi sulmin jo vetëm me kërbaçë e gazra lotsjellëse, trullosëse e helmuese, por intervenoi edhe me armë të zjarrta. Gjatë tërë natës së 1-2 prillit, banorët e Prishtinës dhe të një sërë qytetesh të tjera, dëgjuan të shtëna të pa ndërprera armësh që zbrazeshin mbi trupat e njom dhe të uritur të bijve dhe bijave shqiptare. Rrugët e shumë qyteteve kosovare u skuqën me gjak, por populli nuk u frikësua. Ai i hapi dyert dhe i strehoi bijtë dhe bijat e tij luftëtar, u dha bukë, krip e zemër e u a lidhi plagët. Populli e kuptoi atë natë edhe më mirë se kush ishin armiqtë e tij të vërtetë dhe kush ishin bijtë e tij të vërtetë[97].

---

[94] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Organizatat dhe grupet...vep. e cit., f , 62.
[95] Po aty, f. 3.
[96] "Demonstratat e Kosovës janë vepër e popullit të saj ", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 4.
[97] Po aty, f. 5.

Pas kësaj ndërhyrjeje trishtuese të policisë jugosllave, me një mënyrë apo tjetër, pushtetarët e dinin se populli nuk do qëndroi i qetë dhe duar kryq. Andaj për "mbrojtjen" e Kosovës angazhuan edhe ushtrinë-"APJ"-në, tanket dhe aviacionin, shpallën gjendjen e jashtëzakonshme dhe vendosën orën policore. Jo vetëm burgjet, por edhe stadiumet u mbushën me të burgosur, kurse konviktet e nxënësve dhe të studentëve u mbushën plotë e përplot policë të ardhur nga Serbia dhe viset e tjera të Jugosllavisë. Më shumë se kaq nuk mund të bënte Jugosllavia e Titos, ngase kështu nuk kishte bërë as Jugosllavia e kralve, nuk kishte bërë as Gjermania e Hitlerit. Por as këto masa fashiste nuk e trembën popullin e pamposhtur të Kosovës. Ata që kishin menduar se me tanke e aeroplan mundë ta frikësonin popullin shqiptar, ishin mashtruar keqas[98].

Ajo që ndodhi me 2 prill, duhet të jetë mësim më i mirë për çdo armik dhe tradhtar. Në Prishtinë dhe në shumë qytete të Kosovës, atë ditë punëtorët nuk dolën në punë, nxënësit nuk shkuan në shkolla. Ata atë ditë kishin vetëm një drejtim dhe një kahe e cila i shpinte në demonstrata të reja. Me vetorganizim u ngritën barrikada të reja forcave të ushtrisë dhe policisë dhe u përleshën me to me heroizëm të paparë. Në këmbë ishte ngritur i madh e i vogël. Përball tankeve e mitralozave , populli tundte grushtin e tij të fuqishëm. Pothuajse të gjitha dyert e shtëpive ishin të hapura për bijtë e nënave. Dora e madhe e popullit u sillte vazhdimisht bukë e ujë luftëtarëve të tij. Infermierë dhe mjekë mantel e zemërbardhë të spitalit të Prishtinës u sillnin pa ndërprerë ushqime, fasha e barëra demonstruesve, u mjekonin dhe u lidhnin plagët. Kishin arsye ata oficerë e ushtarë të huaj që kapnin kokën dhe fërkonin sytë nga guximi i tyre. Bijat dhe bijtë e Kosovës kreshnike, duarthatë po zemër zjarr, ua hapnin gjoksin plumbave të armikut, bile kishte edhe aso që hidheshin edhe mbi tanke"[99] siç ishte rasti i vashës trime nga Hogoshti i Dardanës (ish- Kamenicë).

Demonstratat që shpërthyen anë e këndë Kosovës u shuan me gjak. Qindra bijë e bija të popullit u vranë, u plagosën dhe u lënduan rëndë, por lufta e drejtë e popullit për të drejta e liri nuk u shua kurrë. Në përkrahje të kërkesave të drejta të popullit, në shumë qytete të Kosovës shpërthyen greva e demonstrata të tjera, kurse vëllezërit tanë që ndodheshin në kurbet organizonin dhe vazhdonin të organizonin demonstrata të fuqishme dhe mitingje të shumta proteste nëpër vende të ndryshme të botës. Populli ynë edhe më tej vazhdonte luftën e tij në forma të ndryshme, dhe përsëri dot vazhdojë atë deri në realizimin e plotë të kërkesave dhe aspiratave të tij,[100] deri në fitoren e tij të plotë.

Nga vet shkrimi i gazetës vijmë në përfundim se autori i shkrimit sikurse të gjithë ne ishte i mllefosur ndaj parisë politike të Kosovës. Mu kjo edhe ishte shkaku që autori nëntitullin e shkrimit e pagëzon: "Jo rinisë, por tradhtarët janë plehu i Kosovës"[101].

"Pas shumë diskutimeve që i ndërmorën për të shqyrtuar shkaqet dhe arsyet e demonstratave studentore" shkruan autori. Në takimet e shumta nga vet kreu politik kosovar dolën akuzat më të rënda, me të cilat vlerësime nuk u pajtuan demonstruesit dhe intelektualet e Kosovës. Andaj anëtarët e organizatës reaguan shumë ashpër në shtypin

---

[98] Po aty.
[99] Kush po e nxit nacionalizmin ", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 4.
[100] Po aty.
[101] Jo rinisë, por tradhtarët janë plehu i Kosovës, revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 5.

ilegal të kohës. Njëri nga shkrimet që iu kushtua demonstratave studentore të vitit 1981, ishte edhe shkrimi i lartpërmendur, në të cilën autori thotë se "Hyzmeqaret besnik të të huajve dhe armiqtë si Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Mahmut Bakalli, Dushan Ristiqi, Ali Shukrija, Asllan Fazlija etj, jo vetëm që u dalluan në masat e egra që u ndërmorën kundër rinisë dhe popullit tonë, por po tregohen shumë të zellshëm edhe në fushatën propagandues që kishin marr jugosllavët në të gjithë Jugosllavinë për ti dënuar demonstratat e Kosovës dhe kërkesat e tyre[102], thotë autori i shkrimit.

Këta prefektë anadollakë të tipit të Qazim Mulletit, me fjalimet e tyre gjysmë shqip e gjysmë serbisht, akoma pa u tharë gjaku rinor që u derdhë, akoma pa i varrosur dhjeta djem e vajza që i vranë mizorisht, u munduan të na bindin se bijtë e bijat e popullit qenkan "rrugaçë", "nacionalistë", e "reaksionarë", se ata qenkan "Agenta të të tjerëve", se rinia e pastër e Kosovës qenka "plehu i Kosovës".

Autori thotë se "Bijtë dhe bijat e Kosovës kreshnike nuk e kanë damkosur dhe nuk do ta damkosin kurrë kombin e popullin shqiptar, ata nuk janë "huliganë" e agjentë të të huajve. Por janë bijtë më të mirë e më besnikë të popullit, ata nuk janë plehu i Kosovës, por floriri i saj. Jo rinia, po tradhtarët e njollosin popullin shqiptar..." [103]

Gjatë kohës kur ndodhën demonstratat , edhe pse ishte shumë transparente se i tërë populli i përkrahte studentët dhe rininë përparimtare, ata (pushtetarët), trumbetonin se "rinia është e jona", "rinia do të jetë me ne" etj. Dhe nuk donin të pranonin se rinia përparimtare e Kosovës kurrë nuk kishte qenë dhe nuk do të jetë me ta, kurrë nuk kishte qenë me ta, nuk ishte as atëherë dhe as që do të jetë ndonjëherë. Ajo kishte zgjedhur rrugën e vetë të vetme, rrugën që i kishin lënë amanet edhe dëshmorët e demonstratave të fundit, që ranë me heroizëm për të mos vdekur kurrë[104].

[102] Po aty.
[103] "Kush po e nxit nacionalizmin ", revista "Liria" nr. 3, 1981, f. 4.
[104] Po aty.



Kadri Zeka (25 prill 1953-17 janar 1982)

Si çdo kund në botë, nuk kishte forcë që mundte ta largonte rininë e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare nga kjo rrugë e lavdishme.

Në nëntitullin e shkrimit "Demonstrata e Kosovës janë vepër e popullit të saj", u bënte fjalë për ngjarjet e vitit 1981. Menjëherë pas 11 marsit, pushtetarët dhe hyzmeqaret e tyre filluan një fushatë të paparë duke trumbetuar se demonstratat i kishin organizuar armiqtë e vendit dhe ata nga bota e jashtme. Duke dhënë pa hezituar mendimet kuturu të vetat se me popullin u manipulua dhe se ata janë shumë të kënaqur që jetojnë në Jugosllavi, dhe duke përdorur lloj- lloj ofendimesh e shpifjesh kundër Shqipërisë.

Në këtë mënyrë donin ti mbulonin shkaqet e vërteta që e shtynë popullin që të ngritët në greva dhe demonstrata. Ata e dinë mirë se këto shkaqe ishin se Kosova ishte në një pozitë të vështirë dhe të pabarabartë me republikat tjera, ishte nën shtypjen e egër dhe të shfrytëzimit të egër e të vazhdueshëm e të shumëfishtë që ushtrohej mbi masat e saja punonjëse, rol kyçë luante edhe mungesa e një sërë të drejtash dhe lirish kombëtare e demokratike, dhe pakënaqësia e madhe që mbretëronte kudo dhe që po shtohej çdo ditë, ishte evidente, edhe pse u mundonin ti kamuflonin, sepse pikërisht ata dhe politika e tyre ishin shkaktarë të një gjendjeje të këtillë dhe rrjedhimisht edhe të demonstratave e të grevave që u bënë në Kosovë. Po të mos ishte kjo gjendje kaq e vështirë dhe populli të jetonte vërtet i lirë e i lumtur, siç duan të thonë ata, atëherë asnjë forcë e brendshme e as e

jashtme nuk do të mundë ta nxirrte popullin në rrugë, sado që të përdornim "parulla demagogjike"[105]

"Sa ishte logjike" thotë autori, se në çdo fjalim dhe në çdo artikull që u shkrua rreth demonstratave u thoshte se "masat u mashtruan nga parullat demagogjike që u hodhën", por harrojnë të thonë se ato parulla na qenkan "demagogjike", dhe deri sa qenkan të tilla, si u bë që populli të jetë aq "mendjelehtë", sa jo vetëm që përkrahu që në fillim parullat e kërkesat e demonstruesve , por i përkrahte ato edhe më vonë, bile akoma edhe më me ngulmë. Është interesant që të dihej gjithashtu se, përse krerët e Beogradit e kalemxhinjtë e tyre nuk i zënë fare në gojë edhe parullat e tilla të demonstruesve si: "Duam punë!", "Ktheni kurbetçinjtë!","Çmimeve stop!", "Lironani shokët!", "Të burgosurit kosovar, ktheni në Kosovë!"[106] etj.? Pse ata nuk po e shpjegojnë "karakterin demagogjik dhe armiqësor" edhe të këtyre parullave, dhe pse nuk po i zgjidhin këto probleme të mëdha, në mënyrë që "forcat armiqësore" të mos munden t'i "mashtronin" masat herëve tjera?"[107], në këtë propagandë armiqësore u kyçën që të gjithë, por rolin kryesor e lozi shtypi i Beogradit, që nuk ngelnin pas as mjetet e informimit të Kosovës.

Duke i paraqitur demonstratat dhe grevat e vitit 1981-1982 që kishin ndodhur në Kosovë, si vepra të grupeve e forcave të ndryshme të organizuara, pushtetarët në një mënyrë u bëjnë atyre një nder të madhe, e madje edhe të tepruar. Pararoja e organizuar në Kosovë, dhe patriotët e vërtetë, pa dyshim që kanë luajture rol të rëndësishëm në këtë lëvizje revolucionare, por duhet thënë hapur se detyrën e saj në organizimin dhe udhëheqjen e masave, ajo ka qenë dashur dhe ka mundur ta kryente edhe më mirë. Grevat dhe demonstratat në Kosovë, më shumë se të organizuara ishin spontane. Ato nuk janë dhe nuk mund të ishin vepër e askujt tjetër, por e vetë popullit të saj heroik. Ai ishte iniciatori, udhëheqësi dhe organizatori kryesor.

Është për tu theksuar edhe qëllimi tjetër i krerëve dhe kalemxhinjve të pushtuesit, të cilët, edhe pse e dinin sigurisht se gjatë gjithë demonstratave brohoritej pa ndërprerë e nga të gjithë për republikë të Kosovës, për barazi e të drejta kombëtare, megjithatë ata mundohen ti paraqesin demonstratat e Kosovës si vepër të reaksionit antikomunist shqiptar. Duke qenë të bindur se mbeturinat e reaksionit, ballistë etj… nuk kanë pothuajse kurrfarë influence në popullin e sidomos në rinin e Kosovës dhe të viseve të tjera të banuara me shqiptarë., pushtetarët mundoheshin ta bindnin popullin se pikërisht, këta reaksionar qëndronin në krye të demonstratave dhe jo bijtë e popullit, revolucionarët dhe patriotët e vërtetë. Në këtë mënyrë ata orvateshin ti shkëpusnin masat popullore nga pararoja e tyre që në të vërtetë, siç treguan ngjarjet e fundit, janë një dhe të pandarë. Propaganda e tillë ishte edhe një shërbim i mirë për reaksionin antikomunist shqiptar, i cili ishte shumë i interesuar për të krijuar bindjen se ai ishte akoma gjallë dhe se akoma ka ndikim në popullin shqiptar[108].

Në pjesën e shkrimit "Kush po e nxitë nacionalizmin", ajo që bie në sy më së shumti në fushatën e gjerë propagandistike që ka shpërthyer në të gjithë Jugosllavinë

---

[105] Po aty.
[106] "Demonstrata e Kosovës janë vepër e popullit të saj", Liria, nr. 3. 1981, f. 4.
[107] Po aty, f. 3.
[108] Po aty.

kundër demonstratave në Kosovë, kundër demonstruesve e madje edhe kundër të gjithë popullit tonë, ishin akuzat e shumta për "nacionalizëm", "irredentizëm"[109], "separatizëm" e madje edhe për "shovinizëm shqiptaromadhë". Pa u lëshuar në argumentimin e asaj që thonë pushtetarët që nga më të mëdhenjtë deri te më të vegjlit, çirren me të madhe se gjoja demonstratat paskan pasur për qëllim të nxisin nacionalizmin dhe shovinizmin shqiptar, të mbjellin mosbesimin, përçarjen dhe urrejtjen ndërnacionale në Kosovë dhe Jugosllavi, të shkatërrojnë vëllazërimin e bashkimin e tyre dhe gati sa nuk thonë se demonstruesit paskan dashur ta pushtojnë e gjithë Jugosllavinë[110].

Ashtu pa dashur shtrohet pyetja, po vallë, ç'nacionalizëm e ç'shovinizëm kishte në grevat dhe demonstratat që bëri populli në Kosovë? Ç'nacionalizëm e ç'shovinizëm kishte në parullat kundër papunësisë, kurbetit e ngritjeve të çmimeve? Ç'kishte nacionaliste e shoviniste në kërkesën e drejtë për kthimin në Kosovë të burgosurve kosovar, ose në kërkesën gjithashtu të drejtë që Kosova dhe viset e tjera shqiptare të çlirohen nga zgjedha koloniale, që krahinës së Kosovës ti i pet statusi i republikës në kuadër të Federatës Jugosllave? Që keqe u erdhi popujve jugosllavë në Kosovë e Jugosllavi nga demonstratat që u bënë dhe ç'të keqe do tu sillte atyre realizimi i kërkesave të drejta të demonstruesve? Asnjë, bash absolutisht asnjë të keqe. Lufta e studentëve, e punëtorëve dhe e gjithë popullit të Kosovës për të drejta e liri, jo vetëm që nuk drejtohet aspak kundër popujve jugosllavë, jo vetëm që nuk ju sjell asnjë të keqe, po përkundrazi, ajo e ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejt luftën që bëjnë edhe punëtorët dhe masat e tjera punonjëse jugosllave për të drejtat e veta. Aq më tepër kjo vlente për pakicat serbe, malaziase, turke etj, në Kosovë, të cilat lirinë e tyre nuk mund ta shohin në shtypjen dhe robërimin e popullit shqiptar, por përkundrazi, në lirinë e tij të plotë[111]", i elaboronë ngjarjet autori.

Siç dihej se gjatë historisë populli shqiptar, ka vuajtur shumë nga pushtuesit e huaj, gjithmonë ka luftuar kundër okupatorëve e zullumqarëve të huaj, por ai vetë kurrë nuk ka qenë pushtues, kurrë nuk ka qenë shovinistë e zullumqar ndaj të tjerëve. Ai kurdoherë ka ditur të bëjë dallimin mes popujve të tjerë, me të cilët ka jetuar në miqësi e fqinjësi të mirë, dhe krerëve të tyre shovinist, kundër të cilëve ka luftuar pa mëshirë. Jo vetëm në LNÇ, por edhe në luftën patriotike të Azem Bejtës e Isa Boletinit, populli ka dënuar çdo lloj dhune e zullumi ndaj pjesëtarëve të pafajshëm të kombësive jo shqiptare[112].

Sa ishte paqësor populli shqiptarë u vërtetua edhe ne ngjarjet e vitit 1981 që ndodhën në Kosovë. Gjatë demonstratave, jo vetëm që nuk u hodh asnjë parullë kundër popujve të tjerë, po përkundrazi, më se një herë u theksua qartë dallimi mes popujve jugosllav e krerëve të tyre shovinist. Gjatë demonstratave jo vetëm që nuk u dëmtua popullsia jo shqiptare, por pati edhe serbë, malazias, turq, romë etj, që iu bashkuan

---

[109] Po aty, f. 5.
[110] Po aty.
[111] " Kush po e nxitë nacionalizmin? ", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 4.
[112] Po aty.

grevave dhe demonstratave, ose u solidarizuan me to, strehuan demonstruesit, u dhanë bukë dhe u a lidhën plagët[113].

Populli shqiptar gjatë historisë ishte dallua për patriotizëm, por qe deshi, kur fati nuk ishte në anën tonë, vërtet ishte patriot, por kurrë, shovinist. Shovinistët ishin ata që e kishin robëruar atë, e kishin copëtuar dhe e mbanin me dhunë nën zgjedhë, e jo shqiptarët që luftonin për të drejtat dhe lirit e tij, pa u rënë në qafë të tjerëve. Kolonialistët janë ata që sjellin polici, ushtri e tanke në Kosovë, ata që vrasin , gjymtojnë, rrahin e poshtërojnë popullin, e jo ata që ngrenë zërin dhe grushtet kundër një mizorie të tillë. Përçarjen dhe urrejtjen e rrezikshme ndërnacionale nuk e nxit populli i Kosovës dhe rinia e tij, por udhëheqja në Jugosllavi dhe Kosovë, e cila duke e shtrembëruar të vërtetën rreth Kosovës dhe luftës së saj të drejtë, orvatët të nxit një frymë antishqiptare kudo në Jugosllavi. Jo ne, por pushteti jugosllavë ka nxitur dhe po nxisin konflikte ndërnacionale në mënyrë që ti bëjnë masat punonjëse të harrojnë problemet e tyre të mëdha ekonomike e sociale, për të lënë në plan të dytë luftën e tyre klasore kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Pas një elaborimi të gjatë të ngjarjeve të vitit 1981, autori prezanton shkrimin me nëntitullin "Rroftë Republika Socialiste e Kosovës"[114], Duke shtuar se "populli shqiptar në Jugosllavi edhe më parë në forma e rrugë të ndryshme, ka kërkuar zgjidhje të drejtë të çështjes së tij kombëtare, ka kërkuar që atij ti njihet e drejta për të vendosur vetë për fatin e tij. Për këtë të drejtë kishte luftuar me shekuj shqiptari.

Populli shqiptar i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara me shqiptar u ngrit në Luftën Nacionalçlirimtare, i bindur se, pas fitores së saj, edhe ai do të fitonte të drejtën për të qenë i lirë dhe i pavarur. Udhëheqja e atëhershme e PKJ-së dhe vetë Titua, më se një herë kishin shpallur se pas luftës do tu njiheshin dhe garantoheshin të gjithë popujve brenda kufijve të Jugosllavisë së vjetër, edhe popullit shqiptar , të drejtën për vetëvendosje dhe shkëputje. Por, pas luftës, ata jo vetëm që nuk e garantuan këtë të drejtë, por e shkelën atë me gjak. Ata që guxuan të kërkojnë këtë të drejtë të ligjshme dhe të premtuar, u shpallën armiq, u vranë, u burgosën, u ndoqën. Tjetër kush vendosi për fatin e popullit tonë të robëruar[115].

Dihet botërisht se në mbledhjen e AVNOJ-it, ku u vendos edhe për fatin e popullit shqiptar dhe të tokave të tij, që fuqitë e mëdha imperialiste padrejtësisht i kishin ndarë nga shteti shqiptar dhe i kishin lënë nën zgjedhën e Serbisë dhe të Malit të Zi, ku nuk merrte pjesë asnjë delegat shqiptar[116]".

Megjithëkëtë, pushtetarët jugosllav thonë pa pikën e turpit të kundërtën, gjëja se populli ynë paska shprehur vetë vullnetin e tij që të jetë kështu siç është. Ç'vullnet i çuditshëm! Shqiptarët që rrojnë në tokat e tyre (dhe përbëjnë shumicën absolute të popullsisë), paskan dashur dhe paskan shprehur vullnetin (për hatër të Titos dhe Rankoviqit), jo vetëm të mbesin në kuadrin e Jugosllavisë, por edhe të copëtohen një

---

[113] Po aty.

[114] Po aty, f. 6; Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Demonstratat studentore '81- kthesë e madhe në historinë më të re të Kosovës", (fejton), Epoka e Re, 8-10 maj 2006.

[115] Po aty.

[116] "Rroftë Republika Socialiste e Kosovës", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 4.

pjesë në Kosovën autonome, një pjesë në Maqedoni, një pjesë në Serbinë e ngushtë dhe një pjesë tjetër në Republikën e Malit të Zi.. Mjerisht ishin larg Kosovës Kroacia dhe Sllovenia, se sigurisht edhe atyre "do tu takonte" ndonjë copë tokë shqiptare![117]

Nëse populli i Kosovës paska vendosur vet që të jetë kështu si është dhe nëse ai e paska lidhur fatin e tij me Jugosllavinë, me LKJ-në dhe me Titon, atëherë, pse ai nuk gëzon të drejtën për vetëvendosje, që Kushtetuta e Jugosllavisë u siguron popujve të tjerë? Pse të mos i lejohet që të vendosë vetë për fatin e tij, kur ai, siç thonë pushtetarët, "dashka të jetë kështu siç është". Është mase e qartë se të gjitha që thonë pushtetarët jugosllavë për "vëllazërim- bashkimin", për "barazinë" e "bashkëjetesën", për "zgjidhjen e drejtë, bile ideale, të çështjes kombëtare" s'janë tjetër veçse demagogji, veçse një rrenë e madhe dhe e kulluar[118].

Trumbetohet se në Jugosllavi "çështja kombëtare është zgjidhur në mënyrë marksiste", bile Tito , për "kontributin e madh" që paska dhënë në këtë fushë, është shpallur edhe doktor nderi, për ironi, pikërisht në Universitetin e Kosovës!. Por, vallë çka marksiste në zgjidhjen që revizionistët i kanë bërë çështjes kombëtare në Jugosllavi, zgjidhje që ndryshon fare pak nga "zgjidhja" që i kishin bërë asaj kralët e Jugosllavisë së vjetër"[119]shpjegon autori me argumente historike.

Për të vazhduar më tutje se propaganda jugosllave akuzon parullën "Kosova-Republikë", se gjoja ajo nxit nacionalizmin, separatizmin e shovinizmin, thuajse në Jugosllavi nuk paska republika të tjera! Sipas kësaj del se të gjithë ata popuj që kërkojnë vetëvendosje, e të mos flasim për shkëputje, qenkan "nacionalistë" e "shovinistë". Krerë të ndryshëm e "teoreticent" jugosllavë dhe sidomos "politiçar" e "koka të mëdha të shkencës" në Kosovë, mundohen ta bindin me çdo mënyrë popullin tonë se ai është krejt i lirë, i barabartë, i pavarur dhe bile i privilegjuar, se autonomia që ka Kosova, nuk ka kurrfarë dallimi nga republika etj…etj… Interesant populli si ky i yni! Jeton në "liri" e "barazi" të plotë dhe nuk i sheh ato! (Kështu nuk shihte ai as "lirinë" dhe "qytetërimin" që i kishte siguruar atij dikur fashizmi)[120].sa absurde ishin të dhënat që ofronin juristet kosovar.

Po të jetë se statusi i autonomisë qenka e njëjta gjë me statusin e republikës, siç po thuhet shpesh, atëherë përse nuk realizohet kërkesa e popullit të Kosovës për republikë, edhe pse për të po derdhet gjak? Se çfarë është, në të vërtetë "autonomia" që ka Kosova, se sa është ajo në fakt subjekt i pavarur i Federatës dhe se sa është ajo në duart e kosovarëve, dëshmuan më së miri ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë. Karakteri revolucionar ose reaksionar i një kërkese kombëtare, qëndron në faktin se nëse realizimi i saj do të ndihmonte ose do ta pengonte zhvillimin e përgjithshëm të atij populli. Cili është ai që mund të thotë (dhe të mos gënjej se çlirimi nga zgjedha koloniale nuk do ta

---

[117] Po aty.
[118] Po aty.
[119] "Lufta e popullit tone është e drejtë dhe do të triumfojë", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 5.
[120] Po aty, f. 6.

ndihmonte zhvillimin e përgjithshëm dhe çështjen e socializmit, jo vetëm në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, por edhe në gjithë Jugosllavinë.?"[121]

Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve Stane Dollanc në një intervistë pat thënë në mes të tjerash, se Republika e Kosovës do të ishte shkatërrim për Jugosllavinë, dhe këtij avazi i binin edhe më shumë artikujt e fjalimet e të tjerëve, duke paraqitur shkatërrimin e Federatës Jugosllave edhe si qëllimin kryesor të demonstratave në Kosovës![122]

Autori mendonte se shteti jugosllav dhe çdo shtet tjetër shumëkombësh ka rrezik të shkatërrohet jo duke u dhënë popujve të shtypur lirinë, por duke ua mohuar atë, duke ia mohuar të drejtën që ata të vendosnin vetë për fatin e tyre, duke u përpjekur për ti mbajtur ata me dhunë në zgjedhën koloniale. Edhe sikur robëria e Kosovës të ishte shtylla që e mbanë Jugosllavin dhe po të jetë vënia në vend e padrejtësive që i janë bërë dhe po i bëhen popullit tonë do të thoshte shkatërrim i shtetit jugosllav, atëherë del se ky farë shteti do të shkatërrohet patjetër dhe do të duhej shkatërruar, pasi është ndërtuar keq, pasi se është ngritur në dëm të lirisë së popujve të tjerë[123].

Duke i mbrojtur "zgjidhjet" që i kanë bërë çështjes kombëtare të Kosovës fuqitë e mëdha, imperialiste dhe qarqet monarkiste të Serbisë dhe të Malit të Zi, pushtetarët jugosllav shkelin me të dy këmbët mësimet e demokracisë mbi çështjen kombëtare[124].

Me qëllim të armiqësimit të popujve jugosllavë dhe popullit tonë, klika e Beogradit mundohet ti paraqes demonstratat e Kosovës dhe sidomos kërkesën për republikë si "sulm të drejtuar kundër popullit serbë, malazezë, maqedonas dhe popujve të tjerë të Jugosllavisë". Po për këtë qëllim, ata kanë organizuar nëpër qytete të ndryshme të Jugosllavisë edhe tubime dhe protesta nën parullën : "Zhivot damo , Kosovo ne damo" (jetën e japim- Kosovën se japim), por kralët e rinj të Beogradit dhe ata që iu shkojnë pas tyre duhet ta dinë mirë se Kosova nuk është çiflig i tyre dhe i askujt në botë. Kosova është e kosovarëve dhe vetëm kosovarët kanë të drejtë të vendosin për fatin e saj.

Kërkesat e drejta të popullit për ta hequr qafe zgjedhën koloniale, jo vetëm që nuk drejtoheshin kundër interesave të masave popullore në Serbi, Maqedoni e Mal të Zi, po përkundrazi, ato ishin edhe në interesin e tyre, prandaj edhe duhej ta përkrahnin.

Parulla "Rroftë Republika Socialiste e Kosovës" ishte e drejtë, prandaj edhe përkrahej nga çdo shqiptar . Kërkesat e tij të ligjshme për republikë nuk mundi ti a shuajnë popullit asnjë lloj propagande e frazeologjie, sado e ashpër ose kërcënues që të jetë, ashtu siç nuk mundi ti a shuajnë as masat e egra të dhunës e terrorit, as plumbat e tanket e diktaturës. Për realizimin e kësaj të drejte të ligjshme, populli ynë trim e patriot do të luftojë pa marrë parasysh asnjë sakrificë, deri sa në kushtetutë të shohë të shkruar: Republika Socialiste e Kosovës.[125]sugjeronte autori.

---

[121] Po aty; Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Liria"- gazetë ilegale me fizionomi të re dhe me qëndrime të qarta", (fejton), Epoka e Re, 15 prill- 3 maj 2006.
[122] Si në shënimin 119.
[123] Po aty.
[124] Po aty.
[125] Po aty, f. 6.

Me qëllim të diskreditimit të rinisë dhe të gjithë popullit tonë, propaganda në Jugosllavi dhe në Kosovë mori një fushat të shpifjeve dhe trillimeve kundër demonstruesve, andaj edhe nëntitulli i shkrimit "Kriminelët akuzojnë për vandalizëm" dëshmon qartë se si dha çka ndërmori okupuesi ndaj popullatës liridashëse. Sipas asaj që thonë qarqet okupuese, demonstratat nuk i kishte bërë populli, po "nja 200 – 300 rrugaç, studentë të dobët, e punëtorë të këqij", të cilët nuk paskan pasur asnjë qëllim tjetër, pos të "shkaktojnë incidente e gjakderdhje, të shkatërrojnë pronën shoqërore, të thyejnë shitoret dhe të vjedhin mallin". Ata, jo vetëm që i paskan "detyruar njerëzit me dhunë që të dilnin në demonstrata", por edhe paskan " vënë përpara fëmijë me qëllim që organet policore të mos mundin të shtien mbi ta"!!! Çfarë shpifje e çfarë trillime[126] thotë autori, thuajse populli ishte naiv dhe nuk e dinte të vërtetën.

Çdo kush mund të bënte pyetjen: Si është e mundur që disa qindra "huliganë" të bëjnë, gjatë një muaji reshtë, greva e demonstrata të njëpasnjëshme, bile në të gjithë Kosovën? Si ia arritën disa "rrugaç" siç thoshin ata, që të nxjerrin "me dhunë" masat në demonstrata, kurse pushtetarët me gjithë dhunën e presionin që vërtetë ushtrohej mbi ta , me gjithë organet e shumta që kanë dhe me gjithë demagogjinë e tyre të njohur, nuk ia arritën të nxjerrin popullin në mitingjet që organizoheshin , për të "pritur" stafetën , pikërisht atë ditë kur bëheshin demonstratat. Si nuk iu mjaftoi gjithë ajo polici që sollën nga Serbia, por u detyruan të fusin në veprim edhe ushtrinë me tanke e avion, të shpallin gjendjen e jashtëzakonshme dhe të vendosnin orën policore.

Çdo kush e dinte dhe e kishte të qartë se demonstratat që ishin organizuar në Kosovë gjatë vitit 1981 ishin popullore, se me demonstruesit ishte i gjithë populli, se populli kishte dal të kërkonte në mënyrë paqësore të drejtat e tij, ndryshe nuk do të ndaleshin aq lehtë armiqtë që guxonin të sulmonin me armë popullin e paarmatosur. Gjithkush e shihte se zhurma e madhe që bëhej rreth gjoja brutalitetit dhe vandalizmit të demonstruesve, me tërë ketë bëheshin përpjekje për të fshehur brutalitetin dhe vandalizmin e tyre. për tua hedhur demonstruesve fajin e përgjegjësin për dhunën e paparë që u përdorë, dhe për gjakun që ishte derdhur[127].

Natyrisht, në demonstrata të tilla të mëdha e popullore, është e natyrshme që të ndodhë dhe të bëhej edhe ndonjë veprim i nxituar, i pamatur dhe i panevojshëm. Edhe në demonstratat e 1981-shit, nuk përjashtohej të jetë bërë edhe ndonjë veprim i tillë, por karakteristikë e përgjithshme e demonstruesve të Kosovës ishte rregulli, durimi, pjekuria dhe gjakftohtësia shembullore. Vërtet populli kishte dal në demonstrata por jo në kryengritje , ai i kërkonte të drejtat dhe lirin që nuk e kishte, dhe jo gjakderdhje , prandaj ai edhe ngriti parullën "Pa dëmtime", "Pa incidente"[128], dhe vërtet pothuaj se asnjë dëm, asnjë incident nuk u bë nga ana e demonstruesve para se të sulmoheshin nga policia. Nuk do të bëheshin kurrë dëmet që u bënë, nuk do të derdhej as gjaku që u derdh, sikurse ndaj popullit demonstrues të mos përdorej që në fillim dhuna policore dhe, sidomos , sikur

---

[126] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Liria"- gazetë ilegale me fizionomi të re dhe me qëndrime të qarta", (fejton), Epoka e Re, 15 prill- 3 maj 2006, vazhdimi i tetë.

[127] Po aty.

[128] "Kriminelët akuzojnë për vandalizëm ", revista "Liria" nr. 3, 1981, f. 7.

mos të kishte ndërhyrë policia e huaj, e cila me veprimet e saja shoviniste të padëgjuara bëri që jo vetëm populli, por edhe policët kosovarë të përlesheshin me ta. Vandalistë e brutale, mizore e kriminele, në të vërtetë, ishin veprimet e policisë fashiste dhe të UDB-es rankoviçiane, që ushtruan mbi popullin shqiptarë gjithë atë dhunë e terror të paparë. Përgjegjësit kryesor për atë që ndodhi në Kosovë ishin krerët politik, qofshin ata në Beograd apo në Kosovë, qofshin shqiptarë apo jo shqiptarë, që urdhëruan shuarjen me gjak të demonstratave, ishin edhe ata që sollën në Kosovë policinë e Serbisë e të Jugosllavisë për të gjakosur, rrahur e poshtëruar popullin, për të tmerruar edhe foshnjat në djep, për të shkretuar rrugët dhe arat tona, përgjegjës ishin të gjithë ata që e bënë Salvador të dytë Kosovën . Ata janë përgjegjës për të gjitha ato që kishin ndodhur dhe ndodhen në Kosovë, ata janë përgjegjës për gjakun që u derdh dhe pa dyshim për këtë, një ditë, do të japin llogari (siç po japin tani në Hagë), para botës.

Autori i shkrimit më të gjatë " Lufta e popullit tonë është e drejtë dhe do të triumfojë", në nëntitullin "Zëri i popullit- zëri i së vërtetës" në mes tjerash na prezanton se "Në kohën kur propaganda e Beogradit dhe një pjesë e një shtypit reaksionar botëror kishin shpërthyer një fushat të paparë shpifjesh, trillimesh e dezionfarmatash të paskrupullta rreth Kosovës dhe demonstratave të saja. Gazeta "Zëri i popullit", organ i Komitetit Qendror të PP të Shqipërisë, botoi një artikull me titull "Pse u përdorë dhuna policore e tanket kundër shqiptarëve në Kosovë"[129], i cili me argumente të shumta dhe të pakundërshtueshme, hidhëte dritë mbi të vërtetën që detyruan popullin e robëruar të ngrihet në greva e demonstrata, rreth qëllimeve e kërkesave të vërteta të tyre. Me anë të këtij artikulli, Shqipëria ngriti fuqishëm zërin në mbrojtje të popullit tonë të robëruar dhe luftës së tij të drejtë, dënoi ashpër dhunën dhe terrorin barbar që u ushtrua mbi ne dhe riafirmoi edhe një herë qëndrimin e saj të drejt si ndaj popullit shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, ashtu edhe ndaj popujve të Jugosllavisë"[130]. Citon autori gazetën më prestigjioze të ish- sistemit komunist shqiptar.

Veç këtij shkrimi, shtypi shqiptar i kohës botoi edhe shumë shkrime tjera të cilat në mënyrë të thukët trajtonin situatën në Kosovë dhe padrejtësitë e shumta që iu bëheshin popullit të saj. Vlen të përmendet edhe shkrimi po aq i rëndësishëm që e botonte "Zëri i popullit" me titullin "Vazhdojnë masat represive dhe diskriminimi i shqiptarëve në Kosovë dhe në vise të tjera të Jugosllavisë"[131] Po ashtu edhe shkrimtari i njohur shqiptar Ismail Kadare, nuk qëndroi duarkryq dhe gjatë asaj kohe reagoi ashpër kundër gjenocidit dhe kulturocidit që po ndodhte në Kosovë, ai po ashtu në gazetën prestigjioze të vendit, botoi shkrimin: "Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh"[132],

Ky artikull i botuar në "Zërin e popullit" pati jehona të jashtëzakonshme dhe të paparë ndonjëherë. Populli ishte i bindur se "Zëri i popullit" ishte vërtet zë i popullit, se ai është edhe zëri i tij, se reagimi i Shqipërisë ishte zë i së vërtetës.

---

[129] Pse u përdor dhuna policore e tanket kundër shqiptarëve në Kosovë, Zëri i Popullit, Tiranë, 25 korrik 1981.
[130] "Zëri i popullit- zëri i së vërtetës", revista "Liria", nr. 3, f. 7.
[131] Vazhdojnë masat represive dhe diskriminimi i shqiptarëve në Kosovë dhe në vise të tjera në Jugosllavi", Zëri i popullit, Tiranë, 23 korrik 1981.
[132] Kultura shqiptare në shënjestër të shovinizmit serbomadh, Zëri i popullit, Tiranë, 29 maj, 1980.

Ndërsa në nënkapitullin "Populli i ynë kërkon liri e jo luftë", autori konstaton se "në përpjekjet e vazhdueshme për ta mbajtur popullin tonë nën thundër, vojvodët e rinj të Beogradit dhe veglat e tyre e kanë përdorur gjithmonë edhe shantazhin e rrezikut të shpërthimit të ndonjë konflikti të madh në Ballkan dhe të ndërhyrjes së superfuqive imperialiste. Këtë kartë ata po e përdorin edhe tani në fushatën propagandistike kundër popullit. Duke i akuzuar demonstruesit dhe përkrahësit e tyre si "luftënxitës dhe prishës të paqes e të stabilitetit në Ballkan", ata kërkojnë hapur nga populli që të rrijë urtë e të mos bëjë zë edhe kur ai është i shtypur dhe shfrytëzohet nga të tjerët. Sepse në të kundërtën, po të ngrihej e të kërkojë ndonjë të drejtë a liri, atëherë ai bëhej shkaktar i prishjes së paqes dhe stabilitetit dhe i ndërhyrjes së superfuqive në Jugosllavi, bile edhe në Shqipëri.[133]vije në përfundim ai.

Populli shqiptar kishte luftuar në shekuj për liri. Por, ai kurrë nuk e kishte dashur luftën, kurrë nuk kishte qenë luftënxitës. Luftërat që u bënë kurdoherë ia kishin imponuar të tjerët, ata që i shkelnin në vatër dhe ia rrëmbenin lirinë. Ai kurdoherë luftën e ka bërë me forcat e veta dhe kurrë në dëm të popujve të tjerë. Populli ynë nuk dëshironte luftë e gjakderdhje. Prandaj, kërkesat e tij i bënte në rrugë paqësore. Por, udhëheqja shoviniste e Beogradit, me qëllim që ta frikësoj atë, këtyre kërkesave iu përgjigj me dhunë dhe terrorin më të egër fashist. Por, ajo duhet ta dijë mirë dhe ta mbajë parasysh se masat e dhunës policore dhe ushtarake që u ndërmorën e po vazhdojnë akoma, vrasjet, burgosjet masive dhe torturat ç'njerëzore , kërcënimet e vazhdueshme me tanke, aeroplanë e masa të ashpra ligjore , jo vetëm që nuk e frikësojnë popullin , por e zemërojnë dhe e egërsojnë atë edhe më shumë, jo vetëm që nuk mundë ta qetësojnë, por e detyrojnë që, për realizimin e kërkesave[134], të mendojnë edhe në rrugë dhe me mjete të tjera.

Mënyra e vetme për ta qetësuar popullin e revoltuar të Kosovës, propozon autori i tekstit ishte realizimi i menjëhershëm i kërkesave të tija të drejta, heqja e gjendjes së jashtëzakonshme, lirimi i të gjithë të burgosurve politik, dënimi i atyre që urdhëruan ndërmarrjen e masave të përgjakshme ndaj popullit etj. Në të kundërtën, zjarri do të rritej edhe më shumë, e përgjegjësia për pasojat që mund të rrjedhin binte vetëm mbi udhëheqjen revizioniste jugosllave[135].

Në nëntitullin "Vetëm marksizmi- leninizmi tregon rrugën e vërtetë të lirisë", autori shkruan se "vetëm në kushte të këtilla të dhunës dhe terrorit të egër që po ushtrohet mbi ne e që nuk është parë as në kohën e Rankoviqit, secili e sheh qartë fytyrën e vërtetë gjakatare dhe antishqiptare të udhëheqjes shoviniste jugosllave dhe shërbëtorëve të saj, prandaj, çështja shtrohet prerë: O me popullin, o me armiqtë e tij, me popullin ose me ata që e vrasin, burgosin, torturojnë e poshtërojnë bijtë dhe bijat tona më të mira, me popullin ose me shovinistët rankoviçian dhe me këlyshët e tyre shqiptar. Kështu duhet të gjykojnë edhe bijtë e ndershëm të popullit në organet e ndryshme të pushtetit, e edhe ata që për të siguruar kafshatën e gojës , ose edhe të mashtruar, janë detyruar t'ia vënë vetes emrin e urryer të agjentit e të policit. Ata nuk duhet të lejojnë veten të bëhen mashë në duart e

[133] " Populli ynë kërkon liri e jo luftë", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 7.
[134] Po aty.
[135] Po aty.

armiqve dhe, për hir të "ubashëve" çetnik të Nishit dhe Beogradit, të vrasin, gjymtojnë e torturojnë vëllezërit e motrat e veta, bijtë dhe bijat më të mira të popullit[136].

Lufta për liri ishte detyrë dhe nder për çdo shqiptar. Por, populli ynë siç ka ditur në të kaluarën , do të dijë edhe në të ardhmen të bëjë dallime në mes atyre që vërtet luftojnë për interesat e tij dhe atyre që orvatën ta keqpërdorin e ta shfrytëzojnë luftën e tij të drejt për qëllimet e tija të errëta. Nuk mund të jenë kurrë me popullin kriminelët që kanë vrarë patriot të mëdhenj Bajram Currin e Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtina e Avni Rrustemin. Nuk mund të jenë kurrë me popullin ata që janë me çetnikët, ustashët e UDB-en e Jugosllavisë titiste për të luftuar kundër shqiptarëve. Populli i Kosovës, që kurrë në historinë e tij nuk u kishte rënë në qafë popujve të tjerë, as më vonë nuk lejuan asnjë shfaqje të nacionalizmit e shovinizmit ndaj popullsive jo shqiptare në Kosovë. Atë që e bënë të tjerët , nuk e benën asnjëherë shqiptarët. Lufta e shqiptarëve, edhe atëherë kur ndodhi, ajo ishte e drejtuar vetëm ndaj atyre që e shtypin dhe e shfrytëzuan, kundër shovinistëve robërues të Jugosllavisë e tradhtarëve shqiptarë të Kosovës, dhe jo kurrsesi kundër popujve jugosllavë, të cilët sikurse edhe ne shtypen e shfrytëzohen nga borgjezia e re jugosllave[137].

Lirinë e ëndërruar në shekuj, populli shqiptar do ta fitojë vetëm me punën dhe luftën e pa mposhtur të tij, vetëm me vuajtjet dhe sakrificat dhe gjakun e bijve dhe bijave të tij. Por në luftën e tij të lavdishme, megjithatë, nuk ishte vetëm. Me të ishin dhe do të jenë gjithë populli liridashës i gjithë botës. Andaj duke u nisur nga të gjitha këto, lufta e popullit tonë është e drejtë, dhe patjetër do të triumfojë[138].

3. 2. Aplikimi i formave të ndryshme të dhunës për nënshtrimin e shqiptarëve

Për nënshtrimin e Kosovës dhe të shqiptarëve, pushtetarët jugosllavë, vunë në zbatim dy format e njohura, të nënshtrimit, dhunës e shtypjes, dhe atë të demagogjisë dhe të mashtrimit[139]. Ata vranë me tradhti kuadro të njohura partizanësh shqiptarë, terrorizuan popullin e, nga ana tjetër , korruptuan ndonjë nga ato kuadro të luftës dhe zgjodhën nga llumi i popullit tonë njerëz të tillë për të vënë firmën e tradhtisë në mbledhjen famëkeqe të Prizrenit më 1945[140]. Që atë ditë ajo mbledhje trumbetohet nga pushtetarët si "shprehje e vullnetit të lirë të popullit shqiptar të Kosovës për vetëvendosje".

---

[136] "Vetëm marksizëm-leninizmi tregon rrugën e vërtetë të lirisë", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 8.

[137] Po aty.

[138] Po aty.

[139] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Format dhe mënyrat e shtypjes me qëllim të shpërnguljes dhe asimilimit, (Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës, 1877-1995), Prishtinë, 1997, f. 60.

[140] Pozita e Kosovës pas vitit 1945, ishte okupuese dhe kolonizuese. Kjo gjendje e saj u vendos më 10 korrik 1945, në Kuvendin e saj që në popull më tepër njihej si Kuvendi i Prizrenit. "Kuvendi i Prizrenit", ishte një tubim i një trupi jo të zgjedhur nga populli dhe në të morën pjesë 137 delegat dhe të ftuar të tjerë, nga të cilët vetëm 32 ishin shqiptar. Në të nuk kishin marrë pjesë përfaqësuesit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë dhe të aleatëve të tjerë të luftës që ishin garantë, se pas përfundimit të luftës çështja e Kosovës do të zgjidhej në bazë të dëshirës dhe vullnetit të lirë të popullsisë shumicë. Siç dihej në këtë u vendos që Kosova ti bashkohej Serbisë dhe po ashtu në këtë tubim u miratua Rezoluta që në një mënyrë mund të quhej dokument i parë zyrtar që vulosi aneksimin e saj nga Serbia.

Historia pas Luftës së Dytë Botërore, thuhej në shkrimin e Mehmet Hajrizit: "Tradhtarët shqiptarë mbrojnë interesat e pushtuesve", ka treguar edhe një herë qëndresën heroike dhe vendosmërinë e popullit tonë të robëruar për të luftuar kundër çdo armiku, sado i egër qoftë ai, dhe për të jetuar i lirë, ka treguar dashurinë që ka ai për Atdheun e tij të lashtë[141]. Kjo luftë nga ana tjetër, tregon se vullneti i kujt ishte shprehur në mbledhjen e Prizrenit.

Si eksponentë të regjimit titist, ata ishin njëkohësisht edhe altoparlantë e interpretues injorantë të demagogjisë së këtij regjimi në Kosovë. Ata ishin caktuar që gjithë jetën e tyre ti bëjnë aureolë regjimit shtypës dhe shfrytëzues në fuqi dhe me kujdes të veçantë krye-xhelatit të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi dhe të popujve të Jugosllavisë, J.B. Titos[142].

Fjalët e zgjedhura e të bujshme që i fliteshin bashkëpunëtorët e pushtetarëve për të ardhshmen e "bukur", që ata i përgatitshin popullit, megjithatë nuk mund ta fshehin gjendjen e rëndë të popullit shqiptar në Kosovë dhe aq më pak ta mashtrojnë atë. Populli i ynë e dinte se liria nuk mund të vijë nga tradhtarët dhe regjimi në fuqi. Zhurma e madhe që bëhej rreth "reformave" ekonomike e shoqërore, "autonomisë" së Kosovës, ose rreth "përfaqësimit të saj në Federatën Jugosllave", "demokratizimit" të jetës, "vetëvendosjes së marrëdhënieve të reja ndërnacionale" etj… ishin blofe me të cilat armiqtë duan ta vënë në gjumë ndjenjën kombëtare e klasore, luftën e popullit për çlirim. Populli shqiptar kurrë gjatë historisë së tij nuk është nënshtruar. Pushtimi i Kosovës nga policia dhe ushtria fashiste serbe, nuk mund të përjetësohet. Çfarëdo që ishin masat e pushtetarëve, populli edhe më tej kishte shumë bijë e bija trima që ishin të gatshëm për të bërë sakrificën supreme për lirin e popullit e që dinë të dalin fitimtarë mbi bajoneta e tanke[143].

3. 3. Në Kosovë, punëtorët kërkonin të drejtat elementare

Në shkrimin e Kadri Zekës, "1 Maji i këtij viti e gjeti Kosovën në llogore lufte", autori në pika të shkurtra na jep një pasqyrë të shkurtër për klasën punëtore dhe proletariatin në botë e veçanërisht në Kosovë. "Punëtorët" thotë artikullshkruesi është " pjesa më e vuajtur e popullsisë edhe sot bëjnë një jetë të mjerë dhe të varfër. Borgjezia e pushtetarëve bënë jetë luksoze dhe nuk çanë kokën për ta"[144]. Autori, pastaj vazhdon "se këtë jetë të mjerë të tyre nuk po mundë ta fshehin as pushtetarët e as të tjerët të cilët mundohen të mos e thonë të vërtetën. Ndërsa sa iu përket punëtorëve shqiptar, vërehej një vetëdije e lartë kombëtare dhe një organizim i mirëfilltë për luftën për të fituar të drejtat e tyre elementare. Këtë e dëshmuan edhe me pjesëmarrjen e tyre aktive në demonstratat studentore të vitit 1981. Në demonstratat e 1,2 dhe 3 prillit, që u zhvilluan në Prishtinë, morën pjesë mija punëtorë dhe u qëndruan heroikisht të gjitha lajkave mashtruese dhe terrorit policor të titistëve. Edhe në qendra të tjera të krahinës, punëtorët qenë forcë e

[141] Po aty.
[142] Po aty.
[143] Po aty.
[144] "1 Maji i këtij viti e gjeti Kosovën në llogore lufte ", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 10.

madhe në demonstrata dhe tani, pa iu trembur syri, kanë lënë punën e janë hedhur në greva[145].

Punëtorët kosovar e pritën një majin ashtu si u ka hije, e pritën me demonstrata e greva me parullat luftarake: "Duam punë", "Duam ngritje pagash", "Çmimet, stop", "Poshtë revizionizmi", Lart solidariteti ndërkombëtar". Të njëjtën gjë e bënë edhe punëtorët shqiptar që ndodhën në botën e jashtme. Ata në mënyrën më dinjitoze iu bashkuan vëllezërve të tyre në Kosovë duke organizuar greva e demonstrata. Kështu shprehen solidaritetin vëllazëror duke kërkuar liri dhe barazi për të gjithë"[146] thotë autori.

Edhe në këtë numër si edhe në numrat e mëparshëm vazhdojnë të bëjnë prezantimin e fjalëve të "Shokut Enver Hoxha për Kosovën ". Në vazhdim jepet fjala e tij e cila është lexuar në Kremlin , në mbledhjen e 81 partive komuniste. Në pika të shkurtra jepen shantazhet e Titosë që i organizoi nëpër mes disa udhëheqësve shqiptar siç ishin: Koqi Xoxe, Dali Ndreu, Liri Gega[147] etj.

Enver Hoxha në mes tjerash ndalet në problemin e pazgjidhur të çështje shqiptare në Jugosllavi, ku ndër të tjera veçojmë se "Jugosllavët na akuzojnë se gjoja ne jemi "shovinist, ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme dhe kërkojmë rektifikimin e kufijve shqiptaro - jugosllavë". Mjaftë nga miqtë tanë mendojnë dhe lënë të kuptohet se ne, komunistët shqiptarë, jemi në këto ujëra. Ne u themi miqve që mendojnë kështu se gabohen rëndë. Ne s'jemi shovinistë, ne as kemi kërkuar dhe as kërkojmë rektifikim kufijsh. Por ajo që ne kërkojmë dhe do të kërkojmë vazhdimisht nga titistët dhe për të cilën do ti demaskojmë ata deri në fund është të heqin dorë nga krimi i gjenocidit kundër popullsisë shqiptare të Kosovës, të heqin dorë nga terrori i bardhë kundër shqiptarëve të Kosovës, të heqin dorë nga dëbimi i shqiptarëve nga tokat e tyre dhe dërgimi në masë i shqiptarëve në Turqi, ne kërkojmë që popullsisë shqiptare në Jugosllavi ti njihen të drejtat, në bazë të kushtetutës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë."[148]

"Liria" e kishte bërë si traditë që në çdo numër të prezantojë biografinë e një dëshmori kombëtar. Në numrin e tretë të saj, në faqen e 12 , shkrimi me titull "Ai ra për të mos vdekur kurrë" i kushtohej patriotit dhe revolucionarit Qemal Stafës, veç shënimeve biografike që jepeshin për të, aty u prezantonte edhe veprimtaria patriotike e atdhetare e tij.

3. 4. Organizimi i punëtorëve tanë në perëndim dhe çështja kombëtare

Veprimtarisë atdhetare të mërgatës i kushtohet artikulli i Kadri Zekës me titull: "Punëtorët kosovarë në perëndim shpalosin flamurin e luftës. Ngjarjet tragjike që ndodhën në Kosovë gjatë vitit 1981, në njëfarë dore e bënë në mënyrë direkt ndërgjegjësimin e punëtorëve tanë në botën e jashtme, se edhe ata, si pjesë e pandarë e popullit shqiptar, në ato momente të vështira që po kalon atdheu, ngritën lart flamurin e luftës. Shtypja e shfrytëzimi, si dhe malli për atdheun e populli që i kishte lindur, kishin

[145] Po aty.
[146] Po aty, f. 10.
[147] Po aty.
[148] " Shoku Enver Hoxha për Kosovën", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 11.

grumbulluar pezmin e zemërimin e pa përshkruar në zemëratë e tyre. Kjo urrejtje ndaj shfrytëzuesve e shtypësve gjakatarë titistë u shprehte më së edhe atyre ditëve me një hov të papërmbajtur në demonstratat, mitingjet e protestat e shumta , që organizuan ata në botën e jashtme.

S'ka si ndodhte ndryshe. Punëtorët tanë, nga skamja e mjerimi, nga presionet që u bënte regjimi titist, ishin detyruar tua kthejnë shpinën familjes e fëmijëve të tyre, vatrave ku kanë lindur dhe çdo gjëje të dashur për ta. Punëtorët shqiptar në atë periudhë ishin më të bashkuar e më të vendosur se kurdoherë më parë në luftën e tyre të drejtë. Këtë e dëshmonin më së miri demonstrata dhe mitingjet e shumta e protestuese të njëpasnjëshme që u zhvilluan atëherë. Më 11 prill 1981 ishin grumbulluar mbi 400 kosovarë, në Bernë të Zvicrës dhe, me flamuj e parulla të shkruara[149], demonstronin rrugëve të qytetit, duke shprehur solidaritetin e tyre me luftën e vëllezërve dhe të motrave në Kosovë si dhe urrejtjen për gjakpirësit titist.

Më vonë, punëtorët të organizuar ishin drejtuar për në përfaqësitë diplomatike të Jugosllavisë në Bernë, ku kishin organizuar një miting proteste për terrorin e masakrat që kishin bërë ushtria e policia jugosllave në Kosovë.

Demonstrata e Bernit dhe të Cyrihut të Zvicrës, që ishin zhvilluar më 18 prill e në të cilën kishin marrë pjesë mbi 700 punëtor shqiptar. Ata kishin marshuar qytetit, duke brohoritur për të drejtat e popullit të tyre.

Pos këtyre, demonstrata nga punëtorët tanë ishin zhvilluar e organizuar edhe në Shtutgard e në Dyseldorf të Gjermanisë Perëndimore. Në të parën kishin marrë pjesë rreth 500 manifestues, kurse në të dytën mbi 800 veta.

Në të gjitha demonstratat që ishin organizuar, si dhe në manifestimet tjera, kishte zotëruar në bazë të të dhënave që kam në diskonim, një shpirt i lartë luftarak dhe një vendosmëri e pashoqe për të luftuar pushtuesit titist. Punëtorët tanë në mërgim organizonin demonstrata të shumta edhe me rastin e 1 Majit, ku bashkë me punëtorët e vendeve të tjera , ku para botës demokratike tregonin forcën dhe unitetin e tyre për liri dhe pavarësi.

Lufta e hapur dhe e pa kompromis e kosovarëve në mërgim demaskonte më së miri shpifjet e telegrameve të konsullatave jugosllave, që dërgonin në emër të punëtorëve kosovarë, ku gjoja se ata dënonin luftën e demonstratat e popullit tonë në Kosovë. Punëtorët, me parullat e tyre luftarake: "Kosova - Republikë", "Republikë-vetëvendosje", "Ja vdekje - ja liri"," Duam lirimin e shokëve", "Luftë, luftë natë e ditë, që të shohim pakëz dritë", "Lartë solidariteti ndërkombëtar", "Poshtë terrori e dhuna në Kosovë", "Poshtë UDB-eja fashiste jugosllave", "Poshtë titizmi", "Titizmi është fashizëm"… [150]u treguan jo vetëm pushtetarëve titist por gjithë botës se ishin të vendosur në luftën e tyre dhe se kjo luftë nuk do të pushojë deri në realizimin e të gjitha kërkesave të drejta të popullit shqiptarë.

Në fund të të gjitha demonstratave që u organizuan në botën e jashtme, u organizonin mitingje protestuese dhe u shpallnin kërkesat para përfaqësive diplomatike

---

[149] "Punëtorët kosovarë në perëndim shpalosin flamurin e luftës", "Liria", nr. 3, f. 13.

[150] Po aty.

jugosllave. Kërkesat e punëtorëve tanë në botën e jashtme ishin plotësisht identike me ato, që paraqitnin edhe demonstruesit në Kosovë.

Me luftën e popullit tonë në vazhdimësi ishte solidarizuar edhe opinioni përparimtar ndërkombëtar i cili dënonte në mënyrën më të rreptë masakrat e krimet ç'njerëzore të regjimit titist në Kosovë. Me demonstratat që u zhvillonin jashtë, iu bashkëngjitën shumë demokratë e miq të popullit tonë të cilët po shprehnin indinjatën e tyre të thellë për ngjarjet tragjike që po përjetonte populli shqiptarë. Ngjarjet e hidhura të Kosovës kishin zënë një vend të mirë edhe në shtypin dhe në mjete të tjera të informimit.

Në vazhdim autori i këtij shkrimi na jep një pjesë të një fjale të cilën e lexon një vashë kosovare në mitingun protestues në Dyseldorf të Gjermanisë, po japim vetëm disa pjesë :

"Të dashur bashkatdhetarë.

Tani e dimë se jo vetëm shqiptarët por tërë botën e kanë tronditur ngjarjet tragjike që po ndodhin në Kosovë. Populli i ynë punëtor, trim, paqedashës e i etur për liri dhe pavarësi, në një gjendje shumë të vështirë ekonomike dhe politike, gjeti rrugën më të përshtatshëm për ti kërkuar të drejtat e veta (borxhin e vjetër) nga qeveria jugosllave[151].

Qeveria jugosllave, që popullin kosovar e ka mbajtur dhe e mban gjithnjë në shënjestër, nxitoi me tanke e helikopterë, vrau, burgosi e theri lulen më të bukur- rininë e Kosovës. Kështu udhëheqësit jugosllavë e treguan edhe një herë fytyrën e vërtetë të pushtuesit, vrasësit, e fashistit gjakatar[152].

Ne jemi një popull i vogël përball një bishe të madhe, por jemi të fortë e të pamposhtur , sepse në zemrat tona kemi indinjatë e urrejtje të thellë për ata që na i shkelën vatrat dhe na i grabitën pasuritë[153].

Kosova prapë do të ketë fëmijë, prapë do të ketë rini , sepse vetë është e re. Kosova do të ketë liri, se për të po lufton dhe po derdh gjak. Ne gratë shqiptare nuk i lindim fëmijët në epruveta, nuk ia lëmë mbiemrin tonë, ne lindim shqiptarë me armë në brez, ne do të lindim e do të rrisim gjithmonë nipa e mbesa të Shotës e Azemit, Isa Boletinit e Bajram Currit…Dhe do të mburremi para botës dhe brezave të ardhshëm me historinë tonë. Çfarë mëkati bëri populli ynë që e kërkoi statusin e republikës? Kush janë irredentistë? Po pushtuesit? Kush kujt ia turbullon ujë? E kush mundohet ta lë dikë pa ujë?[154]

Ne do të fitojmë, thoshte autori i letrës, por, fitoret arrihen e mbrohen me përpjekje e sakrifica. Me luftë e djersë. Betohemi me mendje, me zemër e grushte të bashkuar për tokën, popullin, gjakun e derdhur e lirinë. i dënojmë armiqtë e popullit shqiptar, i thërrasim popujt e tjerë të Jugosllavisë dhe të botës që të ecin rrugës së sigurt të solidaritetit me protesta kundër shtypësve kriminel.[155]për të vazhduar autori i shkrimit me disa parulla që i kishin brohoritur mërgimtarët tanë në protesta: "Poshtë tradhtarët e

[151] Pjesë nga fjala e një motre kosovare mbajtur në mitingun protestues në Dyseldorf të Gjermanisë, "Liria", nr. 3.
[152] Po aty.
[153] Po aty.
[154] Po aty.
[155] "Punëtorët kosovarë në perëndim shpalosin flamurin e luftës", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 13.

Atdheut", "Nuk duam jetë pa liri", "Lavdi dëshmorëve që ranë për Atdheun", "I qofshim falë Atdheut tonë të dashur, Kosovës tonë të shtrenjtë[156]"

3. 5. Regjistrimi i popullsisë- alarm në ilegalen shqiptare

Lidhur me platformën dhe synimet e regjistrimit të popullsisë të vitit 1981, reaguan hapur disa intelektual shqiptar por edhe gazeta ilegale "Liria", sulmoi me të madhe pushtetarët dhe nismën për të bërë regjistrimin e popullsisë në kushte të pa kushte ose në gjendje lufte. Në shkrimet e saja gazeta shkruante se jugosllavët kishin zhvilluar dhe kishin organizuar me kohë një fushat sa të ethshme aq edhe perfide të propagandës dhe të agjitacionit në dëm të disa popullsive. Pas propagandës së tyre me një paturpësi që shkonte deri në tradhti të hapët kombëtare, ishin lidhur me zell të madh edhe disa renegatë shqiptarë të pushtet. Gjatë asaj periudhe fushata filloi të zhvillohej në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë ishte propaganda dhe agjitacioni i organizuar shtetëror në disa pjesë ti quajmë skajore të popullsisë shqiptare , në të cilat secili shovinistët jugosllav kishte marrë për detyrë që të dalë në popull dhe të ushtroj njëfarë ndikimi ç'kombëtarizues e asimilues, siç ishin disa të ashtuquajturit "torbeshë" apo "maqedonas mysliman" në Maqedoninë Perëndimore dhe të ashtuquajturit "mysliman" të viseve shqiptare në Mal të Zi. Të mos flasim pastaj për popullsinë shqiptare të viseve të Sanxhakut, te të cilët shovinistët e Beogradit kishin arritur ti shtypnin pa mëshirë ndjenjat kombëtare dhe të çrrënjosnin në masë të madhe gjuhën amtare shqipe. Ndërkaq, drejtimi i dytë ishte ai i frenimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve, kudo që të ishin ata, me presione të gjithanshme politike[157] etj.

Në punimin e Jusuf Gërvallës "Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve"[158] kishte dy nëntituj. Në nëntitullin e parë "Thirrjet për vampirizëm të "teorive " borgjeze shoviniste", në të cilën autori thotë se "Qysh para tri vjetësh, më 1978, një ekip i Televizionit të Beogradit në krye me poetin dhe gazetarin serb Lubivoje Rshumoviq, realizoi në Maqedoninë perëndimore një seri televizive "dokumentar" të përbërë prej dymbëdhjetë emisionesh një orësh. Duke vajtur nga fshati në fshat, si misionarët e dikurshëm të krishterimit, ky gazetar zhvilloi në atë rast biseda të pafundme me të ashtuquajtur "torbeshë" apo "maqedonas mysliman"[159]. Dhe në këtë mënyrë ky alamet gazetari në një mënyrë bëri propagandën më të ligë në popullsinë shqiptare duke u munduar që ti bindë për origjinën e tyre sllave.

Me një fjalë, emisionet ngulnin këmbë që të nxirrej antroponimia dhe mikrotoponimia sllave e kësaj pjese të popullsisë shqiptare dhe të viseve thjeshtë shqiptare"[160] për të vazhduar më tej se "E tërë kjo ishte një qëllim i tejdukshëm që, me anën e mjeteve dhe metodave të njohura të shovinistëve e "shkencëtarëve" të dikurshëm sllavë si Cvijiqi e Gjorgjeviqi, te kjo pjesë e popullsisë shqiptare të thellohet edhe më tej

---

[156] Po aty.
[157] Po aty.
[158] Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve, "Liria", maj 1981, f. 14.
[159] Dr. Tefik Basha, Shqiptarët sipas regjistrimit 1981-vërejtje për vitin 1991, Bota e re, nr. 10, 1991.
[160] "Regjistrimi i popullsisë në Kosovë u bë nën hijen e tankeve ", revista "Liria" nr. 3, 1981, f. 14

apolitizmi, pacifizmi dhe asimilimi, duke iu ngulitur asaj në kokë mendimin se më par mund të jetë gjithçka tjetër se sa popullsi shqiptare[161] komenton autori i shkrimit.

Por egërsia dhe guximi karakteristik i social shovinistëve jugosllavë në diskriminimin e një populli të tërë, kishte shpërthyer haptas në vitin 1980, në gazetën "Veçer" të Shkupit. Nga 25 shtatori deri më 21 tetor, kjo gazet e shovinistëve maqedonas kishte botuar në 23 vazhdime serinë e artikujve të Nijazi Limanovit me titull "Islamizimi i Maqedonisë". Dhe duke u përpjekur që t'iu dal zot "torbeshve" apo "maqedonasve mysliman", siç quhej këtu me kohë një pjesë e popullsisë shqiptare pjesërisht e asimiluar, gazeta në fjalë doli me sulme të hapëta shoviniste, të padëgjuara deri më atëherë, kundër popullit shqiptar[162].

Sipas të dhënave të Limanovit, një gazetar gjysmë analfabet dhe psikopat nga rrethi i Dibrës, populli shqiptar e paskësh pranuar në të kaluarën me gjithë dëshirë fenë myslimane, me qëllim që pastaj, me një "agresivitet" të paparë prej "pushtuesi" të egër, i kishte islamizuar edhe popullsitë sllave përreth[163]. Në marifetin e tij, Njazi Limanovi- edhe vetë një shqiptar i asimiluar – shkon aq larg sa jo vetëm i thërret të vampirizohen të gjitha forcat e errëta "shkencore" të borgjezisë sllavomadhe serbe, por atyre u siguronte edhe "lëndë" të re lidhur me "agresivitetin", "dhunën" dhe përgjithësisht "egërsinë" e "pushtuesve" shqiptarë. E shqiptaret- pushtetar nuk reagonin ndaj këtyre marrive të Limanovit. Me gjasë bota shkencore shqiptare pritnin që të reagonin pushtetarët, por kjo nuk ndodhi, dhe krejt në fund "Doli dhe reagoi, në mënyrë të thukët shkencore, Akademiku i njohur Prof. Dr. Ali Hadri"[164] thotë autori i këtij punimi.

Ndërsa në pjesën e dytë të punimit "Tragjedia në popull-farsa në pushtet", siç e cekëm në fillim, drejtimi i dytë nga do të dëmtohej popullsia shqiptare në regjistrimin e vitit 1981 të popullsisë , ishte shtrëngimi dhe presioni i gjithanshëm politik mbi shqiptarë. Ky shtrëngim u realizua në radhë të parë me burgosjen masive të djalërisë përparimtare të Kosovës e të viseve tjera shqiptare. Arsyeja për tu burgosur ishte fare e thjesht, ata u futeshin në biruca edhe për një libër, një broshurë, gazetë apo trakt, madje për një fjalë goje të thënë në rrugë. Qindra e mija shqiptar u privuan nga liria dhe i mbushën burgjet e Kosovës dhe të Jugosllavisë në një periudhë fare të shkurtër kohore. Sikur të mos iu mjaftonte kjo, bashkëpunëtorëve të pushtetarëve, morën flamurin e turpit në dorë dhe dolën para mikrofonave e kamerave, duke iu kërcënuar në njëmijë mënyra popullin shqiptar dhe djalërisë së tij përparimtare, me aq pasion të egër, sa të ta mbushnin mendjen se kishte hyrë deri në fyt borxh me djallin po more guximin qoftë edhe të marrësh frymë shqip[165].

Askujt në atë kohë s'ka mundur t'i shkojë mendja se regjistrimi i popullsisë në Kosovë do të vazhdonte edhe në kushtet e tmerrshme që u krijuan pas demonstratave të vitit 1981. Në një kohë kur rrugët, sheshet dhe vatrat tona binin erë gjaku, zhurmë tankesh e aeroplanësh dhe shkëlqim barbar të bajonetës së ngopur me gjakun e rinisë

---

[161] Po aty.
[162] Po aty.
[163] Njazi Limanovski, Islamizimi i Maqedonisë, (fejton),Veçer, Shkup, 25 shtator-21 tetor, 1980.
[164] "Thirrjet për vampirizëm të "teorive" borgjeze shoviniste", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 14.
[165] Po aty.

sonë, në një shtrëngim të tillë hekuri, siç ishte rrethimi i plotë i qyteteve dhe fshatrave tona, ora policore e ndalimi i çdo grumbulli të njerëzve, mbyllja e Universitetit dhe e të gjitha shkollave, mbyllja e ndërmarrjeve, fabrikave dhe uzinave- në një kohë të tillë, pra, një çështje siç është regjistrimi i popullsisë s'kishte gjë tjetër për qëllim , pos barbarin e pamasë të shovinistëve të Beogradit, që deshën ta provonin se si do të reagojë populli shqiptarë edhe në këtë gjendje të rëndë[166].

Shtypi, radio dhe televizioni i Beogradit filluan me mburrje të lavdërohen se, me gjithë situatën e krijuar në Kosovë, ata gjoja se kanë humbur pushtetin dhe regjistrimin e parashikuar të popullsisë po e vazhdonin në kushtet dhe në mënyrën më "normale". Si vazhdimisht qe 69 vjet e këtej, forcat e errëta borgjeze jugosllave deshën edhe kësaj radhe të përfitonin nga mjegulla dhe të mjegullonin statistikat e tyre të mjegullta dhe të zvogëlonin edhe njëherë numrin e shqiptarëve që jetojnë brenda kufijve administrativo-politikë të Jugosllavisë[167].

Por kjo siç dihej, nga kjo distancë kohore, nuk iu bëri nder qeverisë jugosllave .Dhe, aq më pak ndonjë dobi të caktuar. Sepse populli shqiptarë. Ndonëse kësaj radhe ishte i zënë me punë më të ngutshme, me varrimin e bijave dhe bijve të vet, me mjekimin e plagëve që morën ata nga ushtria dhe milicia jugosllave , me burgimet e rënda, ishte absurde të mendohet që ata e kishin harruar rëndësinë e regjistrimeve të popullsisë. Populli i ynë kishte një shpirt të madh. Ai e kishte përballuar burrërisht e heroikisht tragjedinë. Ai vendosi që ta përballoi edhe këtë regjistrim të popullsisë që u bë nën hijen e tankeve dhe nën zhurmën kërcënuese të aeroplanëve[168].

Për falsifikimet që borgjezia jugosllave që i kishte bërë prej motesh lidhur me numrin e shqiptarëve, populli gjithmonë e kishte të gatshme përgjigjen thotë autori i tekstit : Jemi shqiptarë, shqiptarë lindim dhe shqiptarë vdesim! Këtë përgjigje ka pasur kurdoherë në gojë populli i ynë, edhe kur i është vënë zjarri shtëpive, fshatrave e lagjeve tona, edhe kur xhandari serb na ka dërmuar pse i kemi thënë apo nuk i kemi thënë "mirëmëngjesi", edhe kur na kanë shkelur flamurin, na kanë plaçkitur kokrrën e fundit të misrit nga drithniku… Edhe kur na kanë zbritur deri në baltë dinjitetin kombëtar, duke na kërkuar armën që se kemi pasur, edhe kur na e kanë ndaluar gjuhën tonë të ëmbël"[169]. Për të vazhduar më tej autori i shkrimit se "Ç'është më e çuditshme, ne nuk ligemi – nga punët dhe fjalët e armikut. Sepse e dimë se çdo fjalë e tij është vetëm një farsë. Por, as armiku të mos mendojë se e mashtron lehtë këtë popull, i cili po e përjeton tragjedinë e madhe ku e katandisi shovinizmi jugosllav, por i cili ka vendosur me të gjitha forcat e veta t'ia vërë atij pushkën në gjoks[170]. Megjithatë autori thotë se kësaj fatkeqësie që po i ndodhë popullit tonë, do ti dalë zot shqiptari sidomos në këto vite të egra e barbare,që armiku hoqi maskën e tij të urryer dhe doli me fytyrën e tij të vërtetë edhe më të urryer, me fytyrën e kriminelit gjakpirës[171].

---

[166] Po aty.
[167] Dr. Tefik Basha, Eksodi bashkëkohor demografik shqiptar- shkaqet dhe pasojat, (Shqiptarët në rrjedhat ballkanike), Prishtinë, 1996, f, 304-305.
[168] Si në shënimin 165.
[169] "Tragjedia në popull- farsa në pushtet", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 14.
[170] Po aty.
[171] Po aty.

3. 6. Kontinuiteti patriotik i shqiptarëve

Në punimin tjetër të Jusuf Gërvallës, "Kosovë, sa hije të ka xhamadani i trimërisë!" Autori përshkruan krajatat e popullit shqiptar nëpër shekuj dhe luftën e tyre të drejtë për lirinë e vet dhe të tokave të tyre. Në mënyrën më të denjë prezanton luftën dhe vetë sakrificën e Mic Sokolit në grykën e Carralevës dhe vazhdon me paraqitjen e luftërave duke arritur gjerë më vitin 1945 kur shqiptarët as që pyeten për të mbetur nën Serbi e ish-Jugosllavi. Dhe një histori e tillë e lavdishme deshëm o s'deshëm ne kurdoherë ngjalli admirimin e miqve dhe tmerrin e armiqve. Kurse bota për rreth, e ballafaquar me një trimëri kaq të materializuar, pa pasur mundësi ta shqyrtojë e ta definojë saktësisht, bënte sehir dhe mbetej me gojë hapur, e çuditur nga një armë e tillë-gatishmëria mbinjerëzore për flijim dhe trimëri të pashembullt.

Artikullshkruesi thotë se "Bota, e cila dikur çuditej se ku gjente shqipja gjithë atë forcë kur matej me shtatë kralit, sot po çuditet, ç'e gjeti kështu shqiptarin e Kosovës të rebelohet "brenda natës" dhe si po i bënë ballë me muaj të tërë rrethimit të egër me tanke e bajoneta, ushtri e polici, si i bënë ballë tërbimit të zhurmshëm kërcënues të aeroplanëve mbi kokat e popullsisë duarthatë e të pa armatosur"[172]. Nëpër mes këtij shkrimi autori vë në pah rezistencën e madhe të popullit shqiptarë që e kishte bërë më shekuj për çlirimin e tokave shqiptare nga okupatorët.

Dhe ashtu siç ishte heshtur në mënyrë sistematike deri vonë lidhur me çështjen e më se dy milionë shqiptarëve të robëruar nga Jugosllavia, ashtu edhe më vonë u fol në mënyrë sistematike gjithmonë rreth e rreth çështjes sonë, pa përpjekjen më të vogël për të depërtuar në thelbin e saj.

Populli shqiptar i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të robëruara nga Jugosllavia nuk ishte e vërtet se u rebeluan "brenda natës". Rebelimi ç'është e vërteta ishte përgatitur për më tepër se dyzet vjet të vështira jete në kuadër të Jugosllavisë okupuese të Titos, e cila për popullin shqiptare, përballë propagandës lidhur me mirëqenën, barazinë ekonomike, politike e shoqërore me kombet dhe kombësitë e tjera , lidhur me gjëja vëllazërim - bashkimin, s'pati gjë tjetër pos shtypjes kombëtare e shoqërore, pos diskriminimit social e kulturor, pos shfrytëzimit të egër të pasurive të tyre natyrore dhe zbatimit të mjeteve të gjenocidit[173].

Në një situatë të tillë, tërbimi i armikut e shtynte edhe një herë shqiptarin ta veshë xhamadanin e trimërisë. "Edhe kur shtrohet çështja e armëve, Kosova këto i ka me bollëk, dhe bile të gjitha llojet e tyre. Ato i sollën me vete armiqtë e shumtë për ta robëruar e plaçkitur, por, bashkë me kokën e tyre në Kosovë lanë edhe armën që e kishin sjellë me vete. Kaluan mbi tokën tonë shumë pushtues: romaku, Bizanti dhe turku, greku dhe bullgari, serbi e malazezi, austriaku e francezi, italiani e gjermani, bile shumë prej tyre nga dy e tri herë. Që të gjithë ata me forcën e armëve të tyre, mendonin se do ti përjetësonin stemat dhe flamujt e tyre mbi fushën e gjerë të Kosovës. Por stemat dhe

---

[172] " Kosovë sa hije të ka xhamadani i trimërisë", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 15.
[173] Po aty.

flamujt iu shkelën me këmbë, populli i ynë mbeti kryelartë dhe e pasuroi arsenalin e armëve."[174] në ketë mënyrë autori gjen edhe shkakun primar pse shqiptarët ishin të armatosur.

Në vazhdim të shkrimit na jepen shumë argumente që dëshmojnë për trimëritë e popullatës që bënë kundër uzurpatorëve Petritët e Podujevës, (gjatë demonstratave studentore të vitit 1981) me një çifte gjahu, kishin çarmatosur dy autobus me policë të specializuar që kishin ardhur nga Beogradi, ua kishin kallur automjetet, dhe me armët e rrëmbyera kishin formuan në qytetin e tyre të dytën "Arbëri të Vogël". Në Prizren, kishte ndodhur që motrat tona, me emrin e Shotë Galicës në gojë, kishin sulmuar mbi hordhitë e urryera të xhandarmërisë serbe. Kurse në Prishtinë, studenti sypatrembur i kishte dal para tankut, kishte shpalosur gjoksin dhe kishte bërtitur "Shtjer, bishë fashiste, se se trembë dot djalin shqiptar"[175].

Që vlen të ceket thotë autori është rasti i Pejës, kur policia e Beogradit kishte vënë re, një femër shqiptare të veshur me kësulë, tirq e xhamadan shqiptar, u tmerrua dhe si shenjë hakmarrjeje u a vuri drynat dyqaneve ku endeshin veshjet tona kombëtare. Ata e kishin keqkuptuar në mënyrë banale çështjen e xhamadanit të trimërisë. Sepse, nuk ishte zhguna mbi gjokset shqiptare që atyre ua sillte trimërinë, por ishte zemra e tyre e brumosur me dashurinë për tokën mëmë dhe kombin dhe drejtësinë[176].

3. 7. Jehona e ngjarjeve të Kosovës në shtypin e huaj

Ngjarjet e mars-prillit të vitit 1981, patën një jehonë të madhe në shtypin dhe televizionin botëror. Tirana zyrtare gjatë atyre muajve me një kujdes të madh mblodhi, sistemoi dhe botoi gati të gjitha shkrimet që u botuan në shtypin e huaj gjatë vitit 1981[177]. Dhe autori Kadri Zeka, për ti njoftuar sa më drejt lexuesit e gazetës ilegale "Liria", ai në vazhdim të saj jep disa nga ato shkrime në artikullin "Jehona e ngjarjeve të Kosovës në shtypin e huaj" që shkruan shtypi botëror dhe komenton pranverën kosovare[178].

Në artikullin "Mosbesimi në Kosovë është i thellë", gazeta gjermano-perëndimore "Frankfurter Algemaine" e datës 9.4.1981 , ndër të tjera shkruan : "Kur u vjen uji deri në fyt, diktaturat fashiste të Amerikës Latine, vetëadministrimi jugosllav reagojnë siç duket bukur në mënyrë të ngjashme. Gjëja e parë është fajësimi "i armikut të jashtëm". Sipas Dolancit, është gjë kundërrevolucionare, nëse Krahina Autonome e Kosovës, që tani ndodhet nën Serbi, të shndërrohet në Republikë të shtatë të Jugosllavisë. Sepse , kjo sipas tij, qenka në kundërshtim me Kushtetutën. Mirëpo, është një parim i pranuar nga të gjitha kushtetutat e civilizuara që në bazë të procedurës legale këto gjëra mund të ndryshohen dhe Kushtetuta jugosllave parashikon një mundësi të tillë[179].

---

[174] Po aty.
[175] Po aty.
[176] Po aty.
[177] Shtypi botëror rreth ngjarjeve në Kosovë, Tiranë, 1981.
[178] Po aty.
[179] Po aty.

Sipas deklaratave të Dollancit e të Bakallit, shihet qartë se ata nuk janë të gatshëm t'i analizojnë shkaqet e vërteta të turbullirave në Kosovë dhe të marrin masa preventive politike, pos reprezaljeve."[180] Për të vazhduar më tej ajo, duke folur për kërkesat e shqiptarëve, thotë se " nuk doli vetëm kërkesa për shndërrimin e Kosovës në republikë, por edhe për bashkimin e të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi brenda një republike të tillë". E njëjta gazetë, në numrin e datës 30 prill 1981, duke folur për falsifikimin e fakteve nga qarqet zyrtare jugosllave, shkruan: "Sot në disa pjesë të gazetave jugosllave si në "Politika", "Nin" dhe "Politika Ekspres", thuhet hapur se udhëheqja nuk e ka thënë të vërtetën mbi përmasat e ngjarjeve në Kosovë, as para gazetarëve të brendshëm as para atyre të jashtëm…"[181] Në kritikën e gazetarëve thuhej se shtypi jugosllav u pengua nga qarqet zyrtare të politikës informative që të shkruaj për përmasat e vërteta të revoltës së shqiptarëve. Politika informative në përgjithësi ndiqte një rrugë të dyshimtë të informimit.

Gazeta suedeze "Zundsvalstinding", në një artikull me titull "Ngjarjet në Kosovë shqetësojnë shumë udhëheqësit e Beogradit", bënte këtë përshkrim të ngjarjeve: "Demonstratat u përhapën në të gjithë Krahinën, ku pjesën më të madhe e përbëjnë të popullsisë shqiptare. Demonstruesit kritikonin shtypjen që u bëhet shqiptarëve në Jugosllavi. Ata kërkonin liri fjale dhe shtypi, si dhe Krahina e Kosovës të shpallet republikë. Kosova që është zona më e varfër e vendit, është krahina autonome por që bënë pjesë në republikën më të madhe jugosllave, në atë të Serbisë. Autoritetet jugosllave i quajtën demonstruesit nacionalistë, separatistë dhe kundërrevolucionarë[182].

Papunësia në Kosovë është shumë e madhe. Produktiviteti dhe rrogat janë më të ulëtat në gjithë Jugosllavinë. Qarqet zyrtare vazhdojnë ti shpjegojnë turbullirat dhe demonstratat e Kosovës si veprime të kryera prej grupesh të ndryshme nacionaliste dhe theksojnë se çdo shenjë e nacionalizmit do të rëndohet rëndë. Megjithatë, kërkesa e shqiptarëve të Kosovës për republikë duhet të shikohet nga autoritetet e larta jugosllave në atë mënyrë që të zgjidhet drejtë"[183] për të vazhduar më tej gazeta se "nga plenumet e udhëheqjes më të lartë jugosllave dëgjohen thirrjet histerike që u drejtohen atyre kriminelëve serbë e malazezë, që kanë gjakosur 40 vjet tonë dhe që gjatë demonstratave shtien me armë mbi demonstrues, që të tregojnë "patriotizëm" dhe të mos e lëshojnë Kosovën. Kjo, sipas shovinistëve jugosllavë, nuk është nacionalizëm. Por, kur një popull i tërë kërkon të drejtat e tij më elementare, cilësohet si nacionalist e kundërrevolucionar"[184].

Edhe gazeta amerikane "The New York Times" e 27 prillit 1981, pasi thotë se situata me sa duket mbetet e pa stabilizuar, meqë përforcimet e ushtrisë dhe të policisë ndodhën akoma në Kosovë dhe tubimet politike janë akoma të ndaluara, shtron pyetjen : "Shteti Federativ i Jugosllavisë tashmë ka 6 republika. Çfarë ndryshimi do të sillte edhe

---

[180] "Jehona e ngjarjeve të Kosovës në shtypin e huaj", revista "Liria", nr. 3, 1981, f. 16.
[181] Po aty.
[182] Po aty.
[183] Gazeta suedeze " Zundsvalstinding", 1981.
[184] Po aty .

një republikë më shumë? Pse Kosova të mos jetë republikë, kur 85% të banorëve të saj (1,5 milionë) janë shqiptarë etnikë"[185] konstaton me të drejt autori.

Nga ana tjetër gazeta greke "Tovina" bënë këtë koment mbi ngjarjet në Kosovë: "Nuk duhet ta pakësojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin prej shumë javësh në rajonin autonom të Kosovës, në kufi me Shqipërinë, edhe në çoftë se kriza mbytet. Fakt është se autoritetet jugosllave nuk i kursejnë mjetet e tyre mbytëse. Këto telashe përbëjnë paralajmërim serioz"[186].

Gazeta zvicerane "Noje Cyrher" e 25 prillit (1981) shkruan: "Informacionet jozyrtare flasin për qindra viktima, ndërsa ato zyrtare për nëntë" dhe kështu vënë në dyshim ashtu si shumë gazeta të tjera numrin e viktimave të dhëna nga autoritetet zyrtare, dhe vazhdon "Pakënaqësia e shqiptarëve në Kosovë nuk shprehet nga grupet më militante shqiptare në Kosovë, por ajo shtrihet edhe në 300 mijë vetë që banojnë në Maqedoni e 50 mijë të tjerë në Mal të Zi."[187], vlen të përmendët se gazetarët zviceran e përcillnin nga afër ngjarjet në Kosovë, dhe kishin njohuri të mjaftueshme për situatën në Kosovë.

Në disa gazeta të Gjermanisë Perëndimore u botua artikulli i korrespodentit gjerman në Vjenë Volfgan Liman, me titull : "Qetësi varri në Kosovë" në të cilën thuhet : "Kosova e ndien veten të shtypur nga shteti jugosllav. Kjo është e qartë. Rritja e prodhimit shoqëror në fund të vitit 1970 ishte sa gjysma e mesatares së federatës. Më 1978 për çdo 1000 banor në Kosovë ishin të punësuar vetëm 107, ndërsa mesatarja e Jugosllavisë ishte 254. Nga ana tjetër, Kosova është e pasur me lëndë të para dhe ka një industri të mirë nxjerrëse, por i mungon industria përpunuese. Në Serbinë mbretërore dhe në Jugosllavinë e paraluftës, shqiptarët shtypeshin, por shtypja vazhdon edhe në Jugosllavinë e sotme, pavarësisht nga parullat "vëllazërim- bashkim"

Gazeta gjermano-perëndimore "Zyd Kurir" në artikullin me titull "Arsyet e turbullirave në Kosovë", shqiptaret e ndien veten të nënvleftshëm", pohon se: "Harresa e politikës së Jugosllavisë socialiste, e cila fletë me qejf për të drejtat dhe barazitë e kombeve dhe të kombësive në Kosovë, është zor të mohohen. Përveç kësaj, është edhe situata kritike ekonomike në vend e cila duket jashtëzakonisht e qartë në Kosovën e pa zhvilluar. Edhe sikur turbullirat e fundit të jenë vënë nën kontroll, Beogradi duhet të gjejë një zgjidhje politike, e cila për Kosovën ka qenë e domosdoshme."[188]

Edhe shtypi spanjoll nga ana e tij, i ka kushtuar shumë vend ngjarjeve në Kosovë. Gazeta "Avoi" e Barcelonës shkruan se Kosova është rajoni më i prapambetur në Jugosllavi dhe gati në gjithë Evropën. Shqiptaret që banojnë aty konsiderohen qytetar të dorës së dytë, pavarësisht nga përparimi që kanë pasur gjatë këtyre 35 vjetëve të fundit"[189]. Në bazë të të dhënave që kemi për informimin që bëhej në opinionin ndërkombëtar, mund të konkludohet se opinioni i gjerë ishte mjaft i informuar për gjendjen në Kosovë.

---

[185] Gazeta amerikane "The New York Times", 27 prill 1981.
[186] Gazeta greke "Tovina", 1981.
[187] Gazeta zvicerane " Noje Cyrher", 25 prill 1981.
[188] Gazeta gjermano-perëndimore " Zyd Kurir", 1981.
[189] Gazeta spanjolle "Avoi", 1981.

Në një koment të gjatë me titull "Kosova e varfër dhe e diskriminuar", gazetari spanjoll Torro Riesko shkruan "Shqiptaret e Kosovës konsiderohen njerëz të përbuzur në Jugosllavi. Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë dhe e gjithë Evropës. Ekziston një pabarazi e dukshme midis Kosovës dhe krahinave të tjera. Kosova është një vend i pasur me minerale. Atje nxirret më shumë se gjysma e qymyrgurit të Jugosllavisë. Ajo është e pasur me drithëra etj. Që nga mbarimi i luftës, reprezaljet atje kanë qenë të egra"[190].

Nga ana e saj, gazeta italiane "Koriera de la sera", duke shkruar për shkaqet e ngjarjeve në Kosovë, Krahinën e cilëson si rajonin më të prapambetur në Jugosllavi.

Kurse gazeta amerikane "Herald Tribjun" shkruan: "Kosova, në Jugosllavinë e botës së tretë, është pjesa më e varfër, me një hendek që rritet mes varfërisë dhe luksit relativ të republikës më të pasur, Sllovenisë"[191].

Gazeta austriake "Kurir" e 22 prillit, në artikullin me titull "Kosovë: a erdhi ushtria vetëm me një tufë dafinash?", ndër të tjera shkruan: "Ku qëndron e vërteta?" pyet në mënyrë kritike gazeta e Beogradit, duke transmetuar në mënyrë të zbutur informatat në mënyrë kontradiktore të Jugosllavisë lidhur me turbullirat në provincën e Kosovës të banuar me shqiptarë. Dhe, ky informacion është aq kontradiktor sa njeriu duhet tu besoj rrenave , si bie fjala: më 6 prill Stane Dollanci e përmendi numrin 11 të vrarëve dhe 57 të plagosurve. Mahmut Bakalli në konferencën e shtypit në Prishtinë e dha numrin 9 të vrarë dhe 260 të plagosur. Kjo sipas tij, ishte shifra "ekzakte". Më 16 prill, si njofton "Tanjugu" sekretari i Kryesisë së LKJ-së Dushan Dragosavac the se "armiku e ka realizuar qëllimin në kolektivet punonjëse të Krahinës, me parulla armiqësore ia doli të mashtrojë një numër të madh punëtorësh". Një ditë më vonë, Mahmut Bakalli thoshte se " fabrikat nuk e kanë ndërprerë për asnjë çast prodhimin dhe nuk është vënë re kurrfarë turbullire në mes punëtorëve[192].

Sipas Mahmut Bakallit, mes të plagosurve 55 kanë marrë lëndime nga plumbat, por Bakalli thotë njëkohësisht se ushtria nuk ka shtënë asnjëherë mbi njerëzit . Plagët e plumbave janë mistike, ose janë shkaktuar nga gjahu i arinjve. Ose ushtria jugosllave, e cila sipas të dhënave zyrtare, erdhi në Kosovë në natën e 1 prillit në të gdhirë të 2 prillit, dhe vërshoi tërë Krahinën, mos erdhi ajo vetëm me gjethe dafine në dorë? Gjendja e jashtëzakonshme, e vendosur me 2 prill, zyrtarisht, thonë, u hoq më 20 prill. Po "Tanjug-u" njoftonte se gjendja e jashtëzakonshme ishte hequr që më 9 prill në Prishtinë, Podujevë dhe Gllogoc e Lipjan. Ka mundësi që e hequra të hiqet dhe një herë!"[193]. Nga i tërë ky grumbull i të dhënave vërtet lindte dilema, si për shqiptarët njashtu dhe për të tjerët cilës dhe çka të besojmë nga ky mal i gënjeshtrave.

Në mënyrë të ngjashme komentojnë edhe gazetat të tjera të botës, të cilat shprehin mosbesim ndaj të gjitha informatave që japin qarqet zyrtare jugosllave dhe dënojnë dhunën e terrorin e pashoq të pushtetit jugosllav që kishte aplikua në Kosovë.

---

[190] Torro Riesko "Kosova e varfër dhe e diskriminuar", 1981.
[191] Gazeta italiane "Koriera de la sera", 1981.
[192] Tanjugu, 16 prill 1981.
[193] Gazeta jugosllave "Tanjug", 1981.

Dhe krejt në fund të revistës, në një qoshe të saj jepet një informatë shumë interesante ku nëpër mes të saj njoftohen lexuesit se "Klubet e kosovarëve kalojnë në duart e te zotëve", ku thuhej se "Në valën e furisë revolucionare, punëtorët kosovarë të qyteteve gjermano-perëndimor Dyzeldorf e Bilifeld, morën në dorë klubet e punëtorëve kosovar në këto dy qytete. Ata ndërruan udhëheqjen e klubeve e përzunë të dërguarit e konsullatave jugosllave, për shkak se , siç dihet botërisht, deri më tani këto klube ishin kthyer në çerdhe të spiunazhit prej udëbashëve të konsullatave dhe ishin bërë vatra të rrezikshme antishqiptare."[194]informonte dhe i përkrahte gazeta ilegale të mërguarit tanë.

Dhe në fund, thuhej se "Liria" e përshëndet këtë iniciativë revolucionare dhe shpreson se shembullin e këtyre punëtorëve do ta ndjekin edhe bashkatdhetarët në qytete tjera.

4. "LIRIA", nr. 4-5, në vlugun e arrestimeve, në flakën e luftës vazhdon të përkrahë popullin liridashës

Gazeta "Liria", organ informativ i organizatës ilegale "OMLK" edhe pas demonstratave studentore të vitit 1981, vazhdon të botohej. Për dallim nga numrat tjerë të botuar gjerë më tani, numri 4-5 ishte më voluminozë për nga numri i faqeve ngase ishte dy numërosh, kishte 24 faqe. Dhe gati –gati, kryesisht iu kushtohej ngjarjeve që trandën jo vetëm Kosovën por e tërë rajonin. Se sa ishin të rëndësishme më së miri e dëshmon angazhimi dhe sensibilizimi i opinionit ndërkombëtar për gjendjen e robëruar në Kosovë.

Revista ishte e dizajnuar në stilin e numrave të mëparshëm. Në ballinën e revistës, ishte një shkrim i Mehmet Hajrizit, që më tepër i ngjanë një apeli në formë trakti që iu drejtohej popullit shqiptar të Kosovës me titull "Përpara drejt fitores!" në të cilën autori shkruante se "Forcat ushtarake policore- fashiste të borgjezisë serbe mbuluan serish me zjarr e hekur Kosovën tonë të shtrenjtë. Dhjeta mija shovinist të tërbuar kanë shkelur në trojet tona të lashta për të na shtypur dhe nënshtruar. Kralet e rinj gjakpirës serbomëdhenj e kthyen edhe një herë Kosovën në një burg e kasaphanë të madhe fashiste. Ata nuk u mjaftuan me gjakun e bijve dhe bijave tona më të mirë që lau rrugët e qyteteve të Kosovës në masakrën e përgjakshme të marsit dhe të prillit, por mbushën edhe burgjet e tyre famëkeqe me mijëra petritë e sokolesha shqiptare në Kosovë dhe Jugosllavi"[195].

Etja e çmendur për gjak shqiptari, shovinistët serbë i çoi deri atje sa të përdorin mjete e metoda dhune, nga të cilët ishin përmbajtur edhe nazi-fashistët hitlerian.

---

[194] "Klubet e kosovarëve kalojnë në duart e të zotëve", revista "Liria", nr. 3, 1981.
[195] "Përpara drejt fitores!", revista "Liria", nr. 4-5, 1981, f. 1.

Mehmet Hajrizit, autori i shkrimit "Përpara drejt fitores!",
botur në ballinën e gazetës 'Liria', Gusht 1981, Nr. 4 - 5.

Ata mendonin se me një sulm të rrufeshëm, të egër dhe të gjithanshëm mbi Kosovën, të planifikuar me kohë do të frikësonin dhe të nënshtronin shpejt popullin shqiptar. Kështu në këtë mënyrë do të krijohej një teren i lirë për të realizuar në Kosovë politikën shoviniste të Çubrilloviqit e të Rankoviqit me shokë e që ishin bërë qëllime jetësore të pasuesve të tyre, klikës serbe në Beograd. Këto qëllime të bijve të Karagjorgjeviqëve nuk ishin më sekrete për askënd në botë, ata i kishin nxjerrë ato sheshit me bisht e me brirë, duke treguar hapur se duan t'i marrin edhe ato pak të drejta që i kishim fituar me gjak, donin që ta fusnin Kosovën në një sundim edhe më të egër, donin që ta shtypnin, e ta shfrytëzonin barbarisht, donin ta shndërronin përjetësisht në një tokë serbe, donin ta zhduknin gjuhën, kulturën, artin, letërsinë, këngët, simbolet tona kombëtare, të na bënin që të harrojmë historinë tonë të lavdishme, donin të na i fashitnin

njëherë e përgjithmonë ndjenjat tona të zjarrta e të pashuara të lirisë dhe të patriotizmit, idealet tona të shenjta[196].

Ky sulm i ri shovinist mbi Kosovën dhe tokat tjera shqiptare nën Jugosllavi nuk ishin vetëm një represion i egër ndaj kërkesave tona krejt të drejta e të ligjshme, të shprehura në demonstratat heroike popullore në Kosovë, por pjesë e planit të përgjithshëm strategjik serbomadh të shtrirjes së hegjemonizmit dhe sundimit të tij mbi gjithë Jugosllavinë e të sulmit, në bashkëveprim me social imperialistët sovjetikë, edhe kundër Shqipërisë e më gjerë[197].

Gjendja e rëndë dhe e padurueshme që ishte krijuar në Kosovë, sidomos në muajt e fundit (1981), nga dhuna e terrori shovinist, shtypja kombëtare e shoqërore dhe shfrytëzimi i egër kolonial, represioni fashist e persekutimi në masë gjithnjë në shkallëzim, bënë gjithnjë të domosdoshme nevojën e organizimit të një rezistence të fuqishme popullore kundër këtyre valëve të tërbuara shoveno – fashiste e të vazhdimit dhe intensifikimit të luftës për të drejtat e mohuara me zjarr e barot dhjeta vite me radhë nga okupuesi barbar i Beogradit[198] dhe vet Jugosllavia.

Për të vazhduar më tej, autori i drejtohet popullit me këtë mesazh:" Popull shqiptar, ne, bijtë e tu besnikë deri në vdekje, bëjmë thirrje që lufta për të drejtat tona të ligjshme, lufta kundër masave të egra shoviniste antishqiptare të organizohet me guxim e heroizëm, të rritet e zgjerohet dhe të vazhdohet me vendosmëri deri në realizimin e plotë të kërkesave tona të drejta. Rruga e rezistencës, e luftës së vendosur, është rrugë e vetme e fitores, rrugë e vetme e realizimit të të drejtave tona"[199].

Artikullshkruesi na ofron argumentet përse kërkesa për Kosovën- Republikë, duke shtuar "Ne kërkuam të drejtat tona, kërkuam republikën për shqiptaret në Jugosllavi, e drejtë kombëtare kjo që e kanë të gjithë popujt e federatës jugosllave. Shovinistët serbomëdhenj, të prekur në interesat e tyre grabitqare, duke mos pasur asnjë argument, asnjë bazë të shëndoshë për t'i mohuar kërkesat tona krejt të ligjshme, thirrën me lehtësi "kundërrevolucion"!, "u prish federata jugosllave"! e plot blofe si këto, dhe menjëherë dërguan në Kosovë hordhitë barbare të ushtruara për gjenocid e terror mesjetar me qëllim që të na nënshtrojnë. Por llogarit nuk iu dolën si i menduan. Ata, vërtetë vranë, plagosën, gjymtuan e burgosën mija djem e vajza trime shqiptare, por nuk arritën ta frikësojnë dhe nënshtrojnë asnjë, populli heroik i Kosovës qëndroi dhe po qëndron në këmbë i paluhatshëm, i pa përkulur. Dëshmorët tanë të lavdishëm dhanë jetën në demonstrata duke thirrur: "Rroftë republika", "Rroftë populli shqiptar", "Rroftë republika e jonë", "Rroftë liria", "Përpara drejtë fitores[200]". Ky heroizëm i paparë i bijve dhe bijave tona ishte shembull i edukimit atdhetar për rininë tonë.

Pavijonet, korridoret dhe qelitë e errëta të burgjeve fashiste në Kosovë, ku u torturoheshin çnjerëzisht patriotët dhe revolucionarët shqiptarë, dhe ushtonin nga thirrjet

---

[196] Po aty.
[197] Po aty.
[198] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Liria"- gazetë ilegale me fizionomi të re dhe me qëndrime të qarta", (fejton), Epoka e Re, 15 prill- 3 maj 2006.
[199] Po aty, Epoka e Re, 27 prill 2006.
[200] "Përpara drejtë fitores", revista "Liria", nr. 4-5, 1981, f. 2.

protestuese dhe këngët patriotike të korit madhështor të të burgosurve të panënshtruar. Bijtë dhe bijat e Kosovës edhe në pranga, të lidhur dhe të dërmuar, i fusnin tmerrin armikut me qëndresën heroike të tyre, me vendosmërinë e tyre deri në fitore[201].

Duke mos pasur mundësi që tërë popullin ta fusin në burgje, armiqtë e egër kishin organizuar dhe vënin në zbatim një proces të gjatë dhe të pandërprerë persekutimesh në gjithë popullatën, nëpër mjetë të ashtuquajturit "diferencim politik" të masave popullore, i cili kishte për qëllim që një për një të merreshin në pyetje çdo shqiptar dhe, nën presionin shovinist serbë, ti dënonin demonstratat dhe kërkesat e tyre, të përshëndetën pushtuesit dhe dhunën fashiste që ushtrohej në Kosovë, populli shqiptar të përçahet me vëllezërit e tij dhe të nënshtrohej plotësisht përpara armikut. Por duhet theksuar se ky "diferencim" në të shumtën e rasteve në popull, tek punëtorët, në rini madje edh në disa instanca udhëheqëse, ishte sabotuar dhe kishte dështuar plotësisht, ose ishte kthyer në manifestim proteste kundër regjimit shtypës[202].

Në të vërtetë, i gjithë populli merrte pjesë në demonstrata dhe s'kishte si të hiqte dorë nga kërkesat e veta. Të diferencuar nga kërkesat e demonstruesve, nga populli, mbetën vetëm një grusht tradhtarësh e bashkëpunëtorësh të mjerë shqiptarë, që me kohë kishin qenë kundër popullit dhe interesave të tij."Edhe në të ardhmen", porosiste autori i tekstit që nuk ishte identifikuar nga organet hetuese të SPB-së, " duhet të sabotohet dhe të dështojë çdo përpjekje e armikut për të na nënshtruar dhe për të na vënë kundër njëri-tjetrit. Vetëm të bashkuar, të lidhur sup me sup, duke lënë anash çdo hasmëri personale, si vëllai me vëllanë, në ndërmarrje, në fshat, në shkollë, kolektiv e kudo, ne mund të mbrohemi, të sabotojmë aksionet e armikut, të ngrihemi dhe të protestojmë hapur, siç tregojnë shumë shembuj të tillë të guximshëm gjatë këtyre muajve të fundit.[203]"

Duke e lexuar tekstin, në një mënyrë të prerë gjejmë se si autori iu drejtohet punëtorëve: "Punëtorë të Kosovës.

Pasojat e politikës revizioniste të shtypjes e të shfrytëzimit që po ushtrohet në Kosovë, më shumë se kudo, bien mbi supet tuaja. Grabitësit tanë të egër, me krahët tuaj, me forcën tuaj punëtore, me gjakun dhe djersen tuaj, rrëmbejnë pasurit tona të shumta. Nga gjithë puna dërmuese që bëni natë e ditë, ju mezi fitoni kafshatën e bukës për vete dhe fëmijët tuaj. Në demonstrata masive të pranverës së përgjakshme të këtij viti, bashkimi i radhëve të punëtorëve, lidhja e gjokseve tuaj si një barrikadë e pa shpërthyeme çeliku, i tmerroi armiqtë. Ngjarjet e përgjakshme të marsit dhe prillit në Kosovë ishin një provë e vështirë, por, shumë e suksesshme, e bashkimit jo vetëm e klasës punëtore por e të gjithë popullit në rezistencën e përbashkët për interesat tona të përbashkëta. Armiku ynë goditi për vdekje qindra punëtor trima, arrestoi dhe përjashtoi nga puna, ndau nga radhët shokët tonë të dashur. Nëse na do të ishim indiferent ndaj këtyre veprimeve të egra, ai dot na sulmojë një nga një të gjithëve[204].

Prandaj është e domosdoshme që të organizojmë rezistencën e përbashkët kundër shtypjes, për interesat tona të përbashkëta. Nëse viteve të kaluara në Kosovë klasa

[201] Po aty.
[202] Po aty.
[203] Po aty. Epoka e Re, 28 prill 2006.
[204] Po aty.

punëtore organizoi dhjeta greva e protesta, tani ato duhet të jenë me qindra. Të kundërshtohet me to me forcë e këmbë ngulje shtypja dhe shfrytëzimi i klasës punëtore, të kërkohet kudo rritja e pagave, të kërkohet kthimi i shokëve në punë, lirimi i tyre nga burgjet, pushimi i ndjekjeve dhe persekutimeve ndaj punëtorëve me të ashtuquajturat "diferencime", të kërkohen kushte më të mira të punës, jetesës, banimit, të mbrojtjes shëndetësore etj. Në kushtet e mohimit të të drejtave tona kombëtare, lëvizja popullore në Kosovë do të vazhdojë e patundur dhe me vendosmëri deri në realizimin e plotë të tyre. Por, që të arrijë këtë, ajo duhet të jetë e organizuar më mirë dhe e bashkuar si një trup i vetëm. Prandaj, ne i bëjmë thirrje gjithë klasës punëtore në Kosovë , që ti organizojë radhët e veta në çdo ndërmarrje, në çdo repart, çdo brigadë e çdo njësi punese, me qëllim të mbrojtjes të drejtave të saj nëpër mjetë të luftës së përditshme klasore, të zhvillimit të vazhdueshëm të kësaj lufte për kërkesa ekonomike e politike. Të lidhemi me besa- besë me njëri- tjetrin që, bashkërisht, të mbrohemi dhe të luftojmë për të drejtat tona."[205]

Autori në tekst iu drejtohet të gjitha strukturave të qytetarëve të Kosovës, këtu nuk mungojnë apelet drejtuar edhe fshatarëve të saj, dhe sipas shkrimit shpresa më e madhe për ndërrime radikale është te rinia studentore dhe fshatarësia, andaj ai (autori) shkruan: Fshatarë të Kosovës,

Kërkesa e të gjithë popullit tonë për republikë, është kërkesë për shpëtimin tonë nga sundimi i egër shovinist serbë, i cili në bashkëpunim me shovinizmin malazezë dhe maqedonas, shtyp dhe shfrytëzon edhe vëllezërit tanë në Maqedoni e Mal të Zi, është kërkesë kundër grabitjes së pasurive të tokës sonë, për të cilën fshatari patriot shqiptar ka luftuar me shekuj, është kërkesë kundër rrëmbimit të drithit të arave tona, bukës sonë, bagëtive tona.

Është kërkesë për një jetë më të mirë e më të lirë, për shkolla shqipe, për kulturën tonë, kërkesë për zhdukjen e varfërisë së mjerueshme dhe kurbetit të hidhur, papunësisë dhe analfabetizmit, kërkesë për të qenë zotë në trojet tona. Bashkë me bijtë dhe bijat tuaja , me punëtorët, studentët, me nxënësit e intelektualët, me këto kërkesa në gojë dhe në zemëratë që ndizeshin flakë u derdhët edhe ju rrugëve e shesheve të Kosovës, u gjakosët me heroizëm me xhelatët fashist"[206].

Ishte mase e qartë se populli i ynë luftonte për kërkesa të këtilla, e jo "kundër popullit serbë e popujve të tjerë të Jugosllavisë", siç mundoheshin të gënjenin pushtetarët..

Në historinë tonë ishin të njohura luftërat dhe përpjekjet heroike të fshatarësisë për të drejta e liri, për bashkim kombëtar. Ky patriotizëm revolucionar i pasuruar në traditën luftarake të popullit tonë për të drejta dhe liri, fshatarësia patriote shqiptare e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, përbënte forcën më të madhe , e cila bashkë me gjithë popullin dhe nën udhëheqjen e liridashësve marshonte drejtë fitores së sigurt.

"Por, kjo forcë e madhe e fshatarësisë" thoshte autori "duhet të organizohet e të bashkohet me luftën e përditshme të fshatarëve për përmirësimin e kushteve të jetesës,

[205] Revista ilegale "Liria", nr. 4-5, 1981, f. 2.
[206] "Përpara drejt fitores", revista "Liria", nr. 4-5, 1981.

për rrugë, ambulancë dhe shkollë, për tokën e bukës, për dritën e drejtësinë, kundër taksave dhe tatimeve, kundër dhunës dhe presionit fashist, që sidomos tani pas demonstratave po manifestohet brutalisht edhe në fshat"[207] autori pyet: "Cili fshatar i ndershëm shqiptar duron t'i shahen në sytë e tij bijtë e bijat që ranë në fushën e nderit, në ngjarjet heroike të marsit e prillit, t'i shahen e t'i njollosen ata mija bijë e bija që po dergjen burgjeve të errëta , t'i shahet e njolloset vetë lufta e popullit tonë për të drejtat e tij të ligjshme, ti shahet historia e tij, kultura, gjuha, flamuri e nëna shqiptare? A ka më të tmerrshme e më të rëndë për fshatarin tonë të ndershëm e patriot, me dinjitet burri shqiptar, sesa të poshtërohet ditë e natë, të bastiset e të kontrollohet nga banditët shovinistë dhe t'i shkelet nderi i shtëpisë dhe kombit?"[208]

Ishte mjaftë domethënëse për pushtetarët se me 1 e 2 prill, kur shpërthyen demonstratat e mëdha popullore, dhjeta familje shqiptare, që kishin qenë në gjak më parë mes veti, falën gjaqet dhe u përqafuan vëllazërisht për interesin e përgjithshëm, për hir të bashkimit. Ky nuk ishte një fenomen, por një proces që vazhdoi edhe më vonë. Apo të marrim një fakt tjetër: Vëllezërit tanë në kurbet të hidhëruar, kudo që u ndodhën, me të dëgjuar ç'ndodhi në Kosovë, u hodhën edhe ata në demonstratat e shumta dhe në protesta, duke u bashkuar kështu me luftën e drejtë të vëllezërve të vet. Edhe larg Kosovës ata jetonin me Kosovën dhe për Kosovën e tyre të shtrenjtë[209].

Autori i shkrimit "Përpara drejt fitores", me një mesazh të veçantë i drejtohet me një respekt e dashamirësi edhe rinisë kosovare: "Rini e kuqe e Kosovës. Rini punëtore, fshatare, shkollore studentore e Kosovës trime, rini e barrikadave dhe aksioneve heroike revolucionare, ti i vure gjoksin e para tiranëve shtypës e gjakatar, ti e para derdhe gjakun rinor në përleshjet e përgjakshme me armikun. Dhjeta vite me radhë armiqtë u munduan, me çdo mjet e me çdo formë, të të degjenerojnë, të të fusin në një jetë të ç'thurur, pa ideal e pa kuptim, por ti ruajte me besnikëri traditën e të parëve, trimërinë e baballarëve, idealin e aspiratat e popullit që të lindi, dhe në ngjarjet e fundit shembe për tokë gjithë ato përpjekje të ethshme e të vazhdueshme të armikut kundër teje, i tregove gjithë botës se :në Kosovë po rritet dhe po ngrihet një rini e madhe , e fortë , e bashkuar, trime dhe e vendosur , që nuk do të durojë më shtypjen dhe robërinë[210]. Ja përse, shovinistët e tërbuar kanë drejtuar pikërisht kundër rinisë gjithë atë forcë sulmesh barbare.

Ata vranë e plagosën qindra të rinj, arrestuan mijëra të tjerë, që ta frikësojnë rinin tonë, mbyllen Universitetin dhe shkollat , arrestuan dhe përjashtuan nga puna arsimtarët patriot dhe revolucionarë kudo në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, zvogëluan numrin e nxënësve dhe studentëve duke lënë në rrugë mija djem e vajza shkollare[211], na ndan nga profesorët të dashur të Universitetit të Tiranës për t'i zëvendësuar ata me serbomëdhenj nga Nishi, dhe tani po bëjnë plane për shkapërderdhjen e Universitetit tonë dhe për largimin e studentëve shqiptarë edhe nëpër universitete jugosllave dhe, më në fund, ndryshimin e të gjitha plan-programeve mësimore, duke filluar nga klasat më të ulëta të

[207] Po aty.
[208] Po aty, f. 3.
[209] Po aty.
[210] Po aty.
[211] Mbi fillimin e vitit të ri shkollor në Kosovë, Zëri i popullit, 30 gusht 1981.

shkollës fillore e deri te Universiteti, duke hequr prej tyre edhe ato pak elemente që mundë t'i edukonin të rinjtë tanë me ndjenjën kombëtare e patriotike shqiptare."[212]

Autori në këtë shkrim iu bënë thirrje studentëve dhe rinisë në përgjithësi, që të protestojnë dhe të jenë shumë të matur, të organizuar dhe të ruhen nga tradhtarët. Shokë studentë e nxënës thotë autori, "Protestoni në mënyrë të organizuar dhe me forcë kundër organeve qeveritare që duan të lënë rrugëve, jashtë universiteti e shkollave shokët tuaj!

-Kërkoni me këmbëngulje që të ktheheni në radhët tuaja shokët dhe shoqet e përjashtuara nga shkolla dhe fakulteti!

-Kërkoni që t'iu lejohet vazhdimi i studimeve në gjuhën shqipe vëllezërve tanë nga Maqedonia, Serbia e Mali i Zi!

-Protestoni, kundër ndjekjes e persekutimit që po ushtrohet ndaj studentëve, nxënësve e profesorëve patriot!

-Protestoni kundër censurës shoviniste në plan-programet mësimore, në historinë tonë kombëtare, gjuhën, letërsinë e kulturën tonë!

-Kërkoni që profesorët nga Universiteti shtetëror i Tiranës të vazhdojnë ligjëratat në Universitetin tonë!

-Protestoni kundër hallakatjes e shkapërderdhjes së Universitetit dhe studentëve!

-Vazhdoni kërkesat tuaja të drejta për kushte shkollimi e studimi!

-Organizoni në fakultete e shkolla shokë e shoqe më besnikë, të vendosur për të luftuar me çdo sakrificë për të drejtat tuaja e për t'u bashkuar me luftën e të gjithë popullit për të drejta e liri![213] porosiste autori i shkrimit

Vetëm kështu mundë të quhemi bijë e bija të popullit tonë trim e patriot, që na lindi e na rriti, na edukoi e kaliti si thesarin e tij më të çmuar, lulen e tij më të bukur, si trima e heronj, luftëtar të lavdishëm të betejave revolucionare.

Autori vazhdon duke konstatuar se asnjëherë në historinë e Kosovës nuk është parë një pjesëmarrje aktive kaq e gjerë e gruas shqiptare në lëvizjet popullore si kjo, në ngjarjet e fundit historike të popullit tonë të robëruar.

---

[212] "Përpara drejt fitores", revista "Liria", nr. 4-5, 1981, f. 4.

[213] Po aty, f. 4.

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

Gusht 1981 Nr. 4-5

PËRPARA DREJT FITORES!

Populli shqiptar i Kosovës kreshnike,

Forcat ushtarake policoro-fashiste të bor
gjesisë serbe shuluan sërish me zjarr e hek
kur Kosovën tanë të shtrenjtë.Mijëra mijë
ra shovinistë të tërbuar kanë shkelur në
trojet tona të lashta për të na shtypur dhe
nënshtruar.

Krahët e rinj gjakpirës serbomëdhenj e
kthyen edhe një herë Kosovën në një burg e
kasaphanë të madhe fashiste. Ata nuk u nja
ftuan me gjakun e bijave dhe bijve tanë në
të mirë që las rrugët e qyteteve të Kosovës
në masakrën e përgjakshme të marsit e të
prillit, par shoshën edhe burgjet e tyre fa
shkoqe me mijëra petrita e sokolesha shqip
tarë dhe po ushtrojnë një dhunë e terror të
papar ndaj gjithë popullsisë shqiptare në
Kosovë e Jugosllavi.

Etja e qendur për gjak shqiptari, shovi
nistët rankoviçistë i çoi derri atje sa të
përdorin ajetc e metoda dhune, nga të cilat
ishin përmbajtur edhe nazi-fashistët hitle
rianë.

Ata nenduan se me një sulm të egërsuar
të egër dhe të gjithanshëm mbi Kosovën, të
planifikuar me kohë nga Rankoviçi dhe klika
e tij në pushtet,do të na frikësonin dhe të
na nënshtronin shpejt. Kështu do të krijoh
ej një terren i lirë për të realizuar që Ko
sovë politikën shoviniste të Çabrilloviçit e
të Rankoviçit me shokë, që janë bërë sot që
llinë jetësore të pasacive të tyre, klikës
serbe në Beograd. Kësa që linë të bijve të
sotëm të Karagjorgjeviçëve nuk janë më sek
rete për askënd më botë, ata i kanë sajerë
ata shoshat, me bisht e me brirë, duke tre
guar kapur se duan të na i marrin edhe ato
pak të drejta që fituam me gjak, duan ta fa
sin Kosovën në një sundim edhe më të egër,
ta shtypin e shfrytëzojnë barbarisht, ta
shndërrojnë atë përjetësisht në një tokë se
rbe, ta shdukin gjithën, kulturën, artin, le
trësinë, këngët, simbolet tona kombëtare,të
na bëjnë të harrojmë historinë tonë të lav
dishme dhe të na i shkelin e peshtërojnë,të
na i fashitin njëherë e përgjithmonë ndje
njat tona të sjarrta e të pashuara të liri
së dhe patriotizmit,idealet tona të shenjta.

Ky sulm i ri shovinist mbi Kosovën tonë
martire nuk është vetëm një represion i eg
ër ndaj sërbesave tona krejt të drejta e të
ligjshme, të shprehura në demonstratat hero
ike popullore në Kosovë, por pjesë e planit
të përgjithshëm strategjik serbomadh të sh
trirjes së hegjemonizmit dhe sundimit të tij
mbi gjithë Jugosllavinë e të sulmit, në ka
dhërrepsin me socializmin realisht sovjetik,
edhe kundër Shqipërisë dhe më gjerë.

Gjendja e rëndë dhe e padurueshme e krija
r në Kosovë, sidomos këta muajt e fundit,
nga dhuna e terrori shovinist, shtypja kya
ltëre e

KOSOVA REPUBLIKË!

Për këndë të flasësh më parë?, pyet autori i tekstit Për ato mijëra vajza trimëresha, që qëndronin në ballë të demonstratave popullore , bile shpesh edhe në udhëheqje të tyre, për ato mijëra Shotë Galica ,Margarita Tutulani, Bule Naibi e Ganimete të gjalla, apo për ato gra trimëresha të qyteteve dhe të fshatrave të Kosovës që gatuan bukë për demonstruesit, i strehuan ata, ua lidhën plagët e i mjekuan, për ato gra e vajza që po u përplasin shqiptarçe gjithë urrejtjen e indinjatën e tyre armiqve në tubimet "diferencuse", që po organizojnë ata kudo edhe për gratë, apo për nënat tona të forta e heroike , që bijat dhe bijtë e tyre të dashur, lulet e tyre të jetës i përcollën duke iu thënë :"hajt, zemra e nënës, edhe po të mos kthehesh, nga shokët mos u ndaj, mos na turpëro...!"[214]

[214] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Liria"- gazetë ilegale me fizionomi të re dhe me qëndrime të qarta", (fejton), Epoka e Re, 29 prill, 2006.

Nënat shqiptare janë trime, janë roje të bardha të bijve dhe bijave trime të tyre, ato janë heroina se me një krenari të pashoqe ndahen nga bijtë dhe bijat e tyre të pavdekshme. Por, autori thotë se edhe pse ata kanë vdekur, ju nuk keni mbetur të vetmuara. Ju keni sot qindra mijëra djem e vajza të popullit , që ju thërrasin nënë, ju keni dashurinë dhe respektin e gjithë popullit tonë patriot e luftarak, i cili përulet para bijave dhe bijve tuaj, duke thirrur: "Lavdi e përjetshme dëshmorëve të lirisë".Gratë shqiptare edhe pse ia falnin fëmijët e tyre atdheut, ato përsëri e përsëri vazhdonin, të luftoni krah për krah me vëllezërit e tyre, në çdo betejë për të drejtat e tyre, të drejtat e popullit, se ishin të vetëdijshme se, vetëm kështu mund të dilni nga robëria e dyfishtë që po iu zinte frymën[215].

Pa dallim gjinie, i gjithë populli shqiptarë shtypej e shfrytëzohet në Jugosllavi, por akoma më shumë gruaja shqiptare, e cila nuk kishte pothuajse asnjë të drejtë në jetën shoqërore, politike e ekonomike. Kishte gra që ishin të angazhuara në politikën e kohës, porse ato ishin më tepër dekor politike se sa që luanin ndonjë rol të rëndësishëm në të. Sistemi okupues dhe zakonet e egra prapanike, që ruheshin të gjalla, e për pushtetarët kjo dukuri negative asnjëherë nuk ishte në rendë të ditës për të ndërmarrë masa më të rrepta për ta eliminuar. Pa luftë e përpjekje nuk mund të dilet nga gjendja e rëndë në të cilën ndodhet sot gruaja shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë.

Një apel të veçantë ilegalja shqiptare iu drejtonte intelektualëve patriotë e revolucionar, ku ju thuhej se si bijë besnik të popullit, nga gjiri i të cilit keni dal, juve u bie një barrë e rëndë dhe e vështirë e luftës dhe përpjekjeve të popullit tonë të shumëvuajtur për të drejta e liri.

Mija intelektualë patriotë e revolucionarë shqiptarë në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e Serbi , mësues, arsimtarë, profesorë, nëpunës, mjekë, artistë, shkrimtarë, këngëtarë e punëtorë të shquar të shkencës e kulturës e kanë kuptuar drejt detyrën e tyre dhe me vetëmohim janë bërë shërbëtorë të denjë të popullit, të interesave të tij të mëdha[216].

Armiku kishte vënë në shënjestër inteligjencën tonë, duke përdorur mjete dhune , terrori e presioni kundër saj, kulturën, shkencën, gjuhën,letërsinë, historinë tonë të lashtë, duke zbatuar kundër tyre një inkuizicion të tmerrshëm shovinist[217].

Kulturën, gjuhën e historinë betoheshin ilegalitet se do i mbrojnë në çdo kohë, pa marr parasysh pasojat që do i kemi thoshin ilegalitet. Gjuha e kultura jonë u kanë rezistuar shekujve plot rrebeshe, aq më pak sot ato mund të sakatohen e të zhduken.

Censura e egër shoviniste ndaj krijimtarisë letrare e artistike, shkencore, publicistike etj…që është vendosur në Kosovë, nuk mund t'ua mbyllë gojën intelektualëve të Kosovës. Ashtu, sikurse librat, nga Shqipëria që po qarkullojnë ilegalisht në Kosovë, edhe ato të shkruara nga autorët kosovarë, jashtë censurës, do të qarkullojnë fshehurazi dorë më dorë. Kështu na kanë mësuar intelektualët patriotë të

---

[215] Dr. Sabile Keçmezi- Basha,"Gruaja shqiptare në shërbim të çështjes kombëtare" (fejton 5 vazhdime),"Bujku" 24-28 janar 1996.
[216] Po aty.
[217] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Diferencimet ideo-politike në Kosovë 1981-1990", (fejton), Koha ditore (12 vazhdime), dhjetor-janar 2006.

Rilindjes sonë kombëtare. Dhe më pas autori i propozon disa këshilla të cilat do i prezantoja këtu:

-Shfrytëzoni të gjitha format dhe mundësitë në veprimtarinë tuaj krijuese, shkencore, kulturore, arsimore, edukative, letrare e artistike, duke hedhur tej konceptet shoviniste.

-Edukoni fëmijët, rininë dhe popullin në frymë patriotike, kudo që veproni, pa përfillur presionin e egër shovinist.

-Luftoni bashkë me popullin për të drejtat e tij, për një jetë të tij të lirë.

-Luftoni për të drejtën e fjalës e të shtypit, për krijimtari pa censurë të egër shoviniste.

Edhe popull shqiptarë që jetonte në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi, republika shqiptare në federatën jugosllave, që do të përfshinte në vend të gjitha viset shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, do të ishte njësoj si republika serbe, kroate, maqedonase, malazeze etj. Kërkesa shqiptarëve në Jugosllavi për republikë nuk ka asgjë nacionaliste e shoviniste, por është kërkesë për një të drejtë kombëtare, që do të duhej ta kishim me kohë. Kërkesa e jonë për republikë nuk do të thotë aspak dëbim për pakicat serbe, malazeze dhe maqedonase, siç na akuzojnë shovinistët[218].

Shovinistët jugosllav padrejtësisht na kanë ne shënjestër ne shqiptarët, që jemi një popull i vetëm me truall unik e të pandashëm. Asnjë popull në Jugosllavi, shumë prej të cilëve janë më të vegjël se i yni, nuk është ndarë dhe copëtuar, kështu.

Edhe shqiptarët e Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi, gjatë gjithë sundimit okupues në Jugosllavi, i janë ekspozuar një shtypjeje të egër shoviniste, gjenocidit në masë dhe shfrytëzimit barbar, duke qenë të detyruar shpeshherë të lënë edhe vatrat e tyre njëherë e përgjithmonë, për të marr në sy rrugët e botës, si refugjat të përjetshëm[219].

Sot, kur i gjithë populli i ynë i shtypur u ngrit në këmbë, shovinistët, si në Kosovë, ashtu edhe në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi, po ushtrojnë një dhunë e një presion fashist të paparë. Edhe ato pak të drejta elementare që kishin shqiptaret e këtyre viseve, tash po iu hiqen nga ata.

Por, ne do të vazhdojmë të gjithë së bashku luftën për të drejtat tona të ligjshme, deri në realizimin e plot të tyre. Ne shqiptaret trima të Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi, bashkë me vëllezërit kosovarë, nuk do të kursejmë as gjakun, as jetën tonë për fitoren e kësaj të drejte.

Por, një thirrje e veçantë në tekst i bëhej popullit serb e malazias, dhe kamë përshtypjen se ky apel ishte i gjithë ilegales shqiptare që vepronte në Kosovë pas demonstratave studentore të vitit 1981.

Mehmet Hajrizi, iu drejtohej atyre në këtë mënyrë: Armiku ynë i përbashkët po mundohet t'i gënjejë popujt e Jugosllavisë se gjoja shqiptarët janë ngritur në luftë kundër tyre, e jo kundër regjimit shtypës e shfrytëzues të Beogradit, që është armiku edhe i popujve të tjerë në Jugosllavi. Ju, serbët dhe malazeze të ndershëm të Kosovës, e dini më së miri të vërtetën mbi luftën e popullit shqiptar për të drejtat e tij të ligjshme. Ne nuk

---

[218] Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion, (broshure), 1986, f. 80-81.
[219] Po aty.

duam të luftojmë me asnjë popull të Jugosllavisë, as me popullin serb e malazez në Kosovë. Këtë e dinë armiqtë tanë shovinistë dhe duhet ta dinë dhe të gjithë popujt në Jugosllavi.

Popullit të ndershëm serb dhe popujve të tjerë Jugosllavë nuk u vjen asnjë e mirë nga ky trajtim i Kosovës dhe popullsisë shqiptare, serbe, malazeze etj.. që jetojnë në të.[220]

Lufta për të drejtat e Kosovës, lufta e sajë për shkëputje nga vargonjtë shtypës dhe shfrytëzues, është për të drejtat e serbëve dhe malazezëve në Kosovë, është edhe në të mirë të tyre, sepse edhe ata jetojnë në varfëri, nga e cila shpesh detyrohen të ikin, duke braktisur Kosovën. Ky dhe vetëm ky është ai "presioni shovinist" që ka bërë të shpërngulën familjet serbo- malazeze nga Kosova. Por, nga ky "presion" i kanë braktisur vatrat e veta akoma më shumë familje shqiptare. Ky fakt tashmë është i njohur nga të gjithë.

Ne, me të drejtë presim dhe shpresojmë që serbet dhe malazezet e ndershëm në Kosovë do të luftojnë së bashku me shqiptaret për të drejtat e tyre , që populli i Serbisë dhe popujt e tjerë në Jugosllavi do të na përkrahin, të na mbështesin në luftën tonë të drejtë. Çdo armiqësi mes nesh është në interes të armiqve tanë, kundër të cilëve një ditë do të ngrihemi domosdo të gjithë së bashku[221].

Gazeta "Liria", thoshte se populli i robëruar po kalonte qaste të vështira. Një rrezik akoma më i madh, po i kanosej vazhdimisht nga shovinizmi dhe shovinistët e shfrenuar dhe vazhdimisht ishte prezent.

Lufta e popullit shqiptarë në Kosovë ishte e drejtë dhe e ligjshme. Atë e përkrahu e gjithë bota demokratike dhe liridashëse anë e këndë globit, kjo u dëshmua edhe më 1999, kur ndërhynë ushtarakisht në ish-Jugosllavi.

Luftë pa sakrifica nuk ka, thoshte shkrimi në gazetën "Liria". Shumë revolucionar e patriotë, na i rrëmbeu armiku këto kohët e fundit. Por, të tillë populli i ynë ka plot. Më kot armiqtë tanë përpiqen të na nënshtrojnë, ne dhe popullin tonë trim. Ne jemi gjallë dhe kurrë nuk do të zhdukemi, nga asnjë armik, sado i fuqishëm e barbar të jetë ai[222].

4. 1. Populli trim i Kosovës, do pavarësi

Në shkrimin e Hydajet Hysenit "Jemi patriotë, s'jemi shovinistë", është një shkrim ku autori me këmbëngulje jep argumente se shqiptaret që dolën në demonstrata, ata nuk dolën për t'iu bë të keqe popullit jo shqiptar, por, ata dolën në demonstrata për të kërkuar të drejtat e veta të ligjshme. Dihej se menjëherë pas demonstratave, filloi një fushat e çmendur kundër shqiptarëve, kudo që ishin ata. Shtypi legal i kohës për këto heshtte, ndërsa ky ilegal ishte në aktivitet të vazhdueshëm , mirëpo, e tërë kjo vështirë depërtonte deri te opinioni i gjerë. Ata që kishin rast ta siguronin ketë, ata posa e lexonin në një mënyrë apo tjetër e asgjësonin ngase, spiunët e pushtuesit i kishe çdo kund, dhe me një

[220] Përpara drejt fitores, Liria, nr. 4-5, 1981, f. 83.
[221] Po aty.
[222] Përpara drejt fitores", revista "Liria", nr. 4-5, 1981, f. 4 (Mehmet Hajrizi, këtë artikull e kishte shkruar vetëm disa ditë pas varrosjes së djalit të vëllait, dëshmorit Naser Hajrizit, i vrarë në ballë të demonstratave më 2 prill 1981,i cili ishte edhe anëtarë i OMLK-së).

kujdes të hatashëm përgjonin natën e ditën dhe mezi pritnin të gjenin diçka që të lavdërohen para punëdhënësve se kanë zbuluar diçka " shumë të rëndësishme"[223], dhe normal ata i shpërblente okupatori.

Dhe, " me anë të britmave histerike kundër "nacionalizmit" dhe "shovinizmit" të trilluar shqiptar, vojvodët e rinj të Beogradit po mundohen ta fshehin shovinizmin e tyre të egër antishqiptar, të justifikojnë masakrën e tyre të përgjakshme, që bënë gjatë kësaj pranvere në Kosovë, të arsyetojnë masat e papara të dhunës, terrorin e gjenocidin, që e ndërmorën dhe po vazhdojnë të ndërmarrin kundër popullit liridashës. Duke sulmuar me të gjitha mjetet popullin tonë dhe çdo gjë të tjetër, duke e fshehur dhe shtrembëruar të vërtetën rreth gjendjes së tij të padurueshme , rreth aspiratave dhe qëllimeve të luftës së tij të drejtë, ata po orvatën ti nxisin kundër popullit tonë edhe popujt e Jugosllavisë, ti përçajnë e armiqësojnë ata në mes veti, në mënyrë që kështu ti largojnë ata nga lufta kundër regjimit titist dhe ti sundojnë më lehtë në këtë situatë të vështirë që po kalon Jugosllavia[224].

Punimin në fjalë autori e kishte ndarë në disa pjesë. Në pjesën e parë bënte fjalë për shqiptarët që kurrë nuk kishin qenë shovinistë. "Le ti kthehen revizionistët sa të duan të kaluarës sonë të lavdishme për të kërkuar edhe atje "shovinizmin shqiptaro-madh"[225] thotë autori i shkrimit. Le të shfletojnë ata sa të duan libra, kronika e dokumente të së kaluarës. Atje, ata mund të gjejnë sa të duan luftë për liri, se të parët tanë nga një luftë e bënin për çdo vjet, po ata nuk mund të gjejnë kurrë luftë shqiptare për robërimin e të tjerëve. Mundë të gjejnë ata sa të duan vetëmohim e qëndresë heroike, mundë të gjejnë sa të duan xhamadan të trimërisë nëpër Termopilet e shumta shqiptare, por ata nuk mund të gjejnë kurrë shovinizëm, terror e zullum shqiptarë.

Duhet theksuar se populli shqiptarë gjatë gjithë historisë së tij shumë shekullore, ka luftuar me heroizëm kundër shovinistëve të huaj, e pra edhe kundër atyre serbë e malazezë, por, me përjashtim të titistëve, askush nuk ka folur ndonjëherë për "nacionalizëm", "shovinizëm" dhe "ekspansionizëm shqiptaromadh".

Por mund të konstatojmë se për politikanët serbë, gjithçka që ishte shqiptare, gjithçka që ishte patriotike, gjithçka që nuk iu pëlqente atyre ose që ua prishte planet e tyre të përbindëshave, ishte "nacionaliste" e "shoviniste" dhe "irredentiste", "reaksionare" e "kundërrevolucionare". Dhe, meqenëse i gjithë populli shqiptarë, kudo që ishte, me krenari thoshte se është shqiptar, dhe jo jugosllav, meqenëse gjithë populli shqiptarë luftonte për liri (pikërisht patriotët shqiptarë e jo "patriot jugosllav"), dhe meqenëse si i tillë, populli po ua prish atyre planet e çmendura, atëherë, për ta me përjashtim të ndonjërit bashkëpunëtori, gjithë populli shqiptar[226] është "nacionalist", "shovinist", "irredentist", "i egër", "injorant", "i trashë", "reaksionar", "kundërrevolucionar" e gjithçka tjetër.

Me qëllim të diskreditimit të popullit tonë dhe aspiratat e tij të drejta në sytë e popujve të tjerë, sidomos të atyre jugosllavë, shovinistet serbomëdhenj u mundonin ta

---

[223] Jemi patriotë, s'jemi shovinistë, "Liria", nr. 4-5, gusht 1982, f. 5.
[224] Po aty.
[225] Po aty.
[226] Ramadan Musliu, Vetëripëtëritja e totalitarizmit, Tiranë, 1998, f. 57.

paraqitnin gjithë luftën çlirimtare të popullit dhe në mënyrë të veçantë grevat e demonstratat e mëdha të vitit 1981, si luftë të drejtuar kundër popujve të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë, ata jo vetëm që shtrembëruan karakterin e vërtetë të luftës sonë, por edhe u munduan të identifikonin me popujt që ata i shtypnin dhe i shfrytëzonin. Por, një identifikim të tillë, sigurisht që nuk e bëjnë popujt e Jugosllavisë, e atë nuk e ka bërë dhe nuk e bënë as populli i ynë[227].

Në nëntitullin "Lufta jonë nuk drejtohet kundër popujve, po kundër shovinistëve jugosllavë", autori theks të veçantë i epte dallimit në mes pushtetarëve dhe popullit, për të shtuar se " Popujt jugosllavë dhe sundimtaret e tyre shovinistë, nuk janë një. Prandaj, edhe populli i ynë ata nuk i ka futur dhe nuk i fut as sot në një thes. Lufta që po bënë populli i robëruar për të drejta e liri, jo vetëm që nuk drejtohet kundër proletariatit e popujve jugosllavë në Kosovë e jashtë saj, por, përkundrazi, ajo është edhe në interes të tyre[228]. Prandaj, në mos sot, nesër me siguri që do të fitojë edhe përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

Llomotitjet e pandërprera të shovinistëve jugosllavë se gjoja grevat dhe demonstratat e Kosovës ishin të drejtuara kundër popujve jugosllavë, kundër unitetit dhe federatës së tyre, ato u bënë nën parulla të tilla, si : "kundër serbëve", "të gjithë serbet të dëbohen nga Kosova", "për Shqipërinë e Madhe", "për Kosovën e pastër etnike" etj… të gjitha këto janë shpifje e vetëm shpifje[229]. Qëllime e kërkesa të tilla nuk kanë pasur kurrë demonstruesit. Ata trillonin dhe përhapnin të pa vërteta vetë shovinistet serbomëdhenj dhe lakenjtë e tyre shqiptarë, duke u treguar në këtë mënyrë se sa ua duan të mirën popujve jugosllavë.

Gjatë grevave dhe demonstratave, fillimisht populli i robëruar kërkoi kushte më të mira të jetesës, kërkoi punë, kërkoi kthimin e kurbetçinjve e ndalimin e ngritjes së çmimeve , kërkoi që bijtë e tij të burgosur të kthehen në Kosovë, kurse të pafajshmit të lirohen, kërkoi që pasurit e shumta të Kosovës të shfrytëzohen nga vetë kosovaret, kërkoi që ti jepet fund trajtimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare si koloni të thjeshta të republikave jugosllave, që popullit shqiptar në Jugosllavi ti njihej e drejta e tij e ligjshme për vetëvendosje (të cilën kushtetuta jugosllave ua njehë popujve të tjerë edhe më të vegjël se ky yni), që Kosova të fitojë statusin e republikës. Këto kërkesa të drejta jo vetëm që s'ishin kundër popujve të tjerë në Kosovë e në viset e tjera ku jetonin shqiptaret, por, përkundrazi, ato ishin edhe kërkesa të tyre, sepse, ndonëse jo sa shqiptaret, edhe ata u shtypnin e u shfrytëzoheshin nga sunduesit e tyre, edhe ata ishin të pakënaqur me kushtet e tyre të jetesës që ishin gjithnjë e më të vështira, edhe ata vuanin nga papunësia, kurbeti, ngritja e përditshme e çmimeve, edhe ata mbanin mbi kurriz pasojat e shfrytëzimit kolonial të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare[230].

Parulla "Kosova- republikë" nuk u drejtonte as kundër popujve të Maqedonisë e Malit të Zi[231]. Republika e Kosovës do të ishte grusht i rëndë për borgjezinë shoviniste

---

[227] Si në shënimin 370.
[228] Lufta jonë nuk drejtohet kundër popujve, po kundër shovinistëve jugosllavë, "Liria", nr. 4-5, gusht 1982, f. 5.
[229] Po aty.
[230] Po aty.
[231] Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion (broshurë), 1986, 73.

jugosllave, por ishte e sigurt se ajo nuk do t'iu sjellë as një të keqe popujve të tjerë të Jugosllavisë. Nga shfrytëzimi kolonial i Kosovës përfitonte vetëm borgjezia e Serbisë, Maqedonisë dhe e Malit të Zi, dhe aspak masat punuese të këtyre republikave, të cilat gjithashtu shtypeshin e shfrytëzoheshin egërsisht.

Për ta bindur opinionin jugosllav dhe atë botëror gjoja për rrezikun që iu kanoste serbëve dhe Serbisë nga populli "shovinist" shqiptar, shovinistet serbomëdhenj po ngrehnin shumë re pluhuri për gjoja dhunën dhe terrorin që paskan ushtruar shqiptarët e Kosovës gjatë demonstratave të tyre të fundit ndaj "serbëve e malazezëve të pafajshëm". Sipas asaj që thoshin ata del se të gjithë serbet dhe malazezet, jo vetëm në Kosovë por edhe në Beograd e Gjenevë , paskan qenë në rrezik të madh! Demonstruesit e "Egër", " vandalistë", "e terrorist" i paskan ndjekur, i paskan rrahur e kërcënuar, u paskan hyrë brenda, u paskan djegur pasurin dhe shtëpitë[232]…Për ti bërë sa më të besueshme akuzat e tyre, kalemxhinjtë e Beogradit po mbushnin faqet e gazetave e të revistave me " rrëfime" e "deklarata" "tronditëse" të "viktimave", me fotografi të dritareve të thyera e shtëpish të djegura.

Çerdhe çetnikësh e kriminelësh si familja Delibashiq ishin bërë heronjtë ditës dhe fotografitë e tyre u gjendeshin në çdo gazetë e revistë të Beogradit. Heronj të ditës u bënë kriminelet çetnikë, që kishin lyer duart me gjak shqiptari, para e gjatë luftës, që kishin gjakosur popullin tonë gjatë aksionit famëkeq të armëve, ata gjakatarë që tani, ashtu si edhe më 1968 qëllonin tinëzisht me armë zjarri mbi turmat e pa armatosura të demonstruesve shqiptarë, të cilët nga ana tjetër qëlloheshin nga milicia serbe me bomba e mitraloza. Ishin këta kriminelë, që, si kundër veprim, u qëlluan me gurë e shishe nga demonstruesit , e jo njerëzit e pafajshëm serbë e malazezë. Në rrugën e "Sremit", kishte edhe familje të tjera serbe, por populli demonstrues e e qëlloi me gurë dhe i kishte vu flakën vetëm shtëpisë së Delibashiqëve[233], dhe vetëm atëherë, kur prej dritareve dhe pullazit të saj u vranë njeri pas tjetrit shtatë demonstrues.

Pjesë tjetër mjaftë me interes ishte edhe politizimi i shpërnguljeve të serbëve e malazezëve nga Kosova, ketë autori e shtjellon në pjesën "Pse shpërngulën nga Kosova serbët e malazezët", ku okupuesi bënte shumë zhurmë rreth kësaj çështjeje. "Një zhurmë e madhe u bëhej kudo në Jugosllavi edhe rreth shpërnguljes së serbëve e malazezëve nga Kosova" shkruan autori, për të vazhduar se ketë e shfrytëzonin serbomëdhenjtë dhe mundoheshin që tërë ketë ta paraqitnin "gjëja se po shpërngulën nga presioni, që ushtrohet mbi ta nga ana e shqiptarëve "nacionalistë" e "shovinistë" që nga viti 1966 e këtej, dhe sidomos pas demonstratave që u bënë në Kosovë. Kjo temë ishte bërë çështje e preferuar dhe e përhershme në faqet e gazetave dhe revistave të Beogradit., si dhe në fjalimet e krerëve nga më kryesoret në Kosovë, Serbi e Jugosllavi. Për hulumtimin e kësaj "dukurie", jo vetëm që ishin angazhuar gati gjysma e gazetarëve të Serbisë, por , edhe ishin formuar komisione të posaçme, të cilat gjatë "punës" së tyre të madhe hetuese po "zbulonin" plot "fakte" të tilla "presioni", si pyetjet: "A po e shet shtëpinë?", "shkelje

[232] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Propaganda dhe dezinformimi, metoda të organizuara shtetërore jugosllave ndaj shqiptarëve", "Epoka e Re", 20.12.2008.

[233] Po aty.

e arave me biçikletë", "pemët e rrëzuara", "kafshët e ngordhura", disa gurë "të hedhur" në ballkon, gjetja e ndonjë kafshe në të lashta, kryqet e thyer në varreza, zjarri i shpërthyer në një pjesë të Patrikanës së Pejës etj… etj…[234], thuhej në shkrimin e gazetës "Liria"

Me "fakte" të tilla, shovinistet serbomëdhenj u mundonin të "argumentonin" "presionin" që gjoja po e detyronte popullsinë serbo-malazeze të lëshojë Kosovën, por "faktet" e tyre ishin aq të liga, naive e qesharake, sa vështirë mund të besonte njeri. Shovinistet rankoviçistë mundoheshin që të paraqiteshin mbrojtës të serbëve e malazezëve të Kosovës, por në të vërtetë në këtë mënyrë ata ua bënin të keqën edhe atyre, në këtë mënyrë edhe më tepër i nxisnin të shpërnguleshin nga Kosova, i armiqësonin me fqinjët e tyre shqiptarë dhe, në të njëjtën kohë, nxisnin kundër serbëve e malazezëve edhe ndonjë shqiptarë të papjekur[235].

Ishte e vërtet se kishte serbë e malazezë që shpërnguleshin nga Kosova, ashtu siç shpërnguleshin edhe më shumë shqiptaret. Ishte e vërtetë se ndonjëherë mund të ndodhte edhe ndonjë zënkë e mos marrëveshje mes fqinjëve shqiptar e atyre serbë, ashtu siç ndodhte edhe mes shqiptarëve apo mes serbëve. Por, të nxjerrësh konkluzionin se kjo shpërngulje e serbëve ishte pasojë e "presionit" të shqiptarëve të robëruar, këtë mund ta bënin vetëm shovinistet serbomëdhenj. Shkaqet e vërteta të shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve nga Kosova , ashtu si edhe e shqiptarëve ishin kushtet e vështira të jetesës, skamja, papunësi e mjerimi i madh që ishin rrjedhim i drejtpërdrejt i marrëdhënieve kapitaliste në prodhim dhe i shfrytëzimit kolonial të Kosovës. Kjo ishte e vërteta dhe këtë po e thoshin hapur edhe qindra e qindra serbë e malazezë të shpërngulur, që po hidhnin poshtë shpifjet shoviniste për gjoja "presionin" e shqiptarëve.

Statistikat flisnin se popullsia serbe po shpërngulej edhe nga komuna e Leposaviqit dhe nga viset periferike të Serbisë, ku kishte pakë ose aspak shqiptarë[236]. Mos vallë edhe atje serbët po i nxjerrin tabelat "kuça na prodaji" ("Shtëpia në shitje") për shkaqe të "presionit" të "nacionalistëve shqiptarë"[237], thoshte autori i shkrimit..

Në pjesën "Kultura shqiptare dhe inkuizicioni revizionist", bënte fjalë se okupuesi për të justifikuar masat e papara, që i ndërmerrte kundër ndërgjegjes kombëtare të popullit tonë, shovinistët serbomëdhenj po sulmonin kulturën , arsimin, shkencën, artin dhe letërsinë shqiptare, e deri edhe simbolet e veshjet tona kombëtare. Sipas tyre, gjithë kjo kulturë shqiptare ishte e ngarkuar me "historicizëm" e " e romantizëm nacionalist", me "mite", "shpirtra të vdekur" e me "ideale të tejkaluara", dhe si të tilla ajo bëri që rinia të "edukohet keq", të hutohet e të mashtrohet aq shumë sa të ngrihet në greva e demonstrata aq të mëdha. Që të mos përsëritet ajo që kishte ndodhur, shovinistet e Beogradit i kishin hyrë punës për ta "shkarkuar" kulturën kosovare nga fryma kombëtare " e tejkaluar" dhe për ta shndërruar atë në një kulturë "vetëadministruse", në një kulturë

---

[234] Pse shpërngulen nga Kosova serbët dhe malazezët?, "Liria", nr. 4-5. Gusht 1981, f. 6.
[235] Po aty.
[236] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Të dhëna të mangëta për të burgosurit politikë shqiptarë në dokumentet statistikore (1945-1990), "Epoka e Re", 24 maj 2008.
[237] Gazeta e OMLK, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 6.

që kultivon jo "nacionalizëm shqiptar" por të ashtuquajturin patriotizëm jugosllav[238]. Për t'ia arritur këtij qëllimi shovinistet kishin vënë në shënjestër të gjitha institucionet e arsimit e të shkencës, të kulturës si Universitetin, Akademinë e Shkencave dhe e Arteve, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Shoqatën e shkrimtarëve të Kosovës, kompozitorëve, artistëve figurativ e të gazetarëve, shkollat, shoqëritë kulturo-artistike e deri te ato çerdhe të pakta të fëmijëve që ekzistonin në Kosovë. Të gjitha këto po cilësoheshin si "vatra të nacionalizmit e të kundërrevolucionit" dhe po sulmoheshin nga të gjitha anët e më të gjitha mjetet.

Pushtetarët i kishin hyrë edhe njëherë rivlerësimit të historisë kombëtare, gjoja për ta çliruar historiografinë nga "historicizmi", "glorifikimi", "dogmatizmi" e "nacionalizmi romantik". Sipas këtij vlerësimi "të ri" (që nuk ndryshonte aspak nga ai i paraluftës), Skënderbeun legjendar- të cilin dikur bënin çmos që të na e merrnin- na cilësohej vetëm si një person "jo negativ" dhe asgjë më tepër, ose barazoheshin me Car Lazarin e me kralët e tjerë të Serbisë, Ismail Qemali quhej një agjent i Austrisë, Isa Boletini " një bashibozuk turkofil", Azem Galica- "një vrasës i serbëve të pafajshëm", e të mos flasim për udhëheqësit e lavdishëm të Shqipërisë Socialiste, kundër të cilëve nuk lënë gjë pa shpifur e trilluar. Sipas këtij vlerësimi "marksist", gjithë lufta e popullit shqiptar për liri e pavarësi delte nxitje dhe vepër e forcave të ndryshme nga jashtë, Lidhja Shqiptare e Prizrenit quhej " krijesë e sulltanëve të Turqisë", kryengritja e vitit 1912 si "luftë fanatikësh e bashibozukësh", që gjoja se drejtoheshin kundër popullit të Serbisë, Malit të Zi dhe ushtrive të tyre "çlirimtare", formimi i Partisë Komuniste Shqiptare dhe gjithë revolucioni në Shqipëri klasifikoheshin si vepra e merita të "komunistëve" jugosllavë dhe agjentëve të tyre si Koçi Xoxe[239] etj… Ja çfarë historie "kombëtare" dëshironin shovinistet që të mësohej në shkollat tona. Dhe mu me këtë vërtetohej se ku qëndronte "ngarkimi" i saj me "romantizëm nacional", "dogmatizëm", e "historicizëm".

Aq hapur dolën armiqtë e popullit shqiptar sa kërkuan edhe mbylljen e Universitetit të Prishtinës, mbylljen e shkollave dhe shoqërive të ndryshme, kërkonin ndërprerjen e çdo lloji komunikimi dhe kontakti me vëllezërit në Shqipëri, kërkonin që veprat e shkrimtarëve tanë, që i ndalonin, të zëvendësoheshin me "vepra" të antishqiptarëve të tërbuar si Qosiqi, Andriqi, Dedijeri, Tempo e Laliçi, që filmat shqiptarë që ishin hequr nga repertori, të zëvendësoheshin me filma kaubojsh, kriminelësh e prostitutash, që këngët dhe vallet e bukura të zëvendësoheshin me britma dhe lëvizje të çmendura të psikopatëve të Beogradit[240].

Për të qenë ironia edhe më e madhe, gjithë kjo "hajkë" e paparë kundër historisë sonë kombëtare, gjithë kjo luftë kundër shovinizmit të paqenë shqiptarë, bëhej në një kohë kur shovinizmi serbomadh ishte bërë me mjekër, kur po ringjalleshin si asnjëherë më parë çetnikët më të zi të luftës e të pasluftës, kur letërsinë dhe shtypin serbë e përshkonin si një fill i zi unitarizmi e hegjemonizmi serbomadh, kur portreti i Karagjorgjeviqit po shtypej edhe në monedhat e arit, kurse uniformat e ushtrive

[238] Kultura shqiptare dhe inkuizicioni revisionist, "Liria, nr. 4-5, gusht 1981, f. 6.
[239] Po aty.
[240] Po aty.

pushtuese serbe botoheshin gati në çdo numër të gazetave dhe revistave të Beogradit[241], njoftonte autori opinionin e gjerë shqiptarë.

Gjithë kjo fushatë e egër e e paparë, kundër popullit shqiptarë dhe gjithçkaje që ishte shqiptare, u përfshi në nëntitullin "Cilët janë shovinistët e vërtetë" e që ishte vazhdimi i drejtpërdrejtë i politikës së egër antishqiptare të kralve të Beogradit, ishte shprehje e procesit të rankoviqizmit të mëtejshëm të Jugosllavisë revizioniste. Zhurma shurdhuese që po bëhej kundër nacionalizmit e shovinizmit të trilluar shqiptar, s'ishte gjë tjetër pos përpjekje për ta fshehur shovinizmin e hegjemonizmin e vërtetë rankoviçian. Por, shovinizmi serbomadh ashtu si edhe ai malazez e maqedonas, ishte aq i zi e i dukshëm sa nuk mundët të mbulohej me kurrfarë "potere" kundër gjoja nacionalizmit të shqiptarëve të robëruar dhe as me fraza e parulla boshe dhe monotone për "vëllazërim-bashkimin", "barazinë", "demokracinë", "humanizmin"[242]. Nuk ishte vështirë për askënd që të dallojë se kush ishin shovinistët e vërtetë dhe kush ishte preja e tyre, se kush ishin ujqit dhe se kush ishin qengjat, që po iu turbullonin atyre ujin.

Ne, shqiptaret e Kosovës, Maqedonisë, Serbisë e Malit të Zi, thotë autori i shkrimit, kishim luftuar dhe do të luftonim me vetëmohim e heroizëm deri në fitore kundër armiqve tanë shovinistë, por ne nuk ishim dhe nuk do të lejonim kurrë që të binim në ujërat e ndyta të shovinizmit. Ne ishim dhe jemi patriotë. Qëndrimi i ynë ishte dhe ka qenë dhe është: Ndaj popujve të tjerë asnjë dëm- ndaj shovinistëve asnjë mëshirë! Prandaj, ne i bëjmë përsëri thirrje popullit që, krahas intensifikimit të mëtejshëm të luftës së gjithanshme kundër regjimit robërues të shovinistëve jugosllavë, ashtu si edhe deri tani, të mos lejojmë asnjë dëm, asnjë presion e zullum ndaj njerëzve të pafajshëm serbë e malazezë[243].

Veprime të tilla jo vetëm që ishin në kundërshtim me karakterin e luftës sonë, por ishin edhe shërbim i madh për shovinistet serbomëdhenj, të cilët po bënin çmos me qëllim që ta njollosnin e diskreditonin luftën tonë të drejtë. Shovinizmit të armiqve tanë ne nuk i kundërvumë shovinizmin, por grushtin popullor, revolucionin[244]. përfundon autori i shkrimit.

4. 2. Një historik i shkurtër i padrejtësive të shumta ndaj popullit shqiptar të Kosovës

Kosova - Republikë! Kjo ishte kërkesë, që dominoi në demonstratat historike që u bënë gjatë pranverës së këtij viti (1981) anembanë Kosovës dhe në shumë vende të botës ku kishte shqiptarë. Këtë kërkesë të drejtë po e shprehte populli ynë në mbledhjet e shumta që po organizonte armiku, në traktet që po shpërndaheshin gjithkund apo në parullat e panumërta që po qëndisnin rrugët, muret e ndërtesave dhe lëndinat tona, dhe për të vazhduar më vonë në tekstin "Populli shqiptar në Jugosllavi asnjëherë nuk vendosi për fatin e tij", ishte i shkruar nga autori Berat Luzha.

---

[241] Po aty, f. 7.
[242] Cilët janë shovinistët e vërtetë, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 8.
[243] Po aty.
[244] Po aty.

Duke mos pasur asnjë arsye bindëse për ta hedhur poshtë kërkesën e ligjshme për Kosovën- republikë, serbomëdhenjtë u mundonin të spekulonin jo vetëm me të sotmen, por edhe me të kaluarën e ndritshme të popullit tonë. Duke e mohuar, falsifikuar e shtrembëruar në mënyrë të palejueshme të vërtetën historike armiqtë tanë të urryer dhe shërbëtoret e tyre po mundoheshin të na bindnin se gjoja vetë populli ynë paska vendosur të jetë kështu, siç është, nën zgjedhën e huaj, të jetë i robëruar, i ndarë e i copëtuar[245], njoftonte me të drejt autori.

Në nëntitullin "Si mbeti Kosova nën sundimin e Serbisë", autori fliste për copëtimin dhe nxjerrjen në ankand të trojeve shqiptare, e cila kishte filluar para mase një shekulli, kur fuqitë e atëhershme të mëdha dhe shtetet shoviniste fqinje nisen thurjen e komploteve në dëm të popullit shqiptar. Pazarllëqet më serioze në trojet shqiptare kishin filluar me të ashtuquajturin Traktat i Shën Stefanit, që ishte bërë në mars të vitit 1878 në mes të Rusisë dhe Turqisë. Sipas këtij traktati famëkeq, Bullgarisë, përveç krahinave të tjera në Ballkan, i jepeshin edhe tokat shqiptare që shkonin deri në malet e Vaskopojës (shovinistet bullgarë i ëndërrojnë edhe sot e kësaj dite tokat që dikur iu kishte dhuruar Rusia cariste). Ndërkaq, Malit të Zi Traktati i njihte sovranitetin mbi Ulqinin, Krajën, Anomalin, Hotin, Grudën, Kelmendin, Vermoshin, Plavën, Gucinë e Rugovën, kurse Serbia zgjerohej në sanxhakun e Prishtinës dhe në një pjesë të rrethit të Mitrovicës[246].

Meqenëse vendimet e traktatit të Shën Stefanit nuk u pranuan nga fuqitë e mëdha të kohës, sepse ishin të njëanshme dhe të diktuara arbitrarisht nga Rusia cariste, për ti rishikuar ato u thirr Kongresi i Berlinit. Vendimet kryesore të këtij kongresi, që filloi punën më 13 qershor 1878, ishin marrë qysh më parë në bisedime të fshehta , Serbia dhe Mali i Zi, nëpërmjet Rusisë, kishin fituar pozita të mira për të aneksuar territoret shqiptare. Fuqitë e mëdha e mohuan në tersi çështjen shqiptare, kurse Shqipërinë e quajtën "shprehje gjeografike". Delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Abdyl Frashëri, u refuzua të merrte pjesë në kongres, ku vendosej për fatet e Shqipërisë. Në këto rrethana, copëtimi i atdheut u bë fakt i kryer[247].

Kundër copëtimit të tokave shqiptare, i bashkuar si një trup i vetëm, qe ngritur gjithë populli shqiptar, në të gjitha vilajetet. Më 10 qershor 1878, në Prizren, themelohej Lidhja Shqiptare, e cila shënonte faqe të lavdishme në historinë shekullore të popullit tonë. Me heroizëm të pashoq të ushtrisë së Lidhjes, vullnetarëve dhe të vetë banorëve, u mbrojtën me sukses Plava, Gucia, Hoti e Gruda që i ishin caktuar për aneksim Malit të Zi. Vetëm në nëntor të vitit 1880 ushtria turke mundi tua merrte nga duart kryengritësve qytetin e Ulqinit dhe t'ia dorëzonte ushtrisë malazeze. Po Mali i Zi nuk mjaftohej me kaq, por donte me çdo kusht edhe Shkodren dhe territore të tjera shqiptare, deri në lumin Dri, në jug ,dhe deri në Gjakovë - në lindje. Qarqet shoviniste serbe, nga ana e tyre, i kishin vënë syrin tërë Kosovës, Dibrës, Shqipërisë së veriut, me një dalje në det[248] etj.

Për këto kërkesa, në mungesë të argumenteve të tjera, shovinistet serbë bazoheshin në "argumente" gjoja historike, sepse prej shekullit XIII - XV në këto krahina kishte

[245] Populli shqiptar në Jugosllavi asnjëherë nuk vendosi për fatin e tij, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 8.
[246] Si mbeti Kosova nën sundimin e Serbisë, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 8.
[247] Po aty.
[248] Po aty.

sunduar Serbia, e këto "argumente" krerët e Beogradit i përdorin edhe sot për të "mbrojtur" "Kosovën serbe" si "djepin e Serbisë".

Politika pushtuese ndaj tokave shqiptare, e filluar nga kryeministri serb Garashanini, qysh në vitin 1847 ka vazhduar duke përdorur kurdoherë kundër popullsisë së pafajshme shqiptare dhunën dhe terrorin më të egër. Politika shfarosëse si ajo e knjaz Milanit, i cili bashkë me urdhëratë ushtarëve të tij u jepte edhe porosinë: "sa më shumë shqiptarë që të shpërngulën, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut", vazhdoi edhe në Jugosllavinë e re të Titos, gjë që u vërtetua edhe gjatë ngjarjeve të fundit në Kosovë. Politika shoviniste kërkonte kthimin e përbërjes etnike të krahinave të pushtuara në favor të elementit sllav. Prandaj, përveç shfarosjes përmes terrorit e masakrimit u aplikua edhe dëbimi i dhunshëm i shqiptarëve jashtë trojeve të tyre[249]. Por, megjithatë, Kosova dhe krahinat e tjera shqiptare në Maqedoni, Serbi e Mal të Zi mbetën dhe do të mbesin gjithmonë shqiptare.

Lufta e pandërprerë e popullit shqiptar për liri e pavarësi u kurorëzua në 28 Nëntorin historik të vitit 1912, kur i urti Ismail Qemali e ngriti, pas afër pesë shekuj

[249] Po aty, f. 9.

robërie, flamurin e lavdishëm të Skënderbeut. Vendimi i 28 Nëntorit kishte rëndësi edhe më të madhe pasi drejtohej kundër interesave të fuqive të mëdha imperialiste dhe synimeve të liga të monarkive të Ballkanit.

Lëvizja Kombëtare shqiptare, e mbushur përplot luftëra të gjata e të përgjakshme për liri e vetëvendosje, historiografia borgjeze u mundonte ta paraqiste sikur ajo paska qenë reaksionare, primitive, e drejtuar kundër reformave "përparimtare" turke, kundër ushtrive "çlirimtare" të shteteve fqinje dhe e quajtën atë vepër të të huajve apo të një grushti njerëzish, bile agjentësh të huaj. Shpallja e pavarësisë nuk ishte vepër e të huajve , as e një grupi të veçantë patriotësh, po vepër e një kuvendi kombëtar me përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, që erdhi pas luftës dhe përpjekjeve më se shtatëdhjetëvjeçare. Kosovën në këtë kuvend siç dihej e përfaqësonte trimi i madh Isa Boletini. Pavarësia u shpall njëkohësisht për të gjitha krahinat me popullsi etnike shqiptare. Por, që të fitohej pavarësia e vërtetë, popullit tonë do t'i duhej të bëjë edhe shumë luftëra të tjera. Do ti duhej të derdhë shumë gjak të bijve të tij më të mirë[250].

Pjesë e këtij shkrimi, ishte edhe nëntitulli "Thika e diplomacisë evropiane copëton atdheun tonë", ku bënë fjalë kryekëput për ndarjen e atdheut-Shqipërisë në shumë shtete fqinje. Vetëm 19 ditë pas shpalljes së pavarësisë në Londër u mblodh Konferenca e Ambasadorëve. Ajo ishte mbledhur gjoja për të caktuar kufijtë e Shqipërisë, por në të vërtetë qëllimi i saj ishte ndarja e tokave tona që " kishin mbetur pa zot" pas mundjes së Turqisë nga Aleanca Ballkanike[251]. Pa pritur vendimet e Konferencës, ushtritë e shteteve fqinje vërshuan në trojet shqiptare, duke shfrytëzuar pa aftësinë e Vlorës së sapoformuar, e cila ende nuk ishte konsoliduar, si dhe lodhjen e popullit shqiptar nga luftërat e mëdha me pushtuesit turq. Ushtria serbe pushtoi Kosovën, Shqipërinë e mesme e kishte dal në Durrës. Ndërkaq, Mali i Zi po bënte çmos që ta pushtonte Shkodrën e pamposhtur. Luma, nga ana tjetër, kacafytej me hordhitë e panumërta të ushtrisë serbe dhe, siç thotë kënga popullore, "ia mbushte asaj shpinën plot me plumba…"[252]

Me copëtimin e tokave shqiptare, populli shqiptar nuk ishte pajtuar kurrë. Vendimet e padrejta të kësaj konference, patriotët tanë të mëdhenj si Ismail Qemali, Isa Boletini e Luigj Gurakuqi i hodhën poshtë që në Londër.

Nën udhëheqjen e Isa Boletinit, Bajram Currit, Hasan Prishtinës etj… në Kosovë kishte filluar organizimi i kryengritjes për çlirimin nga zgjedha e re, që ishte edhe më e rëndë se ajo turke. Më 22 shtator 1913, populli i Dibrës i dëboi pushtuesit serbë dhe në qytet ngriti flamurin kombëtar. Trupat serbe ishin dëbuar edhe nga Struga e Ohri, ndërsa vullnetaret shqiptar kishin sulmuar Tetovën dhe Gostivarin, e më vonë edhe Gjakovën. Mirëpo, me anën e një ofensive kundër kryengritësve dhe popullit, ushtria serbe ,pas luftimesh të ashpra, i kishte shkelur ato përsëri, duke masakruar barbarisht popullsinë e duke lënë pas vete vetëm gërmadha. Një ushtarak serb, në një letër të botuar në gazetën socialiste "Radniçke novine" (22 tetor 1913) shkruante: "…mund të them se këtu po bëhen gjëra të tmerrshme. Jam i tmerruar dhe pyes gjithnjë se si njerëzit mund të jenë kaq

---

[250] Po aty.

[251] Thika e diplomacisë evropiane copëton atdheun tone, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 9.

[252] Po aty.

barbarë për të kryer të tilla mizori… Mund të them se Luma… nuk ekziston më. Nuk ka veçse kufoma, pluhur e hi". Socialdemokrati serb Dimitrije Tucoviq dhe gazeta e tij "Radniçke novine" e dënuan borgjezin serbe për këto ndërmarrje pushtuese, ndërsa "Rabotniçeski vesnik", organ i socialistëve bullgar, ato ditë kishte shkruar: "Serbia mobilizoi përsëri ushtrinë për ta goditur Shqipërinë, e cila kërkon çlirimin kombëtar dhe vetëvendosjen."[253]

Edhe pas okupimit të Kosovës dhe krahinave të tjera shqiptare nën sundimin serbo- malazez, rezistenca dhe lëvizja kundër regjimit të ri nuk pushoi asnjëherë. Çeta të shumta patriotesh si ajo e Azem Bejtë- Galicës organizoheshin në krahina të ndryshme, si në Drenicë, Moravë, Llap etj. Për të organizuar më mirë këtë luftë, formohet më 1918 në Shkodër Komiteti "Mbrojtja kombëtare e Kosovës"[254].

Një pazarllëk tjetër me tokat shqiptare nga fuqitë e mëdha u bë më 1915, kur u nënshkrua traktati i fshehët i Londrës. Sipas, këtij traktati, Shqipëria duhej të copëtohej përsëri mes Italisë, Malit të Zi, Serbisë e Greqisë. Traktati i Londrës ishte një traktat imperialist, i cili shkelte në mënyrat më brutale pavarësinë dhe tersin tokësore të Shqipërisë dhe merrte nëpër këmbë të drejtat sovrane të popullit shqiptar.

Çështja e kufijve të Shqipërisë u shtrua edhe më 1919 në Konferencën e Paqes në Paris (Paqja e Versajit), e cila kishte filluar punimet më 18 janar të atij viti. Kjo konferencë në vend që ti rishikonte vendimet e padrejta të konferencave dhe trakteve të mëparshme, i kishte rikonfirmuar ato, bile edhe mori vendime për një copëtim të ri të Shqipërisë. Planet djallëzore të Konferencës së Paqes për copëtimin e atdheut u hodhën poshtë nga populli shqiptarë nëpër mjetë të Kongresit të Lushnjes të vitit 1920[255]. Ky kongres shpallte se shqiptaret ishin të gatshëm të bënin të gjitha sakrificat dhe të derdhnin edhe pikën e fundit të gjakut kundër çdo vendimi që vinte në rrezik tersin tokësore dhe pavarësinë e atdheut[256].

Më tutje ky kongres shpallte se "Shqiptaret dinë të vdesin për të mos shkuar nga njëra dorë te tjetra, si tufë delesh e të bëhen plaçkë e atyre që drejtojnë sot diplomacinë e Evropës." Megjithëkëtë, në një konferencë të mëvonshme të ambasadorëve të organizuar nga fuqitë e mëdha, në vitin 1921 ,u mor edhe një vendim që i shkëputste atdheut një pjesë të krahinës së Lumës, Hasit dhe Gollobërdës. Në një protestë të kohës thuhej : "Mjerisht, po bëhej e treta herë që thika e ftohët e diplomacisë po pret në mish të gjallë të atdheut tonë, e që na këputen vise të çmueshme , të cilat, nga çdo pikëpamje që të vështrohen, nuk mund ti mohohen kurrsesi Shqipërisë, kështu që të ndarit e tyre prej trupit të saj formon patjetër një padrejtësi të hapët"[257].

Edhe më vonë politika pushtuese e qarqeve shoviniste të Serbisë ndaj Shqipërisë nuk kishte pushuar asnjëherë. Ishte i njohur intervenimi jugosllav nga vitit 1924, për përmbysjen e qeverisë demokratike të Fan Nolit dhe kthimit në pushtet të Ahmet Zogut . "Kthesa kundërrevolucionare e Ahmet Zogut në Shqipëri, shkruante asokohe Gjergj

[253] Po aty.
[254] Më gjerësisht, Lush Culaj, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924, Prishtinë, 1997.
[255] Si shënimi 403.
[256] Po aty.
[257] Po aty.

Dimitrovi, e kryer me ndihmën e Jugosllavisë dhe me forcat e saja të armatosura , zgjeroi frontin e reaksionit ballkanik deri në Detin Adriatik…"[258]

Bashkë me Italinë, e cila po përgatitej të pushtonte Shqipërinë, ortake në këtë ndërmarrje donte të bëhej edhe Jugosllavia e Stojadinoviqëve dhe kral Aleksandrit. Mirëpo, Italia në atë kohë nuk pranonte ortak në Shqipëri, sepse konsideronte ta ketë atë një koloni për vete.

Gjatë gjithë sundimit të regjimit borgjez të Jugosllavisë së vjetër, krahinat e banuara me shqiptarë, si Kosova, Maqedonia Perëndimore, një pjesë e Malit të Zi, krahinat e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, dhe Peshterit bënin pjesë në viset më të pazhvilluara dhe më të prapambetura të Jugosllavisë, si nga aspekti ekonomik, ashtu edhe nga ai kulturor, arsimor etj. Kjo gjendje, para se gjithash, ishte pasojë e politikës shtypëse dhe shfrytëzuese të borgjezisë serbo-malazeze. Duke i bërë planet jo vetëm për shfrytëzimin e tyre, por edhe për asimilimin dhe dëbimin e popullit shqiptar, Nikolla Pashiqi planifikonte që për 20-30 vjet popullin shqiptar ta asimilojë në pikëpamje kulturore e kombëtare. Sipas tij, "shkrirja e këtyre viseve në Serbi duhej të kryhej në mënyrë të plotë siç janë shkrirë pas 1878-s Nishi, Leskoci dhe Vranja"[259]. Duke zbatuar planet e saja, qeveria shoviniste jugosllave shpërnguli për Turqi dhe vende të tjera qindra mija shqiptar, e në vend të tyre solli kolon të elementit sllavë.

Por, edhe kjo politik asimiluese nuk ngeli pa rezistencë të popullatës shqiptare. Lufta e shqiptarëve duhej tu shërbente qarqeve serbe si mësim " se janë vjetruar metodat e Miloshit të vitit 1883 dhe ato të Ristiqit të viteve 1878- 1879 për Maqedoninë dhe Kosovën"

Ndërkohë, krahina shqiptare në mbretërinë jugosllave , ishin përfshirë prej kohësh nga veprimet dhe luftimet e çetave kryengritëse (komitëve), të cilat sulmonin njësi dhe reparte të ushtrisë e të policisë armike.

Si Shqipëria, ashtu edhe Jugosllavia, gjatë Luftës së Dytë Botërore u sulmuan dhe u pushtuan nga fuqitë e atëhershme nazifashiste. Popujt e këtyre dy shteteve fqinje u hodhën në luftën nacional-çlirimtare, krah për krah njeri tjetrit, kundër armikut të përbashkët. Mirëpo, qysh gjatë luftës, në udhëheqjen e PKJ-së u vërejtën shenja të shovinizmit dhe të mendjemadhësisë. Udhëheqja e PKJ-së, nëpër mjetë përfaqësuesve të saj në Shqipëri, si Dushan Mugosha, Velimir Stojniçi dhe agjentëve si Koçi Xoxe etj… kishin filluar punën e tyre sabotuese dhe përgatiteshin terrenin për aneksimin e Shqipërisë nga Jugosllavia. Ky komplot i rrezikshëm u duk që në Plenumin e Beratit që u mbajt në vitin 1944. Qëllimet e mbrapshta të këtij plenumi dhe vendimet e tij të nxitura nga përfaqësuesi jugosllav, u zbuluan dhe u demaskuan nga Partia e udhëheqësi i saj"[260].

Udhëheqja jugosllave, jo vetëm që nuk e kishte pasur ndërmend të zgjidhte drejtë çështjen e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare, në bazë të së drejtës të kombeve për vetëvendosje deri në shkëputje, por kishte kurdisur plane të rrezikshme për gllabërimin e të gjithë Shqipërisë, për shndërrimin e saj në një republikë të Jugosllavisë. Për këtë qëllim, udhëheqja e PKJ-së kishte punuar nën rrogoz një kohë të gjatë dhe kishte arritur

[258] Po aty, f. 10.
[259] Po aty, f, 10.
[260] Po aty.

që me anë të agjentëve të siguronte shumicën në udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare. Dhe në rrethana të tilla, Shqipëria megjithatë mundi të shpëtojë nga pushtimi i sërishëm …"

Edhe pas luftës, ndërhyrjet, shantazhet e kërcënimet e jugosllavëve kundër Shqipërisë socialiste nuk kishin pushuar asnjëherë. Përmes diversioneve e provokacioneve të pa ndërprera, klika Tito- Rankoviç ndërmori edhe hapa të tillë si përpjekja për invadim në Shqipëri, gjoja për të mbrojtur atë nga pushtimi grek, komploti i vitit 1956 në Konferencën e Tiranës[261] etj. Dëshmi e kësaj politike antishqiptare ishin edhe sulmet, provokacionet, intrigat e kërcënimet, që po bënin kundër Shqipërisë pas demonstratave të Kosovës.

Çështja për vetëvendosje , kuptohet të Kosovës para dhe gjatë luftës, si u trajtonte në dokumentet partiake të ish-Jugosllavisë, autori na jep një pasqyrë të shkurtër në nëntitullin "Si e shihte PKJ të drejtën për vetëvendosje, para dhe gjatë luftës",në kundërshtim me borgjezin serbe, e cila kishte aspirata të vazhdueshme dhe përpiqej me të gjitha forcat për të aneksuar sa më shumë territore shqiptare. Partia Socialdemokrate e Serbisë mbajti qëndrim afirmativ ndaj luftës së popullit shqiptar për liri dhe bashkim kombëtar. Udhëheqësi i kësaj partie, D. Tucoviq, ishte kundër aneksimit të Kosovës nga Serbia dhe e dënoi borgjezin serbomadhe për ndërmarrjet pushtuese në krahinat shqiptare.

Edhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, më vonë mbajti gjithashtu qëndrim pozitiv ndaj të drejtës së popullit shqiptar në Jugosllavi për vetëvendosje. Në Konferencën e saj të III-të ajo dënoi borgjezin serbe për "politikën pushtuese dhe koloniale në Maqedoni dhe kundër Shqipërisë". Ajo kërkonte që ti njihej çdo populli e drejta e sovranitetit në caktimin e marrëdhënieve të veta, prandaj edhe e drejta e shkëputjes së lirë dhe e formimit të shteteve të tyre , respektivisht e bashkimit me shtetet e tyre amë"[262]. Nga ana tjetër, Kongresi i IV-të i PKJ-së, mes tjerash, thërret klasën punëtore jugosllave që "ta ndihmojë nga të gjitha anët luftën e popullit shqiptar të copëtuar dhe të shtypur, për një Shqipëri të pavarur dhe të njësuar" ("Kosova" 2,1973).

Duke dhënë iniciativën për rregullimin e ardhshëm federativ, PKJ vendosi që më 1937 të formojë Komitetin Qendror për Slloveninë e Kroacinë dhe Komitetin Krahinor për Kosovën, i cili prej vitit 1940 lidhet drejtpërdrejt me KQ të PKJ-së dhe kishte të gjitha të drejtat dhe atributet që kishin edhe komitetet e organizatave partiake të Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi etj. Në këtë mënyrë ishte i lidhur gjatë luftës edhe Shtabi i UNÇ-së për Kosovë e Metohi. "Gjatë LNÇ-së, shqiptarët në Jugosllavi kanë pasur trajtim të njëjtë në çdo pikëpamje, e edhe sa i përket të drejtës për vetëvendosje, sikur të gjithë popujt e Jugosllavisë" ("Kosova",2, 1973)

Lidhur me çështjen e vetëvendosjes së kombeve, në një artikull programatik në gazetën "Proleter" nr. 16, 1942[263], vetë Titua shkruante se "çështja e Maqedonisë, çështja e Kosovës e Metohisë, çështja e Malit të Zi, çështja e Serbisë, çështja e Kroacisë, çështja

---

[261] Po aty, f. 10.

[262] Si e shihte PKJ të drejtën për vetëvendosje, para dhe gjatë luftës, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 10.

[263] "Proleteri", nr. 16, 1942.

e Sllovenisë, çështja e Bosnjës e Hercegovinës do të zgjidhën lehët, duke i kënaqur të gjithë". Gjatë luftës , duke folur për çështjen e vetëvendosjes së kombeve të veçanta pas çlirimit, Titua deklaron :"Populli maqedonas, ka të drejtë të vetëvendosë, e madje edhe të shkëputet… Por, populli maqedonas, sovran në të drejtat e veta, ka të drejtë edhe të bashkohet në bashkësinë federative të popujve të tjerë… Në mënyrë të ngjashme duhet shtruar edhe çështjen e Kosovës e Metohisë". (Letër e Titos dërguar Tempos, 1943)[264].

Kështu e shtronin atëherë çështjen kombëtare krerët e PKJ-së, por praktika tregonte se ata nuk mendonin kështu. Ata përpiqeshin të krijonin përshtypjen se kishin qëndrim të drejtë ndaj çështjes së pazgjidhur kombëtare në Jugosllavi, por në të vërtetë ata zbatonin qëndrimin e hershëm të Simiçit me shokë, të cilat ishin kritikuar ashpër nga Kominterni dhe Stalini, si qëndrime që s'kishin asgjë të përbashkët me zgjidhjen e drejtë të çështjes kombëtare[265].

Qëndrimet e AVNOJ-it dhe të Konferencës së Bujanit autori i prezanton në nëntitullin "Çka u vendos në "AVNOJ" dhe çka në Bujan". Qëndrimet e vërteta të PKJ-së rreth çështjes kombëtare, e sidomos rreth asaj shqiptare, dalin në shesh edhe në ndërhyrjen brutale në punët e brendshme të Partisë Komuniste të Shqipërisë, e sidomos gjen shprehje në të ashtuquajturën "Mbledhje të AVNOIJ-it". Në këtë mbledhje, populli i ynë, edhe pse pa asnjë delegat shqiptar , "vendosi dhe shprehu vullnetin e tij të lirë" që të mbetet ashtu siç ishte më parë![266]

Edhe pse populli shqiptarë në Jugosllavi ishte si për nga numri, ashtu edhe për nga territori ku jeton, më i madh se disa kombe jugosllave që fituan të drejtën për republikë, ata u deshtë të "kënaqen" vetëm me konstatimin demagogjik se pakicat nacionale u janë njohur të gjitha të drejtat nacionale[267]. Duke e klasifikuar si "pakicë kombëtare", ose "popullsi" ("narodnost"!), popullin shqiptare e ç'veshin nga shumë të drejta të tij të ligjshme, të cilat i ishin premtuar me kohë nga udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave. Populli shqiptar ishte i privuar në Jugosllavi nga shumë të drejta që të vendoste vetë për fatin e vet[268].

Në zjarrin e luftës, kur popujt e Jugosllavisë dhe të botës vendosnin për fatin e tyre dhe formonin organet e pushtetit popullor, më 31. XII 1943, u mblodhën në Bunjaj të Malësisë së Gjakovës përfaqësuesit e popullit të Kosovës, në Konferencën e Parë të Këshillit Nacional- Çlirimtar. Konferenca në të cilën merrnin pjesë 49 delegatë, përfaqësues të popullit dhe njësive partizane (nga të cilët 6 ishin serbë e malazezë)[269], në Rezolutën që u aprovua, konkludohej se: "Kosova e Metohia është regjion në të cilin jeton, në pjesën më të madhe, populli shqiptar, i cili si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë, prandaj ndjejmë për detyrë të vëmë në dukje rrugën e drejtë,

---

[264] Si shënimi 412.
[265] Po aty.
[266] Çka u vendos në "AVNOJ" dhe çka në Bujan, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 11.
[267] Dr. Sabile Keçmezi-Basha "Trajtimi i çështjes kombëtare në dokumentet partiake me aksent të posaçëm në ato të Kosovës", "Përparimi", nr. 3,1988.
[268] Po aty.
[269] Dokument: Rezolucioni i Konferencës së Bujanit, E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët ne Jugosllavi, Tiranë, 1990, f. 386.

të cilën duhet ndjek populli shqiptar, që shqiptaret e Kosovës e Metohisë të bashkohen me Shqipërinë,[270] kjo është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë, kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij të vendit, sepse kjo është e vetmja rrugë që të fitohet liria, kur të gjithë popujt, prandaj edhe shqiptaret do shprehen për fatin e tyre me të drejt të vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për të gjitha këto janë UNÇ e Jugosllavisë dhe UNÇ e Shqipërisë, me të cilën ishte e lidhur ngushtë. Përveç kësaj, janë garanci aleatet tanë të mëdhenj. Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit), ("Kosova", nr 2, 1973)[271].

Edhe pse ky vendim ishte i drejtë, ishte shprehje e lirë e fatit të popullit tonë, e në përputhje me dokumentet e PKJ-së për vetëvendosje , ky u kundërshtua dhe u kritikua nga udhëheqja e partisë jugosllave dhe nga vetë Titua, si "vendim që është në kundërshtim me vendimet e "AVNOJ-it".

Në një letër dërguar Komitetit Krahinor, Titua ua tërheq vërejtjen komunistëve kosovar se "sot nuk është fjala për caktimin e kufijve në mes të Shqipërisë e Jugosllavisë të dyja vendeve të pushtuara, por, për çlirimin e tyre me luftë të armatosur…Pra, sot do të ishte krejt gabim të parashtrohen dhe të zgjidhen në mënyrë të drejtë vetëm nga ana e popujve të lirë", kështu, kur ia donte puna , Titua me demagogji deklaronte se "punët që sot nuk mund ti zgjidhim, do ti zgjidhim nesër, pas lufte"[272]. Duke iu kundërvënë vendosjes së pushtetit popullor me kompetenca të plota për qeverisje në Kosovë, Tito i porosiste "shokët" kosovarë se "nuk duhej ta krijonin komitetin provincial, për shkak se krahina juaj nuk është një qark kompakt e i veçantë. Ky këshill mund të jetë vetëm iniciator, vetëm organ i unitetit politik të masave, por nuk duhet ti japim atij karakter pushteti" etj.

Deri sa organet partiake jugosllave ose heshtnin ose e përcillnin punën "për nesër" populli kosovar, komunistet dhe simpatizuesit e LNÇ-së kërkonin qëndrim të prerë për fatin e shqiptarëve. Komiteti i partisë për rrethin e Prizrenit, në një letër dërguar Komitetit Krahinor, vë në dukje se simpatizuesit e LNÇ-së nuk e kuptojnë çështjen e vetëvendosjes ashtu si e shpjegojnë ata dhe thonë:"Ne u flasim se vetë populli do të vendosë për fatin e vet, por atyre u duket e çuditshme kjo përgjigje, sepse kërkojnë që tu thuhet se a do ti bashkohet Kosova Shqipërisë në kohën e pasluftës". Edhe Milladin Popoviqi, qysh në vitin 1943 i dërgoi një letër Komitetit Qendror të PKJ-së, ku kërkonte që të përcaktohej përmbajtja konkrete e vetëvendosjes dhe mënyra se si të zbatohej ky parim te shqiptaret e Kosovës. "Ne kemi theksuar gjithnjë parullën e vetëvendosjes , për nesër. Në këtë mënyrë nuk kishte mundur edhe të mobilizohej populli shqiptar kundër pushtuesit". Më vonë, Milladin Popoviçi kërkon që KQ i PKJ-së të mbajë një qëndrim konkret dhe të përcaktojë formën e vetëvendosjes së shqiptarëve në Jugosllavi. Megjithëse çështja e Kosovës kishte ngelur ende e pazgjidhur, kosovarët e vazhdonin luftën , duke shpresuar që së paku pas lufte do ti fitonin të drejtat e veta kombëtare. Lufta

[270] Po aty, f. 11.
[271] Po aty.
[272] Dr. Sabile Keçmezi-Basha,"Reagimet e forcave nacionaliste në Kosovë ndaj vendimeve të Kuvendit të Prizrenit, 1945", "Studime historike", ASHSH, Instituti i Historisë, Tiranë 2007 (1-2).

po intensifikohej gjithnjë e më tepër, dhe nga fundi i saj formacionet luftarake në Kosovë numëronin rreth 50 mijë luftëtar që luftuan deri në krahinën më të largët të Jugosllavisë. Kosova, luftës i kishte dhënë mbi 6 mijë dëshmorë, por kur i shtohet edhe ata mijëra të tjerë të vrarë nga ushtria e "re" jugosllave, ky numër u shumëfishonte. Deri sa brigadat kosovare luftonin anembanë Jugosllavisë, në Kosovë, gjatë vitit 1945, ishin vërsulur divizionet serbe, malazez e maqedonase, që vranë dhe masakruan popullsinë shqiptare[273].

Ç'ndodhi më vonë me fatin e Kosovës dhe popullit të saj, autori na jep të dhëna të bollshme në nëntitullin "Pas "çlirimit", Kosova përsëri në ankand". Derisa në Kosovë ishte vendosur sundimi i egër i administrimit ushtarak jugosllav, në Beograd ishte vënë në ankand e tërë Kosova dhe krahinat e tjera shqiptare në Jugosllavi. Kujt do ti takonin krahinat shqiptare? Ishte udhëheqja "e re" e Jugosllavisë "socialiste" ajo që e shtronte tani këtë pyetje, që e kishin shtruar sa e sa herë ujqit shovinistë serbë[274].

Në Jugosllavi kishte edhe probleme të tjera të pazgjidhura thotë autori, por pazarllëqet më të mëdha u benën si zakonisht, rreth tokave shqiptare, dhe pikërisht rreth Kosovës, pasi që krahinat e tjera , pa diskutim ,u ndan në mes tri republikave të sapoformuara jugosllave, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Varianti i parë që u propozua në udhëheqjen jugosllave ishte se Kosova duhej të ndahej në mes tri republikave, që e rrethonin. Ndërkohë pas një konsultimit me Titon, doli vendimi se Kosova duhet të gëzojë statusin e autonomisë në kuadër të federatës jugosllave, por megjithatë, kjo "autonomi" do të ishte gjysmake, pasi Kosova duhej ti bashkohej si njësi autonome njërës nga njësit federale-republikave. Por, cilës republikë t'i bashkohej?[275] Shtrohej pyetja tjetër që u shtrua në Beograd.

-Ka pasur mendime (kuptohet të udhëheqjes jugosllave) se Kosova duhet ti bashkohet Malit të Zi, me arsyetim se kishte një traditë të lidhjes së Komitetit Krahinor për PKJ për Kosovë e Metohi me Komitetin provincial të Malit të Zi, Bokës dhe Sanxhakut, prej vitit 1937 deri më 1940, si dhe për shkak të " mentalitetit të ngjashëm të popullit shqiptar dhe atij malazez"![276]

-Kanë ekzistuar mendime për bashkimin e Kosovës me Maqedoninë, sepse populli shqiptar dhe ai maqedonas, sipas udhëheqjes jugosllave, ishin të ngjashëm për nga numri, se në të kaluarën kanë pasur fat të ngjashëm dhe se ekziston lidhshmëria e Kosovës me Maqedoninë.

-Kosova sipas disa mendimeve, duhej ti bashkohej Serbisë. Si arsyetim u morën një mori "faktesh": se në Kosovë rreth 20% të popullsisë ishte popullsi serbe, që synonin të jetonin në kuadër të Serbisë, se Vojvodina duhet ti takonte Serbisë për shkak të përbërjes nacionale, prandaj të dy autonomit duhej të ishin në kuadrin e një njësi federale, se Kosova ishte më e pazhvilluar në Jugosllavi, e Serbia njësia më e madhe, kështu që do të mund të jepte "ndihmë të rëndësishme ekonomike" për zhvillimin e shpejtuar të Kosovës, sepse, "nga motivet e internacionalistëve dhe komunistëve të nacionalitetit shqiptar dhe të atij serb për bashkim me Serbinë federale, kishte nevojë që , me anën e

[273] Si shënimi 416.
[274] Po aty.
[275] Pas "Çlirimit" Kosova përsëri në ankand, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 11.
[276] Po aty.

një jete të përbashkët, të afrohen populli shqiptar dhe ai serb, të cilët në të kaluarën, për shkak të politikës së qarqeve sunduese, kanë vepruar kundër njëri- tjetrit! Nga ana tjetër, bashkimi me Serbinë federale "ka qenë deri diku kompromis ndaj paragjykimeve të vjetra për Kosovën serbe, me të cilat kanë qenë të ngarkuar jo vetëm disa shtresa sociale të Serbisë, por edhe një numër komunistësh dhe njerëzish udhëheqës të kësaj njësie federale" ("Kosova" nr. 2.1973)[277]

Kështu, në bazë të të gjitha këtyre "argumenteve" e "fakteve", në favorin e Serbisë, nuk pat se si të mos fitojë propozimi i tretë, që Kosova ti bashkëngjitej Serbisë. Aneksimi arbitrar i Kosovës, i vendosur, nga qarqet e larta udhëheqëse të partisë dhe të shtetit jugosllav, ishte plotësim i aspiratave shoviniste serbomëdha. Vetë A. Rankoviqi, i cili edhe ishte autor kryesor i këtij aneksimi , në prill të vitit 1945, deklaronte me mburrje se " ky aneksim është përgjigja më e mirë për ata që trumbetojnë rrezikun e copëtimit të tokës serbe, që akuzojnë LNÇ-në sikur do ti dobësojë serbët për llogari të kroatëve e të tjerëve"[278].

Aneksimi dhe shitja e Kosovës te shovinistet serbë sipas autorit "ishte edhe një vepër e një grushti udhëheqësish tradhtar të Kosovës. Të cilët, ashtu si Koçi Xoxe me shokë, ishin vënë në shërbim të plotë të klikës Tito- Rankoviç.[279]

Populli i Kosovës, gjatë pranverës së vitit 1945 thotë autori i shkrimit se "nuk dinte se ç'po bëhej me fatin e tij në Beograd. Në prill të këtij viti, Dushan Mugosha, që atëherë ishte sekretar i Komitetit Krahinor për parti, shpreh "dëshirën" e Këshillit Nacional-çlirimtar për Kosovë e Metohin, që edhe " ne, popujt e Kosovës e Metohisë, ti aneksohemi Serbisë federative motër". Kjo deklaratë e një shovinisti të tërbuar në Mbledhjen e Këshillit Antifashist të popullit të Serbisë më vonë u bë "shprehje e vullnetit të lirë dhe e vetëvendosjes së popujve të Kosovës". Më 9 prill 1945, gazeta "Borba" njoftonte se "Mbledhja e Këshillit Antifashist të popullit të Serbisë pranoi dëshirën e popullit të Kosovës e Metohisë për bashkim me Serbinë federale". Mirëpo, po kjo gazetë, duke harruar çka kishte thënë njëherë, botoi me 30 qershor 1945 vazhdimin e fjalës së Dushan Mugoshës, ku ky zbulonte se Kosova nuk kishte bërë asnjë kërkesë dhe nuk kishte marrë asnjë vendim në kuvendin tonë, sepse në Kosovë e Metohi vepronte pushteti ushtarak. Në rastin e parë, sapo të hiqet pushteti ushtarak në Kosovë e Metohi, ne do të vendosim në kuvendin tonë që ti aneksohemi Serbisë federative"[280].

Në bazë të këtyre dallavereve thotë autori, nga më të ndryshmet,, nga të cilat ishte vendosur që Kosova të mbetej nën Serbi, u bë edhe Konferenca e Dytë e Këshillit Antifashist të Kosovës e Metohisë rreth përcaktimit të fatit të Kosovës, vetëm sa për t'iu bërë "aminin" asaj që ishte vendosur në Beograd. Dhe populli e di mirë se në çfarë rrethanash u zhvillua kjo konferencë (Konferenca e Prizrenit), ku delegatet hapur u kërcënuan nga njerëzit e OZNA-së se, po të mos deklarohen "pro", nuk do të kthehen në shtëpitë e veta. Dhe, vërtetë, shumë delegatë që votuan kundër vendimeve të Beogradit, nuk u kthyen më kurrë që andej. Vendimi "historik" i kësaj konference propagandohej

[277] Po aty.
[278] Po aty.
[279] Po aty.
[280] Po aty.

edhe sot nga tradhtarët si "shprehje e vullnetit dhe e dëshirës së popullit të Kosovës që ta lidhë fatin e vet me Serbinë dhe në kuadrin e saj - me Jugosllavinë.

Nga të gjitha që u thanë dhe u vendosën për Kosovën, asnjëherë nuk doli në shesh arsyeja, nuk u fol për të drejtën e popullit të Kosovës për të vetëvendosur për fatin e tij, që Kosova kishte të drejtë edhe të të shkëputej edhe të mbetej në kuadrin e federatës jugosllave, me të drejta të barabarta me popujt e tjerë të kësaj federate.

Këto të drejta ia propozonte popullit tonë gjaku i mija dëshmorëve i derdhur para dhe gjatë LNÇ-së, ia garantonte lufta e bërë, ia premtonte edhe vetë udhëheqja e PKJ-së. Sa për krahinat tjera shqiptare jashtë Kosovës, në udhëheqje jugosllave as që u fol- por arbitrarisht u vendos që ato të ndahen në mes të tri republikave jugosllave. Edhe vetë Kosova pothuajse nuk fitoi gjë, ajo mbeti pa deshën e saj, një "obllast" i republikës së Serbisë dhe asgjë më tepër.

Arsyet dhe shkaqet që e detyruan popullin shqiptar që të qohet në demonstrata ishin të shumta dhe shumë të arsyeshme për të parashtruar kërkesën që Kosova të shpallej republikë në kuadrin e Jugosllavisë. Për ngjarjet e më vonshme autori i sqaronte në vazhdim në pjesën me titull "Kërkesa për Republikë është e drejtë dhe do të triumfojë".Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi me shekuj ka luftuar për lirinë e tij, për të drejtat që i takonin[281]. Nga këto aspirata ai kurrë nuk hiqte dorë, pa marrë parasysh se më kë kishte të bënte. Edhe pas Luftës së Dytë Botërore, populli nuk u mashtrua me regjimin e ri, që ishte po aq i egër e i urryer sa edhe ai i Pashiqit, por e vazhdonte luftën për të drejtat e tij, pra edhe për të drejtën e vetëvendosjes. Pa marr parasysh kushtet e rënda të sundimit okupues, si dhuna e terrori , dëbimi i dhunshëm, prapambetja e theksuar ekonomike, prapambetja arsimore e kulturore, populli shqiptar asnjëherë nuk pushoi së kërkuari të drejtat e tij të ligjshme, statusin e republikës në kuadër të Jugosllavisë [282]etj.

Çështja e statusit të republikës u shtrua sidomos në vitin 1968, me rastin e përgatitjeve të disa amendamenteve të kushtetutës së Jugosllavisë. Përveç se në shumë tubime , këtë kërkesë ia paraqiti Titos një delegacion krahinor. Por Titua kishte refuzuar ti përgjigjej një kërkese të tillë, duke u arsyetuar se "republika nuk ishte faktor i vetëm i cili i zgjidhte të gjitha problemet" ("Rilindja", 4. XI. 1968). Ishte e qartë se udhëheqja jugosllave nuk kishte ndërmend të përgjigjej në kërkesën e kosovarëve. Prandaj, në nëntor të vitit 1968 shpërthyen demonstratat e mëdha të rinisë dhe popullit[283]. Demonstruesit pos të drejtës për vetëvendosje, kërkuan edhe njohjen e statusit të republikës, barazinë e përdorimit të gjuhës shqipe me atë serbokroate, hapjen e Universitetit të Kosovës, etj. Demonstratat ishin shuar me gjak nga forcat policore. Por, pas tyre, udhëheqja jugosllave u detyrua ti plotësonte disa nga kërkesat, si lejimin e përdorimit të flamurit kombëtar, barazinë e gjuhëve, hapjen e universitetit, por kërkesat për republikë nuk ishin pranuar, veç se, si satisfakcion , ishte sforcua statusi i autonomisë

---

[281] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Demonstratat studentore '81- kthesë e madhe në historinë më të re të Kosovës", (fejton), Epoka e Re, 8-10 maj 2006.
[282] Si shënimi 416.
[283] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Ndryshimet kushtetuese dhe Kushtetuta e vitit 1974", "Epoka e Re", 19 janar 2008.

dhe, nga një "obllast"[284], Kosova u shndërruar në një Krahinë Autonome dhe u bë element konstituiv i federatës.

Kosova kishte fituar "autonomin", por, megjithatë, ajo kishte mbetur një koloni e thjeshtë e Serbisë dhe e republikave të tjera, kurse pozita e shqiptarëve në republikat e tjera pothuajse nuk ndryshoi fare. Mbi popullin tonë edhe më tej vazhdonte shtypja dhe shfrytëzimi i egër kapitalist e kolonial.

Populli shqiptarë në Jugosllavi dhe rinia e tij heroike, nuk ishin pajtuar dhe nuk pajtoheshin kurrë me një pozitë dhe trajtim të tillë të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare . Prandaj, ai asnjëherë nuk e pushoi luftën e tij për të drejta e liri. Kjo ishte edhe arsyeja që populli i ynë, i bashkuar si një trup i vetëm, gjatë pranverës '81, kishte vërshuar rrugëve të qyteteve e fshatrave të Kosovës, duke brohoritur : "Kosova është jona", "Trepça është jona", "Kosova-kosovarëve", "Mjaftë me shtypje e shfrytëzim", "Kosova- Republikë", "Republikë, Republikë" etj. Me këto parulla në gojë populli ishte përleshur heroikisht me kordonët e policës serb, u përleshën me ushtrinë fashiste të Jugosllavisë e me tanket e tyre[285].

Kërkesa e popullit shqiptar në Jugosllavi për vetëvendosje e republikë, ishte e drejtë dhe krejt e ligjshme shkruante autori i shkrimit. Për këtë të drejtë populli kishte luftuar shekuj me radhë, për të luftonte pa marrë parasysh asnjë sakrificë, deri në realizimin e saj të plotë, deri sa ai të bëhej zot i tokave dhe i fatit të tij[286].

Kosova dhe tokat e tjera shqiptare në Jugosllavi ishin të atyre që jetonin në to, dhe vetëm ata kishin të drejtë të vendoseshin për fatin e tyre.

4. 3. Tradhtarët, petkun e ndërronin por veset jo

Autori Jusuf Gërvalla, në tekstin "Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj", në mes tjerash shkruante "çdo pushtues, për të bërë zap popullsinë e pushtuar, rekruton në organet e pushtetit të vet një numër vendësish, të cilët bëhen përgjegjës të politikës, të ideologjisë dhe të urdhrave të atij pushteti[287].

Nga viti 1912, kur tokat shqiptare në Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit, në Maqedoni, Mal të Zi si dhe ato në Serbinë e sotme iu shkëputën padrejtësisht trungut shqiptar dhe hynë nën zgjedhën e egër serbo-malazeze, në shërbim të pushtetit të huaj hynë edhe njerëz nga radhët e popullsisë vendëse shqiptare, që nga "poverenikët" më të thjeshtë e deri te deputetet në parlament. Në kohën e Jugosllavisë së vjetër kishte ndodhur që populli shqiptar, duke u nisur nga të drejtat formale që garantonte kushtetuta e atëhershme, bënte edhe përpjekje për të zgjedhur përfaqësuesit e vet në organet e pushtetit (rasti i Zef Lush Markut, Lufta e Baranit e 1937-së)[288] dhe, për ta realizuar këtë të drejtë, ishte përgjakur sa e sa herë me pushtetin shovinist.

---

[284] Kërkesa për Republikë është e drejtë dhe do të triumfojë!, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 12.
[285] Po aty.
[286] Po aty, f. 13.
[287] Po aty.
[288] Po aty.

Ndërkaq, në Jugosllavinë e Titosë, pushteti e kishte kursyer popullin : ai ishte kujdesur vetë për njerëzit që do të zgjidhen në organet shtetërore. "Povereníkët" dhe deputetet shqiptar në "parlamentin" titist i gjenim në një pozitë më të mirë se ata në Jugosllavinë mbretërore: këta s'kishin nevojë as të luanin veshin për të bërë çka do për popullin në mënyrë që të fitonin simpatinë e tij. Mjafton që tu përgjigjeshin kërkesave të pushtuesit dhe e kishin të siguruar kolltukun e butë. Vullneti i popullit përjashtohej fare , sepse, në vende udhëheqëse[289] (qoftë edhe për një drejtor të thjeshtë), funksionaret nuk zgjidheshin por emëroheshin nga forumet e larta lokale dhe qendrore. Pasi ti kishin zgjedhur për qejfi, pushteti i quante këta njerëz- përfaqësues, sipas praktikës së atëhershme, ishte e nevojshme të japësh provime të shumta të gatishmërisë për të bërë politikë antishqiptare, ani pastaj të të emëronin pushtetarët në ndonjë organ lokal apo qendror.

S'kishte tjetër emër për këta sahanlëpirës që i shërbenin me besnikërinë e robit, jo populli, nga gjiri i të cilit kishin dalë, po regjimit të egër antipopullor e antishqiptar, te i cili ishin shitur badihava. Ata ishin bërë thjeshtë një vegël e verbër në realizimin e politikës shoviniste dhe të gjenocidit mbi shqiptaret[290].

Me pajtimin e plotë të këtyre tradhtarëve u masakruan, më 1945, popullsia shqiptare në Drenicë e Gjilan, në Tetovë e gjetkë. Me heshtjen e tyre aprovuese u likuiduan dhjeta mija partizanë shqiptarë në Tivarë, në Srem e Slloveni, ku kishin vajtur për tu dal në ndihmë popujve fqinjë jugosllavë në dëbimin e çizmes fashiste. "Povereníkët" dhe funksionarët titistë ishin kokë e këmbë të pranishëm kur u shkel me të dy këmbët vullneti i popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare, i shprehur në Rezolutën e Konferencës së Bujanit, më 1943, e cila shqiptarëve u garantonte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje dhe bashkimin me vendin amë, Shqipërinë[291], e që ishte aspiratë e natyrshme shekullore e popullit tonë të martirizuar.

[289] Tradhtarët e vjetër dhe tradhtarët e rinj, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 12.
[290] Po aty.
[291] Po aty.

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, 10 korrik 1982: Nga e djathta në të majtë - Jakup Krasniqi, Mehmet Hajrizi, Gani Sylaj, Nezir Myrtaj dhe Berat Luzha. Ky është grupi i parë prej 19 anëtarëve të OMLK'së. Në foto mungon Hydajet Hyseni, i cili nuk u paraqitë në gjykim me arsyetimin e Trupit Gjykues se ai është i sëmurë. Drejtuesit e grupit protestuan, duke e bërë të pamundur mbajtjen e seancës së parë, sepse është dyshuar se Hydajeti është vrarë...(Shënim i editorit të pashtriku.org, sh.b)

Në vend që të viheshin me guxim në ballë të popullit tonë të shkretë e të dërmuar luftërash, masakrimesh e skamjeje, ti prinin atij në rrugën e mëtejshme të çlirimit kombëtar dhe klasor (kur Jugosllavia shkeli të drejtën e premtuar , për të cilat populli i ynë pat derdhur pa kursim gjakun e bijve tanë më të mirë), tradhtarët me shokë, parapëlqyen qyqarin dhe pajtimin në heshtje me të gjitha të zezat që kishin përgatitur për shqiptaret klika titiste. Ata ishin këtu edhe kur zbriten dhe shkelën për më se 20 vjet flamuri shqiptar. Ata nuk paraqitën kundërshtimin më të vogël as më 1947, kur u zbrazën drithnikët e Kosovës dhe populli i uritur u detyrua të ushqehej me barishte, se kopallat dhe demagogjitë e pushtetarëve nuk jepnin bukë. Për më tepër , kur dihej se njerëzit tanë u ndodheshin në krye të detyrës për realizimin e aksionit famëkeq të armëve, më 1956, kur populli shqiptar u masakrua, kur dinjiteti i popullit u kërcënua të ulej deri në baltë nga zullumet e gjakpirësve titistë- rankoviqistë. Qyqarin e tyre nuk e preku as vajtimi i djepave shqiptare, as loti i nënave, as malli i burrave shqiptarë, që u dëbuan nga vatrat stërgjyshore dhe morën në sy shkretëtirat e Anadollit. Tradhtarët ishin gjithnjë këtu, të pranishëm kudo, dhe bënin jetën e tyre të rehatshme në kushtet e "vëllazërim- bashkimit" të xhelatit me viktimën. Dhe për këtë merrnin shpërblim racionin e turpshëm prej sahanlëpirësish: së pari në triska të majme për ushqim e veshmbathje, pastaj në shtëpi të mëdha e apartamente, e më vonë në vila e vetura. Kur krimet individuale e masive të ushtruara nga klika titiste mbi popullin shqiptarë, si prekën dot pushtetarët shqiptarë, marrëzia më e madhe ishte kur prej tyre u prite që të prekeshin nga pabarazitë ekonomike, shoqërore e kulturore nën regjimin titist. Natyrisht, ata assesi nuk përkrahnin

interesat dhe kërkesat e popullit se ishte më me rëndësi fotelia se sa interesi mbar shqiptar[292]. Dhe, kur të mos iu mjaftojnë milicia dhe ushtria e stacionuar në tokat shqiptare të robëruara, ata shkonin aq larg sa mund të thërrisnin edhe milicinë dhe ushtrinë e Beogradit. E dinin se, për të bërë zap shqiptarët, Beogradi nuk kursente ushtrinë e as milicin, tanket e as avionët, helikopterët e as municionin.

Kjo gjë ç'ishte e vërteta, dihej mirëfilli. Ishte parë në ngjarjet e 1945-së e në ato të të 1968-së. U pa edhe në tragjedinë më të re të Kosovës, në mars e prill- 1981-it.

Por ishte e panjohur një gjë tjetër. Me gjithë besnikërinë e tyre të pashoq ndaj Beogradit thoshte autori i shkrimit "tradhtarët shqiptarë… a e meritonin atë që Beogradi ti nxirrte në rrugën e madhe? Dyzet vjet lufte antishqiptare Beogradi nuk iu siguroi as një pension të rehatshëm, thoshte autori i shkrimit, në gazetën "Liria".

Shqiptari liridashës gjithmonë e kishte urryer regjimin antipopullor jugosllav, i cili mbante nën thundrën e vet të përgjakshme edhe popujt e tjerë të këtij mozaiku artificial, por që dëmtonte veçanërisht shqiptarin . Po kjo urrejtje kishte dal haptazi dhe ishte bërë mur i pa kapërcyeshëm për pushtuesin dhe tradhtarët e vendit[293]. Në ngjarjet e marsit e të prillit, populli i ynë kishte thënë njëherë dhe përfundimisht: jo! Kjo i kishte kushtua me gjak. Ndërmjet shqiptarëve dhe qeverisë së Beogradit kishte hyrë gjaku i bijve të shtrenjtë të popullit tonë. Dhe ky gjak ishte ai që i fshinte të gjitha perspektivat e kthimit në gjendjen e mëparshme. Beogradi kërcënohej haptazi me gjakderdhje të reja. Por, si bënte dobi. "Zemra e jonë ka gjak sa gurra!" thoshin të rinjtë. Dhe mbi gjakun e derdhur forcoheshin edhe më shumë themelet e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve të robëruar. Ndjenja e fuqishme e lirisë e kishte bashkuar popullin trim si një trup të vetëm. Me tanket e aeroplanët , me helikopterët e mitralozat, me ushtrinë e milicinë speciale, Beogradi s'bëri gjë tjetër po që dogji etapat e luftës të pashmangshme dhe na ndihmoi shumë në afrimin sa më të shpejtë kah dita e fitores së sigurt.

E dinte mirë Beogradi se nuk gjendej dot ilaç për ta shëruar te populli kujtimin e vrasjeve e të plagosjeve, as akullin e burgjeve. Andaj, përsëri do të kthehemi te tradhtarët e popullit, dhe se populli edhe për ta po përgatiste, atë që po i përgatite okupuesit dhe nuk do ti harronte kurrë, dhe do të ngeleshin të njollosur nga vet populli liridashës.

Si në çdo numër të mëparshëm, edhe në këtë numër të revistës jepeshin disa të dhëna për fjalimet e Enver Hoxhës që i kishte dhënë në diskutime dhe në libra të ndryshëm për Kosovën. Në shkrimin "Jugosllavët të vrasin natën e të qajnë ditën", autori e përshkruan situatën e Konferencës së Parë të Vendit ku marrin pjesë jugosllavët : Bllazho Jovanoviqi dhe Milladin Popoviqi dhe në pika të shkurtra paraqite se si i prezantonte vet Enver Hoxha: "Midis të tjerash, në mendje më ka mbetur edhe një moment tjetër gjatë Konferencës që tregon më së miri se kush qe Milladin Popoviqi. Në përshëndetjen e tij Bllazho Jovanoviqi, pasi vlerësoi punën dhe veprimtarin e partisë sonë Komuniste, foli edhe për Milladinin dhe Dushan Mugoshën dhe në njëfarë mënyre bëri aluzion se këta ishin "krijuesit" e Partisë sonë. Milladini, si internacionalist që ishte ,

---

[292] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Gabimet e vjetra dhe të rejat të pushtetit jugosllav ndaj shqiptarëve**",** "Zëri", qershor 1985.

[293] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Organizatat dhe grupet...vep. e cit., f. 62-63.

duke qenë kundër pikëpamjeve të tilla, në ndërhyrjen e tij theksoi: Askujt nuk duhet ti shkojë ndër mend se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kemi krijuar ne dy të dërguar të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Jo, e vërteta është se Partinë Komuniste të Shqipërisë e krijuat vetë ju, komunistet shqiptarë dhe, nëse duhet folur për rolin tim, ose të çdokujt tjetër nga jashtë ky rol s'është gjë tjetër veçse ajo që në marrëdhëniet midis partive motra quhet ndihmë e përkrahje internacionaliste, vëllazërore. Partinë tuaj Komuniste ju do ta krijonit siç e krijuat, edhe sikur të mos vinim ne këtu[294].

I tillë qe Milladin Popoviqi, prandaj ne e nderonim dhe e respektonim atë për cilësitë e tij të larta dhe për mirëkuptimin që arrinim, kur bisedonim për njërin apo për tjetrin problem. Siç thashë, në ato vite, ne qemë njohur edhe me Dushan Mugoshën dhe në prag e gjatë punimeve të Konferencës, edhe me Bllazho Jovanoviqin. Dushani qëndroi në Shqipëri pothuaj deri në prag të çlirimit, por nuk i afrohej Milladinit as nga kapaciteti, as nga kultura, as nga bonsensi e thellësia e mendimit dhe as nga karakteri. Milladini ishte i çiltër , i dashur me shokë, i rreptë me armiqtë, njeri me kulturë dhe me horizont të gjerë, komunist nga zemra dhe botëkuptimi, kurse Dushani, pa ia mohuar që ishte trim e punëtor, ishte i ngushtë, sektar, i përciptë, i nxituar dhe që me intrigat e tij, ç'orientoi e dëmtoi shumë organizata e kuadro. Por, fytyrën e tij të ndyrë prej shovinisti e titisti, të një agjenti të ultë të Rankoviqit e armiku të përbetuar kundër shqiptarëve të Kosovës, ai e tregoi më mirë kur Partia Bolshevike e Stalini i madh dhe pas saj, Partia e jonë demaskuan klikën trockiste të Titos[295].

Gjatë ditëve që ishte në Shqipëri, siç thashë, ne njohëm edhe Bllazho Jovanoviqin. Në një bisedë që patëm me të ky "shfaqi mendimin" se në ndonjë rast Partia jonë kishte rënë në "sektarizëm"… Ne ia kundërshtuam me forcë Bllazho Jovanoviqit thëniet e tij, argumentuam se si qëndronte e vërteta mbi të ashtuquajturat çeta të partisë dhe u duk se ky ra dakord me ne. Më pas, mbaj mend që as unë,as Miladini nuk patëm me të ndonjë fërkim a mosmarrëveshje, ai qëndroi brenda funksioneve të tij, bile megjithëse ishte anëtar i KQ të PKJ-së. Ai dëgjonte me vëmendje bisedat, argumentet, raportimet etj. Të Miladinit se e shihte që ky e njihte mirë gjendjen e Partisë e të luftës në Shqipëri dhe, siç thashë, në përshëndetjen që i bëri Konferencës së Parë të Vendit[296], vlerësoi lartë realizimet që ishin arritur nga Partia e jonë e re, si në ngritjen e forcimin e saj, ashtu dhe në zhvillimin e luftës antifashiste të popullit shqiptar[297].

Ishte e çuditshme se si pak kohë pas Konferencës së Parë të Vendit erdhi S.V.Tempo, dhe, me një arrogancë e prepotencë të paparë, deshi të hidhëte poshtë gjithë vijën e Partisë sonë. Si, duket, udhëheqja e PKJ-së nuk ishte e kënaqur ngaqë Bllazho Jivanoviqi nuk mundi ta kryejë si deshën ata rolin që i kishin caktuar, prandaj dërguan Tempon me "vërejtje" e "kritikë" ,me planin për "Shtabin ballkanik", për të futur në një thes "federativ" Shqipërinë, Bullgarinë e Greqinë. Vërejtjet dhe propozimet e tij absurde e arrogante nuk mund t'i pranonim dhe u grindem e u ndamë keq me të si unë edhe Miladini. Që në këtë kohë ai përpunoi Koçi Xoxën dhe e nxiti për prapaskena kundër

---

[294] Jugosllavet të vrasin natën e të qajnë ditën, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981, f. 13.
[295] Po aty.
[296] Po aty.
[297] Po aty.

udhëheqjes së shëndoshë të Partisë sonë, por Tempoja s'kishte kohë që të ndalej më shumë në Shqipëri , se kishte plane "të mëdha" dhe me komunistet grekë e bullgarë[298].

Pikërisht në këtë periudhë nisi të shfaqej konflikti i ashpër midis nesh dhe udhëheqjes së PKJ-së e që më pas erdhi gjithnjë duke u acaruar. Ky konflikt në fillim dukej sikur shkaktohej nga personat e dërguar, siç qe rasti me Tempon në verën e vitit 1943 apo Velimir Stojniqit e Nijaz Dizdareviqit në verën e vjeshtën e 1944-së, por koha do të vërtetonte se rrënjët dhe synimet e konfliktit ishin shumë më të thella, të paramenduara prej kohësh e tepër armiqësore

Më vonë shton autori se si i kujtohet Hoxhës "Që, në kohën kur Miladini u urdhërua të kthehej në Kosovë, para se të ndahej nga ne, duke shëtitur unë dhe ai u ngjitëm në kodrat e Odriçanit, e, duke biseduar, ai më tha: Taras, dëgjo, këta , Stojniqi dhe Dizdareviqi, janë armiq. Vetëm në mos u pjeksha dot me Titon, se këta dhe të gjithë ata që i kemi luftuar së bashku, do ti demaskoj"[299].

Por, shpejt ne do të bindemi që vetë udhëheqja jugosllave, me Titon e Rankoviqin në krye, ishte dora që i kishte përgatitur e i kishte dërguar te ne, për veprimtari antiparti e antishqiptare, Mugoshët, Vukmanoviqët, Stojniqët e të tjerë. Dhe më pas, kur tradhtia e tyre doli sheshit, fabrikuan "libra të bardha" e broshura, artikuj e "kujtime", një propagandë të tërë false e të ndyrë për të detyruar opinionin që të besojë se ata kanë krijuar këtë e atë, se ata e bënë këtë e atë, shkurt, ata na e paskan bërë diellin të dalë mëngjeseve në Shqipëri[300].

Këta flasin shumë për të dërguarit jugosllavë, të cilët erdhën për herë të parë nga Kosova në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1941, por nuk përmendin një fakt real: qysh në pranverën e 1939-të më 1940, por sidomos pas prillit 1941, kur hynë italianët në Kosovë, nga Shqipëria u dërguan në Kosovë një numër i komunistëve, me origjinë nga ato anë, por që prej kohësh ishin bërë këtu komunistë e vepronin këtu si komunistë. Ata dhanë një kontribut për organizimin e Partisë dhe të LNÇ-së në Kosovë e gjetkë[301], shumë prej tyre dhanë jetën në zjarrin e luftës.

Po kështu në vitin 1941, por edhe më pas, nga Shqipëria shkuan në Kosovë e në krahina të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, dhjeta e dhjeta mësues shqiptarë[302]. Ne, komunistet e atëhershëm, duke shfrytëzuar këtë rast legal, u përpoqëm dhe mundëm të futnim në përbërjen e atyre që u dërguan në Kosovë elementë patriotik e revolucionarë, shumë nga shokët, miqtë e simpatizantët e grupeve tona komuniste, e më pas, të Partisë Komuniste që krijuam. Ata me porosinë tonë dhanë atje një kontribut të ndjeshëm, duke përkrahur e duke u hedhur aktivisht në luftën antifashiste të popullit trim kosovar, vëllezërve tanë të një gjaku[303].

---

[298] Po aty.

[299] Po aty; Enver Hoxha, Kosova është Shqipëri, Tiranë, 1999.

[300] Po aty.

[301] Po aty.

[302] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Kosova në trajtimin e organizatave e grupeve ilegale në Shqipëri (1945-1948), fejton në 6 vazhdime. Gazeta "Zëri", 1-7 shtator 2007.

[303] Si në shënimin 451.

Dihet edhe kjo e vërtetë shton autori se: njësi të tëra të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, me urdhër të Shtabit tonë të Përgjithshëm, që në ditët e para të tetorit 1944, kur akoma s'qe çliruar plotësisht Shqipëria, vazhduan luftën heroikisht në Kosovë, kurse pas çlirimit të vendit, brigada të tjera të ushtrisë sonë (dy divizione: V dhe VI), vazhduan luftën edhe në viset të tjera të Jugosllavisë, krah për krah me njësit e partizanëve kosovarë e të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Disa qindra prej partizanëve tanë dhanë jetën në Kosovë, në Mal të Zi, në Sanxhak e në Bosnje ku luftuan[304].

Terrenin e falsifikimeve të ardhshme ata e përgatitën qysh më 1945. Jo shumë kohë pas çlirimit të Kosovës Miladin Popoviqin e vranë prapa krahëve njerëzit e UDB-es, sepse ishte shprehur për të drejtën e popullsisë shqiptare në Kosovë për vetëvendosje. Për këtë kemi bindje dhe fakte të plota jo vetëm nga bisedat që bënim me Miladinin, kur ishte në Shqipëri, por në Arkivin e Komitetit Qendror të Partisë sonë kemi dokumente që flasin qartë për këto pikëpamje të komunistit internacionalist, Miladin Popoviqit. Pas kësaj njerëzit e Titos trumbetuan se vrasjen gjoja e paskësh bërë… një shqiptar kosovar! Dhe ku? Mu në tavolinën e punës, në shtëpinë që ruhej nga partizanë jugosllavë! E gjithë kjo farsë kriminale qe organizuar, pra, me cinizëm më të madh nga Titoja me Rankoviqin dhe shokët e tyre, në mes të të cilëve edhe Dushan Mugosha, për të fshehur gjurmët e tradhtisë së tyre karshi nesh. Njeriu, që ata e urrenin dhe e vranë, sepse ai s'mund të pajtohej me veprën e tyre armiqësore ndaj komunizmit, i vunë dekoratën e heroit të popujve të Jugosllavisë. Ky veprim u shkon vetëm banditëve të tillë, për të cilët populli thotë: "Të vrasin natën e të qajnë ditën"[305] përfundon shkrimin.

4. 4. Aktualiteti jugosllav dëshmon të kundërtën

Në një punim që le mbresa për gjendjen aktuale në Jugosllavi, është edhe teksti me titull "Dëshmi e kalbëzimit të "vetëadministrimit" titist". Aty thuhej se ka kohë që propaganda në Jugosllavi po bënte një zhurmë shurdhuese rreth Kongresit të ashtuquajtur të "vetëadministrusve", që ishte mbajtur kohët e fundit në Beograd[306]. Në fjalimet e krerëve si dhe në komentet e shumta që kishin mbushur faqet e shtypit jugosllav, e kishin ngritur në qiell "rendësin e madhe" të këtij kongresi, i cili cilësohej si "ngjarje e madhe", " e jashtëzakonshme", bile edhe "historike"![307]

Si zakonisht në raste të tilla, kjo zhurmë u shoqëronte edhe me himne e ditirambe plotë absurditet e monotoni kushtuar Titos e "vetëadministrimit", "vëllazërim- bashkimit" e "mosangazhimit" etj,,, Në këtë punim autori paraqiste gjendjen e mjeruar në ekonomin jugosllave, dështimet e shumta që ndodhnin në te. Ngase edhe vetë pjesëmarrësit e kongresit dëshmonin një gjë të tillë. Kishte kohë që në Jugosllavi flitej e shkruhej me të madhe për të ashtuquajturën "punë e bashkuar" dhe ligjin e saj, për "pozitën dominuese

---

[304] Po aty.
[305] Po aty.
[306] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Zhvillimi i kulturës në Kosovë" "Bota shqiptare", nr. 10, 1993, Tiranë.
[307] Dëshmi e kalbëzimit te "vetadministrimit" titist, "Liria" nr. 4-5, gusht 1981, f. 15.

të punëtorëve në të", për "zotërimin e riprodhimit nga punëtorët", për "ndarjen sipas punës" etj. Se çfarë ishte gjendja e vërtetë në këtë fushë, tregon më së miri gjendja e vështirë dhe gjithnjë më e padurueshme, në të cilën ndodhën masat punonjëse, tregon edhe ajo që u tha në Kongres. Edhe vetë Mika Shpilaku, që kishte paraqitur referatin kryesor, ishte detyruar të pranonte se " në dekadën e shkuar… tjetërsimi i të ardhurës nga punëtorët edhe më tej ka ngelur dominues"[308], kurse shumë delegatë punëtorë kishin theksuar hapur se puna e mundi i tyre ishte shfrytëzuar në mënyra të ndryshme, të hapura e të fshehta.

Edhe vet Stane Dollanci në referatin që kishte paraqitur, ishte detyruar të pranonte se sistemit i delegimit, "marrë në tersi, nuk ka arritur rezultate të kënaqshme dhe kishte pasur ngecje në punën e tij", kurse delegatët tjerë në diskutimet e tyre, kishin folur edhe më hapur për " mosfunksionimin e sistemit të delegimit", për " pjesëmarrjen formale e simbolike dhe hapësirat e ngushtuara për vendosjen e punëtorëve", për " mungesën e çdo kontrolli punëtor dhe pamundësinë që punëtori të thotë fjalën e vet dhe të ndikojë në vendosjen e çështjeve më të rëndësishme", për "disproporcionin e madh në mes të asaj që thuhet e asaj që bëhet, në mes të normativës dhe reales". Ishte domethënës fakti që edhe në këtë kongres gjoja të punëtorëve shumica dërmuese e delegatëve ishin jo punëtor, por burokratë e funksionar të rangjeve të ndryshme" përfundon autori.

4. 5. Krizat ekonomike në Kosovë

Në artikullin e Nezir Myrtës "Thellohet kriza ekonomike e Kosovës thuhet se vetëm gjatë tre muajve të parë të vitit 1981, në Kosovë ishin regjistruar mbi 1,4 miliardë dinarë humbje më shumë se gjatë gjithë vitit të mëparshëm. Në krahasim me një vit më parë, në maj të këtij viti çmimet u rritën 52,6%, kurse kostoja e jetesës 53,4%. Gjatë pesë vjetëve të ardhshme, supozohej se punë dot kërkonin mbi 180 mijë të papunë të rinj. Ndërsa u zhvillonte "më shpejt" apo po ngecte edhe më shumë Kosova. Të tëra këto autori i kishte paraqit në shkrimin "Thellohet kriza ekonomike në Kosovë".Në fushatën e gjerë propagandistike që po bënin pushtetarët jugosllavë rreth demonstratave të Kosovës, po flitej me të madhe edhe për gjoja sukseset që ishin arritur në ekonomin e Kosovës gjatë muajve të parë të vitit 1981, e sidomos gjatë kohës së demonstratave që u bënë[309]. Në këtë mënyrë, ata donin të thoshin se klasa punëtore, jo vetëm që nuk mori pjesë në këto greva e demonstrata , po përkundrazi ajo i kishte dënuar ato dhe mobilizuar që të punonin edhe më tepër, bile edhe ta tejkalonin planin e prodhimit.

Gjatë katër muajve të parë po të njëjtit vit (1981), prodhimi industrial, sipas të dhënave që jepnin, pushtetarët ishte rreth 3% nën shkallën e planifikuar. Në shumë degë të ekonomisë e në ndërmarrje të mëdha si "Trepça", "Kosova" etj, nuk po arriheshin as për së afërmi rezultatet e parashikuara[310].

---

[308] Po aty.
[309] Thellohet kriza ekonomiken Kosovë, "Liria"nr. 4-5 gusht 1981, f. 16.
[310] Po aty.

Veçanërisht të rëndë e bënin gjendjen në ekonomin kosovare humbjet e mëdha financiare, të cilat, siç shkruante "Rilindja", vetëm për 3 muajt e parë të vitit, ishin shtuar jo më pak se 1,4 miliard dinar. E që ishin më të mëdha se të gjitha humbjet që ishin regjistruar gjatë vitit të mëparshëm, shumica dërmuese e të cilave ishin akoma të pambuluara. Pjesa më e madhe e këtyre humbjeve , ashtu si edhe më parë, shënonte në degë kryesore të ekonomisë, në industri, xehetari, ndërtimtari etj.

Nga propaganda serbomadhe bëhej zhurmë e madhe edhe rreth të ashtuquajturit "nacionalizëm ekonomik", i cili, sipas asaj, qenka prezent edhe në Kosovë. Mirëpo faktet tregonin se ekonomia e Kosovës, më pak se çdo ekonomi tjetër në Jugosllavi, ishte e mbyllur në vetvete. Mallrat e firmave jugosllave bënin gara konkurruese në tregjet e Kosovës në një kohë që mallrave kosovare u kufizohet plasim në tregjet e tjera, dhe, si pasojë e saj, depot e ndërmarrjeve kosovare mbusheshin me stoqe të shumta[311]. Firma e ndërmarrje të të gjitha republikave të Jugosllavisë kishin hapur anë e këndë Kosovës, qindra njësi të tyre tregtare, kurse ndërmarrjet kosovare detyroheshin ti mbyllnin shitoret e tyre edhe në Kosovë.

Vështirësi të shumta i kishin dal Kosovës për plasim të mallit të saj në tregjet e jashtme. Shumë mallra kosovare, që dot mund të eksportoheshin në tregjet e jashtme , grabiteshin me çmime fare të ulëta nga borgjezia jugosllave, e cila pastaj nxirrte prej tyre fitime të mëdha. Dihej nga të gjithë se prodhimet e "Trepçës", firmat jugosllave i marrin me çmime shumë të ulëta, që s'u afroheshin çmimeve reale në tregun botëror, kurse energjinë elektrike, që prodhohej në Kosovë, kosovaret e paguanin më shtrenjtë se sa e paguanin atë në republikat jugosllave[312]. Për sigurimin e lëndëve të para dhe të teknologjisë nga jashtë, Kosovës i jepnin fare pak leje e deviza, kurse vështirësi e pengesa të shumta administrative nxirrnin asaj edhe në fushën e eksportit. Në kushte të këtilla, nuk ishte çudi që vetëm gjatë 4 muajve të parë të vitit deficiti tregtar të arrihej edhe në mbi 1,6 miliardë dinar.

Në gjendje më të mirë nuk ishte as tregu i brendshëm në Kosovë, i cili kishte kohë që ishte boshatisur. Para demonstratave ishte vështir të gjeje edhe artikujt më të domosdoshëm për jetesë, si miellin, kripen, sheqerin, detergjentet etj. Gjatë kohës sa zgjatën demonstratat dhe menjëherë pas tyre, furnizimi i tregut sikur ishte përmirësuar. Pse kishte ndodhur kjo kështu? Nuk ishte ndier më mungesa e mallrave, ishte thyer ajo krizë, apo ato ditë u punua "me vullnet të pathyeshëm" dhe u prodhua më tepër që të ketë edhe për Kosovën. Jo, kishte ndodhur kështu, për hir se borgjezia jugosllave dhe krerët e saj u gjenden në pozitë të rëndë dhe mungesat në treg e rëndonin edhe më shumë gjendjen në Kosovë. Këtë e dëshmon më së miri edhe ajo që ndodhi më pas. Atëherë që lufta sikur u qetësua pak, dollapët e shitoreve ishin zbrazur përsëri, anarkia e kaosi në treg po vazhdonin. Populli i Kosovës nuk gjente sheqer as për ilaç, në kohën që sheqeri i tij eksportohej jashtë Jugosllavisë apo dërgohej nëpër republikat jugosllave. Vetëm në dhjetor të vitit 1980 nga fabrika e sheqerit në Pejë ishin dërguar në Itali jo më pak se 1533 tonë sheqer[313]. Kështu veprohej edhe me millin, vajin e produkte të tjera.

---

[311] Po aty.
[312] Po aty.
[313] Po aty.

Një rritje e paparë gjatë muajve të parë të vitit 1981 shënonin edhe çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të ndryshme. Në fund të majit të po të njëjtit vit ato ishin 52,6% më të larta se në majin e vitit të mëparshëm. Si pasojë e kësaj edhe kostoja e jetës , ishte shtuar si asnjëherë më parë, duke e bërë edhe më të padurueshme jetën e masave punonjëse. Në krahasim me dhjetorin e vitit 1980, në maj të një viti më vonë, ajo ishte shtrenjtua për 23,8%, kurse në krahasim me një vit më parë-53,4%[314].

Se sa ishte zhvilluar "me shpejt" Kosova, tregonte edhe fakti se më 1978 pjesëmarrja e Kosovës në popullsinë e përgjithshme të Jugosllavisë ishte rreth 7%, kurse pjesëmarrja e saj në të ardhurat kombëtare të Jugosllavisë, vetëm 1,9%. Ndërsa në vitin 1953 prodhimi shoqëror i Kosovës për një banor ishte 46,1% nën mesataren e Jugosllavisë, më 1979 ai kishte rënë në gjithsej 28%, kurse gjatë dy vjetëve të fundit, ai kishte zbritur edhe më shumë. Gjatë pesëvjeçarit që kishte shkuar, ekonomia e Kosovës jo vetëm që nuk ishte zhvilluar 60% më shpejt se mesatarja jugosllave , siç planifikohej , por përkundrazi, ajo mbeti për 50% nën këtë mesatare[315], konstaton autori.

Pas ngjarjeve të fundit (1981), Kosovën e vizitonin funksionarë e grupe të ndryshme punuese nga Serbia e Jugosllavia. Të gjithë ata i "preokuponte" gjendja e vështir në të cilën ndodhej ekonomia e Kosovës dhe u angazhonin për "zhvillimin e saj sa më të shpejt"! Por, se çka i kishte preokupuar ata në të vërtetë, se çfarë zhvillimi të Kosovës dëshironin ata, tregonte më së miri potencimi nga të gjithë ata i nevojës së intensifikimit të eksploatimit të mëtejshëm të thëngjillit dhe pasurive të tjera.

Gjendja edhe ashtu e rëndë në ekonominë e Kosovës, e kishte rënduar edhe më tepër përballimi i shpenzimeve për policinë, UDB-en dhe ushtrinë okupuese, që ishin dyndur në Kosovë pas demonstratave.

Në këtë numër të revistës prezantohen edhe dy poezi, ngase gjerë më tani në këtë revistë nuk hasim në to, me gjasë anëtarët e redaksisë nuk e kishin parë të arsyeshme që të botonin poezi, se populli shqiptar u ballafaqonte me problemet që ishin të rënda dhe shumë të mëdha por edhe për faktin që nga "Liria" ishte botuar përmbledhja në poezi "Këngët e lirisë". Këto poezi, kishin përmbajtje patriotike. Poezia e Hydajet Hysenit "Zemra speciale"[316] ka 7 strofa me një rimë të përkryer. E tërë poezia i kushtohej demonstratave studentore të vitit 1981. Po i prezantojmë vetëm ca vargje: /Por, s'na trembni, këlyshë të Drazhës/ Ju të etur gjarpinj të gjakut/ Na jemi bijtë e Mic Sokolit,/ Motra e vëllezër të Emin Durakut, për të vazhduar me vargjet:/Armë e çelik- e dimë- ju keni/ keni tanke e avionë/ Po grushti i ynë i bashkuar/ Është më i fortë se çdo atom. Dhe poezia tjetër e Hydajet Hysenit: "Të gjithë shqiptarët –Mic Sokola",po ashtu ka përmbajtje patriotike, që në një mënyrë të shkëlqyer shkruan për trimëritë e djemve dhe vashave që morën pjesë në demonstrata, dhe pa iu frikuar fare armikut dhe as tankeve të tyre, vërsulen mbi ta e mitraloz dhe mu nga kjo del dhe titulli i poezisë se të gjithë shqiptaret janë Mic Sokola.: Kam parë birin e Kosovës/ Tankut para si i doli/ Para grykës hapi gjoksin/ Sokëllin si Mic Sokoli, për të vazhduar :Kam parë vajzat e Kosovës/ Kam parë nëna shamizeza/ Qëndronin përballë dushmanit/ Si Shotë Galica e Mine Peza.

---

[314] Po aty.
[315] Po aty.
[316] "Zemra speciale", (poezi), Liria, nr. 4-5, 1981.

4. 6. Vrasja e Viktor Emanuelit të III-të

Në shkrimin e Nasho Jorgaçit "Atentat kundër perandorit", autori shkruante për aksionin që e kishte marr rinia shqiptare për vrasjen e Emanuelit të III-të , perandor i Italisë. "Në prill të vitit 1939, Italia fashiste pushtoi Shqipërinë, duke kryer një agresion barbar kundër vendit. Me këtë akt ajo synonte të realizonte ambiciet e saj imperialiste për ta kthyer Shqipërinë në një koloni të saj të përhershme[317].

Në atë kohë rezistenca e popullit shqiptar kundër zaptuesve fashist ishte në rritje. Anëtarët e grupeve komuniste ishin hedhur në veprime konkrete, çetat e para kryengritëse ishin organizuar në krahina të ndryshme të vendit: kurse patriotët- punëtorë, fshatarë e intelektualë përparimtar zhvillonin një rezistencë gjithnjë në rritje kundër masave kolonizuese e shkombëtarizuese që kishin ndërmarrë fashistet në të gjitha fushat e jetës. Në këtë situatë shumë të rëndë, kishte dal nga radhët e tyre, si shprehës i aspiratave liridashëse të gjithë patriotëve e të masave të gjëra, i riu punëtor 21 vjeçar Vasil Laçi , i biri i një familjeje të varfër nga katundi Piqeras i bregdetit të Sarandës, i cili kishte shti me revole kundër perandorit fashist në Tiranë, ndërsa po largohej nga Shqipëria[318].

Jeta e vështirë, padrejtësitë e shumta, robëria dhe skamja e kishin detyruar të riun që të ngre revolen në kreun e okupuesit dhe ata që e njohën nga afër Vasilin, tregonin, thotë autori i këtij shkrimi se nën ndikimin e faktorëve, ndodhi tek ai një zgjim i shpejtë i ndërgjegjes politike, kishte nisur procesi i formimit të tij si luftëtar kundër pushtuesve fashistë[319].

Kjo e tëra shpjegon atë ndjenjë të fuqishme patriotike që u zgjua te Vasili e që u rrit e u shtua gjatë javës që mbreti udhëtonte nëpër Shqipëri. Ai i kishte ndjekur me kujdes lëvizjet e "korteut" mbretëror, duke mposhtur në heshtje zemërimin e përgatitjes shpirtërisht për aktin e tij heroik.

Atentatin që bëri Vasil Laçi (në kohën kur ndodhi), pati jehon të madh në Shqipëri e në arenën ndërkombëtare. Akti i tij ishte bërë shembull frymëzimi në luftën e madhe Antifashiste të popullit, e cila me themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare, në nëntor 1941, ishte shndërruar në luftë të organizuar revolucionare që shpuri në çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe e bëri popullin zot të fateve të tij, kështu thotë autori i shkrimit[320].

4. 7. Letrat e hapura të mërgimtarëve tanë

Nuk ishin të rralla letrat që iu dërgoheshin mërgimtarëve tanë në mërgim nëpër mes të shtypit ilegal. Në këtë frymë është e shkruar nga Kadri Zeka, edhe kjo letër që iu dedikohet punëtorëve tanë në mërgim."Të dashur vëllezër," fillonte letra, "Një mjet i rëndësishëm në duart e armiqve tanë shovinistë për sllavizmin e tokave shqiptare, ka qenë dhe mbetet shpërngulja e shqiptarëve nga trojet e veta shekullore. Titistët, këta armiq të

[317] Atentat kundër perandorit, "Liria" nr. 4-5, gusht 1981.
[318] Po aty.
[319] Po aty.
[320] Po aty.

përbetuar të popullit tonë, si erdhën në fuqi, kurdisën plane të reja për ta ngritur në sistem këtë politikë. Atyre nuk iu mjaftuan marrëveshjet e konstruktuara të Jugosllavisë Monarkiste me Turqinë[321] për dëbimin e shqiptarëve dhe vendosjen e tyre në shkretëtirat e Anadollit, por arritën marrëveshje të reja me reaksionin turk, për dërgimin në Turqi të kontingjenteve të reja të shqiptarëve.

Sipas statistikave që japin vetë administrata jugosllave, del se regjimi antipopullor i Titos i kishte dëbuar me dhunë e presione qindra mijëra shqiptarë në shkretëtirat e Anadollit e gjetkë. Më vonë, kur shovinistet serbomëdhenj iu bë e pamundur një formë e tillë, e vrazhdët, e shpërnguljes së shqiptarëve, ata shpikën një formë të re, më të rafinuar, atë të emigrimit ekonomik, që në fakt nuk ndryshon nga e para[322].

Skamja dhe mjerimi i madh thotë autori i letrës " papunësia e presionet që ushtroi pushteti, kushtëzuan që kurbeti për popullin tonë të bëhet një fenomen masiv. Sot janë të pakta ato familje që nuk kanë së paku një anëtar të mërguar. Kështu njerëzit tanë u detyruan të shiten tek kapitalistet e huaj, të shkojnë e të mëkëmbën ekonominë gjermane...[323]

Kurbeti është një plagë e vjetër e popullit tonë. Për të tregohen rrëfimet më rrëqethëse e këndohen këngët më të trishtuara. Ne, vëllezërit dhe motrat tuaja në Kosovë, jemi të vetëdijshëm për gjendjen tuaj të vështirë e jetën e rëndë që bëni…[324]

Për çdo ditë bijtë e Kosovës marrin valixhet në duar, përshëndetën me njerëzit e vet me lot në sy e me dhembje të thellë, përshëndetën me prindërit që, ndoshta, nuk do ti shohin kurrë më të gjallë, me gratë që pran burrave mbetën të veja, me fëmijët që mbetën jetim , ndonëse me babin gjallë. Përshëndetën me vatrën e tyre të dashur , me tokën e lumin, me malin e fushën , e cila nuk bleron për ta, me burimet pranë të cilëve kanë kaluar ditët e bardha të femërisë, përshëndetën me varret e të parëve, përshëndetën se është punë që nuk i dihet.

Gjakpirësit titist nuk harrojnë të organizojnë edhe "pritje" për punëtoret e mërguar kur këta vijnë për pushime. Në këto farë "pritjesh", udëbashët e shumtë i kërcënojnë punëtoret të mos shoqërohen me punëtoret e vendeve ku punojnë, të mos solidarizohen me ta e të mos organizohen në sindikata, të mos lexojnë ndonjë revistë shqiptare e të mos e dëgjojnë radion e Tiranës etj. Për të gjitha këto raste, kërcënoheshin udbashët, ne do ju burgosim e t'ju marrim pasaportat. Në vend, që, sipas "lirive" e "demokracisë" së madhe, të interesohen për kushtet e rënda të jetës e të punës së punëtorëve tanë të mërguar, titistet kujdesën që punëtoret tanë të prishen e të degjenerohen sa më shumë. Të humbin çdo ndjenjë kombëtare e progresive. Për këtë qëllim, titistet kanë ngritur si kërpurdhat pas shiut, klubet e ashtuquajtura të punëtorëve, ku shfaqin filma pornografikë, që sjellin nga Jugosllavia, organizojnë në këto klube koncerte me hipik nga Jugosllavia, shpërndajnë gazeta e revista të degjeneruara, që titizmi i ka me bollëk[325].

---

[321] Letra e një mërgimtari, revista "Liria", nr.4-5 gusht 1981; Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Eksodi masiv, pasojë e shtypjes dhe e terrorit serb, (Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës, 1877-1995), Prishtinë, 1997, f. 83-84.
[322] Po aty.
[323] Letra e një mërgimtari, "Liria", nr. 4-5, gusht 1981.
[324] Po aty.
[325] "Dënimet e rënda nuk mund ta frikësojnë popullin tonë", revista "Liria",nr. 6, 1981.

5. “LIRIA”, NR. 6. PËRMBYLL NJË VEPRIMTARI TË SUKSESSHME TË INFORMIMIT ILEGAL

5. 1. Dënime drakoniane për demonstruesit shqiptarë

Sikurse edhe numrat e tjerë të revistës ilegale “Liria” edhe ky numër trajtonte tema të nxehta aktuale politike të kohës të cilat pasuan pas ngjarjeve të vitit 1981. Revistës që në fillim i printe punimi i Nezir Myrtës, anëtar i Komitetit Drejtues të Organizatës, me titull “Dënimet e rënda nuk mund ta frikësojnë popullin tonë” që përcillej me një grafikë e Hydajet Hysenit, që paraqiste të rinjtë shqiptar në proceset e ndryshme gjyqësore. Autori i shkrimit, e që për lexuesit ngelte ende i panjohur, në mes tjerash shkruante “Një valë e egër dhune e terrori ka shpërthyer kudo në Kosovë, pas demonstratave dhe grevave të këtij viti. Çetniket e Beogradit e këlyshët e tyre tradhtarë, nuk u mjaftuan vetëm me vrasjen e dhjeta bijve e bijave te popullit, por vazhduan valën e masave të egra ndaj popullit e rinisë sonë me pushime nga puna, largime nga shkollat e fakultetet, burgosjet e dënime të rënda.

Proletarë të të gjitha vendeve dhe popuj të shtypur, bashkohuni!

LIRIA

Organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës

Dhjetor 1981 Nr. 46

DENIMET E RENDA NUK MUND TA FRIKSOJNE POPULLIN TONE

Një valë e egër dhune e terrori ka shpërthyer kudo në Kosovë, pas demonstratave dhe grevave të këtij viti. Cetnikët e Beogradit e këlyshët e tyre tradhtarë, nuk u mjafu an vetëm me vrasjen e dhjetra bijve e bijave te popullit, por vazhduan valën e masave të egra nd gj popullit e rinisë sonë të kuqe me pushime nga puna, la rgime nga shkollat e fakultetet, burgosje e dënime te rënda.

Me të drejtë opinioni botëror, po i vlerëson këto masa drakoniane si të pa para, pas Luftës së Dytë Botërore. Masa të tilla të egra populli ynë nuk mban mend as në kohën e krajlve të Jugosllavisë, as gjatë pushtimit nazifashist dhe as gjatë kohës se zezë të xhelatit Rankoviç. Për me shumë se një muaj mjetet jugosllave të informimit dhanë njohtime të përditshme për proceset e shumta gjyqësore që u zhvilluan.

Me të drejtë opinioni botëror, po i vlerësonte masat drakoniane si të papara, pas Luftës së Dytë Botërore. Masa të tilla të egra populli i ynë nuk mbante në mend as nga koha e kralëve të Jugosllavisë, as gjatë pushtimit nazifashist dhe as gjatë kohës së zezë të xhelatit Rankoviç. Për më shumë se një muaj mjetet jugosllave të informimit jepnin njoftime të përditshme për proceset e shumta gjyqësore që u zhvillonin në Kosovë.

Në ato procese të pambarimta u dënonin punëtorët, fshatarët, studentët, nxënësit, intelektualët, policët e ushtarët. Numri i të gjithë të dënuarve politik shqiptarë ishte vështirë të dihej, meqë shtypi jugosllav, nuk i publikonte dhe e zvogëlonte numrin e tyre. Sipas vetë shtypit jugosllav, gjatë më shumë se 30 proceseve gjyqësore që u zhvilluan, u dënuan me burgim të rëndë gjerë në 15 vjet jo më pak se 245 veta[326]. Mesatarja e dënimeve të shqiptuara arrinte në më shumë se 8 vjet, kurse po të llogaritën s,bashku, del se vetëm të dënuarve të cilëve emrat iu kishin publikuar iu shqiptuan më shumë se 2ooo

[326] Vazhdojnë dënime drakoniane kundër shqiptarëve në Kosovë, Zëri i popullit, Tiranë 25 gusht 1981.

mijë vjet burg të rëndë[327]. Kur këtij numri ti shtohej edhe numri (sigurisht i zvogëluar) prej 600 vetave të dënuar gjoja se për kundërvajtje dhe numri i madh i atyre që presin të dalin para gjykatave të okupatorit, atëherë mund të shihen përmasat e vërteta të kësaj fushate të egër e të paparë[328].

Edhe gjatë proceseve gjyqësore, në shënjestër të shovinistëve ishte vu në mënyrë të veçantë në shënjestër inteligjencia shqiptare dhe sidomos arsimtaret e gjuhës shqipe, historisë, marksizmit e lëndëve të tjera shoqërore. Ata u akuzuan dhe po akuzoheshin se gjoja paskan nxitur romantizmin nacional, se i paskan indoktrinuar nxënësit me nacionalizëm e dogmatizëm, se i paskan edukuar ata, me ideologji të huaj për "vetëqeverisjen" etj…etj Shovinistet serbomëdhenj nuk ishin ngopur me masat që kishin ndërmarrë kundër inteligjencies shqiptare[329]. Sipas tyre nuk mundet të qetësohej gjendja , deri sa nëpër shkolla e fakultete të jepnin mësim ata arsimtarë, nxënësit e të cilëve kishin marr pjesë në demonstrata, pra po kërkohej hapur që të largoheshin e dënoheshin të gjithë arsimtaret e ndershëm e patriotë.

Në shumë shkrime të shtypit jugosllav thuhej vazhdimisht se klasa punëtore dhe fshatarësia nuk kishte marr pjesë në demonstrata dhe i kishte dënuar ato. Mirëpo, fakti se në mesin e të dënuarve ,ishin jo pak por dhjeta punëtorë e fshatarë, tregonte se demonstratat e pranverës '81, nuk ishin demonstrata vetëm të nxënësve e studentëve por kjo dëshmonte për pjesëmarrjen e tyre masive, në lëvizjet e këtij viti dhe për rolin e rëndësishëm që patën ata në to[330].

Se sa e egër dhe e paskrupullt ishte kjo fushatë shoviniste, tregonte qartë edhe mbushja e burgjeve me vajza e djem të rinj, që ende nuk e kishin filluar mirë jetën dhe dënimet e rënda që po iu shqiptoheshin atyre iu ndërpritnin hovin rinor. Vetëm në vendet më fashiste, mundë të dënoheshin të miturit, me dhjetë e më shumë vjet burg, vetëm pse kishte shkruar një parullë apo një vjershë ose pse kishte kërkuar kushte më të mira jetese, liri e të drejta që garantoheshin edhe me kushtetutë. Për të fshehur fytyrën e tyre të vërtetë para opinionit jugosllav dhe atij botërorë, shovinistet jugosllav nuk e kishin publikuar fare dënimin e një numri të madh të të miturve. Vetëm në grupin që u dënua për çarmatosjen e njësisë speciale të policisë së Beogradit u dënuan dhe nuk u publikuan fare emrat e jo më pak se 16 nxënësve[331].

Të gjitha proceset gjyqësore të atij viti u mbajtën me dyer të mbyllura, pa praninë e as të familjarëve të të akuzuarve, kurse Tanjugu, që ishte i vetmi burim informatash, nga këto farsa nuk njoftonte fare opinionin me deklaratat e të dënuarve. Shumë nga gjykimet u bënin natën dhe të dielave, kurse trupat gjykues ishin krejtësisht anonime ose të sjellë nga Beogradi. Ndërtesat e gjykatave ishin të rrethuara nga një numër i madh policësh të armatosur gjerë në dhëmbë, të cilët kishin bllokuar edhe rrugët për rreth[332].

---

[327] Dënime të tjera kundër shqiptarëve në Kosovë, Zëri i popullit, Tiranë, 11 gusht 1981.
[328] Dënimet e rënda nuk mund ta frikësojnë popullin tonë, "Liria", nr. 6, f. 1.
[329] Mbi gjendjen në Kosovë, Zëri i popullit, Tiranë, 20 maj 1981.
[330] Si shënimi 478.
[331] Po aty.
[332] Po aty.

Shovinistet shpiknin e trillonin gjithçka të keqe kundër të rinjve tanë të dënuar. I quajtën "nacionalistë", "shovinistë", "reaksionar e kundërrevolucionar", njerëz që ia donin të keqen popullit shqiptar, dhe që dënoheshin nga ai vet etj…[333] Në këtë mënyrë, ata donin të mashtronin opinionin e painformuar në Jugosllavi e botë, por ata vetë e dinin se populli i ynë, jo vetëm që nuk i dënonte bijat dhe bijtë e vetë trima e besnik, por i përkrahte dhe i mbështeste ata me të gjitha forcat. Kjo edhe ishte arsyeja e vërtetë pse gjykimet u bënin me dyer të mbyllura dhe nuk ishte arsyeja se mungonin sallat e mëdha, mungesë e karriqave e "arsye" të tilla qesharake.

Edhe përkundër dënimeve të shumta që u bënë dhe masave të egra që u ndërmorën ndaj popullit, në qarqet e ndryshme shoviniste, çdo ditë po ngriheshin zërat të tërbuar të atyre që ishin ende të pangopur me atë që ishte bë. Me anë të të ashtuquajturit "diferencim", ata po orvateshin të ruanin vazhdimësinë e fushatës së dhunës dhe terrorit.

Për të justifikuar masat e tyre të egra shoviniste jugosllave, i kualifikonin demonstratat si armiqësore, madje edhe si përpjekje për kundërrevolucion dhe shpikëshin lloj- lloj parullash e kërkesash të cilat as që ishin përmendur në demonstratat. Sipas asaj që thoshin pushtetarët, delte se populli shqiptarë paska dashur të përmbysë pushtetin, duke u "armatosur" me gurë, shkopinj e çekanë. Me "fakte" të tilla, ata donin të akuzonin popullin për "kundërrevolucion", por akuzat e tyre ishin jo vetëm naive, por edhe qesharake. Çdo njeriut të logjikshëm do të dinte se me gurë e shkopinj, nuk do të përmbysej një pushtet që mbrohej, me ushtri e polici të armatosur gjerë në dhëmbë. Nga ana tjetër , me gjykimet që u zhvillonin, doli se në demonstratat që u bënë, pati parulla për kushte më të mira të jetesës, për lirimin e të burgosurve , për heqjen e policisë së huaj e për shndërrimin e Kosovës në Republikë, parulla kundër plaçkitjes së pa mëshirshme të pasurive, kundër diskriminimit të gjithanshëm, ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi[334] etj, por jo parulla e kërkesa për Kosovën e pastër etnike e Shqipërinë e Madhe, kundër popujve jugosllav e për dëbimin e tyre nga Kosova, e parulla tjera të trilluara nga vetë shovinistet, me qëllim që ti jepnin tjetër karakter demonstratave dhe luftës sonë. Mbi parulla të tilla të fabrikuara ishte mbështetur dhe kualifikimi që i kishin bërë demonstratave udhëheqja jugosllave, prandaj ai edhe ishte krejtësisht i pa bazë.

Me dënimet e shumta dhe me masat tjera represive shovinistet serbë dhe shërbëtoret e tyre shqiptar, mendonin se do ta frikësonin e do ta mposhtnin popullin heroik dhe bijat e bijtë e tij trima. Mirëpo, ata ishin bindur dhe për çdo ditë po bindeshin se në këtë mënyrë ata po i bënin vetes varrin. Me qëndresën e tyre burrërore, thoshte autori i shkrimit "shokët tanë të burgosur, u kallën tmerrin armiqve edhe duke qenë të lidhur me pranga e zinxhir, kurse populli po e vazhdonte luftën e filluar me vendosmëri më të madhe". Këtë të vërtet po detyroheshin ta pranonin edhe vetë autoritetet jugosllave[335]. Në një mbledhje të udhëheqjes kosovare, ishte theksuar se gjyqet që po organizoheshin po quheshin gjyqe tradhtarësh, kurse aktiviteti, me gjithë masat e marra që po vazhdonte me forcat edhe më të mëdha. Nga ana e tij njeri nga udhëheqësit

---

[333] Po aty.

[334] Në Kosovë intensifikohet fushata e represionit dhe e masave të egra policore, Zëri i popullit, Tiranë, 31 korrik 1981.

[335] Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Të burgosurit politik shqiptar (monografi në dorëshkrim), Prishtinë 2006.

jugosllav kishte theksuar se duke iu dhënë dënime të rënda të rinjve, ne po i bëjmë ata heronj para rinisë dhe popullit, kurse në Kuvendin e Kosovës ishin ngritur zëra dhe kishin kundërshtuar hapur dënimet e rënda që iu shqiptuan pjesëmarrësve të demonstratave[336].

Dënimet drakoniane që iu shqiptuan shqiptarëve, nuk tregonin forcën e madhe që i kishte kapluar ata, por tregonin dobësinë dhe kalbëzimin e regjimit gjakatarë. Ata nuk e kishin frikësuar dhe nuk do ta frikësonin kurrë popullin e pamposhtur. Ai do të luftonte me vendosmëri, për realizimin e kërkesave të të tija të drejta dhe krahas kësaj ai do të luftonte edhe për lirimin e bijve dhe bijave të dënuara padrejtësisht.

5. 2. Fisnikërimi i revistës

Po në faqen e tret të revistës "Liria", ilegalët botonin edhe poezi, që kishte frymën patriotike dhe që iu kushtohej shokëve në burgjet jugosllave. Autor i kësaj vjershe ishte Hydajet Hyseni. Në poezinë "Letra e të burgosurit", autori shkruante se edhe pse ishte në qelinë e errët e të vetmuar të burgut, i izoluar dhe i vetmuar, ai shprehte krenarin e vet dhe se asnjëherë nuk ndjente vetmin ngase edhe aty shoqërohej dhe i epnin shpresë këngët e lirisë. Autori rrëfente se aty ka tortura të papara, por ato nuk e mposhtin, nuk e përkulin ,nuk e thyenin dhe më parë pranonte që të vdiste se sa ti epte shokët dhe ta shesë atdheun. Po ashtu në strofën e katërt thoshte se "Një mijë herë po të bie / Do të ngritëm përsëri / Prapë do të hidhem / Në luftë për liri."[337] Me këtë poezi autori na dëshmon për sakrificën dhe vetëflijimin për lirin që do ta bënte deri në realizimin e dëshirave të tija dhe të popullit të vet.

5. 3. Flamuri simbolizon kombin

Në vazhdim botohet një artikull tjetër i Hydajet Hysenit "Jetën e japim - flamurin se japim". Pas demonstratave studentore që ndodhën në Kosovë në pranverën e vitit 1981, në Kosovë kishte filluar një fushatë e paparë kundër çdo gjëje që frymonte shqip. Andaj, armiqtë e përbetuar të popullit shqiptar, pa hezituar ia kishin mësyrë si shumë herë më parë gjatë historisë-në flamurin kombëtar. Ai flamur iu kishte penguar dhe po i pengonte, andaj mënyra më e mirë për ata ishte që ta ndryshonin, pasi se nuk kishin mundur ta zhduknin nga sipërfaqja e dheut. Në atë kohë ishin mbajtur shumë e shumë mbledhje e takime të autoriteteve udhëheqëse, ishin bërë shumë e shumë debate, ishin bërë shumë e shumë diferencime në emër të flamurit. Autori i shkrimit duke e parë këtë rrezik të heqjes së flamurit, kishte shkruar këtë artikull ku thoshte se:" Me revanin e tyre të çmendur antishqiptar , shovinistet jugosllav, kanë zgjatur kthetrat e tyre të përgjakura, edhe drejtë flamurit tonë të lavdishëm[338].

---

[336] Po aty.

[337] Letra e të burgosurit, "Liria" nr. 6, 1981, f. 2.

[338] Dr. Sabile Keçmezi-Basha,"Akademik Ali Hadri në mbrojtje të simboleve kombëtare", "Epoka e Re", 12 prill 2008; Akademik Ali Hadri në mbrojtje të simboleve kombëtare, Ali Hadri-Jeta dhe vepra, Prishtinë, 2008, f.183-189.

Kundër Flamurit tonë kombëtar u ngritën njëri pas tjetrit ngritën ujqërit shovinist dhe duke kërcëlluar dhëmbët ulërin kundër flamurit tonë kuq e zi. Herë nga Nishi, herë nga Cetina, herë nga Shkupi, herë nga Prishtina, dëgjohen britmat histerike "Flamuri shqiptar është shovinist e irredentist", "Ai është flamuri i Shqipërisë dhe i Enver Hoxhës", "ai po i indoktrinon shqiptaret me nacionalizëm e dogmatizëm", "T'iu ndryshojmë shqiptarëve flamurin kuq e zi", "T'ua ndalojmë fare atë flamur të mallkuar me shqiponjë", "flamuri i tyre duhet të jetë flamur trengjyrësh i Serbisë"[339] etj…shkruan autori. Autori në këtë shkrim e thoshte edhe një të vërtet të hidhur se ky rast nuk ishte i vetmi në historinë shqiptare, ngase ata gjithmonë ishin munduar ta asimilonin e zhduknin një popull të tërë, duke e mbajtur të robëruar në shtëpitë e tyre." Çetnikëve të rinj të Serbisë, Maqedonisë e Malit të Zi, edhe më parë ua kishte vrarë sytë flamuri i kuq e i zi, por tani thoshte autori "Ata po mendonin se u ka ardhur koha për tu vërsulur, përsëri kundër tij, ashtu siç bënë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore." Autori iu përkujton se po me këtë flamur kuq e zi, partizanët shqiptar të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi luftuan dhe u vranë gjatë epopesë së lavdishme të luftës antifashiste Nacionalçlirimtare, të bindur se pas përfundimit të saj, do të fitonin edhe ata lirinë e ëndërruar në shekuj. Por, shovinistet e rinj jugosllavë për ti "shpërblyer", për kontributin e madh që dhanë në luftë, e pushtuan përsëri popullin tonë martir, e ndanë dhe e copëtuan siç deshën ata, e vranë e rrahën dhe e masakruan përsëri, ia ndaluan edhe flamurin. U deshtë përsëri shumë luftë e gjak, shumë vjet burgje, vuajtje e tortura, që në tokën e Kosovës, të valonte përsëri flamuri i ynë kuq e zi[340]. Dhe ja tani, pas sa vitesh , lugetërit rankoviqist, po zgjasin përsëri duart e tyre, të përgjakura drejtë flamurit tonë.

Duke shpresuar se kështu do ta robërojnë më lehtë popullin shqiptarë, shovinistet po e quajnë flamurin tonë, flamur të Enver Hoxhës e të Partisë së Punës, por edhe ata e dinin mirë se nën këtë flamur kishin luftuar stërgjyshërit tanë jo më pak por 5-6 shekuj më parë…Me qëllim që ta justifikojnë disi këtë ndërmarrje të pashembullt shoviniste, shovinistet jugosllav po detyroheshin dhe po e përdornin edhe ndonjë shqipfolës që me gojën e vet të kërkojë ndalimin e flamurit tonë. Po këtë kërkesë absurde, flasin edhe letrat e shumta që boton shtypi jugosllav, te nënshkruara nga emra të trilluar shqiptar e që siç është vërtetuar më se një herë, janë të nënshkruara nga vet shovinistet serbomëdhenj. Ja deri ku mund të shkojë ligësia e logjikës shoviniste, duan ta bindin opinionin jugosllav dhe atë botëror se kërkesa për heqjen e flamurit shqiptar na qenka "kërkesë" dhe " dëshirë" e vetë shqiptarëve. Po kush është ai naiv që mund të besojë marifeteve të tilla.

Autori vetë shtron pyetje dhe vetë përgjigjet "Nuk ka popull në botë, që dot dëshironte e kërkonte ti hiqej e ndalohej flamuri i tij, simboli i qenies së tij. Jo, këtë nuk mund ta bëjë askush dhe sidomos nuk mund ta bëjë kurrë shqiptari që flamurin kuq e zi e

---

[339] Jetën japim- flamurin se japim, "Liria", nr. 6, 1981, f, 3.

[340] Reagimi i Akademik Ali Hadrit, "Për përdorim të lirë dhe të barabartë të flamurit autentik kombëtar e revolucionar të popullit shqiptar",(punim në dorëshkrim), 27 nëntor 1986.

ka gjënë më të shtrenjtë, shqiptari që nëpër shekuj, siç thotë kënga: "vritej e pritej për flamur, armiqtë hiq e ai vure…"[341]

Legjendat thonë se dikur flamuri i të parëve tanë dikur ishte i bardhë , siç ishin të bardha edhe veshjet, plisat dhe zemrat e tyre. Kishin ardhur bajlozët e zinj dhe deshën ta shkelin flamurin e Arbrit, që simbolizonte bardhësi, paqe e çiltërsi… dhe në vend të tij, të ngrinin në kështjellat tona flamuj të zinj, pushtues. Që flamuri arbëror të mos binte në kthetrat e zeza të armiqve zaptues, luftëtari arbëror, gjatë një beteje e kishte qarë gjoksin e tij dhe e kishte futur aty, flamurin arbëror. Pas betejës, dy shqiponja të maleve tona e kishin nxjerrë flamurin e arbrit prej gjoksit të luftëtarit trim dhe duke e mbajtur ne dy skaje fluturuan lartë në qiellin arbëror. Bijtë e shqipeve e panë flamurin e tyre që ishte skuqur nga gjaku i luftëtarit, i kishin parë shqiponjat që e kishin valëvitur krenare atë flamur të përgjakur dhe këtë pamje pastaj i kishin dhanë flamurit të tyre.

"Legjenda ishte legjendë" thoshte autori, mirëpo e vërteta ishte se flamuri ishte fituar dhe ishte mbrojtur me gjakun e atyre bijave dhe bijve të këtij trualli, të cilët në furtuna të stuhishme që kalonte atdheu, e mbanin atë në gjokset e tyre të zjarrtë, aty pranë zemrës. Sa gjak shqiptari ishte derdhur për këtë flamur, sa luftëra e beteja të përgjakshme ishin bërë nën këtë flamur, sa trima luftëtar ishin betuar para këtij flamuri , të skuqur me gjakun e të parëve të tyre,sa bijë të popullit ishin kalbur dhe po kalbeshin edhe sot për këtë flamur…! Flamuri i ynë i kuq me shqiponjën dy krenare, ishte përjetësuar edhe në këngët më të bukura të popullit, ishte kënduar në vargjet më të zjarrta të poetëve tanë, ishte qëndisur me qëndismat më të bukura të vajzave e nuseve shqiptare, ishte gdhendur në dru, ishte skalitur në hekur e gur… flamuri i ynë ishte gdhendur e skalitur thellë në zemrat tona, prandaj edhe nuk mundet të hiqet kurrë, por pa i skuqur zemrat tona" thoshte autori i shkrimit[342].

Ndërsa, për ndryshimin e flamurit që flitej në qarqet udhëheqëse të pushtetit autori po ashtu kishte të njëjtën përgjigje: "Po këtë përgjigje ka populli i ynë flamur-dashtë, për të ndryshuar flamurin tonë dhe për ti shtuar si shtesë atij ndonjë simbol jugosllav. Populli i ynë i kishte të qarta qëllimet e errëta dhe tepër të rrezikshme që fshiheshin pas kësaj kërkese shoviniste, sado që në pamje të parë ajo paraqite si çështje jo edhe aq të madhe. Në flamurin kombëtar autori thoshte se " është gjaku, që kanë derdhur brezat në altarin e lirisë, është amaneti i tyre i shenjët, është fati i brezave që do të vijnë, prandaj nuk lejojmë kurrfarë loje me të. Ashtu siç bëri copë-copë sëpatë e Liktorit që fashistet italianë u munduan t'ia ngjitnin flamurit tonë, populli i ynë nuk do të lejonte askënd t'ia prekë flamurin e tij të lavdishëm, nuk do të lejonte kurrfarë arnimi të flamurit të tij, kurrfarë shenje tjetër në fushën e flamurit përveç shqiponjës dykrenore dhe yllit të kuq vezullues. Flamuri i ynë nuk ishte dhe nuk do të jetë kurrë flamur i larmishëm. Flamuri shqiptar ishte dhe dot mbetet për jetë kuq e zi[343].

Flamurin tonë e kishim fituar me gjakun tonë, e kishim mbrojtur me gjakun tonë dhe po të jetë nevoja, jemi gati ta mbrojmë përsëri me gjakun tonë", përfundon shkrimin

---

[341] Si shënimi 489.
[342] Po aty.
[343] Po aty, Lexo më gjerësisht: Gazeta "Rilindja", 2.11.1986.

autori që i tërë shkrimi i ngjan një lloj betimi dhe kërcënimi që i përcillet armikut shekullor.

5. 4. Aktualiteti në faqet e revistës

Veç artikujve që kanë përmbajtje politike në revistë jepen edhe informata, që vijnë nga Podujeva dhe njoftohet opinioni i gjerë për përleshjet në mes policisë serbe dhe qytetarëve të Podujevës. Njoftimi mbante titullin "Përleshjet në mes policisë serbe dhe qytetarëve në Podujevë" shkruar nga Nezir Myrtaj. Policia serbe e cila po qëndronte në Kosovë, që prej fillimit të pranverës së këtij viti, njoftonte artikullshkruesi, përveç sjelljeve të saja banditeske ndaj popullit të pafajshëm po bënte në mënyrë të vazhdueshme provokime të shumta, bile duke e sulmuar atë edhe fizikisht. Përveç disa rasteve që njiheshin në të cilat kjo polici, kishte sulmuar familje dhe individ të ndershëm, siç ndodhi në Prekaz, në Prishtinë, Gjakovë etj… Para një kohe kishte shkaktuar edhe përleshje në mes pjesëtarëve të kësaj policie dhe një familjeje në Podujevë[344].

Shefki Hasani, punëtorë në Shtëpinë e Kulturës në Podujevë, duke pushuar në hotelin "Besiana", papritur iu ekspozua provokimeve të disa policëve, të cilët po ashtu ndodheshin aty. Policët serbë kishin tentuar ta rrahin dhe ta arrestonin Shefkiun, mirëpo ai me shkathtësi dhe forcë i kishte goditur ata dhe kishte arritur që për një kohë ti shpëtonte arrestimit[345].

Të alarmuar nga ky aksident, patrullat e policisë, të armatosur gjerë në dhëmbë kishin filluar rrugën për në shtëpinë e Shefkiut, në mënyrë që të marrin "hakun". Në këto njësi kishte shkuar edhe vetë komandanti dhe inspektori i policisë. Një lagje e tërë në Podujevë ishte rrethuar nga policia serbe, kurse disa prej tyre kishin hyrë në shtëpinë e Shefkiut. Ishte ngritur në këmbë e gjithë familja: dy vëllezërit, nëna, dhe motra e Shefkit. Në përleshje e sipër midis policisë së armatosur dhe familjes duarthatë ishin lënduar shumë policë e veçanërisht komandanti i tyre i cili ishte goditur për vdekje. Pas gjithë kësaj drame që kishin shkaktuar korbat serbe, familja Hasani ishte arrestuar e tëra. Ky akt i ulët i kishte revoltuar gjithë qytetaret e Podujevës e mbar Kosovës por njëherë ishte edhe një mësim i mirë, për të gjithë ata që mësynin ti poshtërojnë e robërojnë vatrat shqiptare.

Në këtë faqe bëhej edhe prezantimi i orarit të Radio-Tiranës, dhe në cilën ore mund të dëgjoheshin lajmet dhe programet kulturo-argëtuese.

5. 5. Lavdi dëshmorëve

Në shkrimin e Berat Luzhës "Lavdi o ju trima, që ratë për atdhe"[346], autor ishte një i burgosur politik- Berat Luzha i cili shkruante për ngjarjet e marsit të vitit 1981,dhe për dëshmorët që kishin rënë në ato ditë të rënda të Kosovës. Në mes tjerash ai thoshte "Rinia

[344] Përleshjet në mes policisë serbe dhe qytetarëve në Podujevë, "Liria" nr. 6, 1981, f. 4.
[345] Po aty.
[346] Lavdi o ju trima, qe ratë për atdhe, "Liria", nr. 6, 1981, f. 5.

e Kosovës edhe kësaj radhe nuk i duroi hordhitë shoviniste, të marrin nëpër këmbë nderin dhe dinjitetin kombëtar, të shkelin në vatrat tona dhe të ç'nderojnë motrat dhe nënat tona. Ajo u prek në sedër nga veprimi i poshtër dhe i pabesë i çetnikëve të Beogradit në konviktet e studentëve me 26 mars. Ajo u përlesh fytafyt me komandoset special të policisë së huaj, të ardhur këtu për të shfryrë dufin prej shovinistëve të pashiqëve, mihajlloviqëve, herleviqëve mbi popullin e pafajshëm. Nga kjo përleshje me hienat shoviniste, të cilët bënë terror të zi, masakrime e persekutime në masë, u plagosën, u vranë e u burgosën mijëra të rinj kosovar, lulja e rinisë sonë heroike[347].

Prishtinë, 1 Prill 1981: Hydajet Hyseni, duke folur para demonstruesve.

Nga terrori që u ushtrua mbi ata, shumë prej tyre edhe gjetën vdekjen, por një gjë është e ditur se ata dhanë jetën për të drejta e liri, por populli është mirënjohës për këtë, respekton dhe vlerëson punën e tyre, për këtë edhe nuk do t'iu harroj kurrë. "Ju nuk e gëzuat edhe këtë pranverë të mbushur me plotë ngjarje e me plotë vlime revolucionare", por janë populli që kujton heroizmin tuaj. Pas një shkrimi të gjatë autori përfundon duke thënë se "Pushoni o shok, pushoni të qetë, se ratë me nderë. Pushoni të qetë se hakun do tua marrë populli. Çështja për të cilën ratë, ju shokë të dashur është e drejtë dhe patjetër do të triumfojë. Rrugën që filluat ju. Ne do ta vazhdojmë, prandaj pushoni, se nuk keni vdekur, në zemrat tona do të jetoni gjithmonë. Pra lavdi o ju trima që ratë për atdhe"[348]

Në një faqe të veçantë të revistës bëhet prezantimi i një pjesë të fjalimit të Enver Hoxhës në Kongresin e Tetë të PPSH-së, e cila ka të bëjë për Kosovën dhe ngjarjet e marsit të vitit 1981. Shkrimi titullohej me titullin "Shoku Enver Hoxha për Kosovën"[349],

[347] Po aty, f. 6.
[348] "Lavdi o ju trima që rate për atdhe", Liria, nr. 6, 1981. f. 7.
[349] Shoku Enver Hoxha për Kosovën, "Liria" nr. 6, 1981.

në këtë shkrim në mes tjerash thuhej se " Problemi i shqiptarëve që jetojnë në tokat e tyre në Jugosllavi, nuk është problem i një "minoriteti", i ardhur apo i vendosur diku në një zonë " vakum" si emigracion ekonomik, as i shkaktuar nga dyndja e Perandorisë Osmane dhe as nga rritja e natyrshme demografike e shqiptarëve që i shqetëson Maltuset e rinj serbomëdhenj. Shqiptaret në Jugosllavi përbëjnë një etni, një popull të formuar në shekuj, që ka historinë, gjuhën, kulturën e vet, një popull autokton, të cilin, siç dihet, e copëtuan dhe e shkëputën nga mëmëdheu i vet fuqitë e mëdha imperialiste dhe ia aneksuan Jugosllavisë. Këtë askush nuk mund ta fsheh. Çdo interpretim tjetër është arbitrar, është një falsifikim i rëndë e i dëmshëm i historisë" përfundon citati. Për të vazhduar se "Mëmëdheun e etnisë shqiptare populli shqiptar nuk ia la as pushtuesve fashist, as askujt tjetër që ta përcaktonte. Shqiptaret kanë luftuar pa pushim e në shekuj kundër armiqve të egër e shumë më të mëdhenj në numër për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe vetë ekzistencën e tyre"[350].

Në të gjitha këto luftëra, si në humbje dhe në fitore , në vitet e gjata të robërisë, në tërë historinë e tij, populli shqiptar nuk e humbi asnjëherë vetëqenien dhe vetëdijen kombëtare, kompaktësinë dhe unitetin e tij. Në çdo rrethanë ai i ka manifestuar ato me një vitalitet të jashtëzakonshëm e shembullor. Pas një historiku të shkurtër që jepet për luftërat e popullit shqiptar, në referat vëmendje të posaçme i kushtohej situatës aktuale në Kosovë në mes tjerash thuhej se " Pas Luftës së Dytë Botërore populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë luftuan së toku e në aleancë të ngushtë kundër pushtuesve fashist italian e gjermanë. Edhe shqiptarët që jetonin në Jugosllavi, luftuan me heroizëm tok me ne dhe me të gjithë popujt e Jugosllavisë kundër të njëjtëve armiq. Jo vetëm luftuan së toku, por ushtria e jonë u shkoi në ndihmë partizanëve jugosllav e vëllezërve kosovar dhe në tokat e tyre derdhi gjakun e bijve e të bijave të popullit shqiptar[351].

Ne vepruam siç na mësonte Partia Komuniste e Shqipërisë, me ndërgjegje e me frymë të lartë internacionaliste. Ne mendonim se kështu do të fitohej liria nga popujt e të dy vendeve tona, do të zhdukej robëria dhe do të ndreqeshin gabimet tragjike të historisë së kaluar. Ne besonim se pas fitores çdo gjë do të zgjidhej në rrugën marksiste- leniniste. Garanci për këtë ishin partitë komuniste që udhëhiqeshin LNÇ-në e të dy vendeve. Por bindja e jonë te "komunizmi dhe internacionalizmi" i udhëheqësve jugosllav, besimi te fjalët e tyre nuk u vërtetua. Në fakt, udhëheqja e Partisë Komuniste të Jugosllavisë nuk e shikoi kurrë drejt e në rrugë marksiste- leniniste çështjen e së ardhmes së shqiptarëve në Jugosllavi, prandaj edhe do ta zgjidhte, siç e zgjidhi gabim e shtrembër, në rrugë nacionaliste e shoviniste, plotësisht antimarksiste[352].

Autori vazhdon më vonë se "Zgjidhja e gabuar e kësaj çështje të madhe e parimore filloi që në mbledhjen e dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, mbajtur në Jajce në nëntor të vitit 1943, ku viset shqiptare në Jugosllavi u përdorën si një mjet për të rregulluar përmasat tokësore e të popullsisë së republikave të Federatës, veçanërisht të Serbisë, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi. E ardhshmja e shqiptarëve të Jugosllavisë u vendos apriori nga lart, pa aprovimin dhe vetëvendosjen e popullit shqiptar

[350] Po aty.
[351] Po aty.
[352] Po aty.

të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe pa as më të voglin konsultim me aleaten e popujve të Jugosllavisë, e interesuar drejtpërdrejtë në këtë çështje. Shqipërinë Popullore udhëheqja e PKJ-së në kundërshtim me "politikën e barazisë nacionale" të shpallur në mbledhjen e dytë të AVNOJ-it, shkeli pa të drejt vullnetin e shqiptarëve në Jugosllavi, të shprehur në mbledhjen themeluese të Konferencës Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Metohinë, mbajtur në Bujan më 31 dhjetor 1943 deri më 2 janar 1944[353], që ishte në përputhje të plotë me të drejtën e "vetëvendosjes deri në shkëputje" të popujve që përbënin Jugosllavin dhe që ishte përcaktuar në dokumentet themelore të Partisë Komuniste e të Lëvizjes Nacionalçlirimtare Jugosllave[354].

Për sa i përkiste konsultimit me Shqipërinë Popullore për zgjidhjen e këtij problemi historik, udhëheqja jugosllave e quante apriori të panevojshme. Ajo ishte kundër një konsultimi të tillë, pse e dinte që një diskutim parimor marksist-leninist e miqësor ndërmjet udhëheqjeve të të dy vendeve tona, duke marrë parasysh edhe vullnetin e tyre në Jugosllavi, do të çonte në një zgjidhje të drejtë dhe jo shoviniste-arbitrare e nacionaliste, si ajo që ndërmori udhëheqja jugosllave. Pas luftës, në vitin 1946, një delegacion i vendit tonë, shkëput autori nga diskutimi i Enver Hoxhës që kishte kryesuar vetë ai, bëri vizitën e parë zyrtare në Jugosllavi. Në bisedimet që ishin zhvilluar me këtë rast me Titon, ky kishte kërkuar të dinte se ç'mendonte udhëheqësi shqiptarë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Me këtë rast ai kishte shprehur mendimin e palës shqiptare se Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptaret i përkasin Shqipërisë dhe duhet ti ktheheshin asaj[355]. Shqiptarët luftuan që të ketë një Shqipëri të lirë e sovrane, së cilës tani duhet ti bashkohen edhe viset shqiptare të Jugosllavisë. Presidenti Tito i ishte përgjigjur: "Jam dakord me pikëpamjen tuaj, por tash për tash nuk mund të bëjmë dot këtë gjë, sepse serbet nuk dot na kuptonin".Ky premtim zyrtar i Titosë për këtë problem të madh e parimor nuk u shoqërua me asnjë veprim të mëtejshëm nga ana e jugosllavëve. Çdo gjë kishte qenë mashtrim nga ana e tyre.

Në zgjidhjen e gabuar në Jajce, në copëtimin e tokave shqiptare dhe në mohimin e shprehjes së vullnetit të lirë të shqiptarëve dhe në mohimin e shprehjes së vullnetit të lirë të shqiptarëve qëndron gabimi themelor, me karakter nacionalist e shovinist, i udhëheqjes jugosllave që u pasua nga gabime të tjera po aq të rënda në lidhje me të drejtat e ligjshme e të natyrshme të shqiptarëve, të cilët akuzoheshin nga serbomëdhenjtë si "shovinistë", "nacionalistë", e "irredentistë". Në këtë zgjidhje shumë të gabuar të çështjes nacionale në Jugosllavi dhe sidomos të entitetit shqiptar prej afro 2 milion banorësh, gati sa gjithë popullsia e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, e kishin burimin ngjarjet e kohëve të fundit në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në Jugosllavi[356].

---

[353] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Përndjekjet e anëtarëve të lëvizjes atdhetare në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1952", Epoka e Re",8 nëntor 2008.
[354] Si shënimi 502.
[355] Më gjerësisht shiko, Dr. Hamit Kaba, Shqipëria në rrjedhën e Luftës së Ftohët (studime dhe dokumente), Tiranë 2007, f, 264-265.
[356] Si shënimi 502.

Edhe në periudhën kur ndërmjet vendit tonë e Jugosllavisë dhe të dy partive kishte marrëdhënie të mira, problemi i shqiptarëve në Jugosllavi ishte një "gjë hekuri" në këmbët e jugosllavëve. Kërkesat e pakënaqësitë e shqiptarëve as nuk shqyrtoheshin, as nuk zgjidheshin politikisht në rrugën e mirëkuptimit, por me dhunë, me masa të egra administrative[357]. Shqiptarët akuzoheshin për nacionalizëm dhe kjo bëhej për të fshehur shovinizmin dhe nacionalizmin serbë. Asgjë nuk mund ti mbuloj dhe ti justifikojë represaliet e përgjakshme kundër shqiptarëve më 1945, më 1968 e përsëri më 1981, diskriminimin e tyre, lënien në varfëri, shtypjen nacionale, mohimet e dallimet në fushën e arsimit dhe të kulturës. Rënia në fatkeqësi e grupit tjetër serbomadh të Rankoviqit, në vitin 1966, e më vonë e grupit tjetër serbomadh të Nikeziqit, shënojnë periudhën e demagogjisë politike të titistve ndaj Kosovës dhe kosovarëve. Nevoja për balancimin e forcave të ndryshme brenda federatës, çoi në njëfarë rishikimi formal të statusit ë Kosovës, e cila nga krahina e thjeshtë e Serbisë, u emërua krahinë "autonome " e saj.

Me dashje ose pa dashje të serbëve, kjo situatë e re u dha mundësi shqiptarëve në Jugosllavi dhe sidomos kosovarëve, të zgjeronin arsimin, të ngrinin Universitetin e Prishtinës, të zhvillonin kulturën, të mësonin historinë e popullit të tyre, të vendosnin kontakte dhe marrëdhënie arsimore- kulturore dhe ekonomike me Shqipërinë, në bazë të ligjeve të Federatës dhe të marrëveshjeve zyrtare midis RPSSH dhe RSFJ. Por baza ekonomike e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës mbeti përsëri shumë e dobët, u la pas dore[358] .

Ngjarjet që kanë ndodhur pas vdekjes së Titos, kanë treguar se sa gabim e në ç'rrugë "antimarksiste ishte zgjidhur çështja nacionale në Jugosllavi dhe veçanërisht çështja e shqiptarëve. Kërkesave të tyre të ligjshme brenda Kushtetutës iu kishte dhënë një grusht i rëndë dhe i përgjakshëm nga ana e udhëheqjes shoviniste serbe dhe e të gjithë udhëheqjes jugosllave pas demonstratave që u bënë në Kosovë., në mars e prill të këtij viti[359]. Ani , më shumë se kurdoherë tjetër, mbi kosovaret dhe mbi gjithë shqiptaret në Jugosllavi përveç gjendjes ekonomike të mjeruar , rëndon edhe shtypja e egër nacionale. Mbi të është vendosur ligji i terrorit, është derdhur policia dhe ushtria serbe, burgjet janë mbushur plot me të rinj e të reja. Masat që janë marrë dhe po merren, shkojnë jo vetëm drejtë zhdukjes së çdo të drejte të ligjshme e të atyre pak përfitimeve që u dukën në zhvillimin e arsimit e të kulturës, por edhe drejt shkombëtarizimit të shqiptarëve në Jugosllavi. Dhe kjo bëhet nga ata që pretendonin të respektonin dokumentet e Konferencës së Helsinkit mbi lirit e të drejtat e njeriut. Opinioni botëror duhej të mos qëndronte indiferent, por të alarmonte për këtë gjendje dramatike te popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Shtrohet pyetja ç'kërkuan në fund të fundit shqiptaret në demonstratat masive që u zhvilluan në qytetet e fshatra të ndryshme të Kosovës. Shqiptarët në Jugosllavi më se një herë me demonstrata paqësore dhe pa demonstrata, kanë kërkuar që gjendja e tyre kushtetuese, ekonomike dhe social- kulturore të ndreqej, të , të vihej në rrugë të drejtë brenda ligjeve të Federatës, ata kërkuan të kenë statusin e Republikës

[357] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, Rrugë e vështirë deri te "demonstratat e vitit 1968", "Lajm", (fejton, vazhdimi i dytë), 6 tetor 2008-3 nëntor 2008 (25 vazhdime).
[358] Si shënimi 502.
[359] Më gjerësisht, Enver Hoxha, Kosova është Shqipëri, Tiranë, 1999.

brenda RSFJ-së. Ata nuk kërkuan as shkëputje nga Federata, as bashkimin me Shqipërinë. Por, kërkesave të drejta e të ligjshme të studentëve, punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve kosovarë as ua vuri veshin kush. Jo vetëm kaq, por ata, si edhe të tjera herë kur kanë paraqitur kërkesa të tilla të ligjshme e të drejta, ishin cilësuar si nacionaliste, ishin persekutuar dhe ishin mbytur në gjak. Po të ecshin në rrugën që kishte zgjedhur dhe po ndiqte udhëheqja e sotme jugosllave, kundërshtimet e shqiptarëve do të vazhdonin, do të rriteshin dhe do të acaroheshin akoma më shumë. Vetëm një zgjidhje e menduar mirë e çështjes nacionale pa pasione nga të dy palët, një zgjidhje që do të pranohej e të aprovohej nga populli i Kosovës do të likuidonte këtë situatë shumë të ndërlikuar, të cilën e kishin krijuar jo kosovaret, por shovinizmi serbomadh. Kosovaret kishin dhënë zgjidhjen më të drejt e më të përshtatshme në këto situata të vështira për Jugosllavin dhe për veten e tyre. Kërkesa për ti njohur Kosovës statusin e Republikës brenda Federatës ishte një kërkesë e drejtë, ajo nuk e cenonte ekzistencën e Federatës[360]. Krerët serbe e jugosllave, në vend që të arsyetonin, dërgonin forca ushtarake të cilat e gjakosën popullin dhe zhvillonin fushatë të gjerë për të famshmin diferencim, duke bërë hetimin policor kush ishte pro e kush ishte kundër demonstratave. Kjo mënyrë veprimi solli terror, pastaj gjoja me "diferencim" do të përpiqeshin të frikësonin masat që nuk frikësohen, të zhdukësh patriotizmin që nuk zhduket, të kesh iluzionin se ke qetësuar gjendjen, por ke ngjallur mërin dhe zemërimin të mendosh se ke sjellë " njerëz të besuar" në pushtet, të cilin e ke spastruar nga "nacionalistët" etj. Por kur e ke e gjithë popullin në rezistencë të heshtur, atëherë më me forcë do e ngrejë zërin kundër padrejtësive që po bëheshin. Këtë situatë s'donin ta kuptonin udhëheqësit jugosllav.

Për të vazhduar më tej autori të citonte diskutimin se: "E ne iu themi hapur këto të vërteta dhe kërkojmë që problemi i Kosovës dhe i gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, i zgjidhur gabim, të ri-studiohet me gjakftohtësi dhe të mos shkohet me dhunë e terror, të lirohen nga burgjet djemtë e vashat kosovare. RPSSH e akuzojnë se ndërhynë në punët e brendëshme të Jugosllavisë, bile atë akuzojnë se nxit turbullira në Kosovë e gjetkë. Dhe si i nxit ajo këto turbullira ? Nëpërmjet marrëdhënieve arsimore e kulturore zyrtare. Shkohet deri atje sa të thuhet se RPSSH bënë kauzë të përbashkët me reaksionin politik shqiptar në mërgim, të cilën ne e kemi luftuar dhe e luftojmë me të gjitha forcat tona[361].

Shqipëria nuk ka bërë ndonjëherë rivendikime tokësore ndaj Jugosllavisë. Por, duke mbajtur këtë qëndrim ne s'kemi mohuar dhe s'do të mohojmë kurrë faktin se në Jugosllavi rron një pjesë e madhe e kombit dhe e popullit shqiptar. Ne kemi mbrojtur dhe do të mbrojmë edhe në të ardhmen, me të gjitha forcat e në rrugë marksiste-leniniste, të drejtat e ligjshme të vëllezërve tanë shqiptar matanë kufirit dhe kjo nuk është ndërhyrje ne punët e brendshme të Jugosllavisë. Kjo është e drejtë e jonë e pamohueshme.

Çështja e Kosovës është një tragjedi. Autoritetet jugosllave duhet të pushojnë terrorin dhe persekutimet ndaj shqiptarëve, të likuidojnë shtypjen nacionale dhe tu njohin atyre të gjitha të drejtat që u takojnë. Për zgjidhjen me drejtësi të problemeve ata duhet të

---

[360] Dr. Sabile Keçmezi-Basha,"Ndryshimet kushtetuese dhe Kushtetuta e vitit 1974", "Epoka e Re", 19 janar 2008.

[361] Enver Hoxha, Kosova është...vep. e cit.

bisedojnë qetësisht, me gjakftohtësi dhe në barazi me popullsinë shqiptare në Jugosllavi"[362], përfundon shkrimi për Kosovën dhe diskutimin e Enver Hoxhës në Kongresin e Tetë të PPSH.

5. 6. Dhuna – përditshmëri kosovare

Në shkrimin e Kadri Zekës "Edhe një akt i poshtër shovinist"[363], bënë fjalë për aktet e ndryshme të dhunës që aplikohen në Kosovë nga pushteti okupues serb. "Vargut të masave të egra që shovinistet serbomëdhenj po ushtronin ndaj popullit tonë, iu shtua edhe një akt i poshtër në shumë pjesë të Kosovës, u pengua përcjellja e emisioneve të Radios dhe të televizionit shqiptar. U vu kështu në jetë kërkesa që kishte bërë para sa muajsh shovinisti me damkë, Dushko Ristiqi dhe antishqiptaret e tjerë të tërbuar, si ai.

Krerë të ndryshëm shovinistë e tradhtar, dikur deklaronin plotë fodullëk se nuk kanë nevojë ti pengojnë emisionet e radiotelevizionit shqiptar dhe as që ti pengojnë njerëzit që të njohin realitetin shqiptar, të cilin e quanin të mjerueshëm, e aq më pak flisnin kundër këtij kualiteti, pasi siç thoshin ata, ai nuk mund të ndikonte fare në opinionin në Jugosllavi. Më vonë ata u detyruan të bënin fushat të paparë shpifjesh e trillimesh kundër Shqipërisë dhe kur e panë se as kjo nuk mjafton, se kështu i nxirrnin sytë e vetës, ata u detyruan që në këto momente të vështira krize që po kalonin, të harxhonin miliarda për të blerë instalime, me të cilat do të pengojnë emisionet e Radiotelevizionit shqiptar. Në kanalin e valëve të televizionit shqiptar[364], shovinistet kishin vendosur perden e zezë, në mënyrë që njerëzit tanë të mos mundtë shohin diellin e lirisë, kurse në vend të tingujve gazmor të çiftelisë e gërnetës që i penguan ata, lëshuan një zhurmë të bezdisshme, që të ngjan në kuisjen e një bishe që po jep shpirt.

Në këtë mënyrë, shovinistet donin ta ndanin e izolonin krejtësisht popullin tonë nga bota që e rrethonte dh sidomos nga Shqipëria Socialiste dhe kështu ta mbyllte brenda kafazit të tyre shovinist, ta përpunonte atë, ta zhvishte nga çdo frymë patriotike e kombëtare, ta ç'shurrte e degjeneronte plotësisht.

Por, shovinistet serbomëdhenj, edhe në këtë rast i kanë bërë gabim llogaritjet e tyre. Populli shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, nuk do të bëhej kurrë siç duan ata. Ai e kishte kuptuar të vërtetën, e kishte gjetur rrugën e tij dhe nuk kishte forcë në botë që mund ta ndalte në rrugën e lirisë dhe përparimit. Asnjë perde nuk mund ta pengonte rrezatimin e diellit të lirisë, asnjë zhurmë e kuisje prej bishe nuk mundte ta pengojë zërin e Atdheut. Populli ynë thotë: "Dielli me shoshë nuk mund të mbulohet". Shkrimi përcillej edhe me një karikaturë, ku shihet Dushko Ristiçi i hipur mbi një tank, ku e shoqërojnë fjalët "ne jemi vendi më human në botë…"

5. 7. Feja - alibi i dobët për pushtetarët

---

[362] Po aty.

[363] Edhe një akt i poshtër shovinist, "Liria", nr. 6, 1981.

[364] Po aty; Dr. Pajazit Nushi, Fenomenologjia e dhunës ushtarake-policore në Kosovë në vitet 1982-1992, (Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual), Tiranë, 1996, f, 286-287.

Në një skicë- shkrim të Hydajet Hysenit "I mbyturi kapet edhe për feje"[365] thuhej se "Për qëllimet e tyre të errëta antishqiptare, shovinistet jugosllavë dhe tradhtarët, po mundohen të shfrytëzojnë gjithnjë e më shumë edhe fenë. Për këtë qëllim , kohët e fundit, krerët më të lartë të Serbisë, Kosovës e Maqedonisë, organizuan takime me personalitete më të larta fetare dhe u munduan ti fusin edhe ata në fushatën antishqiptare. Në këtë mënyrë ata donin t'i mashtronin besimtaret e ndershëm dhe ta përçajnë popullin tonë që ishte i bashkuar sikur më parë, pa dallim feje e bindjeje politike, në luftë për të drejta e liri.

Veç shkrimeve me tematika politike, në revistën "Liria" kohë pas kohe botoheshin edhe shkrime të ndryshme për poetët tanë të mëdhenj kombëtar siç ishin Naimi, Çajupi, Noli etj. Në ketë numër autori Berat Luzha na prezanton jetën, veprimtarin dhe kontributin e madh kombëtar të poetit të mjerimit siç e quanin ndryshe - Migjenin, në shkrimin "Poeti i madh revolucionar" që botohej me rastin e 70 vjetorit të lindjes së poetit.

Revistën e bënë edhe më të pasur numrin i shtuar i poezive patriotike që botoheshin në ketë numër. Pastaj kemi disa vargje që pas leximit të vëmendshëm ke përshtypjen se janë të shkruara nga një poet i talentuar që e donte fortë Kosovën, Shqipërinë dhe çdo gjë që është shqiptare. Në poezinë "Shqipja e furtunës" kushtuar dëshmorit të demonstratave Naser Hajrizit, poeti militant, Ismail Syla paraqet ditët e marsit e të prillit, kur Naser Hajrizi ndodhej në ballë të demonstratave, deri sa ra dëshmor më 2 prill 1981. Ndërsa në poezinë tjetër të Ismail Sylës "Rinia ime", paraqitet rinia e viteve të 80-ta, ku poeti me një modesti pak si të tepruar paraqet se si rinia e atyre viteve kishte ngjyrën e bozhureve të Kosovës dhe ngjyrën e flamurit, kishte zemrat e zjarrta, dhe ishte e pamposhtur në barrikada dhe përfundon poezinë duke thënë se "Rinia ime heroikja / është e jotja Republika", kështu që me një optimizëm përfundon se pa marrë parasysh sakrificat që do i bëjë, megjithatë ajo do të kurorëzohet me shpalljen e Kosovës – Republikë, dhe mu për këtë arsye ia vlen edhe të vdisje edhe të jetohet për këtë.

Autorja Teuta Hadri shkroi poezinë: "Dy yjeve të pashuar"[366] që iu kushtohet dy luftëtareve të shquara Bule Naipit dhe Persefoni Kokëdhimes, kurse poezia tjetër që i kushtohet "Kosovës", autori me një dashuri të madhe shkruan për Kosovën si një vend e fole e shqiponjave, por mjerisht okupatorët e shumtë atë e kanë lidhur në pranga , dhe mu ky vend i cili me shekuj e gjakoi lirin, u rriten trimat me nam e me fletë që tani duan t'ia kthenin nderin e nëpërkëmbur. Autori me një dashuri e mall shkruan për kohërat kur luftuan trimat me radhë, gjeneratë pas gjenerate, siç ishin: Azem e Shotë Galica, Bajram Curri e Isa Boletini, si dhe rinia e madhe e trime e Kosovës , andaj edhe këto vargje që të prekin në shpirt siç ishin: "Eja moj pranverë e kuqe / Qe të lulëzojë Kosova ime / Eja ditë e ëndërruar me shekuj / Falë të qoftë rinia ime", sa është e kuptimplote, aq edhe është e dhembshme. Rinia e Kosovës gjatë tërë historisë ishte e gatshme që më parë të japin jetën se sa të jetonin të robëruar e të shtypur. Andaj edhe lindi parulla "Jetën e japim, Kosovën se Japim".

---

[365] I mbyturi kapet edhe për feje, "Liria", nr. 6, 1981.
[366] Dy yjeve të pashuar, Liria, nr. 6, 1981.

Në faqet e revistës, veç poezive , ilegalistët u kujdesën që të botonin edhe tekste për këngë, që më vonë këto u shpërndanin u mësonin përmendësh, dhe të rejat e të rinjtë tan, gjatë demonstratave dhe në qelit e burgut i këndonin me një zë të lartë. I tillë ishte edhe teksti i këngës "Kosovarë dhe kosovare" i autorit Hydajet Hyseni, që ishte shumë e lehtë për tu mbajtur në mend dhe kishte plotë ritëm dhe një sens të veçantë për turmat, autori bënë apel te masat e gjëra që të ngritën në këmbë për lirin e atdheut, dhe njëherë e për gjithmonë ta shporin armikun nga trojet tona , citojmë : "Kosovarë dhe kosovare / të ngrihemi ne për liri / të lidhemi me besë shqiptare / pranë flamurit kuq e zi / Ti ngremë grushtet përsëri / më mirë vdekje se robëri"[367], Robëria shekullore ishte ajo që tërë popullin e Kosovës si një trup i tërë u ngrit në demonstrata, për të manifestuar edhe një herë jetën e padurueshme nën thundrën e okupatorit.

5. 8. Dezinformimi- armë e dobët në duart e okupuesit

Artikulli "Demagogjia nuk mund ta mbulojë dhunën dhe terrorin"[368] nga autori Nezir Myrta një vëmendje të posaçme i kushtonte dezinformatave që dalin nga shtabet e posaçme të sistemit, të cilat në opinionin e gjerë fusin dezinformata, me një qëllim të caktuar që te njerëzit e ndershëm të krijonin dyshime dhe dilema që po ato dezinformata shkaktonin dame të mëdha tek lëvizja ilegale shqiptare, dhe shtonte autori "Këto kohët e fundit në shtyp, radio televizion u shkrua, dhe u fol me të madhe për "aksionet e shumta punuese" që u organizonin me pjesëmarrjen e njësive të armatës dhe policisë së ardhur në Kosovë, nga viset e ndryshme të Jugosllavisë. Artikuj, shënime e reportazhe të shumta ngrinin në qiell rëndësinë e madhe të këtyre "aksioneve" për forcimin e dashurisë dhe unitetit në mes rinisë sonë dhe njësive të ushtrisë e policisë, për farkëtimin e harmonisë dhe bashkëjetesës në mes tyre, për forcimin e vëllazërimit e bashkimit në mes tyre etj… Gati sa nuk thuhej se këto njësi nuk kanë ardhur këtu për tjetër, por për të ndërtuar rrugë dhe ura, për të hapur kanale e për të ndërtuar ujësjellës, për të rregulluar oborret e shkollave e fabrikave tona, për të pyllëzuar malet tona[369].

Me anën e këtyre rasteve qesharake, shovinistet serbomëdhenj po mundoheshin ta gënjenin e mashtrojnë opinionin në Kosovë edhe jashtë saj. Edhe me këtë rast shovinistet po mashtronin veten , kur po mendonin se njerëzit janë aq naiv sa të gënjehen aq kollaj dhe të hanin gjellën bajate që e servirëte kuzhina propagandistike e serbomëdhenjve. Se cili ishte misioni dhe qëllimi i vërtet i njësive të huaja policore e ushtarake , tani e dinë mirë sidomos ne, kosovaret, që për muaj të tërë po i ekspozoheshin dhunës dhe terrorit të tyre fashist.

Populli i ka parë me sytë e tij hienat e Beogradit si i masakronin , rrihnin, poshtëronin dhe plaçkitnin studentët tanë të pambrojtur, si qëlluan me bomba, snajperë, e automatikë mbi trupat e njom të motrave e vëllezërve tanë, si i ngritën kapakët e tankerëve dhe qëlluan mbi fëmijët tanë, si i qëlluan dhe i torturuan edhe të plagosurit, si i

---

[367] Të gjitha poezitë ndodhen në faqen e 11 e 12, të gazetës "Liria",nr. 6, 1981.
[368] Demagogjia nuk mund ta mbulojë dhunën dhe terrorin, "Liria", nr. 6, 1981, f. 12.
[369] Po aty.

rrihnin dhe i poshtëruan njerëzit e pafajshëm , vetëm e vetëm se ishin shqiptar…[370] Ai i ka parë këta kriminel, si lavëronin varrezat me tanke , si i sulmonin njerëzit në shtëpitë e tyre me tanke e helikopterë, si qëllonin popullin me automatikë në mes të qytetit të tyre, i kishte parë ata të shkelnin edhe atje ku nuk mund të durohej,në nderin dhe dinjitetin tonë.

Gjatë këtyre muajve të rëndë dhe gjatë gjithë historisë së tij, populli i ynë kishte parë shumë, prandaj ai nuk mashtrohet më .Ai nuk gënjehet nga demagogjia dhe hipokrizia e atyre që natën lyejnë duart me gjakun më të mirë të bijve të popullit, kurse ditën , organizojnë "aksione të përbashkëta vullnetare" me të rinj tanë, atyre që hapën gjithë ato varre të reja dhe tani dashkan ta nderojnë dhe zbukurojnë vendin tonë, të vëllazërohen dhe të bashkohen me ne… Jo , vëllazërim me vrasësit e tij gjakatarë, populli i ynë nuk ka pasur e nuk do të ketë kurrë. Për ta populli i ynë ka vetëm urrejtje. Se cili është qëllimi i vërtet i tij për njësit e saja pushtuese, tregon ajo që ndodhi në Prekaz, e tregon përleshja në Gjakovë dhe varrimi madhështor i të riut Nesimi që u vra mizorisht nga këto njësi, tregon përleshja në Podujevë, protesta në Qendrën e Studentëve e tregon urrejtja që ruhet në sytë e çdo kosovari, tregojnë parullat që po shkruhen anë e kënde Kosovës me kërkesën e njëzëshme :Policë të huaj shkoni në shtëpinë tuaj! ". Artikullin e shoqërojnë edhe tri fotografi , që paraqesin ngjarjet e mars-prillit në Kosovë.

5. 9. Vet sakrifica si dëshmi e atdhedashurisë

Në shkrimin e Kadri Zekës "Asnjë pëllëmbë të tokës shqiptare, nuk e lëshojmë për pa dalë fare"[371], nga vet titulli mund të supozojmë se i ngjan më tepër një kushtrimi apo apeli që iu drejtohet popullatës së robëruar. Shkrimi është i shkruar rrjedhshëm, qartë dhe qëndrimet që dalin nga ky shkrim janë shumë të kapshme. Viti që shkoi u karakterizua nga vlimet revolucionare që përfshin mbar Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi. I gjithë populli i ynë dhe rinia e tij e kuqe u ngritën në këmbë për të kërkuar të drejtat dhe liritë e mohuara, për të kërkuar Republikën e Kosovës. Kërkesat e drejta të popullit tonë, u përkrahen dhe u mbështetën fuqimisht edhe nga punëtorët kosovarë në mërgim, të cilët gjatë gjithë vitit zhvilluan një aktivitet të dendur patriotikë e luftarak. Ata qëndruan të patundur në përkrahje të studentëve, punëtorëve e fshatarëve, në mbështetje të mbarë popullit të Kosovës. Kjo e tërboi si UDB-ën ashtu edhe përfaqësuesit diplomatike në perëndim, të cilat nuk lanë mjet pa përdorur e gurë pa lëvizur për ti shmangur punëtoret nga rruga e tyre e drejtë. Por përpjekjet e tyre shkuan huq. Punëtoret as nuk u përçan as nuk u tremben, nga presionet. Tani, kur punëtoret kanë filluar të vijnë për pushime në vendlindje, pranë familjeve të tyre, udëbashët e herleviqit nuk po organizojnë "takime" me punëtoret (pasi e dinë se nuk shkon kush në to, edhe po të shkojnë, punëtorët kërkojnë llogari, si viteve tjera), por kanë ndërmarr një fushat të paparë burgosjesh e arrestimesh. Shumë punëtor janë arrestuar ende pa arritur në shtëpi

[370] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Propaganda dhe dezinformimi, metoda të organizuara shtetërore jugosllave ndaj shqiptarëve", "Epoka e Re", 20.12.2008.

[371] Asnjë pëllëmbë të tokës shqiptare, nuk e lëshojmë për pa dal fare, "Liria", nr. 6, 1981, f. 13.

kurse qindra të tjerëve u është rrethuar shtëpia, pa u çmallur mirë me njerëzit e familjes dhe janë flakur qelive. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i punëtorëve, çdo ditë po merret në pyetje me kërcënime e presione të shumta. Aq larg kanë shkuar shovinistet serb dhe veglat e tyre në Kosovë sa ti akuzojnë punëtoret për vepër penale, pse janë anëtarësuar në klubet e punëtorëve shqiptar në mërgim[372].

Masa të jashtëzakonshme po ndërmerren edhe në vendkalimet kufitare, ku punëtoret shqiptar malltretohen, kontrollohen imtësisht dhe mbahen në burgim kufitar, pa asnjë faj me ditë e javë të tëra.

Gjatë këtyre ditëve që punëtoret ndodhen në Kosovë, po shohin për së afërmi, dhunën dhe terrorin e pashoq, që po ushtron regjimi mbi rinin e popullit tonë, po shohin edhe masat e shumta antishqiptare, që po ndërmerren me qëllim që t'ia zënë frymën popullit tonë, ta nënshtrojnë e shkombëtarizojnë atë.

Të gjitha këto bashkë me brutalitetin policor si dhe situatat e vështira e të ndërlikuara që po kalon Kosova. Çdo ditë e më tepër po i kalitin punëtorët tanë mërgimtar, që ti kalojnë vështirësitë e sulmet e gjithë anshme të armiqve. Kjo po shprehet çart në qëndresën e vendosur, të shumicës dërmuese të punëtorëve, që u dënuan dhe të atyre që janë në hetime e në presione.

Një nga synimet kryesore të serbomëdhenjve (të cilën mërgimtarët dhe populli i ynë i kanë kuptuar me kohë), është që përmes masave represive e presioneve të detyrojnë njerëzit tanë (sidomos rinin) të marrin rrugën e botës, për të mos u kthyer kurrë më në Kosovë. Situata kritike që po kalon tani Kosova, nuk është e para në historinë e popullit tonë. Gjyshërit dhe baballarët tanë, u lidhën fortë me njëri tjetrin dhe të bashkuar qëndruan të papërkulur, në tokat shqiptare, të trashëguara dhe të lara me gjak nga të parët tanë[373]. Ata me trimëri të rrallë i bënë ballë masakrave e brutalitetit të kralëve serbë dhe terrorit të fashistëve italian e gjermanë. Më vonë po me të njëjtën qëndresë përballuan gjenocidin titist dhe krimet e UDB-ës e Rankoviqit. Shembulli i tyre , duhet të jetë një frymëzim i madh për çdo shqiptar. Prandaj, sot për çdo shqiptar të ndershëm e patriot, vihet si detyrë e dorës së parë, që të ngulitet fortë në vendlindjen e vet dhe pa marrë parasysh vuajtjet e sakrificat të mos largohet e t'ia kthej shpinën Kosovës. Në këtë mënyrë, ne dot shkatërrojmë një planë të rrezikshëm e djallëzor të armiqve. Sot më shumë se kurrë, Kosova jonë e dashur, ka nevojë për bijtë e vet. Në këto situata, të braktisësh atdheun (qoftë edhe me pretekstin se do të ndihmojë luftën edhe nga jashtë) është barazi, me atë që quhet sabotim i luftës. Të ikësh sot nga Kosova është njësoj sikur ti çosh duart nga istikami, kur armiku kërkon dorëzimin tënd. Në përgjithësi këtë të vërtetë e kanë kuptuar punëtorët tanë në mërgim, prandaj janë aq shumë të lidhur me vendlindjen dhe fatet e atdheut[374].

Më siguri në të ardhmen edhe qëndresa e përpjekjet e tyre, do të forcohen e konsolidohen edhe më tepër. Revista "Liria", me këto shkrime domethënëse më së shumti u shpërndante në mërgim dhe të mërgimtarët tanë, kështu rolin që e kishte te ata ishte i

[372] Po aty.
[373] Po aty.
[374] Po aty.

pazëvendësueshëm për qëndresën e tyre dhe për gjeturin e tyre para organeve hetuese që i pritnin në Kosovë.

5. 10. Letrat e mërgimtarëve

Në mesin e shumë shkrimeve që gjenin vend në faqet e revistës, ishin edhe diskutimet e shumta që bënin punëtorët tanë në takime të shumta anë e kënd shteteve perëndimore, që ata punonin për kafshatën e gojës. Shkrimi i Ismet Rashitit "Letër Kosovës"[375], është pjesë nga fjala e një punëtori kosovar mbajtur në mbrëmjen festive të 28 nëntorit, organizuar nga punëtorët shqiptar në R.F. Gjermane.

Mërgimtari ynë i vuajtur dhe trim fjalën e vet e fillon me fjalinë domethënëse "Mirëmbrëma Kosova jonë heroike!,

Ne bijtë e tu mërgimtar, bijtë e tu të ndershëm, jemi tubuar në këtë natë, të festojmë 28 Nëntorin, ditën e flamurit tonë të lavdishëm dhe ditën e çlirimit të nënës sonë Shqipëri.

Nëna jonë e dashur Kosovë, gjendemi larg gjirit tënd dhe të njerëzve tanë, por gjithmonë marrim frymë së bashku me ty. Të kujtojmë nëna e jonë e dashur në ëndërr e në zhgjëndërr dhe sa herë të mendojmë për ty na rrjedhin lotët rrëke faqeve tona të zbehura.. Ne vërtet jemi larg atdheut , por nuk harrojmë amanetin e vëllezërve dhe motrave tona , djemve dhe vajzave , nënave dhe baballarëve tanë, që na porositën të qëndrojmë besnik ty nënë Kosovë. Kjo porosi sidomos tani është bërë kushtrim për ne, kur shovinistët serbomëdhenj kanë vu një peshë të rëndë mbi trupin tonë plotë plagë. Për të vazhduar më tutje se " Jemi tubuar sonte bijtë e tu besnik dhe çdonjërit i shihen rrudhat e ballit për ty Kosova jonë hallemadhe. Në këtë natë, na kujtohet çdo gjë që po ndodhë mbi trupin tënd të bukur, na kujtohen torturat e shumta që bënë policia speciale e Beogradit dhe kriminelët e UDB-ës mbi vëllezërit tanë, mbi motrat tona të ndershme, mbi bijtë tu revolucionar dhe me lot në faqe nderojmë heroizmin e tyre dhe qëndresën tënde[376].

Ne mërgimtarët tu me kohë të jemi betuar se kurdoherë na ke me vete. Për ty nuk do të kursejmë as pikën e fundit të gjakut. Luftën tonë të drejtë do ta çojmë deri në fund, peshën e rëndë që ke ti o nënë Kosovë, motoja e përgjithshme në marrshin tonë ngadhënjimtar është: Ja vdekje, Ja liri! Mërgimtari ynë i devotshëm përfundon diskutimin e tij me fjalët më të zgjedhura dhe më të fuqishmet: Rroftë populli i ynë heroik! Rroftë Kosova jonë kreshnike! Rroftë 28 Nëntori-Dita e flamurit![377]

5. 11. Mesazhi i një të arrestuari

Në faqen e 14 të revistës "Liria", hasim në një shkrim të Kadri Zekës, që ishte i titulluar "Lamtumirë vendlindja e dashur Kosovë !"[378], shkrimi fillonte me "Të dashur lexues, Demonstratat paqësore që i zhvilloi në mars e në prill të këtij viti populli i ynë,

[375] Letër Kosovës, "Liria",nr. 6, 1981,f. 13.
[376] Po aty.
[377] Po aty.
[378] Lamtumirë vendlindja e dashur Kosovë!, "Liria", nr. 6. 1981, f . 14.

shovinistet serbomëdhenj i shtypen me zjarr e hekur. Njësit e policisë speciale shtinë pa pushim mbi demonstruesit e pa armatosur dhe vranë qindra vëllezër e motra tona. Vala e dhunës dhe terrorit policor nuk u ndal as pas demonstratave masive dhe po vazhdon me tërbim të papërmbajtur. Qeveritarët e Beogradit dhe tellallët e tyre në Kosovë, ngulën këmbë se në të gjitha demonstratat që u zhvilluan në krahinë, nga dora e policisë u vranë vetëm nëntë veta. Por e vërteta e hidhur nuk mund të mbulohet me asnjë gënjeshtër… Populli që ishte autor dhe dëshmitar i këtyre ngjarjeve tragjike dhe të lavdishme, tërhoqi nga thinjët e çetnikëve me dhjeta kufoma gjatë demonstratave.[379] Shumë shqiptar tjerë të pafajshëm, u rrëmbyen dhe u zhdukën nga patrullat policore që kishin zënë çdo rrugë e skutë, që edhe sot e kësaj dite nuk dinë kush për fatin e tyre.

Populli thotë: dardha e ka bishtin prapa",kriminelët titistë, tani pas sa muajsh, kanë filluar ti kthejnë ë kufomat e shumë viktimave që deri më tani i "ruajtën" nëpër frigoriferë, duke trilluar rreth vdekjes së tyre. Kështu ndodhi edhe me një të ri patriot, nga një fshat i komunës së Vuçitërnës. Ishin ato ditë heroike kur i gjithë populli ynë ishte ngritur në këmbë dhe kishte dalë në demonstrata, për të kërkuar të drejtat e veta. I ndjeri drejtohet për në spital, që të dërgonte një të afërt të plagosur në demonstrata. Posa hynë në oborrin e spitalit, njësit e policisë serbe, që pritnin "gjahun" u turrën me rrëmbim drejtë tyre, ndërsa shoqëruesi kapet nga duart e milicëve gjakatarë. Që nga ajo ditë kaluan muaj të tërë, familja Ademi nuk diti gjë për birin e vet që e rriti dhe e shkolloi me njëqind mundime[380]. Para pas pak ditësh Aliu, vëllai i tij, merr telegramin e kobshëm nga Zagrebi, ku thuhej; "Të vini të merrni kufomën, që ka vdekur në fatkeqësi komunikacion…" dhe asnjë shpjegim tjetër nuk epej rreth tij. Në të vërtetë i ndjeri u rrëmbye dhe u torturua për vdekje nga udbashët kriminelë. Këtë e vërteton letra e shkruar nga vetë dora e tij, para se ta linin forcat e fundit. Letra që po botonin në origjinal i drejtohet nënës së tij, ajo tregon çartë për moralin e lartë të tij edhe në ato qaste kritike, për dashurinë e pakufishme ndaj Kosovës së dashur, fletë për qëndresën heroike dhe idealet e larta, të njërit nga shumë yjet e pashuar, që anë kësaj pranvere për lirin e popullit dhe atdheut. Në vazhdim po e japim ashtu siç edhe është e shkruar në gazetë letrën e atij djaloshi në formë poezie: "Në vend të panjohur jam qëlluar / plagë të rënda më kanë rrokë mua / dora më punon një letër me shkruar / n'paqin mundësi, vëllezërit kufomën në shtëpi me ma pru / Dil përpara dhe pritëm mua / hiq pa lot fytyrës t'u lotuar / se për vëllezërit shqiptar jetën e kam ndërrua / për vëllezërit shqiptar, Kosovë Republikë / për të drejtat e popullit, që barbarët i kanë grabitë / Qoftë dhe rroftë populli shqiptar martir / Trashëgues i aspiratave gjerë në fitoren përfundim / janë përshëndetjet e mija të fundit / që mbetën përgjithmonë / Lamtumirë nëna ime krenare / Lamtumir vendlindja e dashur Kosovë[381].

---

[379] Po aty.

[380] Më gjerësisht :Bajram Kelmendi-Adem Bajri, Aktet gjenocidale të pushtetit serb nga viti 1981 e këndej (vrasjet, plagosjet dhe dëmtimet trupore e psikike, si akte gjenocidale kundër shqiptarëve në Kosovë në periudhën 1981-1993 (Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndej) , Prishtinë, 1995, f. 264-265.

[381] Si shënimi 529.

Pas këtyre vargjeve- letër që të copëtonin zemrën ky fat i mallkuar i të riut nga Vushtrria, pasojnë edhe disa poezi. Poezia e Teuta Hadrit "Amanet moj nënë"[382], është një vjershë që i kushtohet një të riu i cili vdes në fushën e betejës, por para se të vdiste i lë nënës një amanet, dhe me ngulm kërkon që ajo ti përmbahet. Citojmë :" Kudo që të vdes moj nënë / dua trupin të ma kërkosh / dua lot të mos derdhësh / me flamur kur të më mbulosh, për të vazhduar pastaj : "kur flamuri të më mbulojë / ti mos qaj, moj nëna ime / I qetë në varrë do të pushoj/ Paskam rënë për tokën time. Po në këtë frymë patriotike ishin edhe poezitë: "Rroftë Kosova, Republikë", e Hydajet Hysenit "Kosovë e kuqe" dhe "Kjo tokë të rriti" e Teuta Hadrit.

Në faqen e parafundit të revistës është një tufë e madhe me poezi që janë të shkruara enkas për këngë revolucionare e patriotike., këto janë edhe disa këngë që janë kënduar edhe më herët në popull, por këtu i hasim më të përpunuara dhe të përshtatura rrethanave dhe kohës. Ta zëmë teksti e këngës "Besa Besë", ku autori Nezir Myrta shkruan: "Besa besë një besë kemi dhënë / Ty Kosovë ne të kemi nënë / Të kemi dhënë besë, e të kemi dhënë fjalë / Shpirt e zemër të kemi falë/ etj…etj…Ose kënga "Ushton toka e Kosovës", ku autori Hydajet Hyseni adapton këngën e Grykës së Kaçanikut, me atë të Kosovës, dhe kështu lind refreni "Hej moj Kosovë o shkëmb e gurë / Vritesh e pritesh- o për flamur / Me armikun o grykë për grykë / Për liri o për Republikë/, ose kënga "Moj Kosovë o moj malësore" (Hydajet Hyseni), që është e përshtatur nga kënga "Mori Shkodër". Është për tu habitur se si poeti në një mënyrë të mrekullueshme bënë përshtatjen e këngës me atë të aktualitetit, citojmë : "Moj Kosovë, moj malësore / Pak na duke e shumë na dole/… "Herleviq o krye lopa / S'na frikëson me tanke , me topa/ As me topa, as me aviona / jem shqiptar o e jem shqiponja/. Ose kënga "O trima luftëtarë" - Hydajet Hyseni, me vargjet "Se mjaft më moj Kosovë / Ne vuajtje, robëri / O djem shtrëngoni grushtet / Ja vdekje, ja liri/. Kënga "Kam qëndisur një shami" e Saime Isufit, është këngë e përshtatur dhe thuhej "Kam qëndisur një shami / Me shqiponjë kuq e zi / Mbi shqiponjë kam shkruar pa frikë / Rroftë Kosova, Republikë/. Në të njëjtin stil është shkruar edhe kënga "Ratë ju për Kosovë"[383] e Hydajet Hysenit, me vargjet : "Ratë ju për Kosovën / Ratë ju për liri / Lavdi ju qoftë o lule / Lavdi për jetë lavdi/.

[382] Amanet moj nënë, Liria, nr. 6, 1981.
[383] Të gjitha poezitë gjenden në faqen e 15, të "Liria", nr. 6, 1981.



5. 12. Detyrë e parë e okupuesit - asimilimi i shqiptarëve

Në faqen e fundit të revistës jepet një shkrim ku vë në shënjestër asimilimin e popullit shqiptar në republikën e Maqedonisë. Në shkrimin "Shkolla shqipe në shënjestër të shovinizmit maqedonë"[384], ku thuhej se "Udhëheqja titiste, që krijoi prej leckash

[384] Shkolla shqipe në shënjestër të shovinizmit maqedonë, "Liria", nr. 6, 1981, f. 16.

Federatën jugosllave , pasi ripushtoi tokat shqiptare , filloi të vejë në zbatim bile edhe më me vendosmëri, politikën asimiluese dhe shkombëtarizuese ndaj popullit tonë të filluar që nga kralët serb. Natyrisht , në këtë kuadër, Titoja me shokë u kujdes që edhe klikës shoviniste të Kolishevskit, ti mbetej pjesa " e vëllait të vogël" në tokat shqiptare.

Kështu pa pyetur vullnetin e popullit tonë dhe as gjakun e tij të derdhur, për të jetuar i lirë e i bashkuar u lanë territore të tëra shqiptare nën mëshirën e shovinistëve të tërbuar maqedonë. Për këtë nuk pati kundërshtime as klika shoviniste serbe e Rankoviqit, pasi ishte e bindur se miku i zemrës Kolishevski me shokë, do të tregohej edhe më i papërmbajtur se edhe vetë ai në shkombëtarizimin e sllavizmin e tokave shqiptare. Dhe në të vërtetë ashtu ngjau. Historia dyzetë vjeçare e popullit tonë në Maqedoni, është nga më të trishtueshmet. Mbi popullin tonë në Maqedoni u bënë masakra masive dhe u ushtrua terror i vazhdueshëm policor, me mija shqiptar të pafajshëm, u dënuan dhe u kalbën në burgun famëkeq të Idrizovës e në kapedome tjera. Në nivel republikan u formuan institucione e shtabe të veçanta me qëllim që të përjetojnë pushtetin maqedon në tokat shqiptare[385].

Në shërbim të këtij plani, u shpërngulën me dhunë dhjeta, mija shqiptar dhe në vend të tyre po sillen elemente sllave, nga Greqia e vende të tjera. Masa të jashtëzakonshme janë ndërmarrë e po ndërmarrën kundër kulturës e shkollës shqipe. Dhe po të flasim me gjuhën e fakteve del se mbi 23 mijë fëmijë shqiptar, mësojnë në gjuhën maqedone dhe kjo përbën gjysmën e numrit të përgjithshëm të nxënësve shqiptar, kurse gjysma tjetër mësimin e ndjekin në të dy gjuhët dhe vetëm një pjesë e vogël (kryesisht nxënësit e viseve malore, kanë të gjitha lëndët në gjuhën shqipe), Për absurditete, këtë gjendje, Sekretariati Republikan për shkencë e arsim të Maqedonisë, përpiqet ta shpjegojë me "dëshirën e nxënësve dhe prindërve të tyre, që mësimin ta ndjekin në gjuhën maqedone[386].

Për habi nuk dihet deri më tani ndonjë rast, që fëmija maqedonë , të ketë shprehur dëshirën të mësojë në gjuhën shqipe apo në ndonjë gjuhë tjetër. Në këtë drejtim gjendja paraqitet më kritike në shkollat e mesme e të larta, ku shovinistët maqedonë në pretekstin e "mungesës së kuadrit", të "vëllazërim- bashkimit", "patriotizmit jugosllav" etj, pjesën dërmuese të nxënësve e studentëve shqiptar i kanë detyruar të mësojnë në gjuhën maqedone. Shembull tipik për këtë është Universiteti i Shkupit, në të cilin studiojnë 2365 shqiptar. Nga të gjitha fakultetet e degët që i ka ky universitet vetëm në Akademinë Pedagogjike, dega e Gjuhës Shqipe, për studentët shqiptar mësimi është organizuar në gjuhën amtare. Për këtë arsye si dhe për diskriminimin e gjithanshëm që iu bëhet studentëve shqiptar, para pak kohe u organizua një protestë e fuqishme , nga studentët shqiptar[387].

Gjithashtu edhe standardi jetësor i tyre është shumë i ulët në krahasim me mesataren e studentëve të Republikës.

Nga numri i përgjithshëm i shqiptarëve në këtë universitet, vetëm 489 veta shfrytëzojnë bursë ose kredi, kurse në shtëpitë e studentëve (barakat e mbetura që nga tërmeti i vitit

[385] Po aty.
[386] Po aty.
[387] Po aty.

1963), banojnë 430 studentë shqiptar, prandaj protestat e tyre, nuk përmbanin vetëm kërkesën që mësimi të zhvillohet në gjuhën shqipe por në vetvete ngërthenin shumë kërkesa tjera. Ata gjithashtu shprehnin përkrahje e solidaritet me vëllezërit e tyre në Prishtinë.

Pas ngjarjeve të Kosovës, shovinistet maqedonë, të alarmuar e në panik, nga protestat e fuqishme të popullit, sulmuan frontalisht jo vetëm shkollat shqipe në Maqedoni por edhe historinë, simbolet e figurat tona kombëtare. Goditje të rëndë ka pësuar sidomos edhe pak ai arsim shqip që ishte në Maqedoni. Janë ndryshuar pothuajse rrënjësisht të gjitha plan programet e shkollave shqipe, po ndryshohen shumë libra e tekste mësimore e disa prej tyre janë ndaluar krejtësisht. Aq shumë i ashtë errësuar logjika shovinistëve maqedonë sa t'ia ndalojnë edhe përdorimin e shumë librave shqipe që botohen në Kosovë. Kështu ka ndodhur me librin e historisë të Akademik Ali Hadrit[388], për të cilën janë përgjigjur penalisht, arsimtarët që janë shërbyer me të. Të gjitha tekstet e dyshuara e të ndaluara është vendosur të zëvendësoheshin, me tekste të përkthyera nga maqedonishtja[389].

Në mungesë të librave (sidomos të gjuhës shqipe, historisë e gjeografisë) nxënësit po detyrohen të mësojnë përmes shënimeve.

Në Maqedoni, që nga lufta e këtej janë ndërmarrë masa represive kundër mësim-dhënësve shqiptar dhe inteligjencies përparimtare. Vlerësohet se që nga viti 1946 e deri në prag të demonstratave, në Maqedoni janë burgosur e përjashtuar nga puna mbi 500 arsimtarë shqiptar. Kurse sivjet është bërë një aksion që ka marrë tiparet e një fushate të organizuar shtetërore. Deri më tani, janë arrestuar e larguar nga puna mbi 100 arsimtar shqiptar. Vetëm në komunën e Tetovës, në prag të fillimit të vitit të ri shkollor , u larguan nga puna 18 mësim dhënës, në këtë komunë ky proces po vazhdon edhe më me intensitet të shtuar. Në fshatin Strec u dënuan me burgim 7 arsimtar, pse gjatë vitit të kaluar shkollor kishin regjistruar mbiemrat e nxënësve në përputhje me normat e drejtshkrimit shqip, pa prapashtesën maqedone "ski". Represione ndaj arsimtarëve shqiptar janë ndërmarrë edhe në komunën e Dibrës, Kumanovës, Strugës [390]etj.

Me pretekstin "e lirisë së besimit fetar" me të madhe shovinistët, po inkurajojnë e përhapin religjionin. Kjo ka bërë që një përqindje e madhe e fëmijëve shqiptar të ndjekin shkollat (mejtepet) fetare me të cilat është angazhuar një ushtri e tërë priftërinjsh. Duket paradoksale por në Maqedoninë Perëndimore në këto farë shkolla fetare, ishin përfshirë rreth 25 mijë fëmijë[391].

Goditjet e shovinistëve maqedonë ndaj shkollës shqipe, në të ardhmen do të intensifikohen edhe më shumë. Kjo del qartë nga shumë materiale të Sekretariatit Republikan për Shkencë e Arsim si dhe nga deklaratat nervoze të krerëve republikan, të cilët kërcënojnë për masa të reja dhe shanin e shpifin popullin tonë. Por, populli ynë as nuk frikësohet e as nuk mashtrohet nga armiqtë e tij. Populli shqiptar në Maqedoni[392], me

---

[388] Dr. Sabile Keçmezi-Basha, "Tentimi shkombëtarizues i shqiptarëve", Epoka e Re, 21 prill 2007.
[389] Si shënimi 534.
[390] Po aty.
[391] Po aty.
[392] Po aty.

një guxim të rrallë u ka përballuar shumë stuhive e rrebesheve shoviniste dhe ka një traditë të shkëlqyer në luftën për të drejta e liri. Ai i njeh mirë shovinistet maqedonë e planet e tyre djallëzore dhe do të dijë ti mbrojë drejtat e veta.

5. 13. Rrena për pushtetarët - afinitet dhe kreacion

Po ashtu në fund të gazetës është edhe një reagim që vije nga Kadri Zeka. Në shkrimin "Edhe rrena ka një kufi"[393] bëhet reagim ndaj fjalës së Millosh Miniqit, që e mbajti në mbledhjen e Komitetit Qendrorë të LKJ-së me 18 tetor 1981 ku u shqyrtua e miratua e ashtuquajtura "Platforma politike e LKJ-së për Kosovën". Ai në qendër të vëmendjes për "demaskim", kishte vu deklaratën e Enever Hoxhës në Kongresin e Tetë të PPSH,, lidhur me bisedën e tij që pati me Titon më 1946 rreth fatit të popullit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi. Sipas shkrimit del se çdo fjalë e Millosh Miniqit ishte gënjeshtër e kulluar ngase, Enver Hoxha asnjëherë popullin shqiptar në Kosovë nuk i ka quajtur shqiptar jugosllav, por e vërteta ishte krejt ndryshe, por Millosh Miniqit ajo e vërtet nuk i pëlqente dhe mu për ketë ai edhe i shtrembëron faktet[394].

Për këtë të dhënë më së miri flasin të dhënat që vet Enver Hoxha i shkroi në librin "Me Stalinin ", që është botuar më 1979 dhe decidivisht thuhej "Titoja më pyeti se çmendoja unë për Kosovën, "Kosova dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi, i thash unë, janë toka shqiptare që fuqitë e mëdha padrejtësisht ia shkëputën Shqipërisë, ato i përkasin Shqipërisë dhe duhen ti kthehen Shqipërisë. Tani që ne jemi dy vende socialiste është koha që ky problem të zgjidhet drejtë. Titoja më tha: "Jam dakord, ne e dëshirojmë këtë, por tash për tash nuk mund të bëjmë gjë, sepse nuk e kuptojnë serbet një gjë të tillë", Pra ky pohim i publikuar qysh më 1979, kur Titoja ishte gjallë i demanton të gjitha të dhënat tjera[395], përfundon artikullshkruesi.

6. NJË HISTORIK I DHEMBSHËM I NJË 'LETRE...' I TË BURGOSURVE POLITIK SHQIPTAR NË (C. Z) BURGUN QENDROR TË BEOGRADIT MË 1985

[393] Edhe rrena ka një kufi, "Liria", nr. 6, 1981, f. 16.
[394] Po aty.
[395] Po aty.



Broshura "Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion", u botua në vitin 1986, nga biblioteka "Liria", e organizatës "MLK", dhe ka 146 faqe. Ajo fillimisht ishte ideuar dhe më vonë shkruar në formë letre-protestë nga të burgosurit politik shqiptar: Hydajet Hyseni i dënuar me 15 vjet burg, Zijah Shemsiu, me 13 vjet burg, Bajram Kosumi, 15 vjet burg, Ali Lajçi, 15 vjet burg dhe Gani Koci i cili ishte i dënuar po ashtu me 15 vjet burg. Fillimisht, ky shkrim u pagëzua me emrin "Letër Kryesisë së RSFJ-së"[396], që u shkrua në burgun famëkeq "CZ" (Burgu Qendror) të Beogradit, në prag të katër vjetorit të demonstratave gjithë popullore të Kosovës, 1981.

Sipas parathënies së broshurës, thuhej se gjatë kohës a vuanin dënimin të burgosurit politik shqiptar shpesh nga aty shkruanin letra protestuese, reagime të ndryshme, ankesa që iu dërgonin organeve më të larta shtetërore, personaliteteve udhëheqëse, intelektualëve shqiptarë që bënin fjalë për kushtet e vështira dhe

---

[396] Dr. Sabile Keçmezi-Basha,"Rëndësi e tejkohshme e një dëshmie", "Koha ditore", 8 prill 2006.

keqpërdorimet që u bënin nga ana e organeve të burgut. Bile, kishte shumë raste kur të burgosurit bënin grevë urie ose i përkrahnin të burgosurit e tjerë politik në ndonjë iniciativë që shkonin në favor të tyre. Por të gjitha këto iniciativa e angazhime, që bënin ata, nga ana e pushtetarëve haseshin në vesh të shurdhër. Ato ngelnin në kuadër të të burgosurve, dhe të burgosura së bashku me dëshirat e tyre, se ato askush nga udhëheqësit nuk i lajmëronte, nuk i publikonte dhe tamam puna të depërtonin në mjetet e informimit.Pikërisht, duke e parë këtë gjendje të mos informimit dhe sensibilizimit të gjendjes së tyre të mjeruar dhe padrejtësisht të dënuar, ata morën nismën që të shkruanin një letrën, në formë proteste, vetëm e vetëm për ti sqaruar shkaqet, arsyet dhe karakterin e vërtet të demonstratave të pranverës shqiptare 1981. Në përmbajtjen e saj edhe sot të lexuar nga një distancë dy dykatëshe kohore, vërehet se me sa argumente e fakte prezantoheshin situatat të cilat sollën deri tek demonstratat, dhe se si në mënyrë të drejtpërdrejt protestohej hapur kundër krimeve e reprezaljeve që ishin bërë dhe po bëheshin vazhdimisht ndaj popullatës së pafajshme shqiptare, që në detaje paraqitnin shkaqet kryesore që sollën shpërthimin e demonstratave dhe kërkesat e tyre të drejta. Nga vetë vizioni dhe shtjellimi i problemeve që paraqesin në këtë broshurë "Letër..."[397], shihet qartë se me çfarë njohurish e të dhënash shkencore elaboronin situatën që solli deri tek demonstratat. Një qasje e tillë shkencore, thonë letër-shkruesit edhe pse kishin kaluar shumë vite nuk iu kishte bërë asnjëherë as demonstratave e as kërkesës "Kosova-Republikë". Por, ata gjykonin dhe akuzonin se këtë lloj analize nuk e kishin bërë si duhet as pushtetarët e atëhershëm, që më tepër u merrnin me propagandë (dezinformata) politike se sa me analiza të mirëfillta shkencore.

Dhe, me të drejt mund të konstatojmë, se ndoshta, mu këtu qëndron vlera dhe rëndësia e madhe e kësaj broshure, kur dihej se në çfarë rrethanash dhe kushtesh të pa kushte u shkrua dhe gjeti shtegun për të dal dhe depërtuar në opinionin liridashës "Letra..." e të burgosurve politik shqiptar.

6. 1. Si lindi ideja për tu shkrua letra

Ideja për të shkruar një letër-protestë të të burgosurit politik shqiptar kishte lindur herët, ndoshta posa të burgosurve politik iu kishte shqiptuar dënimi, ose posa ishin takuar në mes veti në qelit e ftohta të burgut. "Letrën..." nga vet përmbajtja e vërejmë se atë e kishin përgatitur gjatë, duke hedhur për çdo ditë nga diçka në të, duke shtuar e hequr me korrektësi çdo gjë që ishte e rëndësishme për historinë dhe për momentin. Për ta përfunduar diku në ditët e para të marsit të vitit 1985, kur edhe iu dorëzua organeve kompetente të Burgut Qendror të Beogradit. Më saktë, letra u dorëzua me 8 mars po të njëjtit vit, ndoshta kjo datë edhe nuk ishte ashtu krejt e rastësishme, ngase përputhej edhe me përvjetorin e katërt të nismës së demonstratave studentore të vitit 1981.

Dhe jo rastësisht, pas dorëzimit të letrës nga ana e të burgosurve politik organeve kompetente, në burg dhe në kreun e saj, u ngrit një "alarm", ku përsëri i tërë mllefi u shpreh te të burgosurit politik shqiptar, dhe menjëherë pas dorëzimit të saj, të burgosurit

[397] Ngjarjet në Kosovë nuk ishin kundërrevolucion, 1986.

politik që ishin nënshkrues të letrës u shpërndan në burgje të ndryshme anë e kënd ish-Jugosllavisë. Dy nga të nënshkruarit u transferuan në Nish, një në Zajeçar, një në Pozharevc, ndërsa Zija Shemsiun e ndaluan në Burgun Qendror të Beogradit[398]. Dhe e tërë kjo nuk ishte aspak befasuese për të burgosurit ngase një gjë të tillë edhe e kishin pritur. Ndërsa me të burgosurin politik Zijan, gardianët e burgut me gjasë kishin edhe disa hesape të pa kryera që iu kishin grumbulluar prejse kishte rënë në burg. Ai me trimërinë dhe guximin e vet kaherë kishte tërhequr vëmendjen e gardianëve dhe hetuesve serbë për qërim hesapesh me të.

6. 2. Masat ndëshkuese ndaj autorëve të letrës

Pas dorëzimit të letrës, organeve hetuese të Burgut Qendror të Beogradit, thuajse iu dha edhe një shkas edhe më i madh për të përdorur tërë arsenalin e dhunës që kishin në dispozicion ata. Për një muaj e më tepër rresht nuk pushuan torturat e metodat më shtazarake që u përdorën ndaj tyre. Mllefin më të madh pa dyshim e shprehen ndaj të burgosurit politik- Zija Shemsiut, të riut nga Perlepnica e Gjilanit, i cili ishte i dënuar me grupin që ilegalisht kishte sjellë armë nga shtetet e Perëndimit për nevoja të ilegales në Kosovë. Ndaj tij përdorën mjetet e metodat më barbare, dhe më 1 maj të vitit 1985 e likuiduan fizikisht. Për vdekjen e tij, arsyetimi ishte i thjesht, (si rëndom kur i mbytnin djemtë tan) se kishte vdekur nga një sëmurje e rëndë në burg. Por, e tërë kjo farsë nuk kaloi tek populli, se ata vetëm ishin të mësuar si i vdisnin patriotët dhe se nga çfarë "sëmurje" vuanin. Edhe pse fizikisht e kishin dërmuar, duhet thënë hapur se po mos të ishte guximi i tij prej një atdhetari të devotshëm sot, nuk do të kishim as këtë broshurë "Letër..." (protestë), në duart tona, që vjen si ushtimë për një kohë të rëndë që e përjetuam. Ai edhe nëpër atë zjarr, edhe nëpër ata dryna e grila arriti që një kopje të kësaj letre, nëpër mes të një burgosuri ta nxjerr jashtë dhe tua dërgoi shokëve të idealit.

[398] Po aty, f. 2.

Zija Shemsiu (1950 - 1985)

Vdekja e atdhetarit Zija Shemsiut u hesht nga organet kompetente, nuk u njoftua opinioni, siç bënte zakonisht në raste të tilla , edhe një arsye tjetër ishte edhe më e madhe se Zija Shemsiut, ata i frikoheshin edhe kur ishte i vdekur.

Ndërsa, ndaj të burgosurve të tjerë, që ishin hartues të "Letrës...", masat ndëshkuese u shtuan, dhe nuk ishin të rralla edhe ndëshkimet kur i qonin në qelit e ftohta e të vetmuar të kalonin muaj të tërë.

6. 3. Përmbajtja e letrës

Në letrën e hartuar nga të burgosurit politik shqiptar: Hydajet Hyseni[399], Zija Shemsiu[400], Bajram Kosumi[401], Ali Lajçi[402] e Gani Koci[403], shkruhet e vërteta dhe vetëm

[399] Hydajet Hyseni sipas aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë: P. nr. 31/82.

[400] Zija Shemsiu me 1984, dënohet me 13 vjet burg (Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut-Beograd, K. nr. 51/84). Pas nënshkrimit të Letrës së lartë përmendur, për një muaj rresht, UDB, përdori mjetet dhe metodat më shtazarake ndaj të burgosurve shqiptar, por ato erdhën në shprehje sidomos ndaj Zijas, të cilin edhe e likuiduan fizikisht mu në festën ndërkombëtare të punëtorëve, më 1 maj 1985.

[401] Bajram Kosumi ishte i dënuar politik, i lindur në fshatin Koretin më 1960, student. Në procesin gjyqësor të gjykatës së Qarkut në Prishtinë, më 1981 u dënua me 15 vite burg të rendë (aktgjykimi, PP. nr. 58/81)

[402] Ali Lajçi, i dënuar politik. Ishte i lindur në fshatin Malaj, komuna e Pejës. Në kohën kur u dënua ishte student dhe kishte 21 vjet. Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 30 gusht 1981 ia shqiptoi dënimin prej 15 vitesh burg të rendë.

e vërteta për ngjarjet historike, për shkaqet dhe arsyet që sollën deri tek demonstratat studentore e më vonë gjithë popullore dhe për kërkesën sublime që lindi në to "Kosovën-Republikë"

"Letra..." fillon se "Po bëhen katër vjet që kur filluan ngjarjet e mirënjohura në Kosovë, katër vjet kur ne me qindra bij të Kosovës, padrejtësisht po mbahemi prapa grilave, dhe po aq kohë që për këto ngjarje për ne dhe për tërë popullin tonë po flitet e po shkruhet zi e më zi"[404] thoshin letërshkruesit.

Por ajo, që i lëndonte më së shumti të burgosurit tan në burgjet anë e kënd ish-Jugosllavisë ishte, kualifikimi që erdhi nga vet pushtetarët shqiptar të asaj kohe, dhe thoshin ata, "se një kualifikim i tillë mund të jetë i nxituar, ngase në histori mund të kalojnë dekada e dekada për të ardhur deri te një e vërtet historike. Dhe si pasojë e këtij kualifikimi, se "demonstratat studentore ishin kundërrevolucionare", me një mënyrë apo tjetër i hapën rrugë prokurorive publike që të ngrehnin aktakuza të shumta , dhe gjykatave të qarqeve iu dhanë mundësi që pikë për pikë të përsërisin vlerësimet e prokurorive, që pa fije turpi e drejtësie të shqiptonin aktgjykime me dënime të rënda për demonstruesit shqiptar, kudo që jetonin ata në ish-Jugosllavi. Dhe nuk ishte aspak e çuditshme se të gjitha këto u bënin në emër të popullit, dhe absurd mbi absurde, populli dënonte bijtë e vet pse donin të kishin Kosovën-Republikë!!![405]

Pjesa më e madhe e "Letrës..." i kushtohet ngjarjeve në Kosovë që të burgosurit politik i kundërvihen me fakte se ato nuk mund të quhen kundërrevolucionare. Për të vazhduar më tej se "Për ngjarjet në Kosovë, për Kosovën dhe për çështjen e saj, gjatë këtyre katër viteve, u fol dhe po flitet me të madhe nëpër forume më të larta partiake e shtetërore, u shkrua dhe po vazhdon të shkruhet pa ndërprerje në mjete të ndryshme të informimit...", për të vazhduar më pas se" por për fat të keq që nga fillimi e edhe sot e gjithë ditën ato po trajtohen në mënyrë të padrejtë, jo objektive, jo shkencore..."[406]

"E dihej", mendojnë letër-shkruesit, se demonstratat studentore të vitit 1981, "ishin më shumë se serioze", për të vazhduar në "Letër..." se "Për çudi as në forumet e ndryshme partiake e shtetërore dhe as në mjetet e informimit atyre nuk iu bë asnjëherë një analizë mos më shumë së paku serioze. Që nga fillimi, ato u vlerësuan dhe u kualifikuan në mënyrë të thjeshtësuar, subjektive, paushallë e disi kuturu".[407] Autorët e "Letrës...", vazhdojnë tutje duke bërë analiza për situatën e rënduar politike për shqiptarët në Kosovë që nga viti 1945 e këndej, për kohën e IB-es, për zhvillimin ekonomik të saj, zhvillimin e arsimit, ekonomisë, shëndetësisë, punësimit, për emigrantët tanë që ishin të detyruar të lëshonin vatrat e tyre, për të shkuar jashtë-në perëndim, për shpërnguljet e mëdha për Turqi, aksionin e armëve, për proceset e shumta gjyqësore-politike e shumë e shumë të tjera .

---

[403] Gani Koci është i lindur më vitin 1958, në fshatin Polac të Skenderajt. Për pjesëmarrje në demonstratat studentore të vitit 1981 dhe të organizimit të veprimtarisë ilegale u arrestua dhe u dënua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 15 vjet burg të rendë (Aktgjykimi , PP. nr. 58/81)

[404] Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundër revolucionare, 1986, f. 23.
[405] Po aty.
[406] Po aty.
[407] Po aty.

Edhe sot, konstatojmë se mund të jetë aktual shkrimi i "Letrës...", kur letërshkruesit thonë se "Gjendja në Kosovë mund të qetësohet e stabilizohet vetëm duke e zgjidhur drejt çështjen e Kosovës, e në kushtet e krijuara, çështja e Kosovës mund të zgjidhet në mënyrë fatlume në radhë të parë duke mbajtur një qëndrim të drejt ndaj kërkesës "Kosova Republikë". Ende i kemi të freskëta, kërkesat dhe parullat kryesore të studentëve që u brohoriteshin rrugëve e shesheve të Kosovës, por ajo kryesorja ndër më kryesoret ishte "Kosova Republikë", madje, siç dihej ajo ishte shtruar edhe para demonstratave, në diskutime e në studime të ndryshme, e bile edhe në biseda të udhëheqjes së Kosovës me udhëheqësit më të lartë të ish-Jugosllavisë. Mbi të gjitha ajo ishte kërkesë e të gjitha grupeve e organizatave ilegale e më vonë u e gjithë popullit shqiptarë në ish- Jugosllavi.

Të burgosurit politik shqiptar vinë në përfundim se "çelësi kryesor për stabilizimin e vërtet të gjendjes në Kosovë është çështja e pazgjidhur e statusit të saj në ish-Jugosllavi. Andaj nuk mund të qetësohet një popull në qoftë se nuk dëgjohet zëri, kërkesat dhe dëshirat e tij. Pa këtë çfarëdo masa që do të përdorën, nga çfarëdo dore e fort, vetëm mund të acarohej plaga e hapur me dekada të tëra" nga e cila edhe sot do të merrnim mësime të vlefshme për të mos përsëritur historinë.

6. 4. Rëndësia e letrës

Tani të flasësh për rëndësinë e letrës, më dukej se nuk do koment, ngase, kjo letër-protestë e të burgosurve politikë shqiptar, iu përballoi dyerve të hekurta, grilave, hetuesve, gardianëve të burgut vetëm e vetëm për të arritur sot tek ne si një gjakim i përgjakur për lirin që aq shumë e deshëm dhe aq shumë sakrifikuan në shekuj gjeneratë pas gjenerate, e brez pas brezi, vetëm e vetëm që të realizohej qëllimi suprem që Kosova të jetë e lirë e sovrane në tokat e saja[408]. Kjo "Letër..."-protestë, nga aspekti historik është një dokument i rëndësishëm që dëshmon për luftën e vazhdueshme të popullit shqiptar në ish- Jugosllavi, për të drejtat, barazinë me të gjithë popujt e tjerë që jetonin në atë shtet-kreaturë, që e quani ish-Jugosllavi.